



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 2 DHE 3 SHKURT 2019**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 02. I 03. FEBRUARA 2019. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR  
2019**

## **Rendi i ditës**

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të agjencive të pavarura,
2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zyrtarët publikë,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pagat në sektorin publik,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122, si dhe Ligjin nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256,
6. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit mbi ndarjen buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019,
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuar me Ligjin nr. 06/L-20 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018,
9. Shqyrtimi i Propozim-Statutit të shoqërisë aksionare Trepça sh. a.

## **Dnevni red**

1. Drugo razmatranje N/zakona o organizaciji i funkcionisanju Državne uprave i Nezavisnih agencija,
2. Drugo razmatranje N/zakona o javnim službenicima,
3. Drugo razmatranje N/zakona o platama u javnom sektoru,
4. Prvo razmatranje N/zakona o zadacima, odgovornostima i nadležnostima Državne delegacije Republike Kosovo u procesu dijaloga sa Republikom Srbijom,
5. Prvo razmatranje N/zakona o izmenama Zakona br.03/L-174 o finansiranju političkih subjekata, izmenj Zakonom br. 04/L-058, Zakonom br. 04/L-122 i Zakonom br. 03/L-073 o opštim izborima u Republici Kosovo, izmenj Zakonom br. 03/L-256,
6. Predlog za formiranje Ad hoc komisije za izradu Zakonika o regulisanju i menadžiranju oblasti penzija i beneficija socijalnog osiguranja,
7. Drugo razmatranje N/zakona o budžetskoj podeli budžeta Republike Kosovo za 2019. godinu,
8. Razmatranje Predlog - odluke Vlade Republike Kosova o produženju budžetskih izdvajanja za februar 2019. godine, definisano Zakonom br. 06/L-20 o budžetu Republike Kosovo za 2018. godinu,
9. Razmatranje Predlog-Statuta akcionarskog društva Trepča a. d.

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2019.

Fillojmë me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

### **1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të agjencive të pavarura**

86 janë deputetë janë aktualisht në sallë.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit për Administratë Publike, zotin Nait Hasani, ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime. Urdhëro, i nderuar kryetar!

NAIT HASANI: Përshëndetje, kolegë të nderuar deputetë!

Përshëndetje, kryetar i Kuvendit,

Përshëndetje, kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Përshëndetje të gjithëve,

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media pas një pune të gjatë, të rëndë, të mundimshme, nën presione të ndryshme të organizatave të ndryshme buxhetore ka mbërritur të amendamentojë pakon e projektligjeve të reformës në administratë dhe agjencive të pavarura.

Komisioni ynë duhet të falënderojë kolegët që kanë marrë pjesë drejtpërdrejt në amendamentimin e këtyre projektligjeve, një falënderim shkon për Imetin, Arbanin, Albertin, Xhevën, Rasimin dhe Shqipen, që dikush më shumë e dikush më pak janë angazhuar ta amendamentojmë, ta plotësojmë dhe të sjellim në seancë Projektligjin për reformën në administratë dhe organizimin e funksionimin e agjencive të pavarura. Në këtë projektligj ka disa amendamente, në organizimin e administratës, që është një nga kërkesat edhe të Bashkimit Evropian, reforma e Administratës Shtetërore dhe e agjencive të pavarura. Qëllimi i këtij projektligji dhe dy projektligjeve të tjera është të organizojë, të rregullojë, të sistemojë një çështje mjaft të rëndësishme në shtetin e Kosovës, ndoshta vjen edhe më e rëndësishme se shumë akte dhe ligje që kanë nxjerrë, ose marrëveshje që ka miratuar Kuvendi i Kosovës. Me këtë, nëse komisioni ka mundur të bëjë punën nën këtë presion që ka pasur, në fund edhe një falënderim duhet t'i shkojë postës, Kuvendit që na ka bartur mjaft letra, shkresa, kërkesa që kanë ardhur nga institucione të ndryshme edhe individë.

Po ashtu, ndoshta ka qenë mirë ato incizimet nganjëherë kur po na bëjnë këto postat të na i sillni, se na duhen për ndonjë shkrim, jetëshkrim, sepse sa telefonata është bërë, sa kërkesa është bërë përmes telefonit, edhe ato duhet pasur. Po, njëherësh të falënderojmë ministrin e Administratës, Mahirin, edhe ai ka qenë bashkërisht me neve, edhe dy zyrtarë të administratës po ashtu, edhe dy zyrtarë të financave.

Unë mendoj që në këtë projektligj komisioni e ka arritur qëllimin dhe kërkoj që të miratohen amendamentet e komisionit. Ndërsa, amendamentet të cilat vijnë jashtë komisionit, nga deputetët, është mirë të mos miratohet ose të mos përkrahen, për shkak se e humbin funksionalitetin e ligjit. Humbja e funksionalitetit të ligjit shkakton pasoja në ligjet e tjera dhe bashkërisht në këto projektligje, atëherë kemi mundësi të kemi një defekt, i cili nuk ka mundësi të realizohet asnjëherë. Mosmiratimi i amendamenteve do të ketë pasoja dhe ngërçe, të cilët do ta prishin krejt sistemin e reformës në administratë dhe të Ligjit për zyrtarët publikë, po ashtu edhe për Ligjin e pagave.

Besoj që edhe ministri ndoshta duhet t'ju drejtohet, por unë po kërkoj që t'i përkrahni të gjitha amendamentet e Komisionit Funksional, sepse ato janë amendamente të inkorporuara të deputetëve, të cilët kanë marrë pjesë me sugjerime, vërejtje, këshilla dhe në të njëjtën kohë, ato janë amendamente të komisionit që do ta realizojë ose do ta mbështesin këtë reformën në administratë. Kjo është për projektligjin e parë, ndërsa duhet edhe për projektligjet e tjera. A duhet veç e veç? Faleminderit!

**KRYETARI:** Veç e veç. Faleminderit, i nderuar kryetar i komisionit. E ftoj zotin ministër Mahir Yagxhillar që ta marrë fjalën në emër të ministrisë.

**MINISTRI MAHIR YAĞCILAR:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Më lejoni që në emër të Qeverisë dhe të Ministrisë së Administratës Publike të shpreh falënderimet për Komisionin për Administratë Publike, për bashkëpunimin gjatë hartimit të amendamenteve.

Të nderuar deputetë,

Këto tri ligje si pako ligjore: Ligji për organizimin e Administratës Shtetërore, Ligji për zyrtarët publikë dhe Ligji për pagat në sektorin publik, janë esenciale për zbatimin e reformave në Administratën Publike. Shfrytëzoj rastin t'ju ftoj që të aprovoni amendamentet e Komisionit Parlamentar të tri ligjeve, që ligjet të jenë më të zbatueshme, me qëllim që të kemi një Administratë Publike më të organizuar dhe më efikase. Edhe një herë faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, ministër Mahir Jaghillar!

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 65 amendamente. Do t'i votojmë, në qoftë se nuk ka reagim, të gjitha 65 amendamentet e propozuara me përkrahjen e Komisionit Funkcional përnjëherë me ngritje dore, në qoftë se nuk ka reagim negativ.

A ka reagim? Vetëm ta ngre dorën, nëse ka reagim. Urdhëroni, zonja Haxhiu, për arsye se seanca në fund vendos.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit! Ne na përcakton edhe Rregullorja e Punës, domethënë mënyrën se si procedohen amendamentet. Ne si grup parlamentar, duke pasur parasysh që kemi qëndrime të ndryshme në disa amendamente, pavarësisht faktit që kanë marrë apo jo përkrahjen e komisionit, ne jemi që secili amendament të vendoset në votim veç e veç dhe jo në pako, dhe në mënyrë elektronike, që të regjistrohen votat e deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

**KRYETARI:** Faleminderit! Zonja Shqipe, a dëshiruat fjalën? Jo! Zoti Zemaj, urdhëroni fjalën!

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, kryetar! Duke marrë parasysh specifikat që i ka vetë projektligji dhe adresimet që janë edhe në publik, qoftë të grupeve parlamentare, qoftë të deputetëve individualisht, kërkoj që votimi të jetë në mënyrë elektronike për secilin amendament veç e veç.

**KRYETARI:** Unë do të veproj ashtu siç dëshirojnë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ajo çfarë dua të them, ne kemi disa pika të rendit të ditës këtu, të cilat janë të seancës së rregullt, në të njëjtën kohë e kemi edhe një seancë për ta vazhduar në bazë të një dakordimi që e kemi pasur për përfundimin e seancës së kaluar. Mendova që dëshironi të keni një dakordim që amendamentet, pasi që janë me përkrahjen e Komisionit Funkcional t'i votoni, por në qoftë se nuk dëshironi t'i votoni, t'i ndani ato e të mos shkojmë një nga një, se do të na marrë shumë kohë. 65 në mënyrë elektronike, por në fund unë i vë në votim si të dëshironi ju. A keni ndonjë alternativë, zoti Krasniqi, t'i ndani ato ku janë diskutabile që mendoni të mos i votoni e të mos i vë të gjitha, por në fund si të doni. Zoti Krasniqi, kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Duhet ta kemi parasysh që edhe pse duket që janë pak në numër pikat e rendit të ditës, së paku janë rreth 400 amendamente sot në total që duhet t'i trajtojmë në disa prej këtyre projektligjeve që janë në lexim të dytë. Unë, për shembull, pikërisht te Projektligji për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe agjencive të pavarura, mendoj që do të mund t'i votonim amendamentet të gjitha bashkërisht, siç ka ndodhur në shumicën e rasteve në këtë Kuvend, për arsye se kanë mbështetjen e Komisionit Funkcional.

Nëse ka amendamente të caktuara, ku një grup parlamentar mund të ketë mendim tjetër ose do ta votojë ndryshe, besoj që secili prej grupeve mund ta specifikojë se për cilat amendamente ka një mendim alternativ dhe të votohet ndaras për ato amendamente. Së paku, besoj te ky projektligj dhe ndoshta te Projektligji për zyrtarët publikë mund të shkojmë kështu, sepse kur të hyjmë te Projektligji për pagat ma merr mendja që duhet të shkojmë një nga një, edhe te Projektligji për buxhetin pa dyshim shkojmë një nga një. Por, së paku nëse do të kishte vullnet te ky projektligji i parë besoj që do të duhej ta votojmë siç i kemi votuar shumicën në këtë legjislaturë, të gjitha bashkërisht, përveç nëse ka ndonjë amendament të caktuar që ndonjë prej grupeve parlamentare ka rezerva. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Shqipe Pantina e ka kërkuar fjalën.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryetar!

Ndonëse, në fakt, këto amendamente janë votuar në komision, megjithatë edhe në komision për disa nga amendamentet vota nuk ka qenë unanime, pra ka pasur votë edhe për, edhe kundër. Natyrisht që shumica kanë votuar për këto amendamente, por unë mendoj që duhet t'u jepet mundësia atyre që kanë votuar kundër, atyre grupeve parlamentare, sepse në komisione ne përfaqësojmë grupe parlamentare, jo mendime tona personale, duhet t'u jepet mundësia që të njëjtët ta bëjnë këtu. Ne, ta zëmë, në këtë ligj janë të paktën 5 amendamente për të cilat kemi mendim ndryshe nga Komisioni i Përhershëm dhe duam që të na jepet mundësia të votojmë për ato amendamente. Nëse duam t'i përmendim cilat janë, ne mund t'i japim për cilat kemi votën kundër, përndryshe i votojmë secilën një nga një.

KRYETARI: Zonja Pantina, a ka mundësi t'i përmendni, t'i pyes edhe grupet e tjera parlamentare, në qoftë se dëshirojnë, ose në të kundërtën shkoj një nga një.

SHQIPE PANTINA: Po! Për shembull, te ligji në fjalë, pra për Administratën Publike ne kemi votë kundër për amendamentet 28, 31, 39, 41, 42, 53 dhe 57.

KRYETARI: Faleminderit! Unë i kam evidentuar, mund t'i vendos këto në mënyrë elektronike. Lëvizja Vetëvendosje dhe LDK-ja, a mund të shkojmë në këtë formë, cilat amendamente apo po insistoni. Atëherë shkojmë drejt një nga një, të mos e komplikoj, për arsye se unë mendova pa ndonjë qëllim të theksuar për amendamente, mendova për kohën. Atëherë shkojmë, përgatitemi për votim në mënyrë elektronike secilin amendament.

Amendamenti 1, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Tash para se të konstatoj, 79 deputetë kanë votuar, të gjithë për.

A mund që në momentin që kalon një amendament, ta quaj vetë kalon, pastaj Administrata e konstaton edhe praninë e votave, që të mos vonohem duke i lexuar të gjitha. Atëherë kalon.

Amendamenti 2. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 3. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 4. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 5. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 6. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 7. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 8. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 9. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 10. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 11. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 12. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 13. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 14. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 15. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 16. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 17. Votojmë tash! Amendamenti 17 nuk i ka marrë votat e mjaftueshme. Edhe një herë e votojmë. Amendamenti 17. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 18. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 19. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 20. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 21. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 22, votojmë tash. Amendamenti 22, teknika është një nga problemet që do të na dalë me këto votime, kijeni parasysh teknikën, e kemi jo në gjendje të mirë. Amendamenti 22, ta keni parasysh, nga arsyet që shpeshherë i ikim, 22. Tash vetëm pak, ta marrë regjia se më duket. 22, votojmë tash. Ju lutem, edhe një herë, s'kam çka bëj. Kalon.

Amendamenti 23. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 24. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 25. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 26. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 27. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 28. Votojmë tash. Kalon.

Amendamenti 29. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 30. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 31. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 32. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 33. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 34. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 35. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 36. Votojmë tash. Kalon.

Amendamenti 37. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 38. Votojmë tash! Kalon.



Amendamenti 39. Votojmë tash! Edhe një herë votojmë tash amendamentin 39, regjia! Në qoftë se mund të presim të nderuar deputetë teknikën. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 40. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 41. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 42. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 43. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 44. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 45. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 46. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 47. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 48. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 49. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 50. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 51. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 52. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 53. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 54. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 55. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 56. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 57. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 58. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 59. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 60. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 61. Votojmë tash! Kanë votuar vetëm 60 deputetë! Nuk e ka... Nuk ka punuar? Atëherë edhe njëherë e votojmë amendamentin 61. Deputetë, e votojmë edhe njëherë amendamentin 61. Votojmë tash! Jemi në amendamentin 61, çdoherë. Kalon!

Amendamenti 62. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 63. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 64. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 65. Votojmë tash! Kalon.

Kaluan të gjitha amendamentet nga numri 1 deri në numrin 65. Tani jemi në votimin e tekstit të projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Regjia dhe deputetët përgatiten për votim. 100 deputetë janë sallë. Votojmë tash!

Urime! 64 deputetë kanë votuar.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të agjencive të pavarura.

## **2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zyrtarët publikë**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Zoti Nait Hasani, kryetar i Komisionit për Administratë Publike, ftoheni ta paraqitni dhe ta arsyetoni raportin me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje edhe një herë!

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal edhe Media e ka shqyrtuar Projektligjin për zyrtarët publikë dhe e ka amendamentuar këtë projektligj. Ka nxjerrë 92 amendamente. Këtu dua ta falënderoj edhe Administratën e Kuvendit, zyrën ligjore dhe koordinatorët e komisionit që kanë qëndruar dhe kanë bashkëpunuar shumë mirë që ta harmonizojmë dhe ta plotësojmë këtë projektligj.

Ky projektligj është mjaft i rëndësishëm për zyrtarët publikë. Me këtë projektligj rregullohet qasja më e mirë e zhvillimit në institucionet e Republikës së Kosovës të bazuar në merita, integritet moral, paanësi dhe qëndrueshmëri.

Mendoj që edhe ky projektligj është i rëndësishëm së veçantë. Bashkë me ligjin që e miratuar, janë ligje të cilat e reformojnë Administratën, dhe në të njëjtën kohë e rregullojnë çështjen e zyrtarëve publikë në shtetin e Kosovës.

Prandaj, çdo amendament i miratuar nga komisioni kërkon përkrahjen, sepse përkrahja e amendamenteve të komisionit e rregullon ashtu siç është paraparë edhe me Administratën, edhe me ministrinë, gjë që ky projektligj ta rregullojë këtë çështje.

Edhe një herë kërkoj mbështetjen e deputetëve dhe përkrahjen e amendamenteve të komisionit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit!

Atëherë, në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 95 amendamente. Do t'i votojmë këto amendamente të propozuara sipas radhitjes së paraqitura në raport nga Komisioni Funkcional. Vetëm se në këtë rast janë 95 amendamente. A dëshironi të shkoni një për një, apo dëshironi 95 përnjëherë?

A e vendos në votim në mënyrë që të vendosin deputetët? Si dëshironi, në pako ose një për një?

Në qoftë se shkon në pako, është po. Një për një është jo. Do të thotë në pako. Deputetët le të kthehen në sallë. Po i presim ne. Frika është koj; edhe te teknika, të mos kemi defekt pastaj që të kthehem të gjitha me dorë prej fillimit. Kjo është.

Përndryshe, edhe me dorë, me dorë. Edhe në qoftë se prishet... Ashtu si punon, ashtu do të jetë. Nëse dëshironi mund ta shikojë edhe ndonjë komision teknikën, por po thonë se ka problem dhe s'mund të garantojnë.

Deputetët le të kthehen në sallë, le të bjerë zilja dhe të votojmë. Për është votimi në pako 95 amendamenteve të këtij projektligji. Kundër dhe abstenim, do të thotë nuk kalon dhe shkojmë në votim një për një. Do të shkojmë prapë derisa punon elektronika në elektronikë, ose me dorë një për një. Nuk do t'i ikim transparencës.

Kisha pasur dëshirë që vetëm ta dijë... Edhe një minutë do të presim, në mënyrë që të mos i lëmë mundësi që të thuhet se deputetë nuk janë në sallë. Kuorumi është me aq sa po e shohim, gjithsesi.

Tash e marrim edhe numrin e saktë. Por, në mënyrë elektronike do të votojmë, jo me dorë. Është një votim procedural.

Atëherë, shkojmë në votim. Kemi të bëjmë me... Edhe një minutë?! Po, po do të presim sa të kërkon. Është shmangie procedurale. Presim derisa të kthehen deputetët. Në momentin kur ta marr shenjën se mund të shkojmë në votim, do të votojmë.

\* \* \*

Të nderuar kolegë deputetë, jemi në votimin e mocionit procedural, votimin në pako, të pakos së amendamenteve të Projektligjit për zyrtarët publikë. Votojmë tash!

85 deputetë kanë votuar. 60 për. Kaloi, është shmangie procedurale. Edhe një herë, gjithmonë jam i varur nga administrata, unë s'i bëj kalkulimet. Në qoftë se dikush ka kontest, ju lutem reagoni, pa e futur në pako. Kaloi!

Atëherë shkojmë, i kemi amendamentet 1 deri 95. Amendamentet e pikës: Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për zyrtarët publikë, me përkrahje të Komisionit Funkcional, regjia dhe deputetët të përgatitemi për votim, votojmë tash!

63 deputetë kanë votuar, kalojnë 95 amendamentet. Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

Regjia, ju lutem, jemi në votimin e Projektligjit për zyrtarët publikë. A mund të votojmë? Votojmë tash projektligjin në tërësi!

62 deputetë kanë votuar. 62 për.

Kuvendi miratoi Ligjin nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë.

### **3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pagat në sektorin publik**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional, zotin Nait Hasani, ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit! Përshëndetje, kryetar!

Kemi një nga ligjet më të rëndësishme, tash për tash, në Republikën e Kosovës, Ligjin për pagat në sektorin publik. Për mua është me rëndësi që ky projektligj të rregullohet dhe të harmonizojë pagat në sektorin publik, atë që e ka miratuar komisioni, kërkojmë që t'i mbështetni. Janë pjesë

më të rëndësishme, tash për tash, që komisioni ka pasur. Komisioni ynë ka pasur presione të jashtëzakonshme në këtë ligj dhe po kërkojmë që ky projektligj që rregullon këtë çështje mjaft të rëndësishme, që për 20 vjet ka pasur një anarki të pagave në Kosovë. Me këtë projektligj bëjmë përpjekje, ndoshta jo më të mirën, por ta rregullojmë, ta zgjidhim, prandaj po kërkoj që ky projektligj të miratohet dhe të gjitha amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional të miratohen. Ka pasur amendamente nga deputetë dhe nga institucione të tjera, shumica e amendamenteve të komisioneve funksionale, që kanë ardhur nga Komisioni për Ligje, Komisioni për Financa dhe Buxhet dhe nga komisionet e tjera dhe nga deputetë të tjerë, janë marrë shumica e amendamenteve dhe janë inkorporuar, mund ta falënderoj Bekim Haxhiun për amendamentin që e ka sjellë, por nuk ka pasur hapësirë të inkorporohet ose të hyjë si amendament për shëndetësi, po e kemi inkorporuar në formën e mundshme të zgjidhjes së atij problemi. Kemi pasur presione nga institucione të ndryshme të shtetit, të cilët kanë tentuar t'i ruajnë apo t'i rritin pagat, po ky projektligj është ai që do të bëjë nivelimin e pagave.

Parimi i këtij projektligji është: “Për punën e njëjtë, pagë e njëjtë”, nëse kjo do të arrihet, ne ia kemi arritur qëllimit me këtë projektligj. Por një fjalë e moçme thotë “ra kjo ditë e u pamë”, pikërisht ra ky Ligj i pagave dhe i pamë interesat e institucioneve për ngritjen, ruajtjen e pagave të tyre. Kjo tregon që të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës kanë tentuar dhe kanë marrë pjesë, në një formë apo në një formë tjetër, me presione që të ndikojnë te komisioni për të ruajtur, rritur pagat e tyre. Unë e falënderoj komisionin që ka mundur të qëndrojë, falënderoj edhe një herë kolegët e mi, edhe Milaimin, që edhe ai ka qenë një nga ata që ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në këtë drejtim. Jemi munduar të jemi të paanshëm, në këtë drejtim na ka ndihmuar edhe çështja e protokollit të shtetit, ligji, ai ligj na ka ndihmuar neve të jemi më objektivë, të nivelojmë dhe t'i rendisim gjithë atë listë të institucioneve, përndryshe nuk kishim mundur të ishim objektiv, për shkak të ndikimeve politike, kërkesave dhe presioneve. Kështu që Ligji për protokollin e shtetit ka qenë ligji bazë që neve na ka ndihmuar të paktën t'i rendisim ata.

Po ashtu, ka qenë një kërkesë e kryeministrit dhe e kryetarit të Kuvendit për uljen e koeficientëve, që nga 12 kanë rënë në 10 dhe kjo ka ndikuar pastaj në ngushtimin e gjithë hapësirës, gjithë koeficientëve, gjithë atyre njerëzve që kanë pasur kërkesa. Mendoj që me këtë projektligj dhe me listën që është e bashkëngjitur, ne ia kemi arritur qëllimit që të paktën t'i nivelojmë, t'u japim meritat secilit ku ka, t'u japim atyre që duhet dhe t'i vlerësojmë edhe institucionet e shtetit për mbrojtjen për sigurinë. Me këtë projektligj e kemi siguruar që edhe Forcat e Sigurisë së Kosovës, edhe Agjencia e Inteligjencës të mos jenë pjesë e kësaj, sepse janë në interes të shtetit, ndërsa Policinë e Kosovës e kemi ranguar po ashtu në vendin merituar, drejtësia po ashtu, të gjitha institucionet e kanë vendin e merituar për punën që e bëjnë.

Prandaj, “për punën e njëjtë pagë e njëjtë”, ky ligj i siguron të gjithë ata, në formën që janë miratuar amendamentet nga komisionit. Çdo ndryshim i amendamenteve, çdo ndryshim apo votim kundër një amendamenti, e çrregullon këtë sistem dhe prapë do ta kemi një gjendje më të

keqe se sa e kemi pasur deri më tash. Prandaj, po kërkoj që të votojmë amendamentet e komisionit me përkrahje, ndërsa amendamentet e deputetëve, të cilët janë inkorporuar, kërkoj që ata t'i përkrahin amendamentet e komisionit, ndërsa deputetët e tjerë që s'kanë mundur të përkrahin ato amendamente, i lus që t'i tërheqin, për shkak se e prishin sistemin e pagave dhe nuk mund ta rregullojnë më asnjëherë. Prandaj, e keni shansin e fundit, ta rregullojmë këtë sistem të pagave, t'u japim vendin meritore dhe të dalim me parimin e njëjtë sikur ka kërkuar edhe Bashkimi Evropian, po ashtu edhe miqtë tanë ndërkombëtarë që për punën e njëjtë, ta kemi pagën e njëjtë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit z. kryetar i Komisionit.

Të nderuar kolegë deputetë, në këtë Projektligj janë propozuar 77 amendamente. Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhitjes të paraqitur në raport. Do të shkojmë edhe në këtë rast në votimin. Në fakt, në qoftë se ka reagime, unë do të shkoj vetëm me ato ku kam dakordancën e deputetëve për t'i futur në pako. Një deri në 11 mund të shkojnë në pako, në qoftë se nuk ka rënie.

Po zonja Haxhiu, fjala për ju!

**ALBULENA HAXHIU:** Edhe në fillim të fjalës kur e nisëm këtë seancë, madje edhe nga deputetë të koalicionit u tha që Projektligji për pagat i ka specifikat e tjera nga dy projektligjet që sapo kaluan. Prandaj, është e nevojshme që këtu të votohet secili, sidomos këtu, secili amendament veç e veç. Pavarësisht nëse janë dy propozime nga Komisioni ose nga deputetët, natyra e këtij projektligji kërkon votë veç e veç të deputetëve të Kuvendit në mënyrë elektronike. Prandaj ky është qëndrimi i Vetëvendosjes, andaj duhet ta konsideroni. Faleminderit!

**KRYETARI:** Po e shoh dhe reagimin e kryetarit të GP të PDK-së, për herë të parë që pajtohen me Lëvizjen Vetëvendosje, edhe nga LDK-ja, po më duket po shkojmë një nga një. Një nga një po shkojmë. Po shkojmë një për një.

Atëherë deputetë zini vendet. Deputetë ju lutem, në qoftë se ka mundësi administrata t'iu hep një mundësi deputetëve të kthehen në sallë. Janë 77 amendamente, edhe një nga projektligjet shumë me rëndësi për shërbyesit tanë publikë, për familjet kosovare. T'iu dalim zot kërkesave të tyre. Ju lutem deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, kthehemi në sallë, votojmë.

Të nderuar kolegë deputetë, jemi në votimin e 77 amendamenteve të propozuara nga Komisioni Funkcional. Sipas radhës së paraqitur do të shkojmë një për një. Përgatituni të votojmë, edhe qëndrimet pastaj i bartni çka i keni.

Atëherë jemi në amendamentin numër 1. Me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, kolegë deputetë zini vendet. Amendamenti numër 1, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 2. Votojmë tash! Teknika po thonë deputetët po votojmë, por ta provojmë edhe një herë, se teknika na lajmëron po të ketë vështirësi. Atëherë edhe një herë ne e vendosim për faktin se nuk mund të konsiderohet votim. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 3. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 4. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 5. Votojmë tash! Amendamenti 5 nuk ka kuorum të mjaftueshëm. Edhe një herë votojmë. Amendamenti 5. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 6. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 7. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 8. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 9. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 10. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 11. Votojmë tash. Jemi te amendamenti 11, regjia, të lutem, në qoftë se kur është gati. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 12. Janë dy propozime, në bazë të praktikës së deritanishme, dy propozimet në votim. Zonja Haxhiu, ta bëj një herë Komisioni FunkSIONAL, pastaj kur ta bëj tuajën, nëse dëshironi mund të flisni para se të votojmë. Mundesh edhe tani nëse dëshironi, e ke fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Atëherë amendamenti i propozuar ka të bëjë me shtesën për rrezikshmëri për jetën për Shërbimin Korrektues, përkatësisht për gardianët. Dhe, duke e pasur parasysh që Komisioni FunkSIONAL e ka përfshirë shtesën e posaçme për shkak të rrezikshmërisë për gardianët, atëherë unë tërhiqem nga ky amendament, sepse tashmë ajo është e përfshirë.

Ndërsa, për koeficientët dhe në pjesën tabelare që gardianët, Shërbimi Korrektues të vendoset sikur Policia, e kam amendamentin më poshtë dhe pastaj do ta arsyetoj sërish. Faleminderit!

KRYETARI: Në rregull është! Kjo është e jashtëzakonshme të merret vesh pozita me opozitë në këto rrethana! Armend, fjala për ju.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Vetëm të saktësohet, ndoshta edhe sponsorizuesi edhe ministri duhet ta përcaktojë se ku gjendet Shërbimi Korrektues. Edhe në pjesën e parë të ligjit duket që është rregulluar, por lë dykuptimësi, sepse nuk tregohet koeficienti se në cilën kategori është Shërbimi Korrektues. Po flas për stafin e ulët, jo vetëm për ata që kanë gradë edhe brenda Shërbimit Korrektues.

Kështu që edhe ministri ta saktësojë se a janë në kategori të njëjtë me Policinë e Kosovës, apo kanë statut të njëjtë, por me koeficientë të ndryshëm.

Personalisht kërkoj që të jenë të barabartë, duke e marrë për bazë rolin dhe detyrat që i kryen Shërbimi Korrektues në Republikën e Kosovës.

KRYETARI: Zonja Haxhiu ndërkohë edhe një herë e kërkoi fjalën, e pastaj shkojmë drejt votimit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit! Me çështjen që e përmendi zoti Zemaj, ka kohë që jemi duke u marrë, edhe si komision, edhe si grup parlamentar, sepse është tepër e rëndësishme që Shërbimi Korrektues të jetë i përfshirë në klasën e njëjtë sikur është Polica e Kosovës.

Ky amendament është më vonë te pjesa tabelare, mirëpo në kohën kur është propozuar amendamenti, Sindikata e Shërimit Korrektues nuk ka qenë në dijeni që koeficienti për policët mund të rritet nga komisioni për Administratë, që ne e mbështesim si grup rritjen e koeficient.

Prandaj, duke pasur parasysh ndryshimet që i ka bërë komisioni për Administratë, kjo nënkupton që kur të vijmë tek amendamenti që flasim për koeficientët dhe për përfshirjen e Shërbimit Korrektues, duhet të bëhen ndryshime në seancë për shkak të rrjedhave që kanë ngjarë.

Prandaj, po them që aktualisht kjo ka të bëjë vetëm me shtesat për rrezikshmëri, dhe duhet të mbështeten dhe pastaj kur vijmë te pjesa tjetër sërish e arsyetoj amendamentit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka po e shoh e ka kërkuar fjalën për amendament.

MILAIM ZEKA: Kryetar, meqenëse jam anëtar i komisionit të këtij ligji, nuk po dua këtu të polemizoj dhe të hap debate, por po flas, atje e kam prezantuar Nismën.



Të gjithë deputetët edhe të Vetëvendosjes, edhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës, edhe të gjithë deputetët edhe të PSD-së, jemi dakordur dhe çdo amendament ka kaluar me qëndrime dhe vota unanime.

Të hyjmë tash ne për hir të votave këtu që të kallëzojmë se kush çka ka folur atje, janë transkriptet dhe kategorinë që i kemi mbështetur më së shumti janë pikërisht gardianët e burgjeve, zjarrfikësit dhe kategoritë e ulëta.

Prandaj, unë nuk kisha dashur që të hapen shumë debate, por ta vazhdojmë votimin, sepse pastaj hapet një debat shumë i keq. Disa janë përpjekur që të marrin merita në emrin e komisionit grupacionet, partitë e ndryshme politike.

Qëndrimi im dhe i zotit Nait Hasani, edhe i Imet Rrahmanit, së bashku me zotin Abrashi, edhe Rasim Selmmanaj, edhe Xheva, edhe Shqipja, edhe Valon Ramadani, edhe baca Adem, të gjithë kemi punuar me seriozitetin më të madh dhe kemi qenë unik në mendime, në veprime dhe në votime.

**KRYETARI:** Shkojmë në votim. Ka tërheqje të amendamentit. Nuk janë dy propozime, tani është Komisioni FunkSIONAL.

Regjia dhe deputetë jemi në amendamentin 12. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 13, me përkrahje nga Komisioni FunkSIONAL. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 14. Votojmë tash! Kalon.

Jemi te amendamenti 15. Po e shoh se po hapet debat, i cili ka të bëjë me kategoritë. Është legjitime edhe çështja e lobimit për vota.

Por, ajo çfarë do të bëjë tash, në këto propozime që të jem më i drejtpërdrejtë: propozuesi i cili e ka dhënë propozimin, edhe kryetari i komisionit, më tutje nuk do të shkojë do të futem në debat. Ta keni parasysh për çdo amendament. Për arsye se nuk mund ta hap tash seancën dhe ta shndërrojmë në luftë elektorale.

Komisioni e ka kryer punën e vet në mënyrë të shkëlqyeshme. Propozimet janë në seancë. Propozuesi e thotë fjalën e vet. Kryetari i komisionit në qoftë se e kërkon fjalën ia jap dhe e mbylлим me kaq.

Atëherë, shkojmë në amendamentin e 15. Kemi dy propozime; Komisioni Funkcional dhe deputetja Albulena Haxhiu e ka dhënë një propozim pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. A dëshironi zonja deputete paraprakisht? Urdhëroni, fjala për ju.

ALBULENA HAXHIU: Së pari, ne e mbështetim Komisionin Funkcional, sepse ka të bëjë me zjarrfikësit në operacione të rrezikshme. Por, problemi qëndron që gabimisht i kanë futur dy amendamente që kanë komplet qëllim të ndryshëm. Për shembull, amendamenti im flet për shtesat e posaçme për zyrtarët e Administratës që punojnë në institucionet e drejtësisë.

Besoj, ministri i Drejtësisë tash edhe mund të na njoftojë, sepse kërkesat e punëtorëve të Administratës së institucioneve të drejtësisë nuk janë përfshirë askund. Prandaj, qëllimi i amendamentit ka qenë, që të paktën të kenë shtesa të posaçme për shkak të natyrës së punës që kanë. Prandaj, është gabim procedural në qoftë se amendamentit 15 i vihen dy propozime që janë komplet të kundërta.

E para e komisionit ka të bëjë me zjarrfikësit që ne si grup e mbështetim, ndërsa e dyta siç po e shihni ka të bëjë me zyrtarët në institucionet e drejtësisë, të cilët ushtrojnë funksionet në këtë institucione.

Në korrik, prej 6 korrikut deri më 11 korrik ata kanë qenë në grevë. Besoj që secili prej jush e dini. Pastaj, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, ministri i Drejtësisë...

KRYETARI: Zonja deputete, të kisha lutur që të koncentrohesh në temë... Kjo ka të bëjë me votim, nuk është fushatë elektorale. Edhe në fund mbase nuk e votoni hiç, pastaj vetëm na maltretoni edhe tri ditë.

ALBULENA HAXHIU: Jo, duhet të ndahet amendamenti, sepse nuk janë të ngjashme. Ndoshta kjo për shkak të urgjencës që është kërkuar. Janë bërë edhe gabime të tilla që unë mund t'i kuptoj për shkak se administrata ka qenë nën presion të kohës. Faleminderit!

KRYETARI: Unë do ta edhe në votim për faktin se amendamentet janë të ndara. Amendamenti 15, propozimi a, me përkrahje të Komisionit Funkcional. Votojmë tash!

Faleminderit! 83 deputetë kanë votuar, 82 për, 1 është abstenim.

Tani e kemi variantin e dytë. Ju lutem, unë isha edhe më herët i qartë. Rregulloren as për ju e as për askënd nuk e kam ndërmend ta ndërroj. E kemi një përvojë të përbashkët mbi 4-vjeçare. Jemi në vitin e pestë. Atyre procedurave do t'u shkojmë një për një, vetëm mos abuzoni që të vonohemi.

Amendamenti 15, varianti i deputetes Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Rezultati: 70 deputetë kanë votuar, 24 për, 40 kundër, 6 abstenime. Zakonisht e dini edhe rregullin, por edhe një herë po e them për hir të rasteve të tjera. Ai i cili merr më shumë, kalon ai amendament. Në këtë rast ka kaluar amendamenti 15, varianti a, i cili e ka përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Shkojmë te amendamenti 16, deputetja Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zonja deputete, fjala për ju!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ne sapo votuam që zjarrfikësit ta kenë shtesën e posaçme për rrezikshmëri. Ky ka qenë edhe qëllimi i amendamentit. Duke e pasur parasysh që ne tashmë e votuam, unë tërhiqem nga ky amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Është tërhequr amendamenti 16, s'ka nevojë fare ta vëmë në votim.

Amendamenti 17, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 18. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 19, deputetja Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Urdhëroni, zonja deputete.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Amendamenti në fjalë është si në vijim: FunkSIONARI publik nuk përfiton shtesa tjera mbi pagën bazë, me përjashtim të shtesës së posaçme për anëtarët e Kuvendit Komunal siç parashihet në nenin 12 të këtij ligji. Pra, qëllimi i këtij amendamenti është që të mos ketë shtesa për funksionarët.

Ta zëmë, deputetët e Kuvendit të Kosovës, përveç pagës bazë, marrin shtesa edhe në komisione parlamentare. Marrin shtesa edhe për seancën parlamentare. Prandaj, ne kemi propozuar që këtë shtesë ta kenë vetëm anëtarët e Kuvendit Komunal, për shkak se kanë një herë seancë. E kanë edhe një komision, Komisioni për Punë dhe Financa (KPF) që paguhet 50 euro, 1 seancë 200. Prandaj, paga për ta është e vogël, por natyrisht me këtë projektligj këtyre u është rritur koeficienti.

Qëllimi është që vetëm për deputetët, funksionarët publikë, ku hyjnë edhe deputetët e Kuvendit, t'u hiqen shtesat dhe ta kenë vetëm pagën bazë. Faleminderit!

KRYETARI: Votojmë tash! Votoni, ju lutem! Amendamenti 19, deputetja Albulena Haxhiu, pa përkrahje të Komisionit Funksional. Votojmë tash. Vetëm pak!

63 deputetë, 23 për, 36 kundër, 4 abstenime. Nuk kalon!

Amendamenti 20. Dy propozime, Komisioni Funksional dhe deputetja Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Zonja deputete, fjala për ju.

ALBULENA HAXHIU: Kjo lidhet me diskutimin që e pata më përpara, pra propozimi është që deputetët nuk përfitojnë shtesa të tjera mbi pagën bazë, sepse nenet e Ligjit për pagat lidhen me shtesat, pastaj me emra të përveçëm në këtë rast, me funksione siç është rasti i deputetëve dhe ky është qëllimi i këtij amendamenti.

Pra, që deputetët të mos përfitojnë shtesa mbi pagën bazë.

KRYETARI: Atëherë, ne do të shkojmë dhe dy amendamentet do t'i votojmë ndaras. Në rend të parë amendamenti 20, votohet varianti a, me përkrahje të Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Ky është rezultati për mbamendje: 63 deputetë kanë votuar, 62 për, 2 ishin abstenime.

Jemi tek amendamenti 20, propozimi i zonjës deputete Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Në bazë të këtij rezultati të konstatuar kalon amendamenti 20, propozimi i Komisionit Funksional.

Amendamenti 21.

Deputetja Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Urdhëroni, zonja deputete!

ALBULENA HAXHIU: Duke pasur parasysh që dy amendamentet më përpara që lidhen me shtesat mbi pagën bazë nuk kaluan dhe është fatkeqësi, për faktin se besoj që edhe me koeficientin siç është propozuar, paga e deputetit është goxha e madhe me koeficient 8, nëse nuk gaboj, që i bie 2000 e sa euro, nuk ka nevojë për shtesa.

Prandaj, qëllimi ka qenë që, në qoftë se deputetët kanë pagën bazë, atëherë ka lindur pyetja ose shqetësimi se ata nuk shkojnë në seanca për shkak se e kanë pagën bazë dhe e marrin. Dhe, qëllimi i këtij amendamenti ka qenë që pastaj Kryesia me vendim vendos që nëse deputeti nuk merr pjesë në seanca dhe në komisione, t'i zbritet nga paga bazë.

Dhe, duke pasur që dy amendamentet e tjera nuk kaluan, amendamentet 21 dhe 22 nuk kanë kuptim. Prandaj, edhe nuk ka nevojë që të vendosen fare në votim. Faleminderit!

KRYETARI: U tërhoq edhe kjo, e kam pritur prej juve se do t'ia ulni vetes pagën.

Amendamenti u tërhoq, do të thotë, të dy u tërhoqën, edhe 22.

Amendamenti 23.

Me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 24. Votojmë tash!

Regjia, ju lutem. Jemi te amendamenti 24, kërkoi falje publikisht prej regjisë. Te amendamenti 24, votojmë tash!

Amendamenti 24, ju lutem, se janë të gjitha, të keni parasysh, të mos ju konfuzoj. Tabela është 23 deri 34, po jemi vetëm për 24 duke votuar. Kalon.

Amendamenti 25. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 26. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 27. Votojmë tash!

Ky është rezultati, edhe një herë do të votojmë.

Amendamenti 27.

Me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 28. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 29. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 30. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 31. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 32. Votojmë tash!

Edhe një herë, ju lutem, amendamenti 32.

Votojmë edhe një herë në mënyrë elektronike, votojmë tash.

Kalon.

Amendamenti 33. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 34. Dy propozime, atëherë ju lutem, dy propozime. Është një propozim nga Komisioni FunkSIONAL, me përkrahje, dhe varianti i dytë është nga deputetja Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Zonja deputete, fjala për ju!

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

Ky amendament ka të bëjë me mosndëshkimi e pagesave të mësimdhënësve, të cilët janë pranuar në punë kur ka qenë në fuqi një Udhëzim tjetër administrativ. Meqenëse Komisioni FunkSIONAL, sa po shoh e ka propozuar të njëjtën, domethënë e kanë marrë parasysh kërkesën që unë kam bërë, e tërheq këtë amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Do të thotë, jemi duke votuar vetëm propozimin e Komisionit FunkSIONAL, amendamentin 34.

Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 35.

Janë katër propozime, secilës i shkojmë një nga një. Do t'i jap fjalën secilit propozues, pastaj kur futemi në proces të votimit, e votojmë një për një dhe mbledhim rezultatin se cili kalon.

Një, janë katër propozime, do të thotë, janë: një është e Komisionit FunkSIONAL, dy është e Arbërie Nagavcit, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL; tre është e deputetëve Bekim Haxhiu, Fatmir Xhelili dhe Xhevahire Izmaku, po ashtu pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL dhe katër është deputetja Donika Kadaj Bujupi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Do të shkojmë me rend në bazë të radhitjes, ashtu edhe do t'i vendos në votim.

Zonja deputete Nagavci, fjala për ju. Naiti, në qoftë se synon kryetari i komisionit, fjalën e ka. Urdhëro Nait Hasani!

NAIT HASANI: I nderuar kryetar!

Komisioni ka vendosur që ky paragraf të fshihet, prandaj nuk ekziston ky paragraf, ky nen. Amendamentet që i kanë bërë, i kanë bërë nën nenin që ne e kemi fshirë, kështu që nuk është ky nen që mund të llogaritet më tutje.

Prandaj, po kërkoj që anëtarët t'i tërheqin amendamentet.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit! Unë kam dorëzuar këtë amendament më 8 nëntor të vitit të kaluar dhe ka të bëjë pikërisht me koeficientin e pagës për mësimdhënësit, për personelin në sektorin e arsimit dhe ka qenë e kërkuar, domethënë e llogaritur që punëtorët, gjegjësisht nëpunësit e sistemit të arsimit të kenë një pagesë 20% më të lartë se sa ai që është i përcaktuar në shtojcën numër një të bashkangjitur kësaj. Është pikërisht ajo për të cilën dje u dha lajmi që po jepet për mësimdhënësit dhe u sakrifikuan tri javë të plota për nxënësit dhe mësimdhënësit bënë grevë.

Kështu që mua më vjen mirë që tashmë është arritur të miratohet kjo dhe e tërheq propozimin.

KRYETARI: Faleminderit, zonja deputete! Bekim Haxhiu, në emër të grupit të deputetëve, varianti i tretë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Edhe kryetari i komisionit, zoti Hasani, e tha që e ka inkorporuar dhe e ka rregulluar këtë çështje.

Po e marr fjalën edhe për këtë nen, do të thotë amendamentin 35, edhe 36, do të thotë, por do të kërkoj vëmendjen tuaj te amendamenti 41, ku do ta kërkoj votën për një çështje pak më vonë do të jetë, po edhe 35, edhe 36 nuk kanë nevojë të dalin në votim.

KRYETARI: Do të thotë, tërhiqet amendamenti edhe i tretë, po në të njëjtën kohë edhe 36, variacioni i dytë.

Atëherë zonja Donika Kadaj Bujupi, fjala për ju.

DONIKA KADAJ BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Meqenëse komisioni e ka marrë parasysh dhe koeficienti i pagës bazë do të jetë 30% më i lartë bazuar në ligj, atëherë edhe unë e tërheq këtë amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Shkojmë në votimin e amendamentit 35.

Propozimi i Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!

Kalon.

Të tjerat propozime, do të thotë, janë tërhequr.

Amendamenti 36.

Ka vetëm një propozim, pas tërheqjes së grupit të deputetëve, në emër të tyre Bekim Haxhiu ka folur. Është vetëm amendamenti 36 i Komisionit FunkSIONAL.

Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 37.

Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash!

Ju lutem, votoni amendamentin 37.

Kalon.

Amendamenti 38. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 39. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 40. Votojmë tash!

Presim regjinë, çështje teknike është.

Jemi te amendamenti 40, regjia.

A ka mundësi të na e ndërroni tabelën te amendamenti 40, për votim jemi. Ka vështirësi teknike, të presim, në moment që kthehet tabela, jemi në votimin e amendamentit 40, regjia.

Votojmë ndërkohë me dorë, amendamentin 40, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, derisa të presim. Kush është për, me ngritje dore.

Amendamenti 40, kush është për? Administrata, ju lutem, të mos vonohemi. Shumica janë. A ka dikush kundër? Abstenim.

Atëherë, kalon amendamenti 40.

Amendamenti 41.

Regjia, a mund të kthehemi në tabelë edhe një herë, apo ka bllokadë.

Është një amendament i propozuar nga deputetët Bekim Haxhiu, Fatmir Xhelili, Xhevahire Izmaqu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Bekim Haxhiu, urdhëro!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kërkoj nga ju që ta mbështesni amendamentin 41, i propozuar nga unë dhe deputetët Xhevahire Izmaqu dhe Fatmir Xhelili, sepse rregullon pagat e personelit shëndetësorë që punojnë në SHSKUK dhe ata që janë mësimdhënës në Fakultetin e Mjekësisë. Propozohet që mësimdhënësit që punojnë në SHSKUK të marrin një pagë të unifikuar, jo ashtu si marrin deri më sot, një primare dhe një sekondare, për një punë të integruar, të cilën e bëjnë ata, të ofrimit të shërbimit shëndetësor, të praktikës klinike, mësimdhënies dhe shkollimit specialistik.

Aktualisht këta marrin një pagë primare në Fakultetin e Mjekësisë dhe një sekondare në SHSKUK.

Unë kam propozuar me kolegët e mi që kjo të jetë një pagë e unifikuar, prandaj ky amendament ka të bëjë me atë.



Amendamentin të cilin e kam propozuar është 17 faqe dhe respekton dhe vlerëson përgatitjen profesionale, thirrjen shkencore dhe akademike për të gjithë profesionistët shëndetësorë pa dallim, po e them edhe një herë, po e përsërisë për të gjithë profesionistët shëndetësorë pa dallim. Komisioni i Administratës Publike nuk e ka vlerësuar këtë dhe kërkoj, ashtu si ka vlerësuar përgatitjen profesionale dhe shkollimin të mjekëve, stomatologëve, farmacistëve, psikologëve klinikë, fizioterapeutëve, logopedëve, ergoterapeutëve, të bëhet e njëjta edhe për infermierët dhe mamitë, të cilët nuk janë marrë në këtë rast në shqyrtim dhe janë diskriminuar.

Të nderuar anëtarë të Komisionit Parlamentar,

Infermierët dhe mamitë nuk po kërkojnë zbritje të koeficientëve për të tjerët, po kërkojnë vlerësim të përgatitjes shkollore të cilën ata e kanë bërë, sepse sistemi shëndetësor nuk është ai i para viteve '30-ta, por është një sistem i bazuar në organizimin e Organizatës Botërore të Shëndetit dhe këtë po kërkojnë ata të vlerësohet bazuar në shkollimin që kanë bërë, sepse atëherë pse i kemi hapur këto drejtime universitare për këto kategori, kur nuk ua vlerësojnë përgatitjen shkollore.

Gjithashtu, krejt pasi e kam fjalën në fund, dua t'ju falënderoj juve, kryetar dhe kryetarin e komisionit, zotin Nait Hasanin, ministrin e Financave, kryeministrin gjithë për arritjen e marrëveshjes që keni bërë me mësimdhënësit, e përkrahim atë, duke marrë për bazë që është llogaritur përgatitja e tyre akademike dhe shkollore, po e njëjta gjë po kërkohet edhe për profesionistët shëndetësorë.

Po gjithsesi kam kërkesë që e njëjta të bëhet edhe për shërbyesit civilë, ajo rritja 0,20, të cilën ata e kanë kërkuar, sepse janë shtylla e administratës së shtetit, prandaj po kërkoj që e njëjta gjë të vlerësohet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kryetari i Komisionit ka kërkuar fjalën, ka të bëjë me propozimin. Urdhëroni!

**NAIT HASANI:** Faleminderit, kryetar!

Komisioni e ka vlerësuar drejt kërkesën dhe amendamentin e deputetit. Kemi dalë pa përkrahje, për shkak që kemi pasur takim konsultativ edhe me ministrin e Financave, ministrin e Arsimit, ministrin e Shëndetësisë, edhe ne kemi bërë një pagë të integruar në formën si ka qenë, me 30% nga puna bazë ku punohet. Ndërsa ky amendament ka shkuar pa përkrahjen e komisionit, sepse në këtë sistem të pagave nuk mund të realizohet.

Prandaj, nëse një sistem tjetër ka mundësi, po në këtë sistem jo, prandaj kërkoj që të përkrahet amendamenti, domethënë të mos përkrahet kjo, se është pa përkrahjen e komisionit, sepse e çrregullon krejt sistemin e pagave në sistemin e shëndetësisë.

Unë e falënderoj për angazhimin, për punën, është një punë e mirë që e ka bërë, po në këtë aspekt, në këtë fushë nuk ka mundur të gjejë vend. Prandaj, komisioni ka vlerësuar që nuk mund të realizohet dhe nuk e ka përkrahjen e komisionit. Prandaj, ta votojmë kundër që ta plotësojmë kërkesën e ligjit, që është me profesorët shëndetësorë, ose mjekët që punojnë nëpër universitet do ta kenë 30% të pagës shtesë nga paga bazë atje ku e marrin.

Prandaj, është e realizuar, është në ligj, kështu që kjo është duplikim nëse votohet, kjo do të thotë do të prishë balancën e ligjit më tutje. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Shkojmë në votim!

Amendamenti 41.

Kemi qëndrime, Komisioni FunkSIONAL nuk e ka përkrahur, votojmë tash!

Ju lutem, veç pak, ka gabim diçka, veç pak.

A ka mundësi të kthehemi edhe një herë.

Amendamenti 41, regjia.

Është amendament i propozuar nga deputetët Bekim Haxhiu, Fatmir Xhelili dhe Xhevahire Izmaku, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Regjia, a jemi në rregull në mënyrë elektronike, vetëm pak të marr konfirmimin, votojmë tash!

Nuk kemi numër të mjaftueshëm të votave, duhet të kemi numër të mjaftueshëm të votave.

Duhet edhe një herë ta vëmë në votim.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, amendamenti 41 duhet të kalojë 61 vota, po, jo, është çështje juaja. Votojmë tash!

Nuk kalon. 64 deputetë kanë votuar, 15 për, 40 kundër, abstenime sa ishin? Nuk kalon.

Amendamenti 42. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 43.

Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 44.

Regjia, votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 45. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 46. Votojmë tash!

Ndërpritet procesi i votimit, kryetari i grupit parlamentar çka ka?

Amendamenti 46, pati reagim? Urdhëro, zoti Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryetar!

E mora fjalën, edhe pse po flas, pas konsultimeve me kolegët e koalicionit, por edhe një pjesë të opozitës. 46, 47, 48, këto tri amendamente kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike. E keni parë që prej dje ka pasur njëfarë paqartësie për këtë çështje, edhe pse ne parimisht kemi besuar dhe mendojmë që duhet të ketë njëfarë rregullimi, njëfarë limiti apo tavani për sa u përket shpenzimeve që ndërlidhen me pagat. Megjithatë, besojmë që edhe teksti si ka ardhur nga Qeveria, i cili u lejon hapësirë komisioneve ndërministrare për ndërmarrjet publike që t'i përcaktojnë pagat minimale dhe maksimale varësisht prej mundësive financiare, por edhe profitabilitetit që e gjenerojnë ndërmarrjet publike, ne besojmë që do të duhej ta lëmë mundësinë ashtu siç ka qenë në propozimin e Qeverisë.

Rrjedhimisht, i bie që nenet 46, 47 dhe 48 të votohen kundër, në mënyrë që të mbetet ai tekst. Kjo në asnjë mënyrë shpresoj që nuk duhet të kuptohet nga askush prej nesh si mosvlerësim i punës së komisionit apo i propozimit të tyre, por thjesht duke pasur parasysh situatën, në të cilën i kemi ndërmarrjet publike, edhe rrezikun që do të mund të ballafaqohet me stafin profesional, para së gjithash, ta zëmë me inxhinierët, të cilët sot i kemi qoftë në KEK, në Telekom, në ndërmarrje të tjera dhe me rrezikun që pastaj mund të ketë që ata ta lënë sektorin publik për sektorin privat, sidomos kur tash po flasim edhe për privatizime, e kështu me radhë, konsideroj që do të ishte së paku për periudhën e parashikuar në të ardhmen mundësi më e mirë që të kemi insentiva, ashtu siç i kanë, në mënyrë që të mos degradohet potencialisht niveli i përgatitjes profesionale dhe i potencialit profesional që ekziston në këto ndërmarrje. Andaj, le të deklarohen edhe grupet e tjera, por unë po flas këtu pas konsultimeve me kolegë që nenet 46, 47 dhe 48 t'i votojmë kundër, jo si kundërshtim ndaj punës së komisionit, po e përsëris, po thjesht për ta lënë mundësinë ashtu siç ka ardhur teksti i draftligjit nga ana e sponsorizuesit. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Nait Hasani, kryetar i komisionit, e ka kërkuar fjalën, pastaj grupet parlamentare e thonë qëndrimin e vet.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar! Propozuesi i ligjit është Qeveria e Kosovës, Ministria e Administratës, paragrafi 1 i nenin 26, thotë: “Organet kolegjiale drejtuese të ndërmarrjeve publike me kapital mbi 50% shtetëror”. Në paragrafin e Qeverisë është: “Ato ndërmarrje që i financon nga buxheti i shtetit”, në amendamentin tonë që kryetari i grupit po e kundërshton, është niveli i pagave të punonjësve të tyre të caktuar nga Qeveria brenda koeficientit 1 minimal dhe koeficientit 7 maksimal sipas vlerës së koeficientit. Ky amendament ka të bëjë me ngritjen e cilësisë, me angazhimin në punë të ndërmarrjeve publike, pikërisht sepse ato janë financuar mbi 50% nga shteti.

Prandaj, çdo ndërmarrje publike e financuar mbi 50% nga shteti duhet të ketë koeficient të pagave, përndryshe nuk ka arsye ato të jenë jashtë ligjit. Ndërmarrjet publike që kanë mbi 50%, ato e organizojnë vetë sistemin e pagave, ato bëjnë pagat sipas buxhetit të tyre. Prandaj, po

kërkoj që amendamentet 46, 47, 48 dhe 49 të votohen pikërisht sepse këto e rregullojnë edhe nivelin e pagave për ndërmarrjet publike që financohen nga shteti, jo për ndërmarrjet e tjera që nuk financohen. Përndryshe, do të kemi paga me rregullore, vendime që do të shkatërrojnë dhe do të bëjnë militantë të partive nëpër të gjitha këto organizata buxhetore. T'i ikim kësaj, t'i votojmë këto amendamente, ta rregullojmë këtë çështje, edhe për ndërmarrjet publike, të cilat kanë kapitalin mbi 51% nga Qeveria ose nga shteti.

**KRYETARI:** Faleminderit! Ka të bëjë me amendamentet 46, 47, 48, shumë mirë, qëndrimet e grupeve parlamentare, pastaj votën e keni, është vota e lirë. Do të shkojmë, Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën, nga një i grupit parlamentar le ta kërkojnë fjalën.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit! Po parafrazoj, kryetar, atë që e thatë ju, sepse nuk e kuptuam tash a ke fushatë kjo a ke propozim korrekt, por ajo çka u tha në fillim po lë një lloj dyshimi edhe në këtë propozim, sepse pikërisht ju u drejtuat që komisioni edhe anëtarët e pozitës thanë që kanë bërë një punë të mirë, janë munduar që t'i harmonizojnë qoftë edhe këtë tavanin e pagave. Por, interesant reagimi i PDK-së te ndërmarrjet publike. Dhe tash ky sqarimi, kjo kërkesa që të lejohet një lloj fleksibiliteti brenda këtij projektligji tregon qartë qëllimin, edhe arsyeshmërinë pse është rritur pakënaqësia te qytetarët të Republikës së Kosovës edhe për këtë projektligj.

Si Grup Parlamentar e kemi theksuar edhe më herët që Qeveria me vendimet arbitrare, sigurisht duke i shkelur edhe shumë ligje të aplikueshme në vend, qysh në ditët e para ka ndërhyrë nëpër bordet e agjencive të pavarura dhe ndërmarrjet publike. Dhe tash kjo vetëm po tregon të vërtetën e asaj që kemi thënë në fillim, kështu që mendoj që të mbështetet Komisioni Funkcional, pak a shumë edhe kryetari i komisionit e përmendi atë militantizmin partiak dhe përfshirjen e grupeve klanore dhe të interesit që zhvatin buxhetin në ndërmarrjet publike dhe shpërndajnë para pa asnjë arsye dhe pa asnjë bazë ligjore. Faleminderit!

**KRYETARI:** Nga një përfaqësues i partive do të flasim, jo më shumë, le të merren vesh grupet parlamentare, Dardan Sejdiu nga Partia Socialdemokrate.

**DARDAN SEJDIU:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Amendamentet 46, 47, 48, në fakt, sigurojnë që të ketë një tavan me koeficientin 7 sa u përket pagave të njerëzve në ndërmarrjet publike. Besoj që secili prej nesh e di që ndërmarrjet publike janë ndërmarrje që operojnë në treg, pra japin shërbime komerciale, pronësia është publike, por puna është në treg, në ekonomi. Dhe, në ekonomi konkurron jo vetëm me produkt, por edhe me staf, i cili e ndërton atë produkt, atë shërbim e atë, si të thuhet mirëmbajtje, e tjera, e tjera.

Tash unë kështu si diskutim po e them këtë: nëse një inxhinier i Telekomit, një inxhinier i makinerisë, një inxhinier i elektroteknikës apo në sistemin energjetik të Republikës së Kosovës e ka pagën më të ulët se një operator privat në konkurrencë, ju edhe më shumë po i ndërtoni ndërmarrjet publike, sepse ekspertizën kryesore që janë inxhinierët, po u thonë maksimumi i mundshëm për ju është 7. Ligji e përcakton që Qeveria mund të marrë vendime sa i përket tavanit dhe le të themi, minimumit. Rrjedhimisht si Parti Socialdemokrate jemi tepër të interesuar që stafin profesional në ndërmarrje me interes strategjik t'i mbajmë në ndërmarrje publike dhe të mos krijojmë hapësirë dhe, si të thuhet, kokëçarje sa u përket tavanaeve të parapercaktuara. Unë nuk dua të mendoj që ligjet shkruhen për një mandat qeverisës, as nuk dua të mendoj që si deputet duhet të argumentoj mbi një mandat qeverisës. Për mua është me rëndësi si deputet i Partisë Socialdemokrate që inxhinierët më të mirë të Telekomit, në sektorin minerar, në sektorin energjetik të jenë të rekrutueshëm dhe që mund t'i mbajmë në këto industritë tona që ne besojmë duhet të jenë në sektorin publik. Përndryshe, secili operator privat do të joshë me rroga më të mira dhe kjo nuk do të thotë që jemi duke e përkrahur keqmenaxhimin e 18 vjetëve të fundit, por kjo do të thotë që në emër të keqmenaxhimit të mos e largojmë stafin më të mirë që e kanë këto ndërmarrje, duke i çuar në sektorin privat. Pra, ne jemi kundër këtyre amendamenteve. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Tani, vetëm pak, kisha lutur një anëtar nga grupet parlamentare, kryetar i komisionit, ju do të flisni në fund, kur të përfundojnë këta të gjitha qëndrimet, ju e bartni edhe një herë qëndrimin e komisionit. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, edhe PDK-ja ka shumë deputetë, duhet ta kenë një. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, atëherë vetëm Ahmet Isufit, të tjerëve s'do t'ua jap fjalën.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryetar! Ne e përkrahim propozimin e Qeverisë dhe do të votojmë kundër këtyre tri amendamenteve që u përmendën, 46, 47 dhe 48. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Atëherë e kemi edhe Milaim Zekën.

**MILAIM ZEKA:** Faleminderit, kryetar! Dola këtu për t'i bërë thirrje Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lëvizjes Vetëvendosje dhe deputetëve këndeje, çka jemi bashkë, kush ka ndërgjegje dhe kush do ta ndalë tavanin e vjedhjes të parasë publike. Unë mendoj që, ndoshta me qëllim, ndoshta pa qëllim, por Dardani në këtë pikë është duke e manipuluar Kuvendin dhe qytetarët e Republikës së Kosovës.

Dardani, sepse fare nuk ka të bëjë ky nen me të vërtetën. E vërteta është krejt ndryshe, ne kemi caktuar tavanin që hajnat e këtyre kompanive, të cilët quhen "drejtorë" dhe menaxhmenti që kanë vjedhur që 20 vjet para në ndërmarrje publike, këta nuk mundën më t'i caktojnë vetes rrogën 5 mijë euro, plus reprezentacion për një muaj, dreka e darka nga 40 mijë euro. Të dashur deputetë, KEK-u, Postë Telekomit i Kosovës, çdo ndërmarrje publike, në bazë të këtij ligji mund

t'ia caktojë rrogën një inxhinieri 30 mijë euro. Çdo njeri që ka vlerë për këto ndërmarrje publike mund t'i caktohet rroga dhjetëfish mbi drejtorin gjeneral. Në BBC, për shembull, ose në televizion të Suedisë, ose në ZDF, çka janë televizione publike, më të madhe e ka rrogën një gazetar i vlefshëm se sa një drejtor gjeneral. Çka kanë bërë këtu? Këtu i 'kanë key' parasë publike! Tani PDK-ja, një pjesë e PDK-së, edhe një pjesë e tjerëve po duan të fitojnë vota përmes këtij amendamenti se jaranët, kushërinjtë, tezet, dajat i kanë futur në KEK, në Postë Telekom, në krejt ndërmarrjet publike. Unë as nuk votoj për teze, as për dajë, por votoj vetëm për fëmijët e mi, për të ardhmen e fëmijëve të mi.

Prandaj, me vendim unanim të deputetëve të Lidhjes Demokratike, të AAK-së, të PDK-së, Naitit e Xhevës, të gjithëve ne, me përjashtim që Shqipja e ka kundërshtuar edhe atje këtë nen, të gjithë të tjerët kemi qenë unanim për ta votuar. Prandaj, po ju bëj thirrje njerëzore, dijëni që është pika më e ndjeshme dhe rrëzojeni propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së, edhe të Dardanit, dhe votojeni këtë nen se është shumë i rëndësishëm. Albulenë, ty bile, po të lus kështu personalisht.

**KRYETARI:** Vetëm pak, Dardan Sejdiu, iu përmend emri, po këtu flitet në foltore e të ruhem i nga pak, goditje, të gjithë kanë nga pak në sektorin publik, më duket, në punë, edhe Milaimi e ka dikë, edhe vetë. Po ndoshta ke, unë s'thashë çka ke. Ndoshta ke. Dardan Sejdiu, replikë, po e bëj përjashtimin për faktin se shumë po godasin dhe po mundohem t'i tejkaloj.

**DARDAN SEJDIU:** Faleminderit, kryetar! Qëndrimi im është komplet në frymën e një mendimi ekonomik sa u përket ndërmarrjeve publike dhe si zhvillohen sektorët strategjikë. Për mua dhe për PSD-në Telekom, sektori energjetik, minierat janë sektorë strategjikë që duhet të mbeten në pronësitë publike deri në pikën në të cilën e ngremë vlerën e tyre dhe mund të gjenerojmë të hyra shtesë. Pra, nuk kemi asnjë lloj mendimi tjetër, për më shumë në sektorin publik fatmirësisht unë nuk e kam askënd të punësuar, nejse, më fal, e kam bashkëshorten mjeke, por as në Postë, as në KEK kurrkund s'e kam kurrkund të punësuar, thjesht po e them prej prizmit të konkurrencës sa i përket fuqisë punëtore.

Një inxhinier në një rren prej termocentraleve tona do të jetë lehtë i rekrutueshëm prej çdo konkurrenti, i cili na futet në sektorin e energjisë, qoftë ai në sektorin e energjisë së ripërtëritshme, qoftë ai edhe në këtë marrëveshjen që po mundoheni ta shtyni përpara me "Contour Global". Pra, inxhinierët në termocentrale, në Telekom duhet të kenë mundësinë të jenë konkurrentë me tregun e punës, sepse po flasim për ndërmarrje që operojnë në treg të punës dhe, në këtë drejtim, në këtë frymë dhe në këtë bindje që e kam për mënyrën se si zhvillohen sektorët strategjikë i lus deputetët e këtij Kuvendi që kufizimin që e kanë paraparë me amendamentim kolegët e tjerë deputetë, ta shohin edhe prej një argumentimi që e paraqita unë, kaq. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nait Hasani, kryetar i komisionit, propozimet janë të qarta, votojmë. Nait Hasani, kryetar i komisionit, thuaje qëndrimin përfundimtar.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar! Po më vjen keq prej Dardanit që nuk e kupton logjikën e ligjit, nuk e kupton ndërmarrjen publike, konceptin e Qeverisë që i ka dhënë për ndërmarrjet e financuara mbi 50% nga shteti. Duhet ta kuptojë Dardani se nuk bëhet politika për të fituar vota, por votat që po do t'i fitojë, nuk mund t'i fitojë me këdo, përkundrazi nuk mundet nga analfabetët që kanë shkuar nëpër ndërmarrje publike atje që na kanë sjellë dhe na sjellin ligje, të cilat ose aktivitetet e tyre që tregojnë paaftësi. Nuk mund t'i mbajë shteti ndërmarrjet publike, të cilat janë të paafta. Ne duhet t'i nxisim me këtë amendament ndërmarrjet publike që të dalin fitimprurëse dhe ato t'i përcaktojnë pagat e tyre sipas buxhetit që mund ta rregullojnë.

Prandaj, Dardani me këtë ia 'ka huq' tamam si Dardanët dhe kështu që kërkoj deputetët t'i votojnë amendamentet dhe t'i mbrojmë ndërmarrjet publike, t'i bëjmë funksionale dhe të dalim me buxhet që do ta financojmë dhe uroj që t'i bëjnë edhe nga 40 mijë euro pagat e tyre për individ. Prandaj, kërkoj që t'i votojmë, sepse me këto i finalizojmë, i fuqizojmë ndërmarrjet publike, pikërisht me amendamentet.

KRYETARI: A shkojmë në votim drejt, atëherë? Dardan, urdhëro, replikë, por shkojmë në votim, përgatituni për votim.

DARDAN SEJDIU: I nderuar deputet Hasani, me shumë respekt do të përgjigjem vetëm në terma profesionale, e assesi në terma elektorale. Ka një dallim esencial për ata që e kanë një ditë shkollë në ekonomi mes kapitalit edhe financimit. Pra, kur një ndërmarrje publike është në pronësi të shtetit, nuk do të thotë që shteti e financon atë, thjesht është pronar, hisedar.

Këtu është një moment i vogël, besoj që është i rëndësishëm në leximin e adekuat të asaj çka e keni propozuar ju. Pra, për mua edhe një herë është tepër me rëndësi që nëse një ndërmarrje është duke operuar në ekonomi të tregut ajo duhet të jetë konkurruese, dhe nuk mund të jetë konkurruese nëse njerëzit profesionistë në ato ndërmarrje nuk mund të rekrutohen, rrjedhimisht ky tavan këtu i përcaktuar u pamundëson ndërmarrjeve tona publike rekrutimin e njerëzve të mirë, kaq. Sa i përket mbushjes së Telekomit, KEK-ut dhe ndërmarrjeve të tjera publike, unë besoj që ata kryesisht janë në rendin ku gjendeni ju, zoti Hasani, këtu ku jam unë, asnjë nuk është. Faleminderit!

KRYETARI: Kundër-replikë dhe shkojmë në votim.

NAIT HASANI: Edhe një herë faleminderit, kryetar, e shoh që gjendja ekonomike i paska ndarë socialdemokratët nga Vetëvendosja, do të thotë për të zënë një vend në ndërmarrje publike, prandaj është një çështje që nuk e ka kuptuar konceptin e ligjit. Koncepti i ligjit është

ndërmarrjet publike, të cilat financohen nga shteti duhet të kenë pagë dhe ajo pagë duhet të përkufizohet me koeficient. Nuk ke mundësi ta përcaktosh ndryshe, ndërmarrjet publike qysh kanë qenë gjerë më tash, njëra ka 3 mijë euro, tjetra e ka 4 mijë euro, tjetra 6 mijë euro, tjetra e ka 2 mijë euro, kjo nuk është koncepti i ligjit. Nëse konceptin e ligjit doni ta shkatërroni, shkatërroni, por dije se Dardanët ju marrin në qafë, edhe në zgjedhje kanë me e marrë veten në qafë.

**KRYETARI:** A ka mundësi të shkojmë drejt votimit, jemi në votim. U krye kjo pjesa e debatit, tash të mos e bartim në debat.

Amendamenti 46. Kini parasysh, qëndrimet ishin, këtu te ne ka ardhur me përkrahje të Komisionit Funkcional, i patë qëndrimet e partive politike. Votojmë tash!

89 deputetë kanë votuar, 42 për, 39 kundër, 8 abstenime.

Nuk kalon ky amendament.

Dëgjoni, vetëm kini parasysh, se ju duket pak çudi, si edhe mua. Çdo herë e dëgjojmë pak më shumë kur kemi konfuzion administratën, që e ka një përvojë pavarësisht neve. Nuk kalon për shkakun nuk është shumica e 89, do të duhej të ishin 45. Për këtë tash të jem më korrekt me ju, po e shoh, shumë ekspertë këtu, po interpretimin vetëm edhe 20 sekonda më duhet, në qoftë se administrata ma konfirmon edhe një herë, ju pastaj qojeni në Kushtetuese.

Vetëm pak, unë mbaj qëndrim si do të ma japë administrata, pastaj ju ekspertët. Kemi një votim, vetëm pak të qartësoj, a ka mundësi të zini vendet, nuk është fontanë dëshirash Kushtetuta, Rregullorja e Kuvendit, a ka mundësi vetëm të uleni. Në moment që marr interpretim, të cilin unë i bindem, edhe ju, do të thotë, në bazë të Kushtetutës e kemi obligim ta respektojmë, nuk është çështje e vullnetit, as e dëshirës. Zoti kryetar i komisionit, me dëshirën time, unë e kam edhe një votë publike, që e kam votuar, nuk jam këtu për votën time, jam për ta interpretuar Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ka mundësi, e kemi një votim, vetëm pak, ka filluar debati dhe këto janë lart dhe vetëm kanë krijuar konfuzion. Kalojmë te amendamenti 47, unë e konstatoj këtë, fare s'ka nevojë ta mbyll, po vetëm pak, së pari nuk është çështje këtu cila është vota, nuk kemi kontestim të votës, kemi kontestim të interpretimit të votës, nënkryetar, fjala për ju, por kemi kontestim interpretimi të një rezultatit të votimit, jo gjendje të votuesit. Aty nuk mund ta ndërroj unë, urdhëro, nënkryetar, unë e pranoj edhe këshillën e nënkryetarëve, por mos u futni në seancë, nuk e lejoj. Urdhëro, nënkryetar!



KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Meqë kishte paqartësi, unë propozoj që të përsërisim votimin edhe një herë, domethënë sipas këtij interpretimi.

KRYETARI: Jo, më thuaj cili është interpretimi, nënkryetar, se këtë desha prej teje, se rezultati i votimit është cili është interpretimi në bazë të asaj si e kupton Rregulloren e Kuvendit. Unë e kam një të kuptuar, por nuk dua ta mbaj arbitrare. Kushtetuta ma jep atë mundësi, por unë po e kërkoj si ndihmë, edhe publikisht, nënkryetar i Kuvendit je, interpretimin tuaj! Merre, në qoftë se ke nevojë, e ke Kushtetutën, Rregulloren. Ta theksoj, ka të bëjë me nenin 81 të Kushtetutës. Urdhëro, nënkryetar!

KUJTIM SHALA: Edhe një herë, meqë kolegët e kishin të paqartë, unë propozoj që ta përsëritim procesin e votimit. Përndryshe, interpretimi i Administratës është në përputhje me Rregulloren.

KRYETARI: Kjo është çka tha nënkryetari, se nuk kemi çështje të diskutabilitetit, për arsye se po qe se e kemi prapë rezultatin e njëjtë, unë prapë më duhet ta interpretoj të njëjtën vendimmarrje të seancës. Kjo është! Vendimmarrja e seancës ka ndodhur. Të jemi transparentë, vendimmarrja e seancës ka ndodhur, nuk mund të fus më në votim, kot flitni. Në votim më nuk futet, për arsye se e keni në mënyrë transparente, keni votuar vetë, s'e kam votuar unë.

Publikisht, a ka dikush që i ka rënë pishman, siç thuhet në gjuhën popullore? E krijoj një precedent, pastaj vij në pishmanlinjtë çdoherë. E kemi edhe çështjen e dialogut të fazës finale, po të gaboni ju kështu njëherë, pastaj të na e dëmtoni vendin, nuk bën. Prit veç pak, se jam në interpretim të Rregullores. Në interpretim, ka një debat ndërmjet nënkryetarëve dhe Administratës. Nënkryetari në anën time të djathtë e ka një interpretim, i cili është në kundërshtim me Administratën për atë që edhe nënkryetari tjetër.

Seanca vazhdon, edhe pse jemi në konsultime, s'prish punë. Nënkryetare, zonja Aidë, edhe ju mund të jeni pjesë e interpretimit bashkë.

A ka mundësi, se gjithmonë kur konsultohesh, e kemi një situatë, ju lutem deputetë, zini vendet. Interpretimi është ky, vetëm pak, vendimmarrja juaj tash ka për ta përcaktuar vendimin e Kuvendit. Por kijeni parasysh, në qoftë se e kemi një vendimmarrje si e mëhershme nuk kalon, për arsye se ka interpretim të Administratës, ka interpretim edhe me Kushtetutë, të cilën e ka vënë para meje.

Atëherë shkojmë në votim edhe një herë. Po shkojmë në votim, jo jo...! Edhe një herë, po e shoh që të gjithë po pajtohen. Ju lutem, zini vendet, vendimmarrja është juaja. Deputetë, kthehuni në sallë, një minutë! Ju lutem, Administrata bini një herë kësaj ziles të lumtur se "shkolla fillon".

Dardan, a ke diçka? Edhe Arbëria pati diçka, në qoftë se dëshiron. Urdhëro Dardan, derisa se një minutë jemi në gjysmë pauzë.

**DARDAN MOLLIQAJ:** Dy gjëra. E para, ligji nëse shkon në rivotim, pasi ka pasur pjesëmarrje të përmbushjes së kuorumit, është shkelje. Nëse kryetari i Kuvendit e çon në rivotim një çështje që ka kaluar dhe ka pasur kuorum, je duke e çuar drejt Gjykatës Kushtetuese ligjin, ta dish.

E dyta, në Komisionin për Buxhet dhe Financa, që ka bërë interpretim Zyra Ligjore e Kuvendit, nëse të mbushet kuorumi ose plotësohet kuorumi më mirë të them, duhet të votojnë shumica për. Nëse janë shumica kundër dhe abstenim, ai nuk ka kaluar. Në rastin konkret, sipas interpretimit të Zyrës Ligjore të Kuvendit, kur janë disa vendime, ligji nuk ka kaluar. S'ka rëndësi kush është për e kush kundër. Nuk ka kaluar amendamenti. Kështu që e keni me vendime të Zyrës Ligjore të Kuvendit. Nuk është kjo punë e interpretimit as të nënkryetarëve, as të kryetarëve, e keni me vendime.

**KRYETARI:** Zonja Nagavci, zoti Krasniqi, mos e dramatizoni, ne jemi në rend të parë qenie humane, po mundohemi për të mirën e sektorit ekonomik, edhe të qytetarëve. Të mos dramatizojmë diçka çka s'është për ta dramatizuar. Ajo çka është kryesore, po pajtohemi në Rregullore, kjo është. Por vullnetin tuaj askush nuk mund ta abuzojë, ky do të jetë vullneti juaj në bazë të cilit vendosim. Zonja Nagavci, fjala për ju!

**ARBËRIE NAGAVCI:** Faleminderit!

Në Komisionin për Buxhet dhe Financa nuk është se janë shqyrtuar të gjitha amendamentet, sepse ka pasur ndryshime që kanë ndodhur edhe gjatë ditëve të fundit. Këtë draft që jemi duke e diskutuar, ne e kemi marrë sot. Deri mbrëmë vonë nuk e kemi pasur, kështu që unë gjatë secilit amendament që po e votoj, jam edhe duke e analizuar. Në këtë rast, nëse nuk votohet edhe një herë i njëjti amendament, vota ime është për.

**KRYETARI:** Zoti Krasniqi! Dhe ju kisha lutur pak për qetësi.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit, kryetar!

Unë mendoj që deputetët e thanë fjalën e vet, por po ma merr mendja në këtë Kuvend ka goxha shumë juristë në të gjitha partitë dhe nuk ka nevojë ta dramatizojmë siç thatë çështjen e vendimmarrjes, se është shumë e qartë që për çfarëdo vendimi duhet të jetë shumica minimale e numrit të atyre deputetëve që votojnë. Pyetja e thjeshtë që ua kisha bërë krejt juristëve këtu, nëse votojnë 61 deputetë, 21 pro, 20 kundër, 20 abstenojnë, a kalon ai vendim? Nuk kalon, sepse 21 nuk është shumica e thjeshtë e 61-shit? Edhe nëse ka kaluar ndonjëherë, ka qenë gabim.

Dhe, sot këtu është dashur të jenë 45 vota pro. Ju mund ta interpretoni qysh të doni, por me Kushtetutë të këtij vendit tonë, me Rregullore të këtij Kuvendi, duhet pasur gjysmën e votave për

të vlejtur një vendim. A, përndryshe a di sa raste kemi që kemi zgjedhur njerëz këtu për borde, për RTK, për KPM, për këtë, e për atë? Kanë pasur ta zëmë, kanë qenë 80 votues, 80 deputetë kanë marrë pjesë, dhe një i ka pasur 37 vota, një i ka pasur 35 vota, të tjerët kanë qenë abstenime, ose vota të pavlefshme, ama krejt kanë votuar, asnjë prej atyre kurrë s'i kemi zgjedhur. Pse tash po doni me dy standarde disa prej jush këtu të vendosni?! Nuk e kam dertin të ju them të drejtën kalon apo s'kalon amendamenti, sa duhet ta ruajmë legjitimitetin e ligjit. Nëse e vlerësoni që duhet të vendoset edhe një herë në votim, sepse ka pasur paqartësi, apo diçka tjetër, unë mendoj se nuk është problem, as s'është fundi i botës. Por, ta sqarojmë edhe për tash e tutje, se mund të ketë abstenim edhe në ndonjë rast tjetër të votimit, nëse duhet të jenë gjysma e votave që jepen pro për të vlejtur një vendim apo jo, dhe nëse s'janë gjysma, atëherë të mos vlejë. Unë mendoj se interpretimi është ky që e thashë, nëse dikush e interpreton ndryshe ma merr mendja së paku ishte dashur t'i referohet ose Kushtetutës, ose ligjit, ose Rregullores. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! A di si, e kisha bërë një zgjidhje, për të cilën më së shumti në publik mund të kritikohem unë. Po e shoh se ka reagime. Edhe kur pyeta, pati lëvizje dy deputetë me aq sa e pashë më thanë që e kanë ndërruar votën. Vetëm pak, vetëm po e jap një gjysmë propozimi. Unë do ta jap një propozim. Vetëm pak, a ka mundësi kështu, pastaj për këtë pjesë flasim më ndryshe. A ka mundësi që t'ju kërkoj ju, nëse është vullneti juaj, nuk është kjo dramatike që ta bëjmë, të votojmë edhe një herë, se po e shoh shumica po kanë dëshirë. Po tash dëgjo, në qoftë se ia nisni 120 vetë, keni për t'u kënaqur, deri në mëngjes keni për të na lënë kështu. Edhe thjesht, unë një vendim, edhe e kam të gatuar, po unë po dua ta marrë vendimin prej jush, edhe të mos jem arbitrar, se e kam shumë të qartë se çka duhet të marr vendim. Por po ju them kështu, mos e dramatizoni, njerëz jemi, vendimmarrja është juaja, nuk ka dhunë, a po e shihni nuk ka kurrfarë reagimi jashtë. Kemi për të votuar vetë. A ka mundësi të hyjmë edhe një herë në votim dhe të mos e dramatizojmë? A mundemi të hyjmë edhe një herë në votim, mos e dramatizoni? Po e shoh shumica të votojnë. A ma lini veç një 30-sekondësh t'i thërras nënkryetarët? Nënkryetarët le të vijnë veç pak, nja 30 sekonda deri te unë. Nënkryetare Aidë, a ka mundësi? Shkojmë në votim, vendimi ishte juaji. Zonja Myfera, a ka mundësi veç nënkryetarët, jo të tjerët? Po eja pak, një minutë!

\* \* \*

Sa deputetë janë në sallë aktualisht, që të kemi mirëkuptim të vendimmarrjes. Vetëm pak, sa deputetë janë në sallë? 100 deputetë jemi në sallë, të gjithë janë për të shkuar në rivotim. Interpretimin e kemi të qartë. I thirra edhe nënkryetarët. Nuk ka nevojë fare. Përgatituni për votim, vota juaj vendos. Interpretimi është i qartë.

Regjia, deputetë, përgatituni për votim!

Amendamenti 46, a ka mundësi edhe ju dy deputetë? Votojmë tash!

93 deputetë, 48 për, 42 kundër, 3 abstenime. Kalon.

Amendamenti 47.

Votojmë tash, të mos e dramatizojmë kot. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 48. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 49. Votojmë tash! Vetëm pak! Zonja deputete, e keni një reagim diçka.

Hykmete Bajrami. Ndaleni votimin! Urdhëro!

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, kryetar!

Lidhur me amendamentin 49, të cilin e kemi përpara, nuk e di nëse në materialet nga stafi i Kuvendit e kemi versionin e fundit, por kërkoj shpjegime, sepse sapo votuam që ndërmarrjeve publike t'u caktohen tavanet e pagave, ndërkohë që për Trustin Pensional këtu e kemi bërë një përjashtim. Unë nuk e kuptoj pse është bërë një përjashtim i tillë. Pse duhet ta privilegjojmë një institucion të tillë?

Nëse jemi përcaktuar në parime, për të caktuar kufij minimalë dhe maksimalë, atëherë duhet t'i trajtojmë të gjithë në mënyrë të barabartë. Amendamenti 49 thotë kështu: "Fondi i kursimeve personale të Kosovës vazhdon t'i marrë pagat dhe shtesat deri më 31 dhjetor të vitit 2022. Pas kësaj date, pagat e punonjësve të tyre u caktohen brenda koeficientit minimal 1 dhe koeficientit maksimal 7, sipas vlerës së koeficientit të përcaktuar në nenin 22.1 të këtij ligji". Ju bëj me dije që Fondi i Kursimeve Pensionale i ka pagat mjaft të larta dhe në vitin sapo shkoi, për shkak të investimeve kudo që janë paratë, ne kemi pasur humbje diku rreth 80 milionë euro. Pse duhet këtij institucioni tash t'i garantojmë pagat aktuale deri në 31 dhjetor të vitit 2020? Nëse flasim për parime, hajde të mbajmë parime. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kryetari i Komisionit, dhe shkojmë në votim. Të mos ndërhyjnë të tjerët. Le të na qartësojë.

**NAIT HASANI:** Faleminderit, kryetar!

Fondi i Kursimeve është një institucion që për neve është i njohur si Trusti, është kërkuar që një afat kohor për këtë, kemi rënë në dakordim me anëtarët e Komisionit pikërisht për shkak se është një shumë e madhe e buxhetit që është te ata, një miliard e 700 milionë, dhe u është dhënë një afat dhe ata duket të hyjnë në rregullat 1:7, duhet ta kenë një vlerë, por pikërisht është lënë që të paktën ata ta bëjnë një zgjidhje, të na i bien zgjidhjet neve që t'i miratojmë. Përndryshe, edhe unë jam që edhe ata të jenë pjesë e njëjtë, pjesë e ligjit në buxhetin e pagave, 1:7.

KRYETARI: Faleminderit! Po e shoh që zonja Hykmete Bajrami e ka kërkuar fjalën, edhe dy deputetë janë. Urdhëro zonja Hykmete për qartësim në qoftë se ke nevojë.

HYKMETE BAJRAMI: Unë propozoj që në fakt ashtu siç u votua për ndërmarrjet e tjera publike, të bëhet amendament tani për tani, që kufizimi d.m.th. prej koeficientit 1 deri me 7 të vlejë me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe të mos u jepet afat shtesë. Nëse kishim për t'i pyetur të gjitha ndërmarrjet publike dhe të gjitha institucionet ku keni provuar si komision parlamentar të bëni nivelim, sigurisht se të gjithë kishin për të kërkuar dhe kishin për ta justifikuar me mijëra arsye që t'u zgjaten pagën aktuale deri në vitin 2022. Nëse nuk e pranoni këtë propozim, atëherë ne si grup parlamentar do të votojmë kundër këtij amendamenti dhe i bie që në fakt të mbetet ashtu siç ka qenë në ligj, e që besoj se prishet edhe struktura e tri amendamenteve paraprake të cilat sapo i votuam. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Haxhiu dhe zoti Haradinaj, mundësisht shkurt. Shkojmë në votim.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Ne e mbështetim riformulimin e këtij amendamenti dhe atë si në vijim: Pagat e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës caktohen brenda koeficientit minimal 1 dhe koeficientit maksimal 7. D.m.th., kjo është në harmoni edhe me votimin që bëmë pak më përpara, pra jo deri më 2022, por kështu që të vlejë për të gjithë njësoj. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Haradinaj!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Përafërsisht të njëjtin mendim e ndaj edhe me kolegët që folën, por prapë d.m.th. isha kthyer te neni 27 kur ka qenë kërkesë që t'u jepet e drejta e prokurorëve dhe e gjykatësve të Gjykatës Speciale dhe të prokurorëve specialë që t'u vazhdohet pagesa deri në vitin 2022, njëjtë sikur në këtë institucion tepër të rëndësishëm. Unë pajtohem që është institucion i rëndësishëm, por në të njëjtën kohë janë edhe ato institucione tepër të rëndësishme të cilat u fshi amendamenti 27. Tash unë nuk e di sesi do ta gjejnë zgjidhje në finale, p.sh. sesi do ta zgjidhin këtë problem. Por, në rast se bëjmë një përjashtim, atëherë duhet të kemi përjashtim për të gjithë, sepse të gjitha institucionet unë mendoj që janë njëjtë të rëndësishme.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Hasani, a ka mundësi të na e përkufizoni dhe të shkojmë në votim.

NAIT HASANI: Parimi i njëjtë vlen për të gjithë, prandaj edhe unë pajtohem me kolegët që me hyrje në fuqi të ligjit, ky është tavani që duhet të shkojë, d.m.th 1:7 me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

KRYETARI: Shkojmë në votim. Amendamenti 49. Hajde, formulojeni shpet! A e formuloi Naiti, a e morëm? A mundësi një fjalë ministri i Financave, se na ndihmon sigurisht.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Duhet të jemi të kujdesshëm për disa institucione për shkak se këtu po flasim për një fond që janë kursimet e qytetarëve të Republikës së Kosovës, janë rreth 1,7 miliard. Dhe duhet bërë një pyetje në këtë drejtim. Nëse i kufizojmë pagat, a ka mundësi që të kemi ekspertë me ato paga t'i mbajmë në këto institucione. Nëse duam të mendojmë që t'i krijojmë dikujt një vend pune, sidoqoftë, kjo është diçka tjetër. Por, nëse mendojmë që këto mjete, edhe këtë punë ta kryejmë, është numër i kufizuar i ekspertëve dhe tregu ata ekspertë i vlerëson ndryshe. Të jeni të bindur që ata ekspertë tregu i vlerëson ndryshe. Edhe çka ka për të ndodhur? Ata nuk mund ta ndryshojnë këtë gjendje, ata do ta pranojnë këtë gjendje, dhe sigurisht do të bëjnë zgjidhje që është e përshtatshme për ta.

Prandaj, unë po ju lus që te disa institucione të ketë kujdes, për shkak se është e natyrës specifike, për shkak se i ka në menaxhim 1 miliard e 700 milionë kontribute të taksapaguesve të qytetarëve të Kosovës, prandaj ju lus shumë për mirëkuptim dhe kujdes. Të mos nisemi prej asaj se kush është këtu e tek është; sot është nesër s'është. Por ne po flasim për shtigje pak më afatgjata dhe ju siguroj dhe ju garantoj që ekspertët e tillë në tregun dhe sektorin privat marrin paga sigurisht ekuivalente me ato që i kanë sot, apo ndoshta kanë mundësi që të paguhen edhe më shumë.

Prandaj, unë nuk jam këtu për ta imponuar bindjen time, por jam këtu për t'i bërë sqarimet e nevojshme dhe për të treguar rëndësinë e institucionit për të cilin po flasim dhe kenë për të vendosur. Faleminderit!

KRYETARI: A shkojmë në votim, drejtpërdrejt. Të mos e ngatërrojmë, për arsye se ka pasur debat shumë, na merr edhe një orë njëjtë. Shkojmë në votim. Vendoseni, po-jo! Unë e di se ka shumë ekspertë edhe të juridikut, edhe të ekonomisë në këtë Kuvend. A shkojmë në votim?

Amendamenti 49 i Komisionit, përgatitemi për votim! Nait, e the edhe fjalën tënde. Nait Hasani, edhe një herë!

NAIT HASANI: Kërkojmë që në amendament paga e punonjësve të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës të caktohet brenda koeficientit minimal 1 dhe koeficientit maksimal 7, sipas vlerës së koeficientit të përcaktuar me nenin 22, pika 1 të këtij ligji. Prandaj, kjo është pjesa e amendamentit që duhet ta votojnë tash deputetët.

KRYETARI: A e votojmë, a shkojmë në votim? E vendosa propozimin e Naitit në votim. Zoti kryetar i GP të PDK-së, a ka mundësi një minutë se nuk po... po prej aty. Urdhëro, çka është gjithë ky reagim?

MEMLI KRASNIQI: Ja çka ka. Shikoni, kryetar! Deputetët e kanë materialin para vetes. Amendamenti 49 është ky që e kemi, që e ruan nivelin e pagave në Fondin e Kursimeve Pensional deri më 31 dhjetor 2022, dhe pastaj hyn në fuqi paga me nivelet prej 1 deri në 7. Unë do t'i them dy fjalë që s'pata qejf ndoshta t'i them, veç koncepti që Presidenti duhet ta ketë pagën më të madhe në këtë vend, dhe askush s'guxon ta ketë pagën sa të Presidentit, ta them butë është koncept më shumë se komunist. Veç në komunizmin klasik është dashur të jetë presidenti, lideri suprem edhe në pagë, edhe në gjithçka. Në ekonominë e tregut të lirë, në një vend modern demokratik, ta kufizosh edhe sektorin publik, edhe Trustin që i ruan krejt kursimet pensionale të gati dy milionë qytetarëve, është absurditet. Kjo s'ka as koncept politik, as ekonomik, kjo është më shumë se të bësh hajgare me 1,7 miliard euro që sot janë të mbledhura në këtë fond, se po duam t'ua zvogëlojmë punëtorëve. A dini sa punëtorë i ka Trusti, nuk besoj që janë 30. Sa para i kurseni more, a i kurseni 500 mijë euro në vit? Keni amendamente këtu ju që po bëni zhurmë që sikur të kishin kaluar, 15 milionë euro e kanë koston, dhe e bllokojnë buxhetin e këtij vendi. Këtu 500 mijë euro nuk është ndikimi financiar.

Çka po dëshironi të arrini? Të thuhet që nuk bën që një drejtori i Trustit ta ketë pagën sa ministri! Të thuhet nuk bën ta ketë sa deputeti! Duhet ta ketë 7 ai, se deputeti e ka 8, e deputeti është më i mirë, se neve na ka zgjedhur populli, neve na do populli.

Ata njerëz janë profesionistë që numërohen në gishta në Kosovë. Nuk e njoh asnjërin me emër dhe as nuk i kam takuar asnjëherë në jetë. Por, Trusti i Kursimeve Pensionale e ka pasur performansën më të mirë të mundshme edhe në kohën e krizës 2008-2009, humbjet kanë qenë më të vogla se secili fond në Evropë.

Çka po duam t'u bëjmë sot, t'u themi se kemi ne disa ekspertë tanë; kushërinj, se ata nuk rrinë, e i sjellim aty, dhe shikoni pastaj sesi i ruajnë paratë.

Unë kam problem me konceptin. Unë kam problem me ideologjinë pas idesë që Presidenti e ka 10 dhe të gjithë të tjerët e kanë më pak. Nëse Presidenti e ka 10 domethënë, dihet që në Kosovë askush nuk guxon ta marrë rrogën më të madhe se ai. Këtë ide po dëshironi ta instaloni, me këtë që hajde t'ia kufizojmë Trustit.

Ju lutem kolegë deputetë,

Për shkak të inateve personale, nuk mund të bëjmë ligj. S'mund të bëjmë ligj për shkak të koncepteve personale që mund t'i kemi. Ligji është për krejt Kosovën. Ka institucione e ndërmarrje që kanë rëndësi më të madhe se disa ndërmarrje tjera. Nuk është Trusti nip i

agjencive të Qeverisë. Ashtu siç nuk është as Agjencia e Privatizimit një prej agjencive normale të Qeverisë. Ashtu siç nuk është Gjyqësori veç një institucion atje, siç po e konsiderojnë disa.

Në bazë kontekstit në të cilin jeton një njeri, një vend, ne duhet t'i marrim edhe vendimet. Tekefundit, unë ju propozova për ndërmarrjet publike, të ruhet fleksibiliteti i Qeverisë, nuk kaloi vendimi. E votuan kundër, me siguri edhe plot të tjerë që shumë më shumë mund të kenë interes në ato ndërmarrje sesa që kam unë personalisht.

Unë e mbroj konceptin; ndërmarrjet publike duhet të jenë konkurrencte me ndërmarrjet private në një ekonomi të lirë. Me vendimin e sotëm nuk janë. Sidoqoftë, është vendim sovran i këtij Kuvendi. Por, edhe nëse për Trust mendoni që duhet të kufizohen se ata duhet ta kenë rrogën më të vogël se ministri dhe se deputeti, unë nuk e di çfarë jeni duke menduar për të ardhmen. Ju rritë nderi!

**KRYETARI:** Faleminderit! Po ministër, po kështu. Para se të flas... jo, se kanë filluar këto diskutime, elaborime më tepër të aspektit profesional. A ka mundësi një propozim? Me grupet parlamentare të ma jepni nga një qëndrim dhe shkojmë në votim të një alternative, dhe jo 50 veta sa kanë ekspertët, ose t'i thërrasim edhe në shesh disa profesorë dhe dalim i qesim... Ministër, urdhëro! Jo, vetëm grupet parlamentare, a ka mundësi nga një. Urdhëro, zonja Hykmete! Vetëm se merruni vesh ju, një, një, një... Dhe, ta kam një drejtim, për arsye se nuk po ka qëndrim.

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Faleminderit, zoti kryetar!

E para, menaxhmenti i këtij institucioni është që sa vite, edhe unë nuk besoj që lidhet me ndonjë parti politike këtu në Kuvend.

E dyta, këtu është një numër shumë i vogël, siç e tha edhe zoti Krasniqi, të cilët punojnë në këtë institucion.

E treta, duhet ta ketë dallimin që ky nuk është institucion, i cili finanohet nëpërmjet Buxhetit. Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka të drejtën e caktimit të tarifës dhe në baza vjetore t'ia shqyrtojë tarifën këtij fondi se cila është ajo. Prandaj, duke i pasur për bazë specifikat, rëndësinë, nevojën që ky institucion të qeveriset nga njerëz profesionistë, unë ju lus që të mbetet propozimi i amendamentit siç është në ligj dhe siç ka kaluar në komision. Faleminderit!

**KRYETARI:** Vetëm pak! Në qoftë se e keni parë zonja Hykmete, ty do ta jap fjalën. Vetëm kështu, në qoftë se e keni ndërmend që ta kemi një rrugëzgjdhje, ta bëni një amendament, ju kisha lutur ta bëni propozimin dhe mos na maltretoni, për faktin se veç diskutime po kemi, e jo vendim.



Amendamentimin duhet ta sillni, ta lexojë njëri prej jush, edhe pastaj seanca nëse e pranon që të mos jetë i shkruar që ta dërgojmë tutje.

Nga LDK-ja me aq sa po e shoh, Hykmete Bajrami dhe askujt më nuk ia jap fjalën. Nga PDK-ja, le të flasë njëri. Edhe shkojmë tutje; Vetëvendosja, PSD-ja dhe rend, ju lutem! Urdhëroni!

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, kryetar!

Kam përgjigje edhe për ministrin Hamza, edhe për deputetin Krasniqi.

Unë nuk e di sesi ne mund të konsideroheshim si shtet komunist në qoftë se tash ua caktojmë kufirin, por nuk konsiderohemi shtet komunist në qoftë se atyre u caktohet në vitin 2022. Domethënë, cila është poenta?

Ju keni thënë që deri më 31 tetor 2022 ta marrin këtë pagë dhe pastaj çka? Ku janë parimet tuaja? Ne nuk kemi asgjë personale, por mos vallë keni ju personale që po dëshironi t'i mbroni personat e caktuar deri në fund të vitit 2022. Domethënë, kjo është kështu.

Unë nuk e di a është më e rëndësishme që ta kemi një menaxhment të fortë në një ndërmarrje, e cila është në prag të falimentimit, apo në Trustin Pensional, të cilët i kanë kontraktuar aset-menaxherët, kompanitë ndërkombëtare që investojnë paratë tona në aksione në kompani të ndryshme.

Zoti Hamza, 5 500 euro ka qenë paga e kryeshefit ekzekutiv të Trustit Pensional. Ka qenë anomali edhe atëherë kur Trusti i ka fituar 200 milionë, edhe në kohën kur Trusti i ka humbur 80 milionë, siç është rasti në vitin kaluar.

Në qoftë se flasim për parime, unë e thashë, duke u nisur prej caktimit të pagës në ndërmarrjet publike, atëherë duhet të flasim për parime për të gjithë. Ne nuk jemi që Presidenti ta ketë pagën më të madhe, por jeni që jeni ju që pagat e shoferëve, të kryetarit të Kuvendit, të kryeministrit e të tjerëve i keni caktuar më të larta se të profesorëve, se të mjekëve dhe plot kategorive të tjera, të cilat kanë kualifikim mjaft të lartë.

Ky ligj ka krijuar pakënaqësi dhe pabarazi dhe për këtë arsye ne jemi kundër. Por, kur të flasim për parime, mos na hidhni hi syve.

**KRYETARI:** Vetëm pak! A ka mundësi pak qetësi! Më nuk po dihet kush është kundër dhe kush është për. Më nuk po dihet, janë rrokur individualisht. Armendi flet ndryshe, Hykmetja ndryshe. Pritni pak! Një qëndrim nuk ma dhe zonja Hykmete, cili është qëndrimi i partisë suaj? Në rregull! Nga PDK-ja, kush po e merr fjalën? Memli Krasniqi, urdhëro!

MEMLI KRASNIQI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet dhe voton pro amendamentit 49 që ka e sjellë Komisioni FunkSIONAL dhe secili deputet e ka para vetes.

KRYETARI: Nga Lëvizja Vetëvendosje, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Në momentin që hyjnë në lojë vitet, pra viti 2022 bie çfarëdo argumenti mbi parimet. Këtu s'kemi të bëjmë me parime. Domethënë, në vitin 2022 do ta kemi një ligj, i cili edhe Trustit do t'ia kufizojë koeficientin e pagës sikur zyrtarëve të tjerë të ndërmarrjeve tjera publike. Atëherë, ku është parimi këtu?

Çka dallon sot prej vitit 2022? Asgjë nuk po bëjmë tjetër, përveçse po bëjmë privilegje. Po e privilegjojmë në mesin e shumë institucioneve publike, po e privilegjojmë vetëm njërin prej tyre, që është Trusti.

E kur po shkojmë te diskriminimi dhe te privilegji, atëherë argumenti i vetëm që po e përdorim është se janë gjenialë në menaxhimin e fondeve. Nuk isha pajtuar me këtë interpretim. Sipas vlerësimit të ekspertëve, Trusti në vitin 2018 ka humbur dhjetëra miliona sa i përket efektivitetit të menaxhimit dhe të investimit.

Ekspertët po thonë 85 milionë euro, aty diku është vlerësimi.

Pra, sa i përket kësaj sesa të zotë janë ata edhe sa po i ruajnë fondet tona publike askush nuk po jep përgjegjësi edhe kur po ndodhin dështime. Edhe këta njerëz duhet të thirren në përgjegjësi, sepse po menaxhuakan fonde publike të Kosovës.

Sa i përket kësaj nëse drejtori i këtij fondi duhet ta ketë rrogën 5 500 euro, unë e kam veç një pyetje; a mund ta gjeni një vend evropian, meqë po i prezantoni këto si vlera evropiane, një pozicion publik në një shtet të BE-së është sa 15-fishi i rrogës mesatare? 15-fishi! Vetëm ma gjeni një, thoni Gjermania, Franca. Gjejeni një shtet ku drejtori i një fondi publik e ka rrogën sa 15-fishi i rrogës mesatare, jo i asaj minimale, por i mesatares, unë po them në rregull.

Ne jemi shteti i vetëm në Evropë, nuk e di a është edhe në botë, por në Evropë së paku ku 15-fishin e pagës së një zyrtari publik po e lejojmë në Republikën e Kosovës. Më falni, po kjo nuk është në rregull. Duhet të kufizohet ajo!

KRYETARI: Faleminderit! Dardan Sejdiu nga PSD-ja! Jemi duke shkuar në votim, ta keni parasysh.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Mendoj që një gjë është tepër e rëndësishme që ta kuptojmë, Fondi i Kursimeve Pensionale për krejt kritikën që e kemi për mënyrën sesi i menaxhon në mënyrë pasive me fondet e veta, është një fond i cili menaxhon me 1,7 miliard euro kursime nacionale, fonde pra të secilit prej nesh, të secilit prej qytetarëve që ka kontribuar aty dhe për këtë menaxhim ata e kanë një tarifë të cilën e kanë ulur, tarifë për menaxhimin e mjeteve tash vjet për vjet.

Kështu që ne kritikën mund ta kemi për mënyrën sesi menaxhohen ato mjete, po nuk besoj që ky parimi që nuk duhet ta kenë një pagë çfarë e kanë dhe të barazohet diskutimi në këtë lloj niveli, sinqerisht lë shumë për të dëshiruar.

Amendamenti i 49 i Fondit të Kursimeve, siç është prezantuar kështu, e ka përkrahjen e Partisë Socialdemokrate dhe do të votojmë për të. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nga AAK-ja, Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Unë s'po e kuptoj pse po bëhet kaq zhurmë kur secili grup parlamentar i ka pasur anëtarët e vet në komision dhe janë pajtuar dhe në komision na e kanë sjellë amendamentin këtu, e tash dalin kundër. Vërtet kjo është shumë në kundërshtim, por unë kisha thënë që menjëherë që vihet në votim dhe ta kryejmë punën.

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherfi, nga Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryetar!

U debatua shumë rreth kësaj, Nisma më së paku e mori fjalën. Më lejoni ndoshta pak më gjatë që të përcaktohem se çka do të bëjmë si grup parlamentar.

Mendoj që kur nuk ka dyshim që vende të tilla të punës kërkojnë edhe veçim nga shumë, le të themi kuadro të cilat mund të kryejnë punë të veçanta, kjo ndodh në të gjitha vendet e përparuar të Bashkimit Evropian, por zakonisht jo në paga. Dallimi bëhet në bonuse. Pra, nëse ata gjenerojnë fitime të mëdha, kanë një shumë të caktuar të bonuseve nëpërmjet të cilave pastaj kompensojnë, marrin më shumë sesa të tjerët për shkak të ideve të tyre, për shkak të punës së tyre të madhe profesionale, të cilën nuk mund ta kryejë askush.

Unë mendoj se nëse ka hapësirë, nuk e di a ka hapësirë, por meqë deri më tani u prekën disa amendamente, u ndryshuan, do të ishte mirë që paga përpos që kufizohet paga nëpërmjet ligjit të lejohen bonuset, pra të marrin bonuse nëse kanë fitime. Në rast nuk kanë fitime, por kanë humbje, siç po thuhet që ka humbje tani, atëherë le të mjaftohen vetëm në nivel të pagave.

Do të kisha pasur dëshirë që ta bëj një koment rreth amendamentit, i cili është si i tillë. Në fakt, Glauku tha se i privilegjon, në fakt ata nuk i privilegjon, atyre meqë janë kaq të zotët u jepet kohë që të përgatisin ikjen e tyre nga Trusti. Pra, nëpërmjet këtij amendamenti, ne nuk po i ndalim ata aty, por po u japim kohë që të kërkojnë vende pune, duke u bazuar në profesionalizmin e tyre në tregun privat.

Nëpërmjet ndryshimit të ligjit, a të këtij amendamenti, që edhe këtyre t'u kufizohet nëpërmjet hyrjes në fuqi të ligjit, atëherë i gjithë dallimi është që atyre nuk u jepet kohë tre vjet për t'u larguar, por po u jepet kohë për t'u larguar vetëm 6 muaj.

Unë mendoj që mesazhi duhet të jetë, paga ashtu siç u kufizua për të tjerët, por t'u lejohet mundësia që nëpërmjet bonuseve të marrin të hyra më shumë sesa do të merrnin nëpërmjet pagës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Alber Kinolli nga 6+ dhe shkojmë në votim.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Mendoj se polemizua më tepër me këtë çështje për shkak sepse, siç e thanë parafolësit e mi, secili grup parlamentar i ka pasur përfaqësuesit dhe deputetët e vet në kuadër të komisionit, dhe ka qenë qëndrim ynë ashtu siç është ky amendament i propozuar që të kalojë në seancë.

Ne si Grup Parlamentar 6+, jemi pro këtij amendamenti 49. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Armend, e kërkoje fjalën me insistim, urdhëro! Në rregull! Atëherë, Nait je i fundit, por ai s'qenka fare në sallë. Vetëm e kemi një konsultim me kryetarin e komisionit, me Naitin. Kryetari i komisionit e ka fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Është i njëjti amendament, vetëm ia heqim datën dhe themi "paga e punonjësve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës caktohet brenda koeficientit minimal 1, dhe koeficientit maksimal 7, sipas vlerës së koeficientit të përcaktuar në nenin 22, pika 1 të këtij ligji".

Prandaj, kjo është çështja e amendamentit që duhet të votohet.

KRYETARI: Me ndërhyrjen e kryetarit të komisionit... tash na e komplikuat.

*(Ndërprerje e incizimit)*

Të nderuar kolegë deputetë, a ka mundësi t'i zini vendet? Kështu, kryetari i komisionit e ka bërë një propozim, ju votoni për ose kundër dhe e kryejmë këtë punë.

Po votojmë për ose kundër, po pse... Propozimin e Naitit po e votojmë, votoni për ose kundër. Me ato ndërhyrjet e propozimit të Naitit, jemi në amendamentin 49, për ose kundër. Kaq! Për besë, veç po i komplikoni. Në publik jemi... Është bërë një punë e jashtëzakonshme, 20 vjet kemi pasur anarki në paga, është edhe moment historik, do ta quaja.

Jam duke e vendosur në votim amendamentin 49 me riformulimin e Naitit, votohet për ose kundër. Tash mos e komplikoni. Amendamenti 49, me bashkëngjitjen që i ka bërë, riformulim nga Naiti, votoni si të doni. Askush nuk ua ndërron mendimin, votën tuaj. Ka për të qenë publike, mashalla sa gazetarët i kemi këtu.

A jemi gati për votim, regjia? A ka mundësi t'i thirrni deputetët, kush është për votim, pastaj mos më futni edhe një herë në votim. Interpretimi është i qartë. Ai të cilin e ka pasuar Administrata për amendamentin më herët. Nuk e dëgjoj asnjë tjetër, pos interpretimit të cilin e marr nga Administrata.

A ka ende deputetë, a shkojmë në votim? Shkojmë në votim. Muharrem po, derisa jemi duke pritur. Urdhëro, Muharrem Nitaj. Deputetë, kthehuni nga bufeja! Urdhëro, Muharrem.

**MUHARREM NITAJ:** Faleminderit, kryetar!

Po, amendamenti nuk është i Nait Hasanit, por është i komisionit. Nait Hasani s'ka mundësi që ta ndërrojë amendamentin këtu.

Ju duhet ta nxirrni në votim amendamentin e komisionit, e jo të Nait Hasanit.

**KRYETARI:** Për korrektësinë tuaj, të gjithë kolegë deputetë. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në punimet e seancës, ka pasur ndërhyrje të tillë, më konkretisht është precedenti i nënkryetarit Sabri Hamiti në legjislaturën e kaluar.

Në seancë ka dalë në këtë foltore dhe e ka lexuar amendamentimin me shtesat, e kemi votuar, e keni votua ju, e kemi votuar bashkë. Veç ta dini, nuk veprojmë diçka që s'ka precedent, po vendimmarrja le të jetë juaja. Shkojmë në votim të amendamentit 49 me ndërhyrjen e Nait Hasanit, po ose jo. Votojmë tash!

E keni rezultatin: 93 votues, 37 për, 52 kundër, 4 abstenime. Nuk kalon.

Jemi në amendamentin 50, me dy propozime; Komisioni FunkSIONAL dhe deputetja Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Arbërie Nagavci, jepe propozimin, arsyetoje propozimin, pastaj Memli Krasniqi ka alternativë nuk e di se çka...

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit!

Ky amendament ka pasur të bëjë me pamundësimin që vendimi i jashtëligjshëm i Qeverisë për rritjen e pagave të rregullohet në përbërjen e këtij ligji, dhe meqenëse edhe Komisioni Funkcional tashmë e ka larguar krejtësisht, ka propozuar që ta largojë nenin 27, unë e tërheq këtë amendament.

Aq më tepër për faktin se ky vendim i jashtëligjshëm i Qeverisë Haradinaj për rritje të pagave është duke u shqyrtuar nga Prokuroria. Edhe amendamenti 50, edhe amendamenti 51, kanë të bëjnë me nenin 27, andaj unë i tërheq të dyja këto amendamente, pasi e njëjta gjë është kërkuar edhe nga Komisioni Funkcional. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja Nagavci e tërhoqi propozimin e vet. Zoti Memli Krasniqi, urdhëro! Edhe Muharrem Nitaj e ka kërkuar fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kisha kërkuar vëmendjen tuaj, ngase e kam një propozim konkret. Unë besoj që komisioni absolutisht ka marrë vendim të drejtë kur ka vendosur që ta heqë edhe këtë nen të dispozitave tranzitore në shumicën e rasteve.

Shumë prej atyre që janë paraparë këtu, janë përfshirë, qoftë te tabela e koeficientëve, qoftë amendamentet që ne sapo i votuam.

Por, i nderuar kryetar, siç besoj që e dini edhe ju, e keni pasur më duket edhe një propozim konkret në komision, është një nga degët e pushtetit në Kosovë, e cila nëpërmjet këtij amendamenti dëmtohet në mënyrë të madhe, dhe e kam fjalën për Gjyqësorin.

Gjyqësori është degë e barabartë me Ekzekutivin dhe me Legjislativin dhe normalisht unë besoj që investimi i krejt këtyre viteve të fundit për të pasur një sundim të ligjit, për të pasur një Gjyqësor më të fortë, të paanshëm e profesional, duhet të ruhet.

Rrezikojmë që nëse kalon amendamenti siç është, në vend se të shkojmë përpara, do të bëjmë hapa prapa.

Tani unë jam i bindur që e para e punës parimisht ne do duhej që ta ruanim situatën aktuale që ndërlidhet me pagat e gjyqësorit. Edhe për arsye financiare kemi diskutuar edhe me ministrin e Financave, nuk ka asnjë implikim financiar, sepse ne po flasim për vazhdimësinë, apo për mirëmbajtjen e situatës aktuale, e jo për ndonjë rritje.

Kështu që unë po e propozoj, njëjtë sikur që ishte propozimi i mëhershëm këtu në seancë, në amendament që neni 27, dhe ju kisha lutur për vëmendje kolegë, do t'juja shumëzohë nëse e kërkonti, edhe sekretaria ndoshta mund ta ketë vëmendjen, propozimi është ky: neni 27 të mos fshihet, por të ndryshohet si në vijim:

Dispozita transitorë, pika 1: Dispozitat e këtij ligji për sistemin e pagave, shtesave, shpërblimeve dhe shtojca numër 1 e këtij ligji nuk zbatohen për funksionarin publik me status të veçantë: gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, gjyqtarin, prokurorin, kryesuesin e Këshillit Gjyqësor dhe kryesuesin e Këshillit Prokurorial deri më 31 dhjetor 2022.

Dhe, pika 2, funksionari publik nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk do të përfitojë asnjë shtesë tjetër mbi pagë dhe asnjë rritje page për periudhën e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

Pra, çka është propozimi? Nëse llogarisim që diku në vjeshtë të këtij viti ky ligj hyn në fuqi, të vazhdohet përgjatë periudhës të mbetur në vitin 2019, po edhe për tre vjetët e ardhshme, 2020, 2021 dhe 2022 me nivelin aktual të pagave për gjyqësorin në Kosovë. Pavarësisht a mund të kemi mendime të ndryshme për të kaluar, kur i kemi marrë këto vendime që kanë qenë në funksion të inkurajimit dhe forcimi i gjyqësorit, dikush mund të thotë po ndoshta atëherë është gabuar pse ua kemi rritur pagat, unë besoj që kujto që kur ia rrit pagën, kur e ka një pagë dhe ti ia zvogëlon, realisht është një farë padrejtësie që mund të perceptohet.

Kështu që ju kisha lutur, kolegë deputetë, që gjyqësorin ta kemi parasysh në këtë rast, sundimi i ligjit është prioritet i të gjithëve, pa dallime partiake, ma merr mendja që do të duhej që edhe opozita, edhe koalicioni ta mbështesin këtë propozim, i cili po them nuk ka asnjë ndikim financiar, se nuk kërkon rritje pagash në gjyqësor, por vetëm mirëmbajtje të pagave ekzistuese tashmë. Faleminderit!

E njëjta, zoti kryetar, do të duhej të konsiderohej edhe në ndonjë rast tjetër, nuk është konsideruar, mirë e mbajtëm te Trusti. Edhe për kontrollorët ajrorë do të duhet të kemi një diskutim, po aty kur t'i vijë rendi, po mbi të gjitha ju lus që këtë dispozitë ta votojmë ashtu siç e propozova, mund ta shumëzohjmë nëse doni. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Kryetar i Komisionit në fund do ta japësh mendimin, jo, jo, të lutem, në fund. Ka një propozim të Memli Krasniqit. A ka mundësi çdo grup parlamentar ta japë nga një qëndrim për amendamentin e propozuar të Memli Krasniqit.

Armend Zemaj e ka fjalën, urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, faleminderit!

Po shihet qartë që problemi kryesor është ajo që është instaluar dhe e parafrazove më duket më herët te kjo Qeveri, e cila ka shkelur etikën qeverisëse dhe ka bërë konflikt interesi të hapur kur ka rritur pagat 100% për vete. Dhe krejt këto probleme, krejt këto pakënaqësi dhe krejt ky disnivelizim ka ndodhur për shkak të kësaj arsyeje.

Arsyeshmërinë do të duhet ta jepni ju, po flas ju, Qeveria, po edhe ju personalisht që ka ndodhur kjo dhe asnjëherë s'e keni arsyetuar dhe tash po e shihni në çfarë situatë na keni nxjerrë. Po të mos jetë kjo ndërhyrje, atakohet sistemi i drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Për këtë arsye mendoj që duhet të analizohet shumë saktë, është edhe ministri i linjës, ministri i Drejtësisë, sigurisht ky duhet të marrë përgjegjësi pak më shumë, dhe këtë parimin e pagës së barabartë, mbi të gjitha parimin e transparencës, parimin e mosdiskriminimit ta keni jo të dy anshëm, po ta kemi për të gjithë njëjtë.

Andaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës dëshiron ta dëgjojë Komisionin Funkcional se çka kanë menduar. Këta sigurisht e kanë pasur të fshirja e nenit që t'ju ulen juve pagat, Qeverisë, dhe për këtë arsye kjo në mënyrë analoge ka ndikuar edhe te Ligji për gjykatat dhe rritja që u është bërë prokurorëve, Këshillit gjyqësor dhe Këshillit prokurorial.

Sigurisht që ne jemi të vëmendshëm, jemi shumë të përgjegjshëm ndaj kësaj situatë dhe grupi parlamentar nuk e kundërshton, por e përkrah gjyqësorin në çfarëdo forme dhe çfarëdo mënyre që mendon Kuvendi i Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë, unë do t'i vendos dy propozime tani.

Nga Partia Demokratike e Kosovës është propozuar, në fakt.

Lëvizja Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, po urdhëroni!

ALBULENA HAXHIU: Në kohën kur Qeveria Haradinaj ka marrë vendim për rritjen e pagave në 100% për vete nuk ka qenë në dijeni që kjo prek edhe sistemin e drejtësisë, gjegjësisht prokurorët dhe gjyqtarët. Dhe, ne në vazhdimësi kemi thënë që rritja e pagave nuk mund të bëhet me vendim, ndonëse jemi shumë të angazhuar që prokurorëve dhe gjyqtarët duhet t'i kenë pagat e larta, por në anën tjetër, çka ka krijuar kjo. Kjo ka krijuar që një gjyqtar ose një prokuror të paguhet 2000, 2500 euro dhe një zyrtar ligjor të paguhet 300 euro, ose një bashkëpunëtor profesional që duhet t'i plotësojnë kushtet njësoj sikur prokurorët dhe gjyqtarët, të ketë pagën 500 euro. Pra, kjo është një prej arsyeve që ka krijuar shumë pabarazi, diskriminim, përbrenda sistemit të drejtësisë, sepse tash një bashkëpunëtor profesional kur e merr lëndën t'i ndihmojë prokurorit apo gjyqtarit, kur e sheh që prokurori e ka pagën 2000 euro e ky 500 euro, është njëfarë dallimi i madh.



Në këtë kuptim, ne si Vetëvendosje, duke marrë parasysh që e kemi ditur që do të ulen koeficientët për prokurorët dhe gjyqtarët, kemi propozuar amendamente që i kemi më vonë për prokurorin e Prokurorisë Themelore për Krime të Rënda, për gjyqtarin e Gjykatës Themelore për Krime të Rënda, për prokurorin e Prokurorisë Themelore, për gjyqtarin e Gjykatës Themelore, për gjyqtarë për kundërvajtje. Prandaj, në qoftë se amendamentet tona me koeficientët që i kemi propozuar votohen nga ky Kuvend, nuk ka nevojë për propozime të zotit Krasniqi që sapo i bëri, sepse tashmë janë amendamentet, të cilat i kemi deponuar ne si grup parlamentar, ky hyjnë bashkë edhe bashkëpunëtorët profesionalë, të cilët do t'i arsyetoj më vonë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Shqipe Pantina, nga PSK-ja.

**SHQIPE PANTINA:** Faleminderit!

Në fakt, për nenin 27 kanë qenë debatet më të mëdha që janë bërë edhe brenda komisionit dhe aty ka pasur edhe propozime të ndryshme.

Njëri ka propozimet ka qenë që të mbetet si i tillë, kurse propozimi tjetër, i cili ka marrë shumicën e votave, ka qenë që të fshihet fare.

Ne si PSD edhe në komision jemi munduar ta gjejmë një zgjidhje alternative, pra që as të mos fshihet në tërësi neni 27, por as të mos lihet ashtu siç ka qenë i propozuar nga Qeveria. Pra, një pjesë të zyrtarëve të mos gëzojnë shtesë në periudhën kalimtare, por kjo të mos vlejë për të gjithë.

Po ashtu duke pasur parasysh se vërtet sektori i drejtësisë ka nevojë për mbështetje në mënyrë që të forcohet edhe sundimi i ligjit, ne e përkrahim propozimin që sapo u dha nga zoti Krasniqi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Muharrem Nitaj, urdhëro!

**MUHARREM NITAJ:** Kryetar, unë e mora fjalën, ia mora rendin Rasimit, realisht më tepër e kam për një sqarim, po e rikthej pak në amendamentin 49. Ne e kemi rrëzuar propozimin e zotit Hasani, po realisht ne formalisht nuk kemi votuar fare amendamentin 49.

Prandaj, unë ju lutem që ta nxirrni në votim edhe formalisht amendamentin 49, sepse përndryshe mbetet i pavotuar.

Ndërkaq, për pjesën tjetër flet Rasimi.

**KRYETARI:** Rasim, prapë.

Për çështjen e amendamentit 49, të jem pak më i qartë.

E lus protokollin t'ia dërgojë çka kam vënë në votim para votimit deputetit Muharrem Nitaj, se pati pyetje të drejtpërdrejtë, ia kam sqaruar, po për çdo rast ta nxjerrë nga protokollin fjalën time. Urdhëro, në emër të AAK-së Selmanaj!

**RASIM SELMANAJ:** Faleminderit, kryetar!

Qeveria e udhëhequr nga zoti Ramush Haradinaj është përcaktuar që ta përkrahë rendin dhe ligjin. Unë edhe në komision kam qenë kundër që të tërhiqet neni 27 sa i përket gjyqësorit.

Prandaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e përkrah idenë në këtë rast, ose propozimin e zotit Krasniqi, që neni 27 të mos fshihet, po të lihet qysh ka qenë më përpara, jo të hiqet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Milaim Zeka, nga Nisma.

**MILAIM ZEKA:** Kryetar, unë më shumë do të flas, ajo që po më brengos, e që për fatin e madh qytetarët janë duke na përcjellë në transmetim televiziv, po shihet se me çfarë nënçmimi trajtohen deputetët e këtij parlamenti nga vetë partitë e tyre politike.

Këtu po shihet që fare ju nuk komunikoni me deputetët tuaj, kur këta janë në komisione. Sot këtu po dëgjoj propozime krejt të reja nga të gjitha partitë politike, kur ne kemi shkuar dhe kemi punuar 26 ditë, prej orës 10:00 të ditës deri në orën 24:00, atëherë është dashur ju të na telefononi, të na shkruani, të propozoni e të na këshilloni, po jo sot në seancë, kur kemi ardhur këtu për votime.

Këndo që e pyetni në një shtet demokratik normal, sa do të duhej të ishte rroga e kryeprokurorit të shtetit, shumë më e lartë se sa e presidentit. Sa do të duhej ta kishte rrogën një gjykatës? Shumë më të madhe se sa presidenti, e kushdo qoftë tjetër.

Por ne kemi debatuar gjerë e gjatë këtë pikë dhe kemi ardhur në përfundim që me atë dispozitë, me atë nen, të cilin ne e kemi rrëzuar përtokë, shpëtohet buxheti i Kosovës dhe largohen privilegjet për ata njerëz të cilët e kanë hëngër dhe e hanë më së shumti buxhetin e Kosovës. Nuk e kam fjalën këtu për gjykatës e prokurorë, për të gjithë ata që i ka prekur neni 27, për të cilin kemi votuar për t'u hequr.

Mbi bazën e kësaj, pa hyrë unë e të dalë se gjoja ne jemi kundër prokurorëve, kundër gjykatësve, kundër stafit administrativ, në mënyrë absolute Memli ka shumë të drejtë, edhe ata të tjerët kanë të drejtë, se kjo është të diskutosh edhe-edhe, ama po ta hartonim ne ligjin edhe-edhe, ky ligj nuk kishte ardhur sot këtu në parlament. Po doni ta bëni kaçamak ligjin, sallatë të përzier me patate e me lakra të prishura, po doni ta bëni çervish, bëni more, hiç nuk ka kurrfarë problemi. Bile-bile,

unë kisha propozuar ta tërheqim krejt ligjin. Puna më e mirë ka qenë të tërhiqet krejt ligji, sepse ky ligj ka ardhur me propozim të jashtëzakonshëm të Partisë Socialdemokrate dhe në kushte të jashtëzakonshme gjithmonë bëhen ligjet të jashtëzakonshme, gjithmonë bëhen gabime të jashtëzakonshme.

Mbi bazën e kësaj, unë të kisha fuqi magjike e kisha tërhequr ligjin.

**KRYETARI:** Faleminderit, Milaim!

Grupi 6+ nuk e ka kërkuar fjalën.

Dy deputetë kanë kërkuar fjalën, njëri është mirë të flasë, të dytë nuk mundeni, se jeni pa grup. Mimoza Kusari Lila, fjala për ju.

**MIMOZA KUSARI LILA:** Faleminderit, kryetar!

Po mendoj që diskutimi për dispozitat tranzitore ose për përjashtimet është në kundërshti me vetë parimin e ligjit.

Edhe më herët, kur u diskutua për çështjen e Trustit, nëse ka pasur rëndësi të atillë vitale siç u përmend dhe siç u debatua e u diskutua, atëherë pse nuk u mbajt koeficienti si është, pse afatizohet një rëndësi e një institucioni me peshë. E njëjta është me nenin 27 që tash po e diskutojmë.

Neni 27, në një mënyrë ose tjetër, është modifikim i vendimit të jashtëligjshëm të kryeministrit Haradinaj për rritje të pagave dhe Qeverisë së tij dhe tash për të dalë një vendim i kryeministrit mbi ligjin, është vendosur dispozita tranzitore.

100% jam e sigurt si shumë deputetë në këtë sallë që në momentin kur kryeministri ia ka rritur rrogën vetit dhe ministrave e këshilltarëve politikë, nuk ka qenë i vetëdijshëm se me atë rritje të pagave, rriten edhe rrogat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, domethënë rritja fillimisht ka qenë aksidentale, siç po e dimë të gjithë. Tash, ndodhi kjo rritje aksidentale dhe u implementua për një vit e sa është Qeveria Haradinaj në pushtet.

Në ndërkohë, a kemi pasur performansë më të mirë të rendit dhe ligjit, ose te sistemi gjyqësor? Në ndërkohë, a keni pasur perceptim më të mirë për korrupsionin në vend, në të kundërtën, kemi parametra negativë.

Dhe vetë në esencë baza e Ligjit për pagat, e cila duhet të krijojë një nivelim të bazuar në koeficient, po atakohet me mbajtjen e nenin 27 ose dispozitave tranzitore. Tash pesha e rëndësisë e secilit, prej mësimdhënësve, prej mjekëve, prej gjyqtarëve, prokurorëve, prej Trustit të pensioneve, të gjithë janë me peshë, bile- bile edhe ministrat, edhe deputetë, nëse kishim shkuar në bazë të parimeve për të vendosur një barazi në shoqëri, ishte dashur të kalonte Ligji për

Qeverinë i pari, dhe numri i ministrave prej 22 të binte në 15, edhe numri i zëvendësministrave prej 80 të binte maksimumi në 30, të zvogëlohej numri i këshilltarëve, e atëherë mund të flasim edhe për rritje të koeficientit, se atëherë kemi mundësi të kërkojmë performansë të mirëfilltë. Por tash duke e arnuar ligjin ose duke u munduar të mbahet dispozitë tranzitore, hajde se tash po ua mbajmë gjyqtarëve dhe prokurorëve, e tjerëve po ua zbresim, nuk ka asnjë kuptim.

Atëherë nëse kemi të tilla, domethënë pajtohem me parafolësin që tha nuk jemi gati për këtë ligj, domethënë po duam të vendosim barazi, po jo bash barazi për krejt, ta lëmë dikë jashtë barazisë, hajde ta lëmë dikë jashtë sistemit, i cili ende vazhdon të ketë privilegje.

Nëse jemi për sistem të mirëfilltë e shtet të rendit e ligjit, vendosni me normë më të lartë gjyqtarëve, po jo me dispozitë tranzitore, pse në vitin 2022 ose kur të vijë një ligj tjetër do t'u rënka rëndësia gjyqtarëve e prokurorëve, jo do ta kenë të njëjtin, duhet mirëmbajtur secilin institucion.

Prandaj, ky nen duhet të bjerë, për arsye si i tillë është këtu për të mbajtur jashtëligjshëm një vendim të kryeministrit, që në rend të parë ka qenë i jashtëligjshëm.

**KRYETARI:** Faleminderit! Jemi nga fundi, Islam Pacolli ka një fjalë për gjyqtarët e prokurorët.

**ISLAM PACOLLI:** Faleminderit, kryetar!

Sigurisht që ne jem parti liberale, po jemi dy parti, AKR-ja është vetë dhe Alternativa është vetë.

Me të vërtetë ka shumë këtu çka të bisedohet, unë jam i lumtur që shumë pika janë prekur për ngritjen e pagave të shërbyesve civilë dhe marrëveshja që është arritur me arsimtarët është e rëndësishme që të vijojë mësimi.

Desha ta pyes paraprakisht edhe kryetarin e Komisionit, Nait Hasani, për shërbyes civilë të kullës apo kontrollit ajror në aeroport, një.

Dhe e dyta, propozimi që e ka bërë kolegu ynë, Memli Krasniqi, mendoj që është i rëndësishëm, për arsye që ne kemi institucione të cilat janë të rëndësishme.

Ne nëse duam të funksionojë ligji, atëherë personat përgjegjës duhet pasur kushtet e mira, e pastaj t'u kërkohet edhe përgjegjësi.

Unë shpresoj që ata persona, të cilët ne sot po i përkrahim, ta marrin përgjegjësinë dhe ta kryejnë detyrën në mënyrën më të mirë dhe të mos dalim të zhgënjyer me gjithë këtë përkrahjen që po ua japim. AKR-ja do ta përkrahë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani jemi në përfundim, para votimi, janë dy propozimet. Kryetari i Komisionit në fund. Memli Krasniqi, a ke diçka të shtosh për propozimin? Urdhëro, nëse ke! Edhe jemi në votim, të keni parasysh dy propozime do të jenë.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë desha vetëm të sqaroj diçka çka u tha ndoshta nga parafolës.

Propozimi im s'ka absolutisht të bëjë me vendimin e Qeverisë që ndërlidhet me pagat. Vendimet për barasvlefshmërinë që e kemi marrë më herët mes gjykatësve, prokurorëve dhe ministrave janë në fuqi vite me radhë.

Tash e vërteta është që ky vendim ka ndikuar që ata të kenë një pagë tjetër. Propozimi pse deri në fund të vitit 2022 është se besimi im personal është që vlera e koeficientit që sot është 239 euro, vit pas viti duhet të rritet dhe në një moment po shpresoj në vitin 2023 që kjo vlerë të jetë goxha më e madhe se sa që është sot.

Bazuar në koeficientët që janë paraparë dhe klasifikimi është paraparë për gjithë sistemin e drejtësisë në vend, të jenë pagat mandej të përafërta. Por e kam konsideruar dhe e konsideroj që është goxha arbitrare sot të ndalen dhe shumë prej këtyre rasteve t'u përgjysmohen pagat, të njëjtën kohë kur po lypim fuqizim të sektorit të sundimit të ligjit dhe, mbi të gjitha, sikur të kishte kosto buxhetore financiare shtesë, do të isha rezervuar, por nuk ka asnjë impak financiar, nuk ka asnjë implikim, sepse këtu mjete janë duke u shpenzuar tashmë për këta njerëz dhe normalisht kjo është lehtësimi, i cili ndihmon për këtë propozim.

Kështu që, zoti kryetar, faleminderit për vëmendjen të gjithëve. Qëllimi është që të mos kemi një problem në sektorin e sundimit të ligjit, pavarësisht paralajmërimeve dhe ma merr mendja që është në interesin e të gjithëve, në interesin e vendit, mbi të gjitha, sepse po flasim një prej degëve më të rëndësishme të pushtetit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kryetar i komisionit, fjala juaj është e fundit dhe propozimi i parë votohet propozimi i Komisionit Funkcional.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Dola të arsyetoj qëndrimin e komisionit me shumicë votash, përfshirë nenin 27.

Në komision, para se t'i fillonim procedurat e amendamentit ka ardhur Apostollova e Bashkimit Evropian dhe ka kërkuar sqarime nga komisioni për ligjin dhe për nenin 27, pikërisht për dispozitat kalimtare të këtij neni. Pikërisht për atë që absolutisht pajtohemi me Mimosën, që i tha për nenin 27, është kuptuar që ne jemi kundër prokurorëve, jemi kundër gjykatësve, që është gabim.

Sigurisht që ky ligj e rregullon çështjen e pagave të gjithë atyre që financohen nga buxheti i shtetit. Prandaj, për punën e njëjtë pagë e njëjtë dhe atë që e tha Albulena që një bashkëpunëtor profesional, një ekspert në gjykatë paguhet 500 euro, po as ministri, as Memli nuk reagon sa paguhen gjykatësit e prokurorët sot me vendimin e kryeministrit. Njëri nga gjykatësit e ka 3000 euro rrogën, njëri nga prokurorët po aq, vendimi ka atakuar aksidentalisht, e vërtetë, po a duhet t'i kthejmë në nivelin e pagave, a duhet t'i kthejmë në nivelin e koeficientëve, a duhet ta vendosim drejtësi, me këtë ne nuk po vendosim drejtësi. Me këtë çka po kërkon Memli po kërkojmë ne t'ua zgjasim jetën keqpërdoruesve. A kemi drejtësi më të mirëfilltë që iu ka rritur paga atyre, jo. Luftojmë kundër krimit të organizuar më shumë, jo! Kemi përkundrazi rënie më shumë. Gjithë çështja është sepse ky projektligj që është amendamentuar ose siç është neni 27 thotë: “Ju ruhet paga për vitin e parë, vitin e parë do ta marrin 100%, vitin e dytë do ta marrin 70% të pagës, vitin e tretë do ta marrin 50% të pagës, vitin e katërt do ta marrin 25% të pagës dhe vitin e pestë, atëherë nëse do të ngrihet buxheti, nëse do të mbërrijë ato stazat ose fazat e zhvillimit ekonomik të vendit tonë, atëherë do të barazohemi. Po kush na garanton që ne do t'i ngremë këto paga, ato do të presin atje, askush.

Në anën tjetër, unë them që ata që po thirren, ministri ka lobuar mjaft shumë, nuk e di kush e ka frikën nga prokurori, kush e ka frikën nga gjykatësi, pse ata të jenë të jashtëligjshëm, pse ata të krijojnë privilegje, kush janë ata që të krijojnë privilegje, a po doni drejtësi? Vendosni drejtësinë, kemi vendosur koeficientët, koeficienti është tetë për prokurorin, koeficienti është nëntë për gjykatësin në Gjykatën Kushtetuese, është 7.75 për Gjykatën Themelore, ose 7.25 për krime të rënda ose për Gjykatën Speciale, të gjitha janë të rregulluara.

Prandaj, nëse doni ta qitni mbi presidentin, ai edhe katër vjet ose pesë vjet do ta ketë një pagë 3000 euro, dhe ai do të na mbrojë drejtësinë. Nëse drejtësia mbrohet me paga, është gabim, drejtësia mbrohet me parime, drejtësia mbrohet me ligj, drejtësia mbrohet me ndërgjegje edhe me vullnet që ta luftojë krimin e korrupsionin. Këtu nuk kemi, me këtë çka e shoh unë, Memli do ta mbrojë jo drejtësinë, edhe ministri në anën tjetër nuk po e mbron drejtësinë. Mos u frikësoni për gjykatësve edhe prokurorëve, vendosi që ata të jenë mbrojtës të drejtësisë, jo ata të jenë të privilegjuar me këto amendamente që propozoi Memli. Unë propozoj që ta votoni vendimin e komisionit, të fshihet ky amendament dhe të shkojmë në barazi dhe me atë koeficientin ose barazinë për punën e njëjtë pagën e njëjtë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Kemi pasur një debat shumë të shëndoshë, kemi dy propozime, të cilat do të vihen në votim: propozimi i parë është me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, të cilin e arsyetoi kryetari i komisionit, zoti Nait Hasani. Propozimi i dytë, i cili ka të bëjë për ruajtjen e situatës aktuale të prokurorëve dhe gjykatësve, gjendjes materiale, është propozim i Memli Krasniqit, i cili është pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Këto dy propozime tani dalin në votim. Cili propozim merr vota më shumë, ai aprovohet dhe futet në fuqi. Regjia dhe deputetët të përgatiteni për votimin e amendamentit 50, nën a, për fillim të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

88 deputetë kanë votuar, është e qartë procedura, nuk e di pse po keni këto reagime. 42 për, 41 kundër, 5 abstenime.

Përgatitemi për propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

76 deputetë kanë votuar. 48 për, 21 kundër. 7 abstenime. T'i marr më qartë prej administratës dy krahasimet.

Kalon amendamenti i Memli Krasniqit, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, amendamenti 50.

Shkojmë te amendamenti 51, urdhëroni zonja deputete Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, arsyetoni,

**ARBËRIE NAGAVCI:** Faleminderit!

Edhe amendamenti 51, të cilin unë e kam dorëzuar në nëntor të vitit të kaluar, ka të bëjë pikërisht me këtë nenin 27 dhe me akomodimin që ka tentuar të bëjë Qeveria për vendimin e vet të jashtëligjshëm për rritjen e pagave. Kështu që meqenëse u largua ky nen, unë e tërheq edhe këtë amendament. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Jemi te amendamenti 51, deputetja Arbërie Nagavci pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash. U tërheq, kërkoj falje, se jam duke shikuar gjendjen në sallë.

Atëherë, komisioni ka propozuar amendamentin 52. Votojmë tash!

Amendamenti 52. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 53, po ashtu i ka dy propozime: të Komisionit FunkSIONAL dhe deputetja Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Zonja deputete, a do ta arsyetosh propozimin tuaj? Urdhëro!

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Qëllimi i amendamentit në fjalë është heqja e pagës kalimtare për zëvendësministrat që i keni bërë gati 100, e që s'po dini të ndaleni, pra s'keni tavan. Çka po doni të bëni është që pagën kalimtare ta marrë pas pushimit të funksionit, ta marrin edhe zëvendësministrat. Zëvendësministrat nuk janë kategori kushtetuese, pse duhet zëvendësministrat ta kenë pagën

kalimtare? Mund të arsyetohet, sepse kështu e kanë edhe praktikat e vendeve të tjera, që merr deputeti, ta zëmë, është përfaqësues i popullit, mund ta marrë kryeministri, kryetari i Kuvendit, qysh realisht është e rregulluar, po pse duhet zëvendësministrat?! Prandaj, unë ftoj deputetët, duke pasur parasysh që amendamenti 53 i komisionit është shumë më i mirë se sa si e ka propozuar Qeveria, duhet të votohen dy amendamentet, edhe të komisionit që kanë propozuar, që i heq zëvendësministrat nga paga kalimtare, por edhe ky i komisionit që i ka kufizuar disa privilegje dhe beneficione, të cilat kur vjen Vetëvendosja do t'i heqë krejt, sepse kështu nuk funksionon më. Faleminderit!

**KRYETARI:** Atëherë, shkojmë te komisioni, votojmë amendamentin 53 të Komisionit Funkcional, tash!

Jemi te propozimi i deputetes Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, për të njëjtin amendament ka propozim, votojmë tash!

Kalon propozimi për amendamentin 53, i Komisionit Funkcional.

Amendamenti 54. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 55. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 56. Votojmë tash!

58 deputetë, nuk ka kuorum. Do ta hedh edhe një herë në votim amendamentin 56. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 57. Votojmë tash! Kalon.

Amendamenti 58, votojmë tash!

Urdhëro, Memli Krasniqi, po ashtu Albulena.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit!

Zoti kryetar, ky është ndoshta amendamenti më i rëndësishëm, se është tabela dhe nuk po e marr me qejf të madh fjalën, por realisht është bërë, po shpresoj, ndonjë gabim i vogël te pjesa e administratës, të cilët edhe nëse e kanë bërë, nuk kanë faj, sepse kanë pasur punë të tmerrshme, të mos them, të jashtëzakonshme këto ditë.

Ka pasur një pajtim dhe një amendament që është miratuar, bile është propozuar nga ana edhe e Mërgim Lushtakut si deputet yni në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në marrëveshje edhe me ministrin Gashi, por me mbështetjen, do ta shtoj të gjithë deputetëve, pa dallime, edhe po



ashtu është diskutuar në Komisionin për Legjislacion e kështu me radhë, por nuk ka ardhur si amendament alternativ dhe ka të bëjë me koeficientin e krijuesve dhe performuesve të kulturës dhe të artit.

Realisht janë pesë kategori të krijuesve dhe të performuesve të kulturës dhe të artit dhe propozimet, siç kanë qenë, ka qenë që kategoria e parë të jetë 3.4, e dyta të jetë 3, e treta të jetë 2.6, e katërta 2.1 dhe e pesta 1.9. Kategoria 4 dhe 5 janë ashtu siç i lexova, por ka pasur një ndërhyrje të vogël, një zvogëlim të tri kategoritë e para, andaj propozimi konkret është ky që në tabelë, ju lutem, merreni edhe mendimin e deputetëve të grupeve të tjera...

**KRYETARI:** Kryetar i grupit parlamentar, kështu është çështja, në qoftë se tabela nuk është e njëjtë, duhet të bëhet amendament, e propozon, përndryshe...

**MEMLI KRASNIQI:** Ok! Qe amendamentin, a bën ta them, ta lexoj, në fakt, te krijuesit dhe performuesit e kulturës dhe të artit: 1, nga 3,2 të bëhet 3,4. Te krijuesit dhe performuesit e kulturës dhe artit 2: nga 2,75 të bëhet 3. Te krijuesit dhe performuesit e kulturës dhe të artit 3: nga 2,4 të bëhet 2,6.

Ky është amendamenti, janë kolona 156, 157 dhe 158. Është edhe në dokumentin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, besoj edhe në Komisionin për Legjislacion, ka pasur dakordim të gjerë për këtë punë. Kjo është të ruhen ato paga, të cilat ministri Kujtim Gashi i ka rritur në vitin e kaluar për të gjithë krijuesit dhe performuesit e kulturës dhe të mos i kthejmë për një pasaktësi të paqëllimshme zvogëlimin e pagave të tyre. Pra, vetëm i mirëmbajmë ato paga, të cilat i kanë, realisht i rrisim tek nivelet më të vonshme, por që besoj do të ketë edhe mbështetjen edhe të tjerëve. Ju lutem, zoti kryetar, ta merrni ndoshta mendimin edhe prej partive të tjera. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Albulena Haxhiu, të lutem! Shënohet si amendament.

**ALBULENA HAXHIU:** Në fakt, ne i kemi dhënë mbështetje prej që jemi në këtë legjislaturë, prej bacës Adem Mikullovcit e Saranda, po ashtu edhe në Komision për Legjislacion, ashtu siç kanë kërkuar, në fakt, krijuesit dhe të tjerët. Prandaj, ky ka qenë edhe rekomandimi i Komisionit për Legjislacion për Komisionin për Administratë, por dje u ulën koeficientët dhe nuk e di pse. Mirëpo, unë nuk e pata fjalën për këtë, natyrisht e mbështesim, sepse Saranda Bogujevci flet, por ajo çka po dua të shtoj në emër të grupit, nuk mund ta votojmë amendamentin që është për pjesën tabelare pa i diskutuar amendamentet e deputetëve që i keni në vijim, sepse ndoshta ndonjë prej amendamenteve të deputetëve kalon, prandaj është e rëndësishme që pjesa tabelare që ka edhe amendamente në pjesën tabelare, të jetë amendamenti i fundit që votohet, pra pasi që të trajtohen edhe amendamentet e deputetëve që janë pas pjesës tabelare, ka edhe të komisioneve parlamentare.

Prandaj, kjo është logjika që duhet ta ndjekim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deri tani e kemi një propozim, po e shoh zonja Safete vetëm pak, Lumir Abdixhiku, pastaj vazhdojmë.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Vetëm desha të konfirmoj që Komisioni për Buxhet dhe Financa, me propozimin e deputetit Lushtaku e ka aprovuar dhe e ka amendamentuar kërkesën në fjalë dhe si të tillë e ka dërguar në Komision për Administratë Publike. Është e habitshme pse s'është si amendament në propozim, sepse e kemi dërguar si amendament dhe në këtë vijë formulimin që zoti Krasniqi e bëri, është në vijë me propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe e mbështesim si të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vetëm pak, zonja Shqipe Pantina.

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Në fakt, ndoshta edhe për shkak të punës të madhe dhe të lodhshme që ka bërë komisioni, nganjëherë tjetër gjë kemi votuar atje, e tjetër gjë mandej është përfshirë në tabelën përfundimtare. Dje në komision ka pasur mbështetje unanime për këtë amendament, sepse ka ardhur edhe nga legjislacioni, edhe nga buxheti, mandej kryetari kur e ka hartuar, pothuajse pa na pyet, pa votim, i ka ndërruar koeficientët dhe i ka nxjerrë në tabelë gati pothuajse pa e marrë votën tonë, kështu që unë besoj që edhe kolegët janë këtu, por dje ka pasur votë unanime që ky propozim të përkrahet.

Prandaj, edhe sot ne e përkrahim këtë propozim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani Blerta Deliu-Kodra e ka fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryetar!

Vetëm për korrektësi, bashkë me një pjesë të anëtarëve të komisionit, me Sarandën dhe me një pjesë të anëtarëve kemi qenë në Komisionin për Administratë dje. Ka qenë kërkesë e mëhershme që të rriten pagat e komunitetit artistik dhe të performuesve të artit dhe të kulturës.

Ministri ka bërë një rritje, aktualisht komuniteti artistik, të gjitha kategoritë që i përmendi zoti Krasniqi marrin pagat me rritje. Megjithatë, dje në komision do të thotë koeficienti aktual ka pasur një ulje që, në fakt, i bie që komuniteti artistik do t'i marrin pagat me ulje nëse ne votojmë për amendamentin që është amendamenti i Komisionit për Administratë Publike. Prandaj, propozoj që atë që e tha edhe zoti Krasniqi që ne të përkrahim amendamentin e Mërgim Lushtakut në Komisionin për Buxhet, në mënyrë që përfundimisht të zgjidhim një herë e mirë këtë çështje, meqë aktualisht këta performues të komunitetit artistik, në mungesë të ligjit pagat i

kanë me një rregullore që është hartuar nga Ministria e Kulturës dhe besoj shumë që numri i tyre është i ulët. Ata po bëjnë një punë të mirë dhe meritojnë që të përkrahim sot amendamentin, në mënyrë që pagat e tyre të jenë paga të dinjitetshme.

**KRYETARI:** Faleminderit! Armend Zemaj, Saranda Bogujevci, po shkon, Armend, fjala për ju, bëhet gati Saranda Bogujevci.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, kryetar!

Pasi jemi te pjesa tabelare, mendoj që komisioni ishte dashur t'i qartësojë 2-3 pozicionet që po ndërliidhen edhe me këta artistët që po i përkrahin artistët. Janë dy kategori domethënë që ka diskrepancë në vetë funksionet çfarë i kryejnë këto. Po e zëmë, ekspertët që janë të fushës në Prokurorinë Speciale iu ka ulur koeficienti për dallim prej ekspertëve në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial. Ose Avokatura shtetërore. Avokatura shtetërore, e cila i mbron të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës dhe i përfaqëson dhe e kisha lutur komisionin tash, pasi po propozojnë ndryshimet e koeficientëve, t'i parashohin edhe këto dy kategori, të cilat janë shumë të rëndësishme, edhe numër të kufizuar, por edhe të rëndësishme së punës sipas natyrës dhe funksionit çfarë e kanë, në mënyrë të njëjtë me institucionet e tjera të drejtësisë, e cila i dallon pothuajse me nga 2-3 koeficientë.

**KRYETARI:** Faleminderit! Saranda Bogujevci e ka fjalën, bëhet gati Rasim Selmanaj.

**SARANDA BOGUJEVCI:** Faleminderit, kryetar!

E kisha vlerësuar kur e kërkoj fjalën në fillim të më jepet mundësia, besoj që herëve të tjera e ke në konsideratë këtë. Kështu, tek çështja e amendamentit që u përmend prej Memli Krasniqit, kërkesa ka qenë qysh në fillim prej ministrisë është përkrahur në Komisionin për Legjislacion dhe në Komisionin për Buxhet. Është bërë një punë me një kohë të gjatë me artistë dhe krijuesit, të rregullohet një rregullore, ku përmbushen kërkesat e këtij komuniteti.

Çka dua të përmend është se, mendoj që është shumë me rëndësi të vlerësohet puna e komisionit, për shkak që të dhënat rreth këtyre ndryshimeve i kanë marrë shumë me vonesë. Kështu që këtu komisioni nuk ka pasur faj dhe e vlerësoj shumë punën e tyre që e kanë bërë. Propozimet janë dhënë dhe po kërkoj prapë edhe prej anëtarëve të komisionit, pra edhe prej deputetëve të tjerë që ta përkrahin këtë amendament, për shkak që është bërë një punë që një kohë të gjatë dhe mendoj që është me rëndësi të votohen këto ndryshime. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! E dini, me aq sa po e shoh, rrjedha e diskutimeve po shkon njëjtë, a shkojmë te këto dy propozime, për faktin se më tepër është një lloj vetëm fjalë, unë fjalën juaj jap, por të njëjtat propozime, nuk ka diçka të re, urdhëro Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Këtu po e shoh që po bëhet pak një garë se kush e ka propozuar, kjo pjesë mua s'më intereson, por dëshiroj të them që dje në mbledhjen e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, përfshirë edhe kryetarin e komisionit, ky amendament e ka marrë përkrahjen e të gjithëve, prandaj unë nuk e di si ka ndodhur që kjo të mos jetë e përfshirë në këtë rast.

Kështu që Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës i jep mbështetje që këta koeficientë për njerëzit e kulturës të rriten. Faleminderit!

KRYETARI: Po shihet që ka edhe gabime njerëzore, të mos vazhdojmë më tutje. Unë jam i obliguar ta vë propozimin e Komisionit FunkSIONAL, se e kemi me letra kështu, mund të rrëzohet ai, pastaj kalon propozimi, të cilin e keni bërë, i obliguar jam, s'mundem pa e nxjerrë propozimin e Komisionit FunkSIONAL, pastaj mund ta hedh propozimin e Memli Krasniqit, me ato ndërrime, në qoftë se ka. Safete Hadergjona, po e shoh reagimin, urdhëro fjalën!

SAFETE HADERGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Është krejt e natyrshme që kur ka kështu punë pak me ngarkesa, lëshohen edhe gabime në përgatitjen e raporteve përfundimtare. Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka paraqitur Komisionit për Administratë Publike 2 amendamente: amendamenti i parë, i cili është paraqitur është bërë pjesë e raportit përfundimtar. Kurse, amendamenti i dytë që ka pasur të bëjë me performuesit dhe krijuesit e kulturës, nuk ka hyrë si amendament në kuadër të raportit përfundimtar, gjë që duhet të figurojë në raportin përfundimtar të Komisionit FunkSIONAL sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Zonja deputete, më lejo edhe një herë për hir...

SAFETE HADËRGJONAJ: Unë propozoj që amendamenti i Komisionit për Buxhet të hedhet në votim, i plotë ashtu siç është paraqitur para Komisionit për Administratë Publike. Ajo ka të bëjë me ndryshimin e pikës, siç e tha Memli.

KRYETARI: A ka mundësi edhe një herë të flas, se unë po e shoh dëshirën të secilit të flasë, por në qoftë se doni ta zgjidhim këtë çështje, duhet marrë vendim, të votojmë. Historia ka përfunduar me ardhjen në seancë, i keni dy mundësi: komisioni e ka sjellë një propozim dhe, në qoftë se ka qenë gabim, po besojmë, por kjo duhet të votohet dhe duhet të rrëzohet. Në qoftë se dëshironi të votoni tjetër gjë, e keni edhe një propozim që e ka dhënë Memli Krasniqi, e votojeni atë, ose mbetet i Komisionit FunkSIONAL me ato gabime.

Urdhëroni, kush dëshiron prej deputetëve të flasë? Memli Krasniqi, a ka mundësi ta artikulojë amendamentin, kush do të bëjë amendament, pastaj flisni secili deputet, jua hedh në votim, të mos e maltretojme publikun dhe seancën.

**MEMLI KRASNIQI:** Zoti kryetar!

Është e vërtetë që duhet ndoshta nganjëherë sqarime kështu krejt bazike, sepse është goxha e rëndësishme. Ju keni të drejtë në atë që po thoni, unë propozova plotësim-ndryshim, pa dyshim, por kolegët deputetë, për ata që kanë paqartësi. E kemi ne amendamentin 58, është amendamenti i komisionit, ne duhet ta votojmë këtë, edhe ky amendament është kështu qysh është, ky del në votim, nuk del ky me plotësim, Safete, ky del në votim, 58-shi, me këto gabimet që i përmenda unë. Dhe, unë po jap një propozim alternativ, amendamentin, ta quajmë “58b”.

Çka po kërkoj të përmirësohet, janë ato që i thashë, a po më kuptoni? Ta kemi të qartë se po kam drojë mos po gabon ndonjë deputet në votim pa qëllim, edhe sekretaria le të na ndihmojë. Një herë vendoset amendamenti i komisionit, apo jo, hedhet poshtë nëse bëhet ajo çka po them unë. Pastaj, vendoset edhe amendamenti me ndryshimet që po i propozoj unë në këtë tabelë dhe nëse merr shumicën e votave, mbet ai. Kallëzomëni mos e kam unë gabim, apo e ka gabim ndokush tjetër dhe pastaj duhet saktësuar amendamentin, se s’e kam kryer.

**KRYETARI:** A ka mundësi të futemi në votim për dy propozime, të mos maltretohemi, nënkryetar, urdhëro!

**KUJTIM SHALA:** Faleminderit, zoti kryetar!

Mendoj që s’është e nevojshme të votojmë dy herë, mund të votojmë amendamentin e komisionit, me plotësim-ndryshimin e propozuar, meqë ai mund të reflektohet drejtpërdrejt te tabela. Domethënë, vetëm një votim, me plotësim-ndryshim.

**KRYETARI:** A ka mundësi Memli, brenda amendamentit diktoi koeficientët dhe mos na maltretoni, ju lutem. Po shoh dakordancë të gjithëve, kjo është e mira, a ka mundësi? Pastaj ta jap fjalën gjithsesi.

**MEMLI KRASNIQI:** Në rregull! Faleminderit, kryetar!

Besoj që është në rregull, kur ka dakordim prej deputetëve, unë dëshiroj që amendamentin tim të saktësoj edhe te çështja e universiteteve, ku pavarësisht miratimit që mund ta konfirmojë komisioni, nuk është i reflektuar në tabelë dhe e kam fjalën për pozicionet nga rendi 133 deri 140. Pra, prej profesor i rregullt, profesor emeritues, këshilltar shkencor, pastaj profesor i asociuar, profesor asistent, bashkëpunëtor shkencor, ligjërues në universitet, lektor në universitet, asistent në universitet, hulumtues i pavarur dhe, në fund asistenti i ri, të gjitha këto prej F1 në F8 nuk u është reflektuar rritja prej 0,1, nga ajo që na njoftuan edhe kolegët nga komisionet. Andaj kërkoj mirëkuptimin që të bëhet pjesë e amendamentit edhe kjo. Dhe, po ashtu propozoj që në

kuadër të këtij amendamenti të bëhet edhe e treta, që ndërlidhet me rendin 29, ku është e përfshirë drejtori i përgjithshëm i Transmetuesit Publik RTK, i cili propozoj që të fshihet, sepse besojmë që paga e drejtorit të Radiotelevizionit të Kosovës duhet të përcaktohet si tavan me ligjin për RTK-në, të cilin e kemi në procedurë. Të mos krijohen keqkuptime të cilat mund ta definojnë që RTK-në po e trajtojmë sikur të jetë televizion shtetëror.

**KRYETARI:** Tani kemi dalë në tri ndërhyrje. Nën një, për artistët me atë koeficient, të cilin e ka propozuar kryetari i GP të PDK-së, Memli Krasniqi. Nën dy, universitetet dhe ato të cilat janë përmendur me 0,1, dhe nën tre, që RTK-ja të largohet nga ndërhyrjet politike.

Jo, tash unë do t'ia jap fjalën secilit grup parlamentar. Armend Zemaj, qëndrimin. Pastaj dilni secili grup parlamentar. Dalim në votim. Mund që në këtë amendamentin 58 t'i futim të gjitha.

**ARMEND ZEMAJ:** Kryetar, pikësëpari, pa dashur të ndërhyj në parimet që...

**KRYETARI:** Afroje më afër për shkak të zërit.

**ARMEND ZEMAJ:** Për shkak që i ka dhe i lejon edhe Rregullorja e Kuvendit çdo deputeti, çdo grupi parlamentar, është e pandershme që pozita si mazhorancë dhe e cila ka qenë edhe pozitë në Komisionin Funkcional, edhe jeni Qeveri, tash të tregtoni me amendamente, me koeficientë për çdo kategori, e cila në momentet e fundit mund të ketë pakënaqësi të caktuara.

Tash dëshironi të hyni edhe në baza personale, edhe familjare, edhe kolektive, edhe grupe për të caktuar koeficientë për çdo individ, i cili është i pakënaqur në momentin e fundit dhe po e detyroni Kuvendin, po i detyroni deputetët që t'i shfaqin pakënaqësitë dhe është fyerje për Komisionin Funkcional, i cili ka punuar më shumë se një muaj ditë. Po na vini në lajthitje tash me këto propozime, duke futur 3-4 propozime brenda një tabele, e cila nuk është në rregull. Andaj e kisha lutur edhe propozuesin. Mirëkuptimi ishte për performuesit artistikë dhe për disa kategori të cilat janë specifike dhe i ndihmojnë zhvillimit të vendit, e jo tash për teke personale e individuale t'i vini deputetët pa dallim në pozitë të palakmueshme, ashtu siç po tentohet të degradohet edhe vetë Ligji i degraduar faktikisht i pagave.

**KRYETARI:** Faleminderit! Nga PDK-ja, e dëshiron dikush fjalën? Nga Vetëvendosja, Albulena Haxhiu.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Tash po ndalem te disa çështje që lidhen me tabelën, meqë u hap diskutimi dhe s'po shoh që jeni të pajtimit që tabela të votohet në fund. Dhe, duke qenë kështu, unë dje isha në Komisionin për Administratë dhe aty i propozuam kërkesat e Inspektoratit Policor të Kosovës, që kanë të bëjë me largimin nga shërbyesit civilë, sepse Inspektorati Policor i Kosovës janë policë të Policisë, pra i

hetojnë policët. Ata janë të armatosur dhe nuk ka asnjë logjikë që të njëjtit të lihen shërbyes civilë dhe kjo u miratua në Komision. Por pastaj, te pjesa tabelare e pashë që vetëm për inspektorët në Inspektoratin Policor të Kosovës janë futur në pjesën tabelare.

Prandaj, nëse dikush po mban shënime, atëherë unë po e lexoj propozimin për Inspektoratin Policor. Pra: Inspektorati Policor i Kosovës, kryeshefi ekzekutiv të jetë në linjë të njëjtë me ndihmësdrejtorin e Departamentit të Policisë. Pastaj, drejtuesi i Departamentit në Inspektoratin Policor të Kosovës të jetë 179, nënkolonel në Policinë e Kosovës, pra në linjë të njëjtë, dhe 181 majror në Policinë e Kosovës të jetë i barasvlershëm me udhëheqës i Divizionit në Inspektoratin Policor të Kosovës.

Pastaj, i kemi disa amendamente që lidhen me Shërbimin Korrektues të Kosovës, që besoj që është tepër e rëndësishme dhe kërkoj mbështetjen e deputetëve të Kosovës për këtë amendament, që është tepër i rëndësishëm. Pra, ne kemi propozuar amendament që Shërbimi Korrektues i Kosovës të jetë i ranguar sikur Policia, mirëpo ky amendament nuk na është përkrahur nga Komisioni për administratë dhe është gabim i madh që nuk e kanë përkrahur, sepse ata kanë kompetenca dhe kanë jashtëzakonisht vështirësi në punë, po ashtu sikur Policia e Kosovës.

Prandaj, propozimi është që të futen në linjë të njëjtë me koeficientët sikur në Polici. Pra, po e lexoj, sepse po e shoh që zyrtarët e Administratës të Komisionit janë këtu: Udhëheqës i pavijonit në Shërbimin Korrektues të Kosovës sikur kapiten në Polici, pra me koeficient 3; Mbikëqyrësi i lartë në Shërbim Korrektues, sikur toger në Polici; Mbikëqyrës i lartë në Shërbimin Korrektues sikur rreshter në Polici; Oficer me përvojë pune mbi një vit, polic i lartë në polici, koeficienti 2.2; Oficer korrektues me përvojë 1 - 10 vjet me koeficient 2; polic në polici dhe oficer kadet, viti i parë i punësimit me koeficientë 1,9, polic i ri.

Tjetra që ka të bëjë me bashkëpunëtorët profesionalë, propozimin që e kemi proceduar Komisioni e ka marrë parasysht, por jo edhe koeficientin. Ne kërkojmë që koeficienti 3,5 për bashkëpunëtorët është shumë i vogël, sidomos pas votimit të fundit që propozoi për gjyqtarët dhe prokurorët, prandaj ne kemi propozuar me amendament dhe në kohë të duhur që koeficienti i tyre të jetë 5. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Ahmet Isufi, fjala për ju, në emër të Aleancës.

**AHMET ISUFI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne jemi te amendamenti 58 dhe konsideroj që ato vërejtjet që u dhanë nga z. Krasniqi të votohen, pastaj të kalohet në tema të tjera dhe në amendamente të tjera, sepse po shihet që deputetët kanë amendamente të tjera. Por, tani për tani, e kemi amendamentin 58. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Milaim Zeka, nga Nisma.

MILAIM ZEKA: Jo valla kryetar po t'i jap ty minutat e mi se moti e kam pritur fjalën. S'kam asgjë, no comment, gjë s'jam duke marrë vesh çka po zihet. Jemi bërë këtu sikur të jetë Komisioni kur kemi punuar ne. Tash krejt deputetët janë shndërruar në anëtarë të Komisionit për Administratë Publike. Nait, urime, je Komisioni më i madh. Kështu që bile mund të bëhesh edhe kryetar i Kuvendit, në qoftë se shkojmë kështu me amendamente.

KRYETARI: Me emër të Zotit! Faleminderit shumë, edhe e meriton. Nait, si kryetar i Komisionit, fjala për ju. Ka një propozim të Memli Krasniqit. Kryetari i Komisionit tani e jep propozimin. Nait, derisa nuk ishte këtu, u biseduan disa propozime. Anëtarët e Komisionit thanë se janë trajtuar, por nuk janë vënë në tabela, ka pasur gabime të paktën teknike, apo administrative.

NAIT HASANI: Faleminderit kryetar i Kuvendit!

Po më vjen çudi nga ministri i Administratës që nuk ka asnjë reagim. Këtu e keni gjetur një ministër që është i komunitetit pakicë dhe nuk po ka mundësi të llobojë, e ka ndoshta mundësinë e vogël, apo hiç s'ka mundur të llobojë, të kundërshtojë, pikërisht duke e krahasuar ministrin e Drejtësisë, edhe ministrat e tjerë që kanë lobuar dhe po llobojnë që ta prishin tabelën dhe ta kemi një tabelë të çakorduar, e cila do të jetë në kundërshtim me të gjitha.

Në marrëveshjen për ngritjen e koeficientit për mësuesit prej edukatorit deri te mësimpldhënësi i shkollës së mesme, dje ka qenë kjo tabelë dhe kemi kërkuar që kjo tabelë, këto koeficientë të rriten për 0,1. Mësueseve, do të thotë nga edukatorja, që ka qenë 1,9 deri te drejtorët e shkollave të mesme, që janë 2,7, e tash janë bërë me 2,9. Gjithë kjo ka qenë ngritja, jo për nivelin e lartë universitar. Tash del Memli sikur bëri pak më parë, del tjetri që do ta bëjë më vonë. Do të kemi amendamente e amendamente, dhe duhet t'ua ngremë. Tregoni kush kujt i ka mbetur, cili dajë, cila teze, cila hallë, që po thotë Milaimi t'ia ngremë koeficientin. Veç kallëzoni. Hajdar, a ke ndonjë koeficient për të ta ndrequr?

Prandaj, unë nuk pajtohem me këta, sepse është prishje e rendit dhe e ligjit, prishje e tabelës, që është në kundërshtim me çdo gjë. Performuesit e artit që kanë ardhur dhe e kanë sjellë ditën e fundit, ministri thotë i kam rregulluar ata me rregullore. Edhe unë kisha mundur ta bëj një rregullore për t'ia rregulluar dikujt të Komisionit, por e kemi një rregullore që është mbi ne, është ligji. Prandaj, performuesit e artit, edhe më herët u kam thënë, që nuk ka shkallë që mund ta masë vlerën e tyre. Vlera e tyre është e pamatshme për shkak se janë performues të formave të ndryshme të artit, a kulturës, a arteve, a pikturës, a skulpturës. Ndoshta ne nuk e kuptojmë mjaft mirë pikturën, ose nuk e shohim mirë skulpturën, por diku ka vlera. Vlerat e jashtëzakonshme janë vlera të papërcaktuara që nuk maten me asnjë vlerë, me asnjë gradë, me asnjë çmim, por në rrethanat ku jemi ne, si është vendosur koeficienti 3,2 e është kërkuar 3,4, është se drejtori i tij e



ka 3,2. Nuk mund të shkosh mbi drejtorin. Kjo është çështja. Performuesi i artit që merr pjesë është 3,2, ne duam ta lëmë drejtorin me 3,2, e performuesin e artit ta bëjmë 3,4. Kjo ka qenë kërkesa. Për këtë nuk kemi mundur të pajtohemi me kërkesat që kanë ardhur nga Komisioni për Buxhet, nga Komisioni për Financa dhe nga Integrimet apo nga Komisioni për Ligje, prandaj kërkesa është që ne i kemi rritur koeficientët e tyre. Vetëm dy koeficientë kanë rënë nën nivel, që është dashur të bien. Koeficienti 1,9 është ruajtur, koeficienti 2,1 është ruajtur, 2,4 është ruajtur, 2,75 është lëvizur, është zbritur për 0,20 dhe koeficienti 3,2 është për 2. D.m.th., nga 50 euro i kanë mangut këta që janë performues të artit.

Prandaj, le ta gjejnë një mundësi tjetër t'i rregullojnë, po mos të hyjnë ta prishin. Mos t'i nxjerrë artistët e formave të ndryshme mbi drejtorët e tyre, sepse do të jemi në kundërshtim.

Në këto çështje ka shumë dëshira. Unë mund t'ju falënderoj, por ministri është dashur të dalë e të thotë që ky ligj duhet të tërhiqet në formën që është prekur koeficienti. Ky ligj nuk krijon më barazi, ky ligj nuk krijon pagën e njëjtë për punën e njëjtë. Ju po kërkonit individët t'i ngremë, individët po doni t'i ngrini, po frikësoheni nga gjykatat, ja ku i keni gjykatat. Tash, unë e di që ndoshta do të mi lëshoni mua krejt ata gjykatës të më hetojnë ku jam e ku s'jam, po megjithatë unë jam këtu në Kuvend të Kosovës, jam në Kosovë, s'e kam mendjen të ik, por të gjithë ata që i keni votuar, dijeni që e keni frikën dhe për shkak të frikës e keni bërë.

**KRYETARI:** Hera e parë që dëgjova që Naiti është frikësuar. 15-16 vjet i ka mbajtur burg, e s'është mërziur as për gjykatës, as për prokurorë, se për të drejtën ka luftuar. Po, Nait, ti je gjithmonë në të drejtën, mos u mërzi.

Kështu, Memli Krasniqi a mundësi të na japësh propozimin e dytë. Unë i vendos variacionin A - Komisioni Funkcional, dhe varianti B që e propozon ti, amendamenti 58. Të lutem, dhe na qartëso!

**MEMLI KRASNIQI:** Zoti kryetar, faleminderit!

Më duket me propozimin e nënkryetarit Kujtim Shala u pajtuam që kjo të jetë jo të votohet një herë e dy herë, por të votohet veç një herë propozimi të cilin po e jap. Nëse ky propozim s'kalon, mbetet tabela kështu siç është dhe propozimi im është konkret: të fshihet pika 29, drejtor i përgjithshëm i Transmetuesit Publik - RTK, për arsyet që i shpjegova, dhe të bëhet rinumërimi i të gjitha pikave që vijnë më tutje, ose rëndeve. Pastaj, çdo rend nga ajo që është aktualisht, 133 deri 140 janë në transkript, se i përmenda prej profesor i rregullt deri te asistent i ri, sipas marrëveshjes që e konfirmuat të gjithë të shtohen për 0,1, sepse nuk janë reflektuar përkundër asaj që thanë kolegët që ka pajtueshmëri të miratohet. E fundit, rendi 156 te krijues dhe performues të kulturës dhe artit 1, koeficienti 3,2 të bëhet 3,4. Te 157-shi, krijues dhe performues të kulturës dhe artit 2, 2,75 të bëhet 3 dhe te krijues dhe performues të kulturës dhe të artit 3, te 158-shi, 2,4 të bëhet 2,6, të tjerat mbeten kështu si janë. Ky është amendamenti, po besoj goxha

konkret. Pra, i trajton kulturën dhe artin, i trajton universitetet publike dhe kërkohet që të hiqet RTK-ja që të trajtohet me ligjin për RTK-në. Kjo është.

**KRYETARI:** Faleminderit! Ky është propozimi B. Vetëm pak, s'prish punë. Kryetari i Komisionit, ti je i fundit. Kryetar i Komisionit në fund, edhe pse e sqarove, por edhe një herë.

Saranda, a e dëshiron fjalën? A ke propozim? Propozim! Mos gjykoni në bazë të kësaj që jam duke folur. Urdhëro, a e keni propozimin C?

**SARANDA BOGUJEVCI:** Më fal, veç sqarim këtu. Te pjesa e krijuesve dhe artistëve që u bë propozimi, d.m.th. të gjithë kemi qenë të pajtimi që kjo pjesë të ndryshohet. Po më vjen keq, por për pjesën tjetër të propozimit të Memlit unë nuk mund të jap mendim, ose nuk dua të votoj në atë. Të ndahen gjërat. Të mbetet pjesa e parë e ndryshimit të artistët e krijuesit, me kërkesën që e paraqiti Memli, por të shkojmë vetëm me atë pjesë. D.m.th., kështu e kemi diskutuar të gjithë dhe kemi qenë të pajtimit të gjithë që këtë pjesë ta ndryshojmë.

Edhe një diçka që desha edhe një herë ta shtoj, që mendoj se nuk u bë e qartë. Të dhënat për Komisionin kanë shkuar shumë vonë, për Komisionin Funkcional, kështu që edhe një herë dua të falënderoj shumë Komisionin për punën që e ka bërë dhe që i ka marrë përsipër këto kërkesa për ndryshime. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Megjithatë znj. Bogujevci nuk na thatë propozimin tjetër. Qëndrimin e thatë, por a dëshironi të formuloni amendament, variacion të amendamentit 58 tjetër, apo dëshiron veç të mbani qëndrim në bazë të këtyre të dyjave, të cilat i kemi tani? Tash ta ketë parasysh, se nuk është faji te ju, por unë jam i detyruar si rregull procedural. Ai e ka bërë një propozim, ajo do të jetë. Ju mund ta bëni një propozim, i cili mund të jetë si të doni, ne e përkrahim vetëm pjesën e krijuesve, por nuk e përkrahim këtë, këtë, këtë, dhe ky është qëndrim. Për këtë arsye desha, a doni të bëni propozim?

**SARANDA BOGUJEVCI:** Ok! D.m.th., propozimi është që në amendamentin 58, në pjesën e tabelës 156, prej koeficientit 3,2 të bëhet 3,4, 157 prej 2,75 në 3 dhe në 158 prej 2,4 në 2,6, qysh fillimisht u propozua edhe nga z. Krasniqi. D.m.th., ky është propozimi.

**KRYETARI:** Atëherë e kemi propozimin C, neni 58. Urdhëro nënkryetar, fjala për ju!

**KUJTIM SHALA:** Faleminderit z. kryetar!

Edhe një herë, plotësim-ndryshimi ka vlerë, ka kuptim vetëm për amendamentin 58, e që ka të bëjë me krijuesit dhe performuesit. Asgjë tjetër. Përtej kësaj është propozim i ri që lidhet me amendamentet e tjera dhe nuk mund të propozohet kështu në bllok. D.m.th., unë po propozoj që amendamenti 58 të hidhet në votim vetëm njëherë me plotësim-ndryshimin për koeficientët që

kanë të bëjnë me krijuesit dhe performuesit. Asgjë tjetër. Pastaj kategoritë e tjera janë çështje krejt tjetër, që s'lidhen me këtë amendament.

KRYETARI: Mos e ndërprit nënkryetar, por unë s'mund ta bëjë atë pa e bërë kryetari i Komisionit, se ai i vetmi e ka atë mandat për këtë propozim tuajin. S'mund ta bëni as ju, as unë, se kryetari i Komisionit e ka mandatin. Këta na kanë sjellë të shkuar diçka, Komisioni e ka në dorë. Jo, jo, kryetar Komisioni është Naiti, Armend. Urdhëro, nënkryetar!

KUJTIM SHALA: Edhe një herë, propozimi për plotësim-ndryshimin e amendamentit nr. 58 është i Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe duhet ta paraqesë formalisht dikush, njëri nga anëtarët në emër të këtij Komisioni, që të mund të ecim më tutje.

KRYETARI: Kryetar i Komisionit, e ke një situatë, kur mund të na nxjerrësh nga kjo gjendje, ose duhet të shkojmë me votime, e votime, e votime. Kryetar i Komisionit, jemi në përfundim. Jo, ju lutem, nuk ka më diskutime. Kryetar i Komisionit, fol për procedura, pastaj flasim më ndryshe.

NAIT HASANI: Faleminderit edhe një herë, po i shohim kërkesat dhe dëshirat individuale për t'i ruajtur drejtorët, ose t'i ruajmë tezet e Milaimit që na thotë, prapë po duhet t'ia përmendi emrin, se shumë e ka të qëlluar këtë. Nëse duam ta ruajmë dhe ta heqim pikën drejtori i përgjithshëm i Transmetuesit Publik, po tregojmë që jemi duke i ruajtur interesat individuale. Nuk jemi duke bërë ligj. Ne e kemi vendosur këtë, se është një ligj që e kemi marrë edhe model, që ligji në Kuvendin e Kosovës që na e kanë kushtëzuar socialdemokratët, është ligji i modelit të Sllovenisë. Në ligjin e Sllovenisë, drejtori i transmetuesit publik slloven është në ligjin e pagave, me koeficient.

Prandaj, modelin e kemi, të gjitha i kemi, të gjithë transmetuesit publikë që financohen nga shteti e kanë nivelin e përcaktuar të pagave. Televizioni i Kosovës, për Memlin dhe për të tjerët që po duan ta heqin, duhet ta dinë se i merr 12 milionë para të Buxhetit Kosovës, 8 milionë prej tyre i çojnë në pagat e tyre. 8 milionë euro paga i ndajnë ata për nevoja të veta. Unë s'kam asgjë kundër Transmetuesit Publik, përkundrazi. Jam për ta rregulluar Transmetuesin Publik, jam që ata të jenë në nivel. Nëse ata do të fuqizohen, do të rriten, nëse ata kalojnë në buxhetin e pavarur, ky amendament, ose kjo pikë nuk vlen. Nëse ata kalojnë si ndërmarrje publike, transmetues publik që financohen vetë, kjo nuk vlen, ata le ta rritin pagën, le ta bëjnë pagën sa të duan, sa të kenë mundësi. E kemi thënë edhe në Komision, e kemi thënë edhe më herët, Tereza Mej, kryeministre e Britanisë së Madhe, e ka rrogën 120 mijë funte, drejtori i BBC-së e ka 400 mijë funte për shkak të...

KRYETARI: Nait, a ka mundësi, se këto janë diskutime për Komision, vetëm qëndrimin. Do të thotë, ti mendon të dalë në votim varianti që e ke sjellë në seancë. Nuk pranon të bëhen ndërhyrje.

NAIT HASANI: Para Komisionit jemi duke folur tha Milaimi, kështu që jemi duke e diskutuar pikën e Komisionit.

KRYETARI: Jo, jo, thashë ta vëmë në votim, se unë po mundohem të vë diçka në votim. A pranon që kulturën, të paktën...?

NAIT HASANI: Unë kërkoj që të votohet amendamenti dhe tabelat si i ka bërë Komisioni. Asnjë plotësim-ndryshim i askujt, përveç një gabim teknik që nuk është vendosur ku është ambasadori një ministër fuqiplotë, që është një gabim teknik, që duhet përmirësohet. Prandaj, të gjithë të tjerët janë në rregull. Performuesit e artit janë në rregull, televizioni është në rregull. Lus deputetët ta votoni tabelën siç është. Mos bëni ndryshime, mos e shkatërroni ligjin!

KRYETARI: Faleminderit. Do të koncentrohemi njëherë vetëm te kultura. Zonja Hadërgjonaj, e keni edhe një alternativë, Komisioni për Buxhet dhe Financa t'i vërë këto dyja në votim, që ndërlihet edhe me atë që e tha Memli.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë kërkoj që amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa të hidhet në votim dhe të miratohet.

KRYETARI: Na a lexo të lutem, për deputetët.

SAFETE HADËRGJONAJ: Unë kërkoj që amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa të hidhet në votim dhe të votohet për, ashtu siç e ka propozuar Komisioni për Buxhet. Ky amendament të jetë me numër 58, kurse amendamenti nr. 58 kalon në numër 59 dhe e votojmë.

Amendamenti 58 është i Komisionit për Buxhet dhe Financa, i cili thotë në shtojcën 1 të Projektligjit të ndryshuar me amendamentin 53 të Komisionit Funkcional bëhen ndryshimet si në vijim: Në pikën 153, në pozitën krijuesit dhe performuesit e kulturës dhe të artit 1, koeficienti nga 2,75 ndryshohet në 3,4. Në pikën 154, në pozitën krijuesit dhe përfituesit e kulturës dhe të artit, koeficienti nga 2,4 ndryshohet në 3. Dhe, në pikën 155, pozitën krijuesit dhe performuesit e kulturës dhe të artit 3, koeficienti nga 2 ndryshohet në 2,6. Ky është amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe kërkoj që ky amendament të votohet me numër 58, kurse amendamenti nr. 58 të kalojë në amendamentin nr. 59 dhe të vazhdojmë më tutje.

KRYETARI: Zonja Shqipe, fjala për ju!

SHQIPE PANTINA: Jo, unë desha edhe proceduralisht, se tashmë u bë një lëmsh i madh këtu. Amendamenti 58 është tabela në tërësi. Çdo amendament pas 58-shit, duke filluar prej amendamentit 59-77, hidhet poshtë mandej automatikisht.

Nëse fillojnë ndërhyrje të tilla në tabelë, atëherë vërtet prishet balanca e kësaj table dhe atëherë secili prej nesh kemi të drejtë të propozojmë ndërrim të koeficientëve. Kjo tabelë është hartuar pas debateve të mëdha, pas ndërhyrjeve, kërkesave herë proceduralisht, herë në kundërshtim me procedurat, por si komision ne kemi arritur në përfundim të kësaj table.

Ne jemi dakord që t'i mbështetim edhe performuesit e artit. Tash, nëse votohet amendamenti i komisionit, njëmend e prish balancën e tabelës, e atëherë përgjegjësinë le ta marrë pra seanca, por në momentin që votohet amendamenti 58, që është tabela, çdo amendament pas kësaj nuk ka më kurrfarë vlere. Proceduralisht ta prishë pastaj krejt tabelën. Kështu që, ose 58 duhet të jetë i fundit dhe të votohen amendamentet tjera, ose në momentin që votohet tabela, që është aktualisht amendamenti 58, amendamentet tjera duhet të tërhiqen të gjitha. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Do të dalim në përfundim. Amendamenti 58, do të votohet kështu; Komisioni Funkcional, propozimi që është, ai të cilin e ka dhënë Nait Hasani. A ndërro mendje, apo njëjtë? Pak më ndryshe, hajde tash, të lutem!

NAIT HASANI: Kryetar!

E kam një propozim që kemi harruar t'i futim edhe këta shërbyesit civilë dhe kuvendarët e Prishtinës, t'i veçojmë pak prej komunave të tjera.

Unë po kërkoj që t'ua ngremë... Propozim i tyre ka qenë 15%, po meqë këtu ka vullnete të mira, unë propozoj që t'ua rritim për 20% mbi nivelin e të gjithë atyre... Të gjithë po jetojmë në Prishtinë, ky ka qenë propozim edhe i Arbanit, edhe i Imetit, prandaj të kalojmë me 20% mbi këto nivele, kështu që ta kemi një mundësi më të mirë. Ne po jetojmë në Prishtinë.

KRYETARI: Jo, jo, mjaft më! Nuk do të toleroj diskutim në këtë çështje. Kryetar i komisionit, a ka mundësi tjetër...

NAIT HASANI: ...si amendamenti i Safetës edhe i Memlit, edhe i Shqipes, edhe i tjetrit, por le të hyjë amendamenti... për Komunën e Prishtinës.

KRYETARI: Nuk do ta transformojmë seancën në diçka, e cila e humb kuptimin. Kështu, jo vetëm pak! Çdo propozim që e keni pas këtij propozimit të amendamentit 58, e bëni në amendament të ri. Në këtë rast, do të jetë vetëm për krijuesit. Koncentrohemi, i kemi dy

propozime; Komisioni FunkSIONAL dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, cili të marrë vota më shumë, kalon.

Safete Hadërgjonaj e dha propozimin, Nait Hasani e arsyetoi në Komisionin FunkSIONAL. Regjia, deputetët, përgatitemi për votim! Së pari, Komisioni FunkSIONAL çdoherë, keni parasysh, me të cilin krijuesve nuk u rritet paga.

Me Komisionin për Buxhet dhe Financa u rritet paga ajo të cilën e kanë publike edhe iu është premtuar. Atëherë, votojmë amendamentin 58, propozim i Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Të nderuar kolegë deputetë, kthehuni në sallë, për arsye se opozita zakonisht nuk po voton në shumicën e rasteve, por le të kthehen në sallë, në qoftë se dëshirojnë. Ka të bëjë me artistët.

Propozimi i Komisionit FunkSIONAL i mban këto paga të cilat i kanë, nuk ua rrit. Propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, krejt diskutimet ishin që t'u rriten, kjo është vendimarrje juaja.

Edhe njëherë, deputetët le të votojnë, 61 duhen, përndryshe. Komisioni FunkSIONAL, votojmë tash! Ky është votimi nëpërmjet të cilit me këtë vendim nuk u rriten pagat. Do të thotë, i sanksionojmë.

Tash është propozimi i dytë për Komisionin për Buxhet dhe Financa. Shkojmë në votim. E diskutuam, e shterëm. Me këtë jo, u mbeten pagat siç e ka propozuar, do të thotë...

Tash, propozimi variacioni dy i Komisioni i Buxhetit, votojmë tash!

Faleminderit, deputetë! Kalon ngritja e pagave për krijuesit, sepse e meritojnë. Pra, kalon ky i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Ato për profesorë, edhe për RTK-në, bëjeni një amendament, në qoftë se dëshironi e hedhim në votim. Për aq sa e bëmë për Këshillin Gjyqësor, edhe për Këshillin Prokurorial, të njëjtën.

Kalojmë në amendamentin 59 të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Urdhëroni, a ka dikush diskutim? Prisni pak, ndërpritet votimi. Më fal, se Komisioni për Shëndetësi ka për ta sqaruar, ka të drejtë. Urdhëro, zonja kryetare, Besa Baftiu.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryetar!

Unë e mora fjalën që t'i sqaroj rreth amendamentit që e ka propozuar Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Amendamentin që deputetët e kanë para vetes e ka pësuar një ndryshim. Në mbledhjen të cilën sot Komisioni për Shëndetësi e ka mbajtur ka marrë vendim që koeficienti 6 për mjekë specialistë të jetë 5,5, ndërsa për infermierë me bachelor të jetë 2,8 nga 3,0.

Më lejoni që ta sqarojë apo ta jap arsyen pse komisioni e ka marrë një qëndrim të tillë. Duke e pasur parasysh se koeficientët prej 5 e deri në 12 fillimisht janë ndryshuar dhe duke e pasur parasysh që këto koeficientë kanë pësuar ndryshime, ne si komision kemi propozuar që amendamentet të zvogëlohen prej 6 në 5,5 për arsye se është një kosto më e madhe buxhetore me 6, andaj kemi dashur që ta bëjmë një kompromis dhe që ky amendament të kalojë.

Prandaj, unë i ftoj të gjithë deputetët që ta votojnë amendamentin i cili është votuar në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, dhe herën e parë i ka marrë votat e të gjithë anëtarëve të komisionit, mirëpo edhe herën e dytë me këto ndryshime është votuar nga komisioni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ministri i Financave e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Disa pozita të disa organizatave buxhetore që realisht mund të shkojnë me kosto shtesë mbi këtë çka është dhënë në deklaratën financiare nuk mund të them që nuk mund të akomodohen brenda Buxhetit të Kosovës.

Mbi të gjitha, nëse kalohen koeficientë të caktuar për kategori të caktuara, të jemi të sigurt që do ta kenë efektin zinxhir të të gjitha kategoritë tjera dhe do të shkaktojnë pakënaqësi dhe do të shkaktojnë kosto financiare që buxheti i shtetit nuk do të mund t'i akomodojë brenda kornizave që garantojnë stabilitetin makrofiskal.

Prandaj, kur kemi të bëjmë... I kuptoj dhe i mirëkuptoj deputetët, edhe të profesioneve të ndryshme, edhe ata që flasin për arsimin, edhe ata që flasin për policinë, edhe për shëndetësinë, edhe për të gjithë. Mirëpo, megjithatë, duhet të ruhen disa ekuilibra, që unë besoj që në të ardhmen do të ketë vend të korrigjohet edhe kjo. Por, nëse krijohen shpërprurje të atilla, ju siguroj që do të shkaktojë, sipas bindjes sime, s'do të thotë që unë 100% po e flas atë që mund të ndodhë, por sipas bindjes sime do të shkaktojë probleme tek të gjithë sektorët tjerë në zinxhirë dhe do të shkaktojë kosto, e cila do ta bëjë ligjin pastaj të paimplemtueshëm, sepse nuk mund të financohet.

Prandaj, unë e kam obligim që t'ju lus që në votimin tuaj ta keni në konsideratë këtë çështje. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Nga një përfaqësues i grupeve parlamentare na e jepni qëndrimin. Naser Rugova, urdhëro!

**NASER RUGOVA:** Faleminderit!

Zoti kryetar, ky është njëri nga ligjet më të rëndësishme dhe duhet të jemi shumë të kujdesshëm që të mos e prishim organikën dhe parimet e këtij ligji.

Në si Komision Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale i kemi pranuar kërkesat e të gjithë komunitetit të mantelbardhëve, të punëtorëve shëndetësorë. I kemi trajtuar me kujdes dhe e kemi bërë një kompromis, sepse ka qenë koeficienti nga 1-12, tani është nga 1-10.

Është kërkesë legjitime që mjekët specialistë ta kenë koeficientin 5,5. Të mos harrojmë, sepse nuk ka shëndetësi cilësore pa kujdesin e infermierëve, dhe duhet t'ua ngremë koeficientin edhe infermierëve. Bile, u bëj apel kolegeve deputete, sepse 80% të infermierëve janë femra.

Prandaj, Lidhja Demokratike e Kosovës, ashtu siç e ka ngritur dorën edhe në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, do ta votojë këtë propozim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Nga PDK-ja një, jeni dy. Memli Krasniqi, urdhëro!

**MEMLI KRASNIQI:** Zoti kryetar!

Ky amendament është ligji. Domethënë, ky amendament e prish të gjithë atë që e bëmë ne deri tash. S'di pse nuk kemi folur për këtë amendament njëherë, pastaj do të mund të flisim për atë se çfarë bëmë ne deri tani.

Thënë të drejtën, amendamenti i Komisionit për Shëndetësi gjeti goxha mirëkuptim. Këta nuk e kanë pasur shumë përgjegjësinë që të mendojnë si Komisioni për Administratë Publike, dhe kanë bërë propozime të jashtëzakonshme, të cilat, sikur të ishte Kosova Luksemburg, unë mendoj që do të duhej të bëheshin edhe më të mëdha.

Problemi tjetër është, atë që ju nuk e lejuat zoti kryetar, që të vendoset propozimi im edhe për universitetet publike, edhe për çështjen e RTK-së, edhe për çështjen e performuesve, domethënë tri kategori të ndryshme, këto janë tri kategori të ndryshme.

Këtu nuk po flasim ne vetëm ta zëmë për atë që e tha Naser Rugova për infermieret. S'është amendamenti vetëm për infermieret, ndoshta do të votonim ndryshe sikur të kishte qenë veç për



infermieret. Por, këtu është futur rritja e koeficientit për mjekë, për stomatologë, për inspektorë shëndetësorë, për farmacistë, për fizioterapeutë, për psikologë klinikë, për infermierë, mami, teknikë mjekësorë. Disa me bachelor, disa pa bechelor. Jemi duke folur për gjithë sistemin shëndetësor me një amendament.

Unë kam mirëkuptim që një komision, që e ka përgjegjësinë në kuptimin e asaj që i përfaqëson edhe këto interesa të bëjë kësi propozimi, por nëse i kemi në njërën anë deklaratimet e ministrit Hamza, qëndrimin e Qeverisë në përgjithësi e të Ministrisë për Administratë Publike dhe po ashtu amendamentet dhe tabelën që e miratuam deri tash, kjo i bie që e gjitha që është bërë deri në këtë moment është e kotë, sepse kjo e ndryshon totalisht strukturën e buxhetit dhe nuk na thanë propozuesit se sa është kostoja shtesë.

Ngase nëse kostoja shtesë mund të jetë ta zëmë 15 milionë euro në vit, është mirë që të na tregoni se kujt duhet t'ia presim që t'i japim këta 15 milionë. Përndryshe, propozim shumë i mirë. Veç edhe ta kemi arsytimin sesi kanë menduar që ta realizojnë. Ose të bëhet ashtu siç ma imponove ti mua personalisht, zoti kryetar, po shkojmë po votojmë për infermieri ndaras. Për mami, ndaras. Për psikologë klinikë, ndaras. Për fizioterapeutë, ndaras. Për mjekë të mjekësisë familjare, ndaras. Për specialistë, ndaras. Atëherë, ma merr mendja do të kemi votime shumë më mirëkuptuese sesa ky votim që do ta kemi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Nga Lëvizja Vetëvendosje, Fatmire Kollçaku.

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Faleminderit!

Është për t'u habitur sesi e futët në votim tabelën para se të shqyrtohen edhe amendamentet tjera që i patëm. Ishte një propozim shumë i mirë që tabela të lihet që të votohet në fund.

Kryetar, ju e keni sot një propozim tjetër nga komisioni për të cilin unë kam votuar kundër. Prandaj, fillimisht duhet ta sqaroni këtu situatën se çka do të votohet, propozimi i sotëm që u paraqit nga kryetarja me gojë, sepse nuk është arritur që të përgatitet dokumenti i shkuar apo ky amendament, të cilin e komentoi edhe kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së pak më herët.

Po e shtroj një pyetje, meqenëse koeficienti 6, i cili paraqitet në amendamentin e komisionit të datës 8 nëntor të vitit 2018, ky është i vetmi të cilin deputetët e kanë para vetes, dhe e shtroj a është kjo një kërkesë aq e habitshme përderisa këtu kërkohet të ruhet paga e drejtorit të Trustit 5 600 euro, ndërsa për një kirurg, kardiokirurg, neurokirurg kërkohet paga 1 400, qenka diçka aq e habitshme, apo po kërkohen standardet si në Amerikë apo diku tjetër në Evropë, kur dihet fare mirë si janë pagat e kirurgëve atje. Nuk krahasohen me asnjë profil tjetër. Janë marramendëse, sepse vlerësohet puna e njerëzve që kanë bëjnë me jetën e njerëzve.

Nuk është kjo demagogji. Ne si Lëvizje Vetëvendosje i kemi pasur amendamentet, të cilat falë marrëveshjes që e kemi arritur në komision që t'i harmonizojmë qëndrimet, i kemi tërhequr.

Këtu përpara i kemi koeficientët, unë nuk e di a e dinë qytetarët, a kanë lexuar dhe a kanë pasur mundësi që ta dinë se cili është amendamenti i propozuar nga komisioni. Por, vetëm dy po i përmend, sepse janë më të përfolura. Ne kemi kërkuar që propozimi i Qeverisë për koeficientin 5 për mjekë specialistë të ngrihet nga 5 në 6 dhe ky ka qenë kompromisi që e kemi arritur me të gjitha grupet parlamentare. Dhe, për infermierë që janë me shkollim bachelor të ngrihet në koeficientin 3.

Këtu përfshihen edhe shumë kategori të tjera, nuk e di se a kam kohë t'i lexoj. Ndoshta do të ishte mirë që qytetarët të jenë në dijeni se çfarë po votohet këtu. Aq sa kam kohë nga grupi, e kisha shfrytëzuar rastin që amendamenti i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie dhe Sociale kërkon që për titullin e pozitës mjekë specialistë klasa 2,3, koeficienti 5 të zëvendësohet me koeficientin 6, fusha e zbatimit mjekë specialistë nga të gjitha lëmenjtë në sektorin e shëndetësisë, duke i përfshirë mjekë specialistë të mjekësisë familjare dhe specialistë të stomatologjisë.

Pas titullit mjek specialist të shtohet titulli specialist i farmacisë klinike dhe specialist i kimisë sanitare të shtohet klasa D7/1 me koeficient 5,5.

Titulli i pozitës mjek në specializim, stomatolog në specializim, farmacist në specializim klasa D6 koeficienti 3,65 të zëvendësohet me koeficientin 4,5. Të plotësohet titulli i pozitës me mjek i përgjithshëm, stomatolog i përgjithshëm, farmacist, inspektor shëndetësor klasa D7, koeficienti 3,4 të zëvendësohet me koeficientin 4,0.

Titulli i pozitës fizioterapeut, psikolog klinik klasa D7 të shtohet 3,20 fusha e zbatimit me shkollim universitar 3 deri në 4-vjeçar, të punësuar në institucionet shëndetësore dhe në institucionet tjera, ku ushtrohet profesioni përkatës.

Titulli i pozitës infermier, mami, teknik mjekësor 1 klasa D14, koeficienti 2,20 të zëvendësohet me koeficientin 3,0, fusha e zbatimit me shkollim bachelor të punësuar në institucionet shëndetësore dhe në institucionet tjera, ku ushtrohet profesioni përkatës.

Titulli i pozitës infermier, mami, teknik mjekësor, fizioterapeutë, klasa D18, koeficienti 1,90 të zëvendësohet me koeficientin 2,4. Fusha zbatimit me shkollim të mesëm të punësuar në institucione shëndetësore dhe në institucione tjera, ku ushtrohet profesioni përkatës teknik i autopsisë.

Në fund, titulli i pozitës ndihmësinfermier, mami, teknik mjekësor, klasa D21, koeficienti 1,70 të zëvendësohet me koeficientin 2,0. Fusha e zbatimit me shkollim bachelor të punësuar në institucione shëndetësore dhe në institucione tjera, ku ushtrohet profesioni përkatës.

U mbetem borxh edhe inspektorëve sanitarë, por edhe inspektorëve shëndetësorë të cilëve fillimisht duhet t'u zgjidhet statusi ashtu siç u përket dhe pastaj të diskutohet për koeficientët e tyre, sepse padrejtësisht inspektorët sanitarë dhe inspektorët shëndetësor janë të anashkaluar, të nënçmuar e të mos themi se çfarë roli të rëndësishëm luajnë sa i përket përshkrimit të punës së tyre.

Prandaj, kërkoj që ta dimë këtu se çfarë do të futet në votim, të na tregojë kryetari i Kuvendit. Dhe, pastaj ne do të marrim vendim për votim. Mendoj që vazhdimi i nënçmimit të profesionistëve shëndetësorë nuk i kontribuon përmirësimit të situatës në këtë sektor. Një padrejtësi 20-vjeçare që u është bërë deri tani mendoj që duhet të korrigojohet tani, por është e qartë që ajo çfarë kërkoj unë është përmirësimi i kushteve të punës së profesionistëve shëndetësorë dhe përmirësimi i pozitës së pacientit, ngase tek e fundit është më i rëndësishmi kur flasim për sektorin e shëndetësisë.

**KRYETARI:** Edhe një herë, kemi të bëjmë drejtpërdrejt me një situatë kur më tepër po shikohet manipulimi sesa të drejtat e punëtorëve.

Në qoftë se ky ligj nuk kalon, atë që dua ta them publikisht; mund të qajë secili, po edhe të manipulohet në mënyrë elektorale, pasi s'e ka peshën e përgjegjësisë, se ky është Buxheti i Republikës së Kosovës, por të gjithë doktorët, specifikisht arsimtarët, edhe për një vit do të mbeten pa paga, me këto paga të cilat i kanë, do të thotë pa iu rritur paga doktorëve 60-70%. Pa iu rritur 30% arsimtarëve, e të gjithë këtyre.

A dalim te situata, votoni apo jo? Më nuk ka vend për debat.

Është propozimi, por keni sqaruar, keni dhënë. Të gjithë deputetët e kanë të shkruar, ju lutem! Ju po lexoni, unë po e kuptoj për hir të asaj që të fitoni vota dhe është legjitime, por mos abuzoni me seancën.

Të shkojmë në votim. Amendamenti 59, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, e votojmë "po", "jo"!

Në qoftë se ke amendament, dil e thuaje, lexoje dhe ta qesim në votim edhe me kaq e morëm vesh. Gjuhën shqipe e kuptojmë.

Zonja Shqipe Pantina e kam parë reagimin, por ju kisha lutur që të shkojmë drejt votimit. Mos luani me ndjenjat e njerëzve, të cilët kanë nevojë për përkrahje, vetëm pse mundni.

**SHQIPE PANTINA:** Faleminderit!

E para, veç t'ia përkujtojmë secili vetes që jemi në lexim të dytë. Diskutimet sesi do duhej të bëhej ligji është dashur të bëheshin në lexim të parë, e para. E dyta, në momentin që është votuar tabela e propozuar nga komisioni me disa ndryshime për artistët, çdo amendament pas këtij që hidhet në votim, vetëm sa e bën ligjin të pazbatueshëm, sepse nuk ka më kuptim. Tabela është një nen, një amendament i vetëm, këto tjerat janë propozime që të plotësohet tabela.

Tash, nëse kalojnë e bëjnë ligjin të pazbatueshëm. Propozimi im është që pas amendamentit 58, ose të tërhiqen, ose të hidhen në votim të gjitha menjëherë edhe të votohen kundër, nëse duam që ligji të jetë i zbatueshëm.

Nëse duam që veç të marrim poenë dhe të bëjmë fushatë, atëherë në rregull, vazhdojeni siç e keni filluar.

**KRYETARI:** Ministër, fjala për ju!

*(Reagime nga salla)*

Më fal zonja deputete, me respekt! Zonja deputete, me respektin e madh, s'ka ndodhur sa kam qenë kryetar, mos i jep zor se ta jap fjalën... Ta jap fjalën në mikrofon, mos u lodh. Ta jap, por veç shkojmë me rend, të lutem! Mos krijoni situata të paqena.

Urdhëro zonja deputete, ministri po tërhiqet. Ia jap fjalën secilit, por mos e dramatizoni çka nuk është për t'u dramatizuar. Urdhëroni, zonja deputete!

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Deputetja parafolëse tha që çdo votim tash e tutje qenka non sens, sepse ne e paskemi votuar tabelën. Kryeparlamentar, shtrohet pyetja: pse nuk e aprovat propozimin e koleges sime, zonjës Albulena Haxhiu, e cila shumë qartë ju dha vërejtje, të mos futemi në votim të tabelës pa u përfunduar amendamentet.

Atëherë, po ju pyes, a jemi në rregull të vazhdojmë me paraqitjet, se amendamenti 59 është pas 58-shit, unë nuk kam pasur mundësi ta lexoj amendamentin 59 para 58-shit. Vetëm ju keni mundur të vendosni rregull këtu.

Atëherë, shtroj pyetjen, cilin amendament do ta futni në votim? Sot kryetarja e komisionit e parashtrroi një ndryshim për amendamentin e komisionit, për të cilin unë kam qenë kundër. Ju

shtraj pyetjen: a do ta votojmë propozimin e ndryshuar sot, apo këtë që e kemi të gjithë përpara për të ditur si të votojmë, të jeni të qartë?

Përndryshe, kjo me tabelë, pres që sekretaria e Kuvendit ta sqarojë, përndryshe, atë çka e tha deputetja Shqipe, që kjo s'paska më logjikë të vazhdojë votimi, kërkoj sqarim nga ju.

KRYETARI: Zonja deputete, për korrektësi, edhe të publikut, edhe për deputetët, çdo vendim të cilin e merr kjo seancë, është i plotfuqishëm, të kesh parasysh, mund të kenë qëndrimin edhe ministri, edhe deputeti, thotë se po ndodhi të votohen këto propozime, prishet balanca, prishet ligji, kjo është çështje tjetër, vendimmarrja është juaja. Ndoshta ju deri tani keni votuar për një drejtim, 61 deputetë, mundet, nga tash e keni ndërruar mendjen dhe e ktheni, kjo është vendimmarrja juaj, të jem më korrekt. Çdo vendim, të cilin e kemi, këto amendamente të cilat janë nga 59 deri në amendamentin 77, unë do t'i hedh një nga një në votim, edhe në qoftë se ato e prishin ligjin, ju vendosni, s'vendos unë, do të thotë, do të votohen të gjitha.

Ministër, fjala për ju, ama të gjitha do të shkojnë në votim.

MINISTRI URAN ISMAJLI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj t'ju them që e dëgjuat edhe ministrin e Financave, i cili realisht foli edhe për një mundësi që amendamentimet, të cilat ndodhin pa planifikim, mund të na krijojnë një situatë, ku ligji nuk arrin t'u bëjë ballë kërkesave tona, të cilat i kemi bërë.

Të kalojmë pak në historik të kësaj pune.

Rrogat në sektorin e shëndetësisë janë rritur si asnjëherë më parë dhe kjo e arritur për shkak të një pune të komisionit, të Qeverisë, të ministrisë, domethënë kemi arritur një punë të përbashkët, nuk po dua të them që atë çfarë e kam bërë, e kam bërë vetë. Mirëpo, të keni parasysh, në rast se propozimet tona, të cilët ne i kemi dërguar, i kemi kalkuluar mirë dhe kanë ardhur deri këtu tentohen në çfarëdolloj forme t'u qitet pengesë, apo barrë më e rëndë financiare, keni rrezik se krejt ajo rritje e cila ka ndodhur do të shkojë në pikën zero.

Prandaj, unë ju ftoj që ta votoni atë ligj, i cili është në fund i realizueshëm, ato amendamente, të cilat në fund janë të realizueshme. Në të kundërtën, ne mund të bëjmë një fontanë dëshirash, secili deputet mund të dalë, edhe unë mund të dal si ministër i Shëndetësisë dhe të shpreh këtu një fontanë dëshirash, po a jepen rrogat, a i marrin ato rroga, është pyetje tjetër.

Ne e kemi një ligj, i cili u garanton mundësi mjekëve dhe infermierëve që të marrin si asnjëherë më parë një rrogë, të cilin e kanë pritur ndoshta më shumë se 20 vjet.

Prandaj, ju lutem, bëni ligjin, votoni ligjin që të arrihet t'i merrni ato rroga, e jo të mbajmë fjalime në Kuvend e në fund të tentohet të votohet një ligj, i cili nuk arrin t'ua realizojë të drejtën.

Kemi bërë shumë, është arritur shumë, të votohen ato që për momentin i keni brenda Komisionit FunkSIONAL. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Jemi duke tentuar ta përfundojmë, zonja Besa Baftiu, vetëm pak, do t'ju jap fjalën dhe futemi në votim pastaj.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryetar!

E mora fjalën edhe një herë për sqarim, se me sa e pashë, Fatmirja tha cilin amendament po e votojmë? Normalisht se po e votojmë amendamentin që e keni ju para, me dy ndryshime, që i thashë paraprakisht, kjo është e vërteta. Prandaj, këtu nuk ka asnjë konfuzitet, për arsye se është amendamenti që e kanë përpara deputetët, vetëm me ndryshimet që koeficienti 6.0 për mjekë specialistë, tani është 5.5 dhe koeficienti 3.0 tani është 2.8 për infermierët, kjo është e tëra. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votim të amendamentit 59.

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!

Nuk ka kuorum të mjaftueshëm, i lutem regjisë t'i thërrasë deputetët.

Kolegë deputetë, ju kisha lutur të vini në sallë, për faktin se kemi bërë një punë deri në amendamentin 59, për korrektësi, pas amendamentit 58 vendimmarrja është juaja, por çdo ndërhyrje e sjell në pikën zero krejt 58 amendamentet e kaluara, ta keni parasysh. Tanimë unë do të hedh për votim çdo amendament të propozuar, por çdo ndërhyrje i sjell në pikën zero të gjitha këto çka i kemi votuar. Do të thotë, në qoftë se kalon ndonjëra, kthehen ligji dhe bëhet jofunksional. Kjo është ajo të cilën duhet ta dimë.

Të keni parasysh edhe një herë, për korrektësi, nuk dua të imponoj asnjë qëndrim. Me votimin e amendamentit 58, shtojca 1 dhe 2 është mbyllur kjo tabelë. Tash çdo votim veç bie në kundërshtim me këtë çka keni votuar deri tani. Ne po shkojmë formalisht, të gjitha do t'i votojmë, përnjëherë, varet prej propozuesit, për faktin se Albulena Haxhiu, deputetja dhe Arbërie Nagavci janë propozueset e 80% të këtyre amendamenteve, pastaj Bekim Haxhiu, Imet Rrahmani dhe Lumir Abdixhiku, mund të kem gabuar ndonjë.

Armend Zemaj, po kur të vij atje, po do ta tërheqësh, a shkojmë një për një shpejt? Deputetët a kanë ardhur në sallë?

Amendamenti 59. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash! Nuk kalon.

Zonja Albulena Haxhiu, i keni disa amendamente, a dëshironi t'i bëni bashkë apo doni një nga një të shkojnë? Urdhëro, fjala për ju!

ALBULENA HAXHIU: Së pari, amendamentet 60, 61 dhe 62 tërhiqen për shkak të votimit që gjyqtarëve dhe prokurorët të mos u zvogëlohen pagat, sepse propozimet konkrete që i kemi propozuar janë rritje të koeficientit për gjyqtarë dhe prokurorë, po meqë kaloi amendamenti, tash ne tërhiqemi nga 60, 61 dhe 62.

Po vazhdoj me amendamentin 63 tash. Ka të bëjë me bashkëpunëtorët profesionalë.

KRYETARI: Të lutem, zonja deputete, ta konstatoj. Amendamentet 60 deri 62 u tërhoqën nga vetë propozuesja.

Amendamenti 63.

Regjia të lutem, fjalën Albulena Haxhiut.

ALBULENA HAXHIU: Amendamenti 63 ka të bëjë me bashkëpunëtorët profesionalë në kuadër të sistemit të drejtësisë. Siç e përmenda edhe më përpara, aktualisht ata marrin pagë tepër të vogël në krahasim me punën që e bëjnë dhe natyrisht kjo krijon edhe pakënaqësi të shumta.

Komisioni për Administratë ka propozuar që koeficienti të jetë 3.5 për bashkëpunëtorë profesionalë, po tash ne me që u dakorduar që gjyqtarëve dhe prokurorëve të mos ua ulim pagat, atëherë propozimi është që koeficienti për bashkëpunëtorët profesionalë të jetë 5 dhe kërkoj mbështetjen e deputetëve të Kuvendit për këtë amendament.

KRYETARI: Shkojmë në votimin e amendamentit 63! Regjia dhe deputetët përgatitemi për votim. Votojmë tash! Pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Nuk kalon.

Amendamentet 64, 65, 66, zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Pra, ishte një amendament që ka të bëjë me infermierët, ai nuk kaloi më herët dhe ky është propozimi, të cilën nuk po e tërheq, meqë amendamenti nuk kaloi.

Pra, propozimi është që infermierët, titulli i pozitës infermier, mami, teknik mjekësor një, vendoset në klasën siç ka qenë, po me koeficient 2,70. Titulli i pozitës infermierë, mami, teknik vendoset në klasën E1 me koeficient 2,20, titulli i pozitës infermier, mami, teknik mjekësor vendoset me koeficient 2.

KRYETARI: Jemi në votimin e amendamentit 64. Po, urdhëro!

ALBULENA HAXHIU: Jo, kjo është manipulim, sepse unë kam kërkuar 2,7, e aktualisht e kanë 2,2. Tash unë nuk po e gjej në tabelë ku është.

KRYETARI: Nuk ka debat, zonja deputete, vetëm propozimin e hedh në seancë, mos u lodh, e vendos seanca.

ALBULENA HAXHIU: Jo, jo, nuk mund ta nxjerrësh në seancë pa e verifikuar se a rritet apo u zbritet koeficienti infermierëve, sepse 2,7 është më shumë se 2,2. prandaj këtë duhet verifikuar edhe një herë.

KRYETARI: Zonja deputete, cili është qëndrimi?

Amendamenti 64.

Deputetja Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, votoni tash! Nuk kalon.

Amendamenti 65.

Zonja Haxhiu, ju kisha lutur vetëm koncentrim, të shkojmë amendament për amendament.

ALBULENA HAXHIU: Propozimi është tepër i rëndësishëm, prandaj edhe kërkoj vëmendjen.

Ka të bëjë me Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe propozimi është që udhëheqësi i pavijonit në Shërbimin Korrektues të Kosovës, koeficient 3, pra të rangohen sikurse policia.

Mbikëqyrësi i lartë në Shërbimin Korrektues, me koeficient 2,75. Mbikëqyrësi i lartë në Shërbimin Korrektues me koeficient 2,4, oficer me përvojë pune mbi një vit 2,2 koeficientin, oficer korrektues me përvojë pune 1 deri 10, me koeficient 2 dhe oficer kadet, viti i parë i punësimit, koeficient 1,9 dhe në këtë pikë unë kërkoj që edhe ministri i Drejtësisë që në përshkrim të detyrave të tij e ka Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe nuk ka bërë asgjë për Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Andaj, e ke obligim të dalësh dhe ta kërkoj votën e deputetëve të Kuvendit për Shërbimin Korrektues të Kosovës, e ke obligim, e ke përshkrim të detyrave. Lej prokurorët dhe gjyqtarët, se me ata merret Kuvendi i Kosovës, siç e the më përpara, se unë e kuptoj pse t'i merresh me ta, sepse e ke në interes të merresh për shkak që të të amnistojnë ndonjëherë ty ose njerëzit e tu.

Prandaj, kërkoj votën e deputetëve të Kuvendit, sepse ata janë duke pritur që ky amendament të kalojë. Faleminderit!



KRYETARI: Faleminderit! Edhe një herë, në qoftë se do të kishte pasur mundësi, megjithëse është legjitime kjo për t'i tërhequr votuesit, të thuhet amendamentin për arsye se dihet për çka është, po shkojmë.

Urdhëro, Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, mendoj që nuk është aq i parëndësishëm Shërbimi Korrektues i Republikës së Kosovës dhe faktikisht nëse atje është rregulluar në pjesën përmbajtjesore të ligjit, janë hequr nga shërbyes civilë dhe kanë status të veçantë, unë mendoj që duhet të saktësohet, e bëra pyetjen edhe në fillim, duhet të saktësohet saktë koeficienti dhe grada e tyre, është e domosdoshme.

Ju e dini që edhe në Raport të Progresit, edhe në gjendjen, atë që ne e quajmë reale në Republikën e Kosovës, Kosova është kritikuar për mospërkrahjen e Shërbimit Korrektues në Republikën e Kosovës.

Dhe, ju e dini se çka ka ndodhur, si ndodh dhe si janë menaxhuar pikërisht për shkak të kësaj mospërkrahjeje.

Andaj, mendoj që ky amendament duhet të trajtohet, sepse nuk po lejoni tash të preket në pjesën tabelare. Shumë kategori në mënyrë të padrejtë po mbesin jashtë kësaj tablele dhe përsëritja e fjalisë time, diskriminimi po ndodh, sepse po ulën pagat për dikë, ndërsa drejtpërdrejtë po rriten për dikë tjetër vetëm në bazë të përkrahjes që po mundohen këtu të arrihen, qoftë përmes grupeve parlamentare, qoftë përmes Komisionit FunkSIONAL.

Andaj, një ndër shtyllat kryesore të shtetësisë dhe të sistemit të drejtësisë është edhe Shërbimi Korrektues në Republikën e Kosovës. Kështu që këta koeficientë janë realë dhe duhet të jenë saktë edhe në tabelë, nuk është ndërhyrje, është rregullim i gjendjes së tyre.

KRYETARI: Faleminderit! Ministër, a e dëshiron fjalën?

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Pra, edhe pagat në Shërbimin Korrektues, edhe të prokurorëve, gjyqtarëve, kanë qenë në kuadër të buxhetit të paraparë. Pavarësisht tendencës që kishim prej komisionit për t'i ulur pagat e gjyqtarëve, prokurorëve, ky ka qenë një kompromis yni me Ministrinë e Financave, ky propozim qysh ka ardhur prej Qeverisë, këtu është bërë maksimumi.

Ne e kemi rritur numrin e Shërbyesve Korrektues qysh s'është rritur asnjëherë, pra, 120 dhe jemi duke i rekrutuar për 80 gjatë vitit të ardhshëm, kështu që kjo ka qenë maksimumi që kemi arritur të bëjmë për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe normalisht, do të jemi në koordinim dhe në

linjë të plotë me Ministrinë e Financave, të mos kemi probleme, të cilat oficerët korrektues në shtator ose tetor na mbesin pa paga, duke iu referuar edhe buxhetit që do ta votojmë sot.

KRYETARI: A ka mundësi të shkojmë në votim, po urdhëro, se je propozuese. Urdhëro!

ALBULENA HAXHIU: Është shumë interesant, se sa herë vjen fjala për shërbyesit civilë, për Shërbimin Korrektues, në këtë rast, për zjarrfikësit, gjithmonë thuhet se s'ka buxhet, Pse nuk po thoni s'ka buxhet kur më përpara votuat për shtesat e deputetëve, ta zëmë, po u drejtohem sidomos deputetëve, ose kur votuan që pakën kalimtare ta marrin edhe zëvendësministrat, ose kur kërkohen miliona t'i jepen Behtel&Enkës, pse nuk flitni atëherë që s'ka buxhet.

Prandaj, zoti ministër, edhe një herë po ta bëj të qartë. Detyra jote e punës është të merresh me Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ata janë në një gjendje të rëndë, prandaj ka ardhur ky amendament, nuk është imi, është nga sindikatat, sepse unë s'e kam ditur sa i kanë koeficientët. Prandaj, kërkoj mbështetjen e deputetëve të Kuvendit për këtë amendament.

KRYETARI: Shkojmë në votim,  
Amendamenti 65.

Deputetja Albulena Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, ligji është në pyetje, votojmë tash!

Është legjitimitet i opozitës t'ju pengojë, t'jua rrëzojë buxhetin, unë i respektoi deri në fund. Nuk kalon.

Kjo po dihet publikisht, opozita është duke e provokuar rrëzimin, ju lumtë! Ju në mund të qëndroni!.

Urdhëro, zonja deputete!

Amendamenti 66.

Pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

ALBULENA HAXHIU: Ky projektligj është bërë masakër, a po doni të dini çka keni bërë me këtë projektligj!

Prandaj, do të duhej ta tërhiqni, asnjë amendament nuk e keni përkrahur, që është tepër i nevojshëm, shumë i nevojshëm. Prandaj, edhe për Shërbimin Korrektues, sikurse edhe për Inspektoratin Policor, sikurse edhe shërbyesit civilë, sikurse edhe për mjekët. Ju po bëni gabim, ju po punoni veç për vete. Prandaj, për kë po e bëni këtë projektligj, se s'po kuptoj!

Amendamenti në fjalë tërhiqet, sepse zjarrfikësit tashmë e kanë koeficientin më mirë se sa propozimi në amendament. Pra, tërhiqet amendamenti në fjalë.

**KRYETARI:** A ka mundësi qetë, falënderoj secilën, u tërhoq amendamenti 66.

Zonja Arbërie Nagavci ka propozimet nga amendamenti 67 deri në 74.

Do të thotë, edhe një herë, kisha pasur dëshirë për vëmendje, zonja Arbërie Nagavci ka propozime nga amendamenti 67 deri 74. Fjala për ju, zonja deputete.

**ARBËRIE NAGAVCI:** Faleminderit!

Amendamentet 67, 68 dhe 69 kanë pasur të bëjnë me koeficientët për udhëheqësit e institucioneve edukativo-arsimore, që tashmë u aprovuan, me kërkesën e komisionit, kështu që këto tri amendamente, 67, 68 dhe 69 i tërheq.

Ndërkaq amendamenti 70, ju kisha lutur për vëmendje, ka të bëjë me mësimdhënësit, të cilët janë duke punuar në shkollat e mesme të larta, shkolla të mesme të ulëta, por edhe me mësimdhënësit në shkollat speciale dhe me instruktorët në qendrat e kompetencës, gjegjësisht në ato që janë profesionale.

Dhe, ajo çka kam kërkuar me këtë amendament, është edhe mësimdhënësit e shkollave speciale, gjegjësisht të qendrave burimore, të cilët i kanë kushtet e punës shumë specifike, të kenë koeficientin të njëjtë sikurse mësimdhënësit e shkollës së mesme. Meqenëse ka ndryshuar kërkesa, unë kisha kërkuar të renditen së paku me koeficientin 2.12, në klasën 2.12. Kërkoj që të kenë përkrahjen tuaj që këta instruktorë dhe mësimdhënës në qendrat e kompetencës të kenë koeficientin e njëjtë sikurse mësimdhënësit e shkollave të mesme.

**KRYETARI:** Faleminderit! Shkojmë në votim.

Amendamenti 70.

Deputetja Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Votojmë tash! Nuk kalon.

Amendamentet 71 deri 74. Urdhëro, zonja deputete!

**ARBËRIE NAGAVCI:** Amendamenti 71 ka të bëjë me koeficientin e mësimdhënësve, kështu që edhe këtë e tërheq, pasi veç kaloi ai i komisionit.

Ndërkaq amendamenti 72 ka të bëjë me koeficientin për pedagogët dhe psikologët shkollorë, gjegjësisht për të gjithë pedagogët dhe psikologët e institucioneve edukativo arsimore, përfshirë edhe ata në çerdhe dhe në kopshte.

Duke pasur parasysh se koeficienti i tyre është shumë më i ulët, dallon shumë me psikologët klinikë dhe, në anën tjetër, edhe me mësimdhënësit, kërkesa ime dhe ju lus të gjithë juve që të votoni këtë amendament, në mënyrë që pedagogët dhe psikologët shkollorë të kenë koeficientin së paku të barabartë me mësimdhënësit e shkollave të mesme.

**KRYETARI:** Faleminderit! Amendamenti 72, do të thotë u tërhoq.

Amendamenti 73.

E propozon deputetja Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.

Urdhëro, a dëshirove prapë, ka të shtojë diçka, para se ta hedh në votim. Urdhëro, zonja deputete!

**ARBËRIE NAGAVCI:** Amendamentin 71 e tërhoqa, ndërsa kërkoja mbështetjen e deputetëve për votimin e amendamentit 72, i cili ka të bëjë me pagesën për pedagogët dhe psikologët shkollorë me koeficient të njëjtë, së paku sikurse mësimdhënësit e shkollave të mesme.

**KRYETARI:** Faleminderit!

Amendamenti 72.

Pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, zonja Arbërie Nagavci. Votojmë tash! Nuk kalon.

Amendamenti 73.

Zonja deputete, urdhëro!

**ARBËRIE NAGAVCI:** Faleminderit! Amendamenti 73 ka pasur të bëjë me koeficientët e punëtorëve në institucionet parashkollore, gjë që është marrë parasysh, kështu që këtë amendament e tërhoq, por meqenëse e kam fjalën, do të doja të bëja të ditur, për shkak se shumë qytetarë janë duke na përcjellë dhe mua, po besoj edhe kolegëve të mi janë duke na shkruar shumë prej tyre, për shkak të mosrespektimit të parimit bazë të këtij ligji, që është për punën e njëjtë dhe për përgjegjësinë e njëjtë duhet të ketë pagesë të njëjtë, ashtu sikurse përmendi edhe deputetja Haxhiu. Me këtë ligj, përkundër që është jashtëzakonisht shumë i rëndësishëm, për shkak të ngutjes që u bë dhe për shkak të kushteve që u vendosën, tashmë është bërë një çorganizim në sektorë të shumtë publikë, duke filluar prej ankesave me të drejtë të inspektorëve të arsimit, pastaj të mësimdhënësve, sikurse e përmenda në qendrat burimore të doganierëve, ku ka pabarazi të shumta, punëtorëve të sektorit publik në Komunën e Prishtinës dhe shumë të tjerëve.

Dhe, për hir të qytetarëve, sepse ju e përmendët, zoti kryeparlamentar, se nëse ky ligj tani duhet të bëhet pengesa dhe një vit nuk do t'i marrin pagat me rritje, është mirë të bëhet me dije për ata që po na përcjellin, se në deklaratën që e përcjell këtë ligj, domethënë në dokumentet zyrtare është përmendur që ky ligj nuk do të hyjë në fuqi edhe 9 muaj, së paku në këto dokumentet që na

keni thënë dhe se vlerësimi i kostos për këtë do të bëhet dhe do të ketë ndikim tek në vitin e ardhshëm. Pra, e vërteta është se përkundër se si po votojmë sot këtu, gjatë këtij viti nuk do të ketë paga në rritje për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe është mirë që këtë t'ua bëni me dije dhe të mos manipuloni, duke thënë se nuk do t'i marrin edhe një vit pagat me rritje.

**KRYETARI:** Zonja deputete, a propozove diçka? Cili amendament je, 74 a do ta vëmë në votim? E vë në votim amendamentin 74, jo, e heq, po thotë zonja deputete.

Atëherë, kështu, deputetët Bekim Haxhiu, Fatmir Xhelili dhe Xhevahire Izmaku, edhe këta më duket po duan ta tërheqin. Urdhëro, zoti deputet!

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

**KRYETARI:** Edhe unë e kam një amendament pastaj.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit! Kjo që kemi punuar bashkë me kolegët e mi, me Xhevahiren dhe me doktor Fatmirin nuk ka qenë për fushatë, as nuk do të diskutoj sot këtu për vota elektorale, sepse e thashë, kur e arsyetova amendamentin 41 që lidhet ekskluzivisht me këtë amendamentin 75. Pse e ka renditur komisioni kështu është çështje krejt e komisionit, nuk është çështje imja, por unë vetëm po dua për çështje parimore, sepse kam menduar ta rregulloj një çështje në sistemin shëndetësor, duke e respektuar përgatitjen profesionale, shkencore dhe akademike të çdo profesionisti shëndetësor, duke filluar nga mjekët, stomatologët, farmacistët, psikologët klinikë, fizioterapeutët, logopedët, ergoterapeutët, infermierët, mamitë dhe profesionistë të tjerë shëndetësorë teknikë dhe unë po e përmend kështu, sipas këtij propozimi mjekët specialistë kanë qenë me 5.5, farmacistët specialistë gjithashtu me 5.5, stomatologët, farmacistët me 5.5, psikologët klinikë me 3.5, dhe biokimistët me Bachelor me 3.5, radiologët po ashtu, specialistët e radiologjisë biokimisë me 5.5, dhe infermierët kanë qenë të propozuar me 3.2 nga ana ime, porse komisioni më herët këtë e rrëzoi, prandaj më është i pazbatueshëm ky propozim, sepse më tabela buxhetore është e votuar dhe është krejtësisht e panevojshme që të vazhdohet me votimin e kësaj, sepse për t'u votuar edhe kjo tabelë dhe ky propozim imi do të duhej të kalonte edhe neni 41. E thashë në fillim dhe po kërkoj një sqarim edhe nga kryetari i Komisionit Parlamentar për Administratë Publike, sepse infermierët nuk kanë kërkuar zbritje të koeficientëve për të tjerët, të zbritet paga për të tjerët, kanë kërkuar respektim të përgatitjes së tyre profesionale për punën e njëjtë, pagë e njëjtë, si në sektorin primar, ashtu edhe në atë sekondar, terciar dhe për punën e njëjtë pagë të njëjtë.

Infermierët nuk kanë kërkuar t'u zbriten të tjerëve koeficientët, por kanë kërkuar që edhe këtyre t'u respektohet koeficienti dhe përgatitja shkollore e profesionale. Prandaj, i nderuar kryetar, duke ju falënderuar për angazhimin, unë e vlerësoj, sepse vërtet është një rritje e pagave në sektorin e shëndetësisë si asnjëherë më parë. Të gjithë profesionistëve shëndetësorë u rriten pagat

dhe, besoj që bashkë me Komisionin Parlamentar për Shëndetësi do ta përgatitim Ligjin për vlerësimet dhe kategorizimin e të gjithë profesionistëve shëndetësorë, një ligj të cilin duhet ta bëjmë ne si Komision Parlamentar për Shëndetësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë u tërheq, a? Faleminderit! Deputeti Lumir Abdixhiku po ashtu e ka tërhequr pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Deputeti Imet Rrahmani? Urdhëroni, zoti deputet!

IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar! Unë amendamentin në fjalë e kam paraqitur kur ka qenë afati ligjor për paraqitjen e amendamenteve dhe komisioni parlamentar e ka shqyrtuar, e ka marrë parasysh dhe e ka inkorporuar në draftin final që është prezantuar sot para deputetëve. Unë i falënderoj kolegët e mi në komision parlamentar për bashkëpunim korrekt, për punën që kemi bërë, por edhe për përkrahjen e këtij amendamenti.

Fjala ka qenë që specialistët e Mjekësisë Familjare të trajtohen njëjtë sikur të gjithë specialistët e tjerë në sistemin tonë shëndetësor. Faleminderit edhe një herë komisionit, faleminderit edhe një herë kolegëve.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Atëherë, faleminderit! Fjalën e ka zoti Veseli, ka propozim amendamente.

KRYETARI KADRI VESELI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
I nderuar kryeministër,  
Kabinet qeveritar,  
Të nderuar kolegë deputetë,  
Kam dalë në foltore për faktin se dëshiroj në fund t'i bëj edhe dy propozime, dy amendamente, pastaj është vullneti juaj a i pranoni apo nuk i pranoni.

Paraprakisht, dëshiroj të falënderoj deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ministrin e Administratës Publike dhe ministrin e Financave, e në mënyrë të veçantë më meritori është Komisioni Parlamentar për Administratë, i udhëhequr nga Naiti, Shqipen, Xhevahiren, Imetin, Valonin, Ademin, Arbanin, Milaimin, Albertin dhe Rasimin, të cilët kanë bërë një punë të jashtëzakonshme, kini parasysh pas 20 vjetëve, që e kemi pasur një praktikë të gjatë të arbitraritetit dhe anarkisë në fushën e pagave në sektorin publik të Republikës së Kosovës, për herë të parë, do të thotë, po e bëjmë një hap, i cili mund të quhet lirisht hap historik për institucionet e Republikës së Kosovës, edhe në fakt, kjo është fitorja më e madhe e sundimit të ligjit në sektorin e pagave. Tani e tutje shumica e punonjësve të sektorit publik do të kenë rritje të pagave: mjekët, arsimtarët, profesorët, ushtarët, mësimdhënësit, të gjitha kategoritë, nuk ka kategori e cila ka ulje të pagave nga ligji, të cilin do ta aprovojmë ne sot bashkarish. Kjo është

vetëm pjesa e parë e përgjegjësive tona, por nuk është sektori publik ai i cili e zhvillon ekonominë e vendit, është sektori privat. Besoj që bashkërisht pas këtij aprovimi të këtij ligji, do të orientohemi nga aprovimi i ligjeve, të cilat kanë të bëjnë me fuqizimin e sektorit privat, ndërmarrësisë, prodhimit, vetëm aty është perspektiva e zhvillimit ekonomik, edhe përmirësimit të jetës sociale të qytetarëve tanë.

Unë dëshiroj me mirëkuptimin tuaj, të mos dal konfuz nga pjesa çka thashë, kjo varet prej juve a e përkrahni a jo. Janë dy amendamente, të cilat dua t'i quaj të ndara: amendamenti 58 a dhe amendamenti 58 b.

Amendamenti 58 a, do ta hedh në votim. Ka të bëjë me punëtorët arsimorë në universitete. Nga pika 133 deri në pikën 140 të tabelës propozoj shtim linear për 0.1%. Do të thotë, u kemi premtuar edhe këtë 0.1%, ta keni parasysh. Kjo është çështje e premtimit, në fund të fundit seanca merr vendim. Punëtorët arsimorë në universitete nga pika 133 deri në pikën 140, jam konsultuar para se të dal këtu edhe me ministrin e Financave, e tabelës i propozoj shtim linear për 0.1%. Ka kaluar më herët, më tepër edhe gabim, koeficienti 0.1% .

Propozimi i dytë, amendamenti 58 b. Kryesuesin e kisha ftuar pastaj t'i hedhë të dyja në votim, ka të bëjë me një institucion, i cili për mua është shumë me rëndësi, edhe për të gjithë ju besoj, Agjencia Antikorrupsion. Drejtorit të Agjencisë iu ka ulur paga, nuk është mesazh i mirë. Unë kisha besuar që është mirë që ky Kuvend t'ia bëjë pagën siç e kanë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Do të thotë, aktualisht e ka 6.75 propozimin koeficient, t'i bëhet propozimi siç e kanë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, njëjtë.

Këto dy propozime janë, i aprovon ju, s'i aprovon, në fund të fundit, është përgjegjësi jona. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Atëherë, të nderuar deputetë, i kemi dy amendamente: 58 a dhe 58 b, i keni lexuar, dëgjuar, ju lus që të votojmë. A ka kuorum?

E votojmë amendamentin 58a. Mirë, a do fjalën ti, a? Në rregull! Zoti Zemaj e ka fjalën!

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit, kryesues! Kjo tash nuk është konform Rregullores së Punës së Kuvendit. Paraqitja e amendamentit të ri nuk ka mbështetje procedurale, e para. Dhe, e dyta, nëse ishte e sinqertë, do të duhej të ishte intervenimi atje te tabelat, kur ne debatua një orë të tërë edhe për koeficientët, për profesorët universitarë dhe për këtë arsye nuk japim mbështetje.

E dyta, sa i përket Agjencisë Kundër Korrupsion besoj që Komisioni Funkcional e ka pasur në shqyrtim. Ne po flasim që po vëmë tavan, po vëmë rregull dhe nuk mundemi që të rikthehemi në çdo pozicion veç e veç, se ka x arsye. Nëse kthehemi për çdo pozicion veç e veç, atëherë po

fillojmë nga shefi i stafit të Kryetarit të Kuvendit, i cili merr pagë 1 mijë e 852 euro, sipas këtij ligji, zëvendësi i tij kur mungon ky, 1 mijë e 610, këshilltarët nga 1 mijë e 434, zyrtari i lartë personal 979, zyrtari pak më i vogël, jopersonal, 884 e tjerë. Andaj, edhe ato dy amendamente që kanë mbetur në fund, për ose kundër, le të kalojnë, por ky amendament i propozuar nga kryetari i Kuvendit nuk ka mbështetjen në Rregulloren e Punës së Kuvendit.

*(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)*

KRYETARI: Armend, ke të drejtë. Unë propozimet i bëra me mirëkuptim në bazë të asaj i vendos, për çdo propozim, bile unë kisha shkuar kështu, kam pritur, të them të drejtën, pak më shumë njëfarë përkrahje që ju do të tregoheshit më korrektë për t'i ulur ende pagat tona. Unë timen e kam ulur në dy koeficientë, edhe këtë situatë në sektorin publik që e kam gjetur, ma ka lënë Lidhja Demokratike e Kosovës, ta keni parasysh.

Shkojmë në votim për këto propozimet e tjera, çka të ka, le t'i vendosim prapë. A ka mundësi të shkojmë në amendamentin 58 a, po, jo. Po urdhëro, Liburn Aliu!

LIBURN ALIU: A mund të na japësh sqarim 0.1% rritje? 0,1% rritje, është sqarimi gabim, kjo nuk ka sens, 0,1% rritje. 0,1% rritje i bie nëse e ke pagën 1 mijë euro, bëhet 1 mijë e 1 euro.

KRYETARI: Tash ke parasysh, Liburn, mirë e qartësoi, mund ta quaj 0.10% në kuptimin apo si ta quash. 0,1%, le të themi deputetë, sa e ke pagën, unë e kam 9 domethënë, e bëj koeficientin 9,1. Po tash, jemi më korrektë, ky është premtimi, të cilin e kemi bërë, po tash quaje 0,1%, ose quaje 1%, si të duash. Lumir, na e qartëso, të lutem, se ka të drejtë. Urdhëro, Lumir Abdixhiku!

LUMIR ABDIXHIKU: Kryetar, nëse je duke e propozuar të rritet me 0,1 koeficientin, nuk i bie përqindje hiç, sepse koeficienti nuk është përqindje, i bie si numër absolut, pra, po do ta shtosh numrin për 0.1, ky është propozimi, jo përqindje, pa përqindje.

KRYETARI: Ka të drejtë, kështu. Hajde, tash shkojmë te votojmë amendamentin 58a, zonja Nagavci, jo, jo, të lutem. A ka mundësi, të shkojmë në votim, e votoni, unë kam kërkuar veç mirëkuptim, ju mund ta rrëzoni, mund ta lëni, si të doni. 58a, 58b.

Nga Nisma Zafir Berisha e ka fjalën. Nga një prej grupeve parlamentare, Teuta nga AAK-ja, në qoftë se dëshiron, po e shoh reagimin edhe votojmë.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryetar! Ne nuk deshëm të inkorporohemi në këtë gamën e fushatës elektorale, por sido që të jetë, unë i ftoj deputetët të votojnë kundër këtyre propozimeve, sepse nuk vijnë nga komisioni adekuat. Kjo ishte puro një fushatë, si fushatat e tjera, por zoti



kryetar, e kam një pyetje shumë të lehtë, në rast se një deputet voton dy propozime për të njëjtin nen dhe për të dyja herët voton për, cili është valid, dhe të dyja fitojnë.

KRYETARI: Jo, Zafir, këtë e di ti, po ke harruar, jemi lodhur, cili fiton më shumë, cili ka numër më shumë. Për shembull, 31, 32 fiton. Po, po urdhëro, Zafir. Fiton cili ka më shumë.

ZAFIR BERISHA: Domethënë, nëse ti ke votuar për të dyja për, dy herë ke të drejtë.

KRYETARI: Po, ke të drejtë, po fiton cili votohet më shumë.

ZAFIR BERISHA: Ama të dyja kanë fituar, karshi të kundërtës.

KRYETARI: S'prish fare punë, në qoftë se fiton më shumë, ai amendament që ka më shumë, fiton.

ZAFIR BERISHA: Kjo përgjigje është sikur puna e vezës edhe e pulës, cila e ka bërë? Faleminderit!

KRYETARI: Zafir, ka të bëjë me premtim, se 0.1 si koeficient, të cilin e qartësoi edhe kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, nuk ka të bëjë me premtim elektoral fare, ka të bëjë me një premtim njerëzor. Në qoftë se doni ta votoni amendamentin 58a, e votoni ose e rrëzoni, hiç mos u lodhni. Unë ju ftoj ta votoni 58a ka të bëjë me profesorët universitarë, rritja e koeficientit 0.1. Votojmë tash!

Veç ju lutem, 61 deputetë votoni. Deputetët të kthehen në sallë, Islam, urdhëro fjalën derisa të kthehen deputetët pa grup në emër të AKR-së.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryetar! Të përfshihem edhe unë pak në fushatën elektorale, me të vërtetë sot po më duket që shpeshherë po dalim prej kritereve. Është e mirë që ne t'i analizojmë, unë besoj që i vetmi ai që i dridhen sot këmbët këtu është ministri i Financave, por unë besoj që ai do t'i rendisë këto, do të ka mirëkuptim dhe sigurisht që këto propozime janë në fund të ditës, janë për ata qytetarët tonë, për njerëzit tonë, për mjekët, arsimtarët të gjithë, të cilët e meritojnë këtë përkrahje.

Prandaj, unë me dëshirë e kisha propozuar, edhe kjo për arsye që janë propozuar të gjitha, kanë ecur, le të shkojë edhe kjo përpara.

KRYETARI: Faleminderit! Deputetë të nderuar, votojmë, jemi 58a, ka të bëjë koeficienti 0.1 për profesorët universitarë. Vetëm votoni 61, ju lutem votoni tash! Kaloi!

Ju falënderoj, por nuk ka të bëjë me fushatë, ka të bëjë vetëm me premtim, ju ua keni dhënë.

Shkojmë për 58b, vetëm kini parasysh, drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit, ideja është të barazohet me drejtorin e përgjithshëm të Policisë, kjo është. E votoni 58b, a insiston zonja deputete? Ka të dëshirë të flasë zonja deputete, edhe më kritikojnë mua se tash unë fushatë po bëj.

ALBULENA HAXHIU: Kam të drejtë, jo dëshirë, kështu ne si Komision për Legjislacion për ta konfirmuar që kemi diskutuar edhe për këtë në kohën kur kemi e shqyrtuar raportin e këtyre projektligjeve dhe nuk jemi pajtuar që është ulët koeficienti i drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, për shkak se gjatë javëve dhe muajve të fundit ne kemi miratuar disa projektligje që Agjencisë i shtojmë kompetenca dhe, meqë kemi si institucion, atëherë është dashur që koeficienti të mos i zbritet. Prandaj, edhe Komisioni për Legjislacion e ka përkrahur këtë kërkesë, por nuk jemi pajtuar që nëpunësve ua keni zbritur përqindjes e shtesës së posaçme, në vend se t'i kenë 30%, ua keni lënë 20% dhe kjo është gabim, prandaj edhe nuk e kam përkrahur atë amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkojmë në votim, amendamenti 58b, drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit, po kryetar i komisionit, po, edhe unë jam kryetar i Kuvendit, më ka drejtuar letër zyrtarisht dhe jam institucion i këtij vendit, e kam për obligim, të paktën e sjell për korrektësi këtu në Kuvend, votojeni po-jo. Urdhëro, kryetar i komisionit.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar! Po më vjen mirë që ty veç një ta ka drejtuar një kërkesë, vetëm Agjencia Anti Korrupsion. Neve komisionit dhe në emër timin personal kanë ardhur mesazhe, e-maila, kanë thirrur në telefon, kanë dërguar letra, shkresa, kërcënime, të gjitha i kanë dërguar. Nëse do t'i kishim pranuar të gjitha këto, atëherë do ta kishim bërë ligjin.

Ju po kërkoni që një institucioni që nuk mund të dalë mbi prokurorin, kërkoni t'i ndërroni krejt, prisheni, shtyjeni e bëjeni një tjetër listë, sipas dëshirave si të duan deputetët e tjerë. Kjo listë nuk është e plotë nëse ti ia ndërron, protokollin i shtetit e ka vendosur kështu, unë s'e kam vendosur. Unë po kërkohet respektimin e secilit vend meritor, drejtori i Agjencisë, punëtorët e Agjencisë janë lënë në status të veçantë, ashtu siç keni kërkuar, nuk ka mundësi ngritje. Nëse ti e ngrit në koeficientin 8, ti e ngrit edhe 30% a 20% sa e ka shtesat, kjo do të thotë ku do t'i çojmë ata, përmbi krejt.

KRYETARI: A shkojmë në votim? Shkojmë në votim, e the qëndrimin, kryetar, shkojmë në votim. Të nderuar deputetë, votojmë tash!  
Amendamentin 58b.

Votojmë amendamentin 58b. Votojmë tash!

Faleminderit! Armendi po thotë këtu do të mbetesh, atëherë unë s'po mbetem, s'po votoni, e tërheq.

**KRYETARI:** Faleminderit! Deputetët janë sovranë në vendimin e vet. E votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Deputetët të kthehen në... Po urdhëro, urdhëro! Kërkoj falje atëherë, po...

**MEMLI KRASNIQI:** Zoti kryetar!

Kur kemi diskutuar për krijuesit dhe performuesit e kulturës dhe të artit, unë e kam bërë një propozim fillimisht për ta që kaloi ndaras, pastaj për universitetet që ju e dhatë tash si propozim, edhe për ta hequr drejtorin e RTK-së. Ju më propozuat t'i ndajmë të tria, u ndanë. Por, heqja nga ligji i pagave, me idenë që të përfshihet te Ligji i RTK-së, e pagës së drejtorit të përgjithshëm të transmetuesit publik nuk doli në votim. Ju kallëzomëni a po doni a s'po doni ta hidhni në votim. Po 58-shin unë e kam kërkuar para këtyre 58-shave krejt, po ju s'e hodhët, se para A-së e B-së e C-së e kam propozuar. Votojeni burrë kundër që doni, ndoshta doni ta bëni televizionin ta ketë njëfarë karakteri tjetër prej këtij që e ka. Unë e kuptoj propozimin e Komisionit, edhe modelin sloven, edhe arsyetimin, edhe të gjitha. Por, sa për korrektësi, propozimi është nëse kalon, kalon. Hiqet. Propozimi është konkret. Në tabelë të hiqet pika 29, rendi 29 krejt, drejtori i përgjithshëm i Transmetuesit Publik RTK dhe të vazhdojë numërimi i përmirësuar nëse miratohet. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! A ka mundësi vetëm të kemi vëmendje? Më së pari të qartësojë pozicionin tim si kryetar i Kuvendit. Ju kryetar i GP të PDK-së, kur e keni propozuar, i vutë të tria në një vend. Nuk mund proceduralisht të procedohet ajo. Kjo është arsyeja pse nuk e kemi vendosur. Pastaj, kjo është, u nda, ky propozimi im për profesorët universitarë ishte imi, pastaj e mora unë, dhe ju do të duhej këtë ta bënit që s'e bëtë tash. Kjo është arsyeja pse s'u vunë të tria në një rast.

A shkojmë në votim drejt? Kështu ashtu, veç po e maltretojmë veten. E votoni, s'e votoni. Është propozimi i Memli Krasniqit që të largohet fare nga sektori publik RTK-ja, një kritikë çka mund t'u jepet Kuvendit edhe institucioneve nga organizmat ndërkombëtarë. Kështu e vendosim po, jo. Ajo çka është, mbetet.

Amendamenti 58c, propozimi i Memli Krasniqi. Votojmë tash! Nuk ka kuorum. Po, po gjithsesi.

Atëherë edhe një herë deputetët të jenë, po dua ta konstatoj... Administrata, a janë 61 deputetë, se nuk mund t'i sjellim deputetët kur nuk duan të vijnë. 87 janë të pranishëm në sallë, 87 deputetë janë aktualisht në sallë, por do të thotë nuk kemi votim. Edhe një herë do ta vë në votim. S'ka pjesëmarrje në votim, do të thotë, në mungesë të kuorumit të pjesëmarrjes, jo të prezencës.

Votojmë edhe një herë. Votojmë tash. 58 c. Zoti kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, dy herë e votuam. Pa kaluar kjo, seanca nuk vazhdon. Urdhëro, fjala për ju!

MEMLI KRASNIQI: Për të vazhduar që të votohet Ligjin tash, duhet dhënë një zgjidhje këtij amendamenti. Deri tash s'ka zgjidhje, ose duhet unë ta tërheq, pasi s'po ka vullnet, por për ta tërhequr kisha pasur qejf ta di së paku prej kolegëve që përfaqësojnë grupet parlamentare, cili është qëndrimi i tyre. Do të thotë a e shohin që duhet të mbetet RTK-ja në Ligjin e pagave dhe të konsiderohet si televizion shtetëror pak a shumë, apo duan ta heqin ashtu siç po propozoj unë, edhe ta lëmë të rregulluar si institucion publik, siç është. Për mua vendimi i secilit, po mendoj i shumicës së deputetëve është final, se s'kemi rrugë tjetër, po pasi janë diku 30 këtu që nuk po vendosin as pro, as kundër, unë do ta tërheq nëse të paktën e kam një përgjigje prej secilit grup çfarë qëndrimi kanë. Përndryshe, bën edhe një herë të hidhet në votim. Faleminderit!

KRZETARI: Zoti Krasniqi, e kam kështu një propozim: votimi i deputetëve është publik, edhe dihet saktësisht cili është qëndrimi i tyre. Në qoftë se do t'i vëmë të flasim në emër deputetëve, pak a shumë krijoni konfuzion se ka mundësi ka qëndrime të ndryshme këtu të deputetëve, nuk është qëndrim i grupeve. Kështu që kisha pasur dëshirë që ta merrni një qëndrim, ose e mban, ose e...

Atëherë, në këtë rrethanë, bllokohet ligji, në situatën në të cilën jemi. Pa votim bllokohet, për arsye se nuk ka tërheqje të propozimit. Urdhëro, z. Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Unë kisha propozuar që ta votojmë kundër. Qe po votojmë krejt bashkë kundër, a po e di, veç ta shprehim një qëndrim të këtij Kuvendi, sepse në fund të fundit sytë janë nga ne, edhe për çështjen e RTK-së, edhe qysh ishim për çështje të tjera. Nëse ju e vlerësoni kryetar, unë e tërheq propozimin, a po kupton, e lëmë RTK-në televizion shtetëror. Ndoshta edhe ligjin sa s'e kemi kryer, mirë është ta shpallim si të tillë, por unë mendoj që ajo është gabim. Mendoj që është gabim ta kthejmë Radiotelevizionin e Kosovës televizion të shtetit. Atëherë mirë është ta emërojmë ne edhe stafin atje.

KRYETARI: Zoti kryetar i Grupit Parlamentar, unë mund ta vë edhe një herë në votim. Për të tretën herë, pastaj na jep një përfundim. Edhe një herë e votojmë, edhe është mirë ta kemi një përfundim.

Regjia, deputetët, amendamenti 58.c, i cili ka të bëjë me RTK-në, largohet nga interferimi shtetëror, propozim i kryetarit të GP të PDK-së, Memli Krasniqi. Votojmë tash!

Zoti Krasniqi, rezultati për herë të tretë është i njëjtë. Cili është qëndrimi juaj për amendamentin tuaj?

MEMLI KRASNIQI: Qëndrimi im është që Radiotelevizioni i Kosovës duhet të jetë institucion publik, e jo shtetëror. Ky është qëndrimi im. Për fat të keq, s'qenka qëndrim i shumicës së deputetëve. Propozoj, ju që keni për të punuar në Projektligjin për RTK, ta bëni edhe formalisht televizion shtetëror, meqenëse po dëshironi të keni kontroll të shtetit përmbi ta. Por ta dini që kushdo që mendon kështu e keni gabim, e këtë amendament unë e tërheq për t'i dhënë mundësi kalimit të ligjit të pagave, e kush e bllokoi këtë ligj keni për ta parë tash si kanë për të votuar këta opozita që kanë ardhur sot për të bërë hajgare këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I përfunduar amendamentet. E votojmë tekstin. Nait Hasani je kryetar i Komisionit, po kryetar i Kuvendit jam unë. Zoti Hasani të lutem, si kryetar i Komisionit, urdhëro!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Po më vjen mirë që po e dëgjoj që ne po duam të bëjmë një televizion shtetëror. Ligji për Transmetuesin Publik dhe për ndërmarrjet publike dhe të gjitha ato, ata që marrin buxhet nga shteti duhet të listohen në listën e pagave. Ata që marrin buxhet nga shteti, Ministria e ka sjellë, unë s'e kam sjellë. Qeveria e ka sjellë, pra hyjnë në listën e pagave, ne e kemi harmonizuar. Të gjitha ndërmarrjet, të gjitha institucionet publike që janë në shtetin e Kosovës, bashkë edhe Kuvendi, duhet të listohen. Ne e kemi listuar si institucion që i merr 12 milionë euro para prej shtetit të Kosovës. Ato 12 milionë euro, ata i ndajnë për rroga, 8 milionë i ndajnë për rroga, 4 i kanë investime të programeve të tyre.

Ne nuk po duam të bëjmë televizion shtetëror. Ata që e interpretojnë dhe e kanë nxjerrë në protesta televizionin, kanë bërë gabim. Gabimi është se e kanë ngritur një institucion duke u frikësuar nga vetja. Përkundrazi, Televizioni i Kosovës, ose Transmetuesi Publik është institucion publik. Pikërisht i ndahet pagesa për menaxhmentin. Në anën tjetër, nëse Televizioni i Kosovës, i dashuri Memli, ka mundësi të financohet dhe ta rrisë buxhetin e tyre me miliona e miliona, ishalla i bën edhe 100 milionë, ai do të jetë një televizion që mund ta caktojë pagën e vet sa të ketë qejf, edhe pesë mijë euro, dhjetë mijë euro, edhe 50 mijë euro. Por, derisa ne e financojmë me taksat tona, merr pagë nga Buxheti i Kosovës, ai duhet të jetë i listuar.

KRYETARI: Gjithsesi, kjo është demokracia, qëndrimet janë të ndryshme. A shkojmë drejt votimit të Projektligjit tani? A ka dikush diçka tjetër në mes? Qëndrime politike, e përfunduar, jemi duke folur për ligjin.

E votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara.

A ka diçka që ka të bëjë me projektligjin? Urdhëro zonja deputete, pasi jemi publik?

ALBULENA HAXHIU: Së pari, unë e thashë edhe më herët. Dje në Komisionin për Administratë është folur për Inspektoratin Policor të Kosovës, edhe z. Hasani është këtu. Tash në pjesën tabelare, ndonëse Komisioni është pajtuar, nuk e di pse s'janë d.m.th. as kryeshefi ekzekutiv, as drejtuesi i Departamentit, as udhëheqësi i Divizionit, janë vetëm inspektorët. Është gabim, duhet t'i përfshijmë. Unë e thashë propozimin, nuk e di pse s'po e merrni parasysht. Nuk ka kosto buxhetore, edhe ministri i Financave po e konfirmon këtë. Nuk ka kosto buxhetore. Unë e dhashë propozimin, nëse doni po e lexoj sërish. Nuk e di pse nuk është në pjesën tabelare. Pra, 178, ndihmësdrejtor i Departamentit të Policisë vjen menjëherë kryeshef ekzekutiv i Inspektoratit Policor. Nënkolonel në Polici të Kosovës vjen drejtues i Departamentit në IPK dhe major në PK vjen udhëheqës i Divizionit në IPK. Pra, nuk ka implikime buxhetore, vetëm duhet përfshirë në tabelë sikurse Policia, sepse është gabim çka po bëjmë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Pavarësisht drejt apo jo drejt, edhe unë e pata një amendament e s'kaloi, tash të mos kthehemi. Shkojmë te ligji. Te ligji shkojmë drejtpërdrejt. Po s'po duan zonja deputete. A e kam vënë në votim më herët, të lutem! Dëshiron? Po e formulon si amendament, Ok? Si do ta quash amendamenti, të lutem propozojë! E futim. Kërkoj falje, nuk ka të bëjë me ty. Urdhëro, thuaje amendamenti, quaje, formuloje, ta vë në votim. Urdhëro zonja deputete! E di se jeni lodhur deputetë të nderuar, po...

ALBULENA HAXHIU: Nuk e kuptoj. Është hera e dytë që jam duke u marrë me këtë amendament dhe duhet vendosur deputetët e Kuvendit të Kosovës, çfarë duan të bëjnë. Pra, dje në Komision për Administratë, ka qenë pajtim i anëtarëve të Komisionit. Tash, çështja është në numrin rendor 179 shtohet edhe kryeshefi ekzekutiv i IPK-së. Me numrin rendor 179, drejtuesi i Departamentit në IPK. 181, udhëheqës i Divizionit në IPK. Kjo duhet të jetë domethënë në pjesën tabelare, ashtu me sa e kam parë është marrë vesh Komisioni, prandaj duhet të votohet.

KRYETARI: Atëherë, vetëm pak! Ky është një amendament, e bëjmë propozim. A ka mundësi, e kemi edhe një dhe të shkojmë ta përmbyllim, pastaj flet. Kryetar i Komisionit, a ka mundësi se edhe një amendament është, se ka ndodhur një gabim në tabelare. Fol Bekim Haxhiu. Ka të bëjë me gabim teknik.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Vetëm te numri 172, te klasa 9, janë dy koeficientë, 2,8 dhe 3,2. Vetëm kjo propozoj ashtu që të jetë klasa 9, një koeficient 3,2. Asgjë tjetër.

KRYETARI: Nuk ka pasur përcaktim, kijeni parasysht. Nuk ka diçka ndryshim, por ka mbetur, s'e ka vërejtur as Komisioni, as ne si deputetë, në të parin nuk ka koeficient. Pra, bëhet fjalë për psikologët klinikë. Ashtu edhe pamë, edhe regjia, tash Administrata.

Janë dy amendamente. Shkojmë me amendamentin e znj. Albulena Haxhiu. Zoti kryetar, fjala për ju!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Po e shoh që jeni lodhur, po te 172 dhe 173 është vetëm që nuk është numri, kështu që është H8 dhe H9, d.m.th. hiqet 2,8-shi dhe bëhet 3,2. Problemi qëndron te Inspektorati Policor. E ka një status të veçantë, ka shtesa të veçanta, e tjetra që është që nuk ka grada se s'kanë ku vendosen me grada, nuk kanë gradime, s'kemi pasur vend ku t'ua ngjitim gradat. Ku është Komisioni për Polici, ata le t'i sqarojnë këto çështje. Po i kemi sqaruar në komision, nuk kanë grada dhe ata janë shërbyes civilë, i keni nxjerrë qysh i keni nxjerrë. Kërkoj që nuk ka më amendament se komisioni e ka shqyrtuar këtë çështje mjaft mirë.

KRYETARI: A ka mundësi, i nderuar kryetar i Komisionit, me dy deputetët ta ingranosh këtë çështje që ta përfundojmë, të mos na mbetet që të kemi pastaj probleme. Po bën zonja deputete, po më mirë kryetari i Komisionit se do ta kishim përfunduar. Po qysh s'flet zonja deputete, menjëherë, urdhëro, fjala për ju! Për atë keni ardhur këtu, jeni përfaqësues të popullit. Zonja Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Kryetar!

Je kryetar i Kuvendit të Kosovës me shumë dashamirësi dhe miqësisht është mirë të mos bësh selektive në dhënien e fjalës. E kam kërkuar edhe më herët, kur ka qenë amendamenti në fjalë, e tash po dua ta shpreh mendimin tim. Jam në mbështetje të propozimit të Albulena Haxhiut, por një modifikim, ju lutem! Veç po jua kujtoj amendamentin 13 të Komisionit funksional dhe të Komisionit të Buxhetit që e parasheh që zyrtarët e Administratës Tatimore dhe inspektorët hetues të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës t'i fusë të përfitojnë rrezikshmëri në punë, ndërkohë që inspektorët hetues të Policisë së Kosovës mbeten me një koeficient të tillë dhe kisha propozuar si modifikim të kësaj, të përfshihen edhe këta inspektorët hetues të Policisë, ta përfitojnë rrezikshmërinë në punë dhe kjo do të vinte në balancën të cilën pretendoi edhe deputetja Albulena Haxhiu. Kaq!

Veç diçka duhet të shtoj. Për mua është plotësisht e pakuptimtë si mund të futen përfitues të rrezikshmërisë në punë inspektorët hetues të Autoritetit të Konkurrencës, veç po jua përkujtoj një rast. Javë më parë, ky autoritet ka shkuar i ka hetuar berberët në komunën e Podujevës që i kanë rritur çmimet prej 2 në 2,5 euro. Ja çfarë rrezikshmërie kanë. Tash krahasoj me hetuesit e tjerë policorë. Kaq!

KRYETARI: Më falni! Ora është 17:00, jemi në përfundim të ligjit. Janë dy , katër, gjashtë, shtatë deputetë që thonë edhe një orë diskutim. A ka mundësi kështu? Kryetari i Komisionit, ministër i Financave, zonja Haxhiu, zonja Shala, zoti Bekim Haxhiu, a ka mundësi të na sillni ndonjë kompromis që ta përfundojmë se janë lodhur edhe deputetët. S'kemi marrë pauzë fare.

Kryetar i Komisionit Nait Hasani, fol!

NAIT HASANI: Kjo çështje është e rregulluar me Ligjin e Policisë, është e rregulluar edhe me akte nënligjore. Ata nuk kanë grada që rregullohen.

KRYETARI: Atëherë shkojmë kështu. Vetëm pak! S'ka kompromis. Albulena Haxhiu ka propozuar diçka. Propozimi i saj vihet në votim. Edhe vihet në votim propozimi i Bekim Haxhiut.

Atëherë në rend të parë shkojmë në votim. Shkojmë me propozimin e zonjës Albulena Haxhiut pa përkrahjen e Komisionit funksional, propozim i përkrahur edhe nga znj. Shala-Berisha. Votojmë tash!

Nuk kalon.

Propozimi i Bekim Haxhiut, pa përkrahje të Komisionit Funksional. Urdhëro, Bekim!

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar!

Kryetari i Komisionit e sqaroi që ai ka qenë veç gabim teknik i tij, d.m.th. edhe 2,8-shi bëhet 3,2, që mendoj se nëse doni edhe votojmë, po...

KRYETARI: Atëherë shkojmë drejt Projektligjit në tërësi. Të nderuar kolegë deputetë, pas gjashtë orësh debate, një punë e jashtëzakonshme, e falënderoj secilin deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mënyrë të veçantë edhe një herë Komisionin. Ju kërkohet falje në qoftë se kanë marrë ndonjë mërzi, po nuk ua kemi nënvlerësuar punën. Çështja ka qenë në interes të kategorive.

Jemi në votim të Projektligjit. Deputetët le të kthehen në sallë, ata që e kanë ndërmend të votojnë. Thërras deputetët të kthehen në sallë, ju lutem! Jemi duke votuar njërin nga projektligjet më me rëndësi, besoj shumë, të kësaj legjislatore, për dy dekada nuk ka ekzistuar. Deputetët, ata që janë në ambientet e Kuvendit edhe një minutë vijnë, ne e votojmë.

Shkojmë në votim. Të nderuar deputetë, votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Urime të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, punonjësve publikë. Faleminderit Kuvend i Republikës së Kosovës! Faleminderit Komisionit Parlamentar për Administratë Publike për punën e bërë dhe ministër i Administratës dhe i Financave!

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-111 për pagat në sektorin publik. Faleminderit të gjithëve!



Kalojmë në pikën tjetër, se po e shoh që një pjesë e deputetëve janë zgjuar. Unë nuk dua në mënyrë arbitrare, si dëshironi që të jetë vendimi? Atëherë, deputetë a ka mundësi, unë po e marr miratimin e juaj, si ju jam edhe unë, njëjtë. Votojmë a po doni të shkojmë në pauzë gjysmë ore, a po doni të vazhdojmë. Ju e vendosni vetë, po e shoh që ka dallime. Zoti Zemaj ka dallime, unë ta jap fjalën, po ka dallime. Pauzë de, por unë po e votoj. Ose pauzë, ose vazhdojmë, ju e vendosni. Ju e vendosni! Unë s'mund t'ia imponoj shumicës vullnetin e pakicës. Por nuk po duan një pjesë.

Deputetë, votoni kush është për pauzë. Kush është për të vazhduar, voton për, kush është për pauzë, kundër. Votojmë tash! A doni të vazhdojmë apo të rrimë?

Regjia, deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Në qoftë se është për, vazhdojmë. Votoni tash! Veç duhet të jenë 60 deputetë. S'ka vendimmarrje pa i pasur 61 deputetë. Jo, jo, s'ka vendimmarrje. Edhe një herë, 61 deputetë në qoftë se votojnë për, vazhdojmë. Përndryshe, ju lutem, përndryshe shkojmë në pauzë. Në qoftë se nuk votojnë 61 deputetë për, shkojmë në pauzë. Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, jam shumë i qartë, nuk abuzoj me asnjë deputet. Vetëm 61 deputetë ma imponojnë vazhdimin e seancës. Jo, jo! Jo do të rri, por do të rri gjithsesi. 61 deputetë në qoftë se votojnë për vazhdimin e seancës, rri unë dhe vazhdojnë. Edhe atëherë kërkoj nga Administrata që t'u silltet ushqimi deputetëve në sallë.

Edhe një herë, votojmë a doni ta vazhdojmë seancën, apo jo. Vazhdoni 61 deputetë. Votojmë tash! Votojmë! Seanca vazhdon, Administrata ju lutem ushqim dhe pije deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, vazhdojmë me seancën. Me shpenzime të Kuvendit, deputetët janë duke punuar.

#### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë**

Komisioni Funkcional për Punë të Jashtme e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. E ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zëvendëskryeministrin... Kush është përfaqësuesi i Qeverisë që do ta marrë fjalën për këtë projektligj? Kryeministër, të lutem! Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj e arsyeton dhe e paraqet projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: Të nderuar deputetë,  
Të nderuar...

KRYETARI: Zoti zëvendëskryeministër vazhdoni, se Kuvendi është duke i vazhduar punimet...  
Bilall të jesh më i koncentruar!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Shumë i nderuar zoti kryetar i Kuvendit,

Kryeministër,

Më lejoni që në pika të shkurtra t'ju informoj në këtë seancë plenare për Projektligjin sa i takon detyrave, përgjegjësi dhe kompetencave të delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës. Një projektligj i cili është miratuar në Qeveri të Republikës së Kosovës dhe e keni para jush.

Më lejoni t'ju informoj që deri më tash ka qenë një kërkesë e të gjitha partive politike në Kuvendin e Kosovës që Kuvendi i Kosovës të jetë bartës i procesit të dialogut, dhe me këtë projektligj Kuvendi i Kosovës bëhet edhe pikënisja e dialogut, edhe pikarritja e tij.

Çdo kërkesë që kanë pasur të gjitha partitë politike në Kuvendin e Kosovës, të gjitha grupet parlamentare, çdo shqetësim dhe çdo qëllim është i përfshirë në këtë projektligj.

Natyrisht që kryefjala e këtij projektligji sa i takon dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, është Kushtetuta e Kosovës dhe mbrojtja e interesave strategjike të Kosovës.

Së dyti, ky projektligj i jep një mandat të qartë Delegacionit Shtetëror të Kosovës...

KRYETARI: Më fal, zëvendëskryeministër! Unë e di se keni lodhje, ata të cilët kanë lodhje, kanë mundësi që të kalojnë në pjesën prapa në mënyrë që të vazhdojmë. Regjia nëse ka shumë zë e ekuilibroni pak. E vazhdojmë seancën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: Së dyti, ky projektligj e rregullon, i jep mandat të plotë Delegacionit Shtetëror të Kosovës e mbikëqyrë këtë delegacion dhe natyrisht që me këtë rregullohet llogaridhënia politike para Kuvendit të Kosovës dhe para qytetarëve të Kosovës.

Së treti, ky projektligj e rregullon përbërjen e barabartë të të gjitha subjekteve politike në Kuvendin e Kosovës, të atyre në koalicionin qeveritar dhe të atyre në opozitë, sesi të përfaqësohen në Delegacionin Shtetëror të Kosovës, sikurse krijon mundësi që të ketë edhe një përfaqësues nga shoqëria civile.

Së katërti, projektligji e rregullon hierarkinë dhe vendimmarrjen në procesin e dialogut. Po ashtu rregullon atë se çfarë mund dhe nuk mund të negociohet, cilat vijat e kuqe të Kosovës në këtë proces.

Funksionim e Delegacionit Shtetëror, strukturën dhe përgjegjësitë e tij, sikurse edhe koordinimin ndërmjet Delegacionit Shtetëror të Kosovës dhe institucioneve tjera të Kosovës, duke përfshirë; Kuvendin, Presidentin dhe Qeverinë e Kosovës.

Dua t'ju informoj që përtej këtij projektligji ne si Delegacion Shtetëror i Kosovës kemi hartuar, në bazë të rezolutës e cila është miratuar në Kuvendin e Kosovës, edhe platformën shtetërore për dialog të cilën jemi të gatshëm ta prezantojmë brenda 24-orësh, kurdo që Kuvendi i Kosovës do të mbledhet dhe ka nevojë që të ketë një debat për një platformë të tillë.

Ka pasur një debat gjatë tërë vitit 2018 rreh dialogut. Ka pasur dallime në qasjen tonë në dialog. Ka pasur një kërkesë permanente që Kuvendi i Kosovës duhet të jetë ai i cili vendos sesi do të duket dialogu, dhe sesi do të formësohet dialogu.

Ne mendojmë që me këtë projektligj, natyrisht që janë dhënë të gjitha parametrat e duhur që çështja e përfaqësimit të Kosovës në dialog të rregullohet në mënyrë të mirëfilltë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Tani e ftoj zëvendëskryetaren e Komisionit Funkcional për Punë të Jashtme, zonjën Time Kadrijaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

**TIME KADRIJAJ:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Në mbledhjen e mbajtur më 30 janar 2019 komisioni e shqyrtoi në parim Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë dhe konstatoi që projektligji i plotëson kushtet që t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në pajtim me Rregulloren e Kuvendit.

Andaj, komisioni rekomandon që të miratohet në parim projektligji në fjalë.

**KRYETARI:** Faleminderit! Vjosa Osmani, urdhëro!

**VJOSA OSMANI:** Faleminderit! Sot do ta paraqes qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së lidhur me këtë projektligj.

Fillimisht do të theksoj që në shtator të vitit 2018, katër parti opozitare që përfaqësojnë 60% të votës qytetare i janë drejtua institucioneve të BE-së për të konfirmuar qëndrimin kundër korrigjimit apo rivizatimit të kufijve dhe kundër rolit të Presidentit në këtë dialog.

Roli i tij madje është kualifikuar si kundër-kushtetues në ato letrat e nënshkruara nga; LDK, Vetëvendosje, PSD dhe Alternativa, dhe u kërkua që mandatimi i delegacionit të bëhet me 2/3 si

e vetmja mënyrë për t'i siguruar legjitimitet delegacionit e implementim një marrëveshjeje potenciale.

Sot, megjithatë, para nesh e kemi një ligj që i jep legjitimitet e mbështetje të plotë politike Presidentit dhe legalizon planet e tij për copëtim të vendit që deri tani nuk gjenin aleatë në Kosovë, por ngelnin thjesht si plane ruso-serbe për ndarjen e Kosovës.

Ligji në kundërshtim me atë që e tha zëvendëskryeministri lëre që nuk pozicionet në raport me negociatat e deritanishme të udhëhequra herë në mënyrë të fshehtë e herë publike në nivel presidentësh, por hap rrugë që negociatat për territor të vazhdojnë, duke mos vendosur asnjë kufizim të vetëm e as një vijë të kuqe për asnjë temë.

Pra, ky ligj lejon edhe negociim të ndarjes edhe të shkëmbimit edhe të korigjimit edhe të Asociacionit të Komunave Serbe edhe të ekstraterritorialitetit, e çka jo tjetër. Por, ky ligj e ka një kusht! E ai është, që kur Thaçi të shkojë në Bruksel t'i marrë edhe disa të tjerë me vete, por disa të tjerë që nuk do ta ndalojnë copëtimin e vendit, por me këtë ligj, thjesht do ta legjitimojnë atë.

U tha nga zëvendëskryeministri se ky ligj përcakton hierarkinë institucionale dhe procedurën e vendimmarrjes në procesin e dialogut. Zëvendëskryeministri e di shumë mirë që këto janë dy fusha që nuk përcaktohen me ligj, sepse tashmë janë të përcaktuara me Kushtetutë.

Kushtetuta identifikon këtë Kuvend si institucionin më të lartë përfaqësues e legjislativ. Përcakton Qeverinë si udhëheqëse ekzekutive, përfshirë edhe deri tani siç ka qenë pra në udhëheqje të dialogut, kurse sa i përket procesit të vendimmarrjes gjithçka sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare, përfshirë edhe atyre potenciale që mund të lidhen me Serbinë, janë tashmë të rregulluara në nenin 18 të Kushtetutës së Kosovës.

Pra, nëpërmjet këtij ligji po tentohet të rregullohet materie kushtetuese që është një absurditet juridik.

Po ashtu, thuhet që ky ligj ka karakterin e lex-specialis, pra duke tentuar që të eliminojë dispozitat e Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare. Por, zëvendëskryeministri apo ata që e këshillojnë e di shumë mirë që edhe duke i dhënë një ligji lex-specialis nuk mund të jetë mbi situatat që normohen si jus-kogens apo situatat kur tashmë janë të normuara me një ligj që përbën detyrim ndërkombëtar kontraktual të Kosovës. Rrjedhimisht edhe ky është një tentim jokushtetues.

Sa i përket transparencës, ne kemi dëgjuar Qeverinë të flasë shumë lidhur me transparencën e nevojshme në këtë dialog, por ky ligj e bën të kundërtën. Në fakt dispozitat e ligjit thonë që secili material do të ruhet si sekret shtetëror, dhe cilido zyrtar që e qet ndonjë letër jashtë do të dënohet sipas ligjit. Pra, e vranë transparencën edhe me ligj.

U fol edhe për emërimin dhe shkarkimin e delegacionit. Siç e dini është parim i përgjithshëm që procedura e emërimit duhet të vlejë edhe për shkarkim, por çka po na servohet sot është një delegacion pa mandat kohor i cili edhe në qoftë se nesër kemi një Qeveri tjetër, do ta ketë për obligim ta mbajë këtë delegacion sepse shkarkimi i tij lejohet vetëm me 50% plus 1, pra me një shumicë më të madhe sesa ajo emërimit, pra duhen 61 për në këtë Kuvend.

Këtu përmendet edhe vendimmarrja me 2/3 e cila kërkohet, ta zëmë për ta ndalur Presidentin. Edhe pse fillimisht tentohet që të kërkohet një konsensus, por pastaj zbret standardi duke rënë kështu në kundërshtim me rezolutën që e ka sponsorizuar vet PSD-ja në të cilën është kërkuar unanimitet i plotë.

Në fakt shumë nga dispozitat e ligjit të cilat thuhet se synojnë që t'i jepen karakter obligativ ligjor rezolutës janë në kundërshtim me vet rezolutën e cila është hartuar. Qoftë ajo sa i përket synimeve të dialogut, qoftë ajo sa i përket atyre që identifikohen si çështje fundamentale për shembull; integriteti territorial apo edhe rregullimi shtetëror i vendit, pro edhe çështjet që kanë të bëjnë me rolin e Kuvendit të Kosovës.

Tani, pyetja ime është: Më kë do të negociojë ky ekip? Përderisa e përlij rolin e Presidentit të vendit nëpërmjet këtij ligji dhe garanton që në nivel presidentësh edhe mund të vazhdojnë negociatat për kufi, sepse asnjë dispozitë e vetme në ligjin aktual që e keni sjellë nuk thotë që nuk mund të negociohet për territor as për shkëmbim, as për korrigjim apo për Asociacionin e Komunave. Me kë do të negociojë ekipi që në ligj thuhet se i ka 11 anëtarë e në kllapa 12? E kemi bërë të njëjtën pyetje edhe në komision.

A është presidenti anëtari i 12-të i cili nuk është përmendur? Dhe si është e mundur që në dokumentin që e keni votuar vet në Kuvendin e Kosovës, keni përmendur 8 emra të Qeverisë e 3 të të ashtuquajturës opozitë, kurse në ligj flisni për komplet numra të tjerë. Pra, edhe këtu është një kundërshtim i madh.

U tha që timoni do t'i jepet Kuvendit. Por, në qoftë se e lexojmë përmbajtjen e delegacionit, aty timonier në fakt është një zëvendëskryeministër dhe një kryetar komune, dhe shumica dërmuese janë anëtarë të Qeverisë e jo të Kuvendit. Madje, po tentoni edhe ta eliminoni rolin opozitar në Parlament duke e eliminuar rolin e komisioneve parlamentare të cilat i kemi të përcaktuara me një rregullore që miratohet me 2/3. Pra, tentoni që ta formoni një komisioni ad-hoc, i cili në mënyrë uniletarale merr kompetenca të cilat tashmë u takojnë komisioneve të tjera parlamentare dhe po kërkoni që ky ekip pastaj të raportojë vetëm para atij komisioni që përbëhet vetëm prej anëtarëve të vet. Kjo sikur të raportosh para vetvetes!

Pra, mos të shkojmë te LDK-ja, mos të shkojmë te VV-ja sepse po kemi qejf të raportojmë vetëm para njerëzve tanë dhe jo para komisioneve që e kanë një obligim të tillë me Rregulloren të Punës e cila është miratuar me 2/3 e Kuvendit të Kosovës.

Ka gjëra të shumta që duhet të eliminohen në këtë ligj, por sikur të fillojmë me amendamentim, atëherë duhet ta ndryshojmë qind për qind. Por, e vërteta është që duke e përmendur Presidentin me një emër tjetër, duke e përmendur me ermin institucioni kushtetues i ftuar, të gjithë ata qederi dje kanë proklamuar se janë kundër roli të tij, dhe kundër planeve të tij për copëtim të Kosovës, sot po ia bëjnë nderin më të madh që ai ka mundur ta imagjinojë.

E ka pasur një kriter që ta plotësojë para bashkësisë ndërkombëtare dhe ai ka qenë që të tregojë që ka mbështetje politike dhe mund ta shesë këtë marrëveshje kur të kthehet në Kosovë. Fatkeqësisht, ky ligj është duke ia dhënë pikërisht këtë. Prandaj, i ftoj të gjithë deputetët që mos ta votojnë, pro t'i mbesin besnik rezolutave tashmë të miratuara në këtë Kuvend, të cilat i japin përgjegjësinë e vetme Qeverisë së Kosovës për ta udhëhequr dialogun, e cila vërtetë e ka përnjëmend, duke filluar nga kryeministri e teposhtë, nuk flet këtu për mbrojtjen e territorit, pro e largon Thaçin nga roli i tij kundër-kushtetues dhe ulet vetë në atë karrige.

Territori nuk mbrohet këtu, por mbrohet kur kryeministri e merr përgjegjësinë e vet kushtetuese e jo duke zgjedhur; kjo po më pëlqen dhe kjo nuk po më pëlqen. Faleminderit!

**KRYETARI:** Atëherë, Elmi Reçica nga Partia Demokratike e Kosovës.

**ELMI REÇICA:** Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje zëvendëskryeministra, ministra,

Kolegë të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne sapo morëm një vendim shumë të rëndësishëm dhe votuam një ligj, dhe po dëshmohet se sot do të kemi për të marrë vendime shumë të rëndësishme.

Gjatë natës së sotme e kemi edhe projektligjin për buxhetin dhe janë çështje që vërtetë janë shumë të rëndësishme për të tashmen dhe të ardhmen e vendit tonë.

Si çështje shumë të rëndësishme dhe pikë shumë të veçantë të rendit të ditës e kemi Projektligjin për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.

Nuk mund të flasim për projektligjin që do të shndërrohet sigurisht në ligj, pa folur për dialogun.

Mendoj se një nga tri çështjet më të rëndësishme para të cilave ndodhet vendi ynë, dhe të cilat janë shumë të rëndësishme edhe njëherë po e ritheksoj për vendin tonë, është edhe përmbyllja e dialogut me Republikën e Serbisë.

E dimë që ka shumë peshë agjenda evropiane, e dimë që është shumë me rëndësi edhe zhvillimi ekonomik, po edhe agjenda evropiane edhe zhvillimi ekonomik edhe shumë çështje, edhe vet siguria e shtetit të Kosovës varet nga përmbyllja e dialogut me Republikën e Serbisë.

Ne kemi qenë në konflikt afatgjatë me Republikën e Serbisë edhe kur ka pasur sisteme të ndryshme të qeverisjes. Edhe kur ka qenë Mbretëri. Edhe kur ka qenë sistemi komunist edhe tash kur është ai i ashtuquajturit sistem i demokracisë parlamentare. Çdoherë ato çështje të hapura kanë eskaluar dhe kanë prodhuar konflikt.

Është obligim yni dhe është përgjegjësi e jona që ta mbyllim këtë vrage këtë varrë e cila është një e keqe që mund të përcillet në gjenerata e ardhshme.

Mos të harrojmë se ka 20 vite që ka përfunduar lufta. Janë lindur, janë rritur dhe janë të bërë të moshës madhore shumë vajza dhe djem të shtetit tonë. Ata sot jetojnë me frikën se mund rikthehet ai konflikt me Republikën e Serbisë.

Për atë arsye është shumë e domosdoshme. Është obligim i këtij Parlamenti dhe i të gjithë neve që në këtë fazë ta përmbyllim këtë konflikt. Është edhe sugjerim është edhe kërkesë. Është edhe insistim i të gjithë miqve ndërkombëtare që ne ta përmbyllim konfliktin me Serbinë.

Konflikti me Serbinë mund të përmbillet vetëm atëherë kur Republika e Serbisë e njëj Republikën e Kosovës, siç do duhej të ndodhte edhe anasjelltas.

Ne kemi pasur momente shumë të veçanta dhe shumë dramatike rreth zhvillimit të këtyre bisedimeve që nga nxjerrja e rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ku na ka obliguar që ne t'i normalizojmë raportet me fqinjin tonë verior.

Në kuadër të kësaj ka pasur lëvizje dhe oscilime. Ka pasur ndryshim pushtetesh. Ka pasur ndryshime edhe individuale, pro dialogu ka vazhduar. Dhe dialogu duhet të vazhdojë me qëllim e vetëm që të përmbillet.

Ne jemi dëshmitarë të kohës që ka momente, ka situata kur ne mund të ndodhemi para një gjendjeje që mund ta eskalojë këtë situatë. Prandaj, po e theksoj që ne duhet domosdo që ta përmbyllim këtë konflikt.

Është e vërtetë që ne si qytetarë të këtij vendi. Ne si Parlament, do duhej që të jemi unik sa i përket këtij dialogu. Nuk ka çështje më të rëndësishme nuk ka çështje më me peshë, po nuk ka çështje që ka brenda saj edhe rreziqe më shumë sesa përmbyllja e këtij dialogu.

Është domosdoshmëri që ky Kuvend të jetë unik, pa marrë parasysh dallimet, ose ideologjike, ose partiake, ose personale.

Është shumë më rëndësi që me këtë projektligj, definitivisht kërkesa që është bërë shumë vite edhe nga partitë e qeverisjes që e mbajnë Qeverinë edhe nga partitë e opozitës, po edhe nga shoqëria civile është kërkuar që Kuvendi ta ketë vendin e vet në këtë proces të dialogimit.

Që Kuvendi të jetë ai i cili do të vendosë në fund se çfarë do të ndodhë me atë dialog. Që Kuvendi të jetë ai që do t'i votojë ato marrëveshje.

Me këtë projektligj sigurohen të gjitha këto çështje. Me këtë projektligj mundësohet që Delegacioni Shtetëror i Republikës së Kosovës, para dhe pas shkuarjes në Bruksel ose në ndonjë vend tjetër të vijë dhe të japë llogari këtu.

Mos të harrojmë se është kërkuar edhe nga shoqëria civile edhe nga opozita. Mund të ndodh që opozita e tashme ka qenë në pozitë atëherë, po edhe nga komisionet parlamentare që domosdo të krijohet një komision që do t'i mbikëqyr bisedimet me Serbinë.

Në kuadër të kësaj, sa më shumë që të ketë transparencë, sa më shumë të ketë llogaridhënie, domosdo që mundësitë për të gabuar do të jenë të pamundura. Do të jenë inekzistente.

Është edhe sugjerim i të gjithë atyre që e respektojnë këtë vend, e kanë mbështetur këtë vend dhe e duan këtë vend, që ne dialog me Serbinë të jemi unik. Në kuadër të këtij uniteti, në kuadër të asaj që kërkohet për vazhdimin e dialogut dhe përmbylljen ose finalizimin e tij, jo vetëm partitë parlamentare që janë aktualisht në Parlament, po edhe partitë që janë të dëshmuara dhe që për shkak të pamundësisë për të marrë votat nuk janë këtu të përfaqësuara duhet të jenë pjesë e këtij dialogu.

Për vet ligji. Ligji është shumë i shkurtër dhe shumë i qartë, dhe është një ligj i cili dëshmon se dialogu me Serbinë po rikthehet në Kuvend. Votimi këtij ligji është dëshmuar që, ajo që u tha më herët, që rezolutat e votuara e kërkojnë domosdoshmërisht që të ruhet tërësia territoriale, që s'ka shkëmbim terriroresh, që s'ka pushtet të mesëm dhe që nuk e ka askush atë të drejtë që të dialogojë pa Parlamentin me Republikën e Serbisë.

Në kuadër të kësaj, mendoj që ky ligj e ligjëson atë çfarë deri tash janë votuar si rezoluta. E ligjëson atë çfarë realisht është kërkuar nga të gjithë ne.



Unë po e ritheksoj edhe njëherë atje, është kërkuar edhe nga KDI-ja që e ka mbikëqyr dhe e mbikëqyr punën e Kuvendit që sa kohë, që domosdo të ketë një ligj të tillë dhe domosdo të ketë një komision i cili duhet t'i mbikëqyr ato bisedime.

Ligji ofron atë çfarë është shumë e domosdoshme për të debatuar dhe për ta përcaktuar të ardhmen e këtij vendi dhe raportet me Republikën e Serbisë.

Dakordohem që neni 5, pika 6 të shkarkimi i komisionit, megjithëse do ta diskutojmë ndërmjet dy leximeve, domosdo që duhet të ndryshojë, dhe duhet të zbatohet parimi që secili institucion, por edhe ky delegacion shtetëror për bisedime me Serbinë, ashtu si zgjidhet, ashtu edhe duhet të shkarkohet.

Nuk e kisha lidhur këtë vetëm me të qenit sot në pozitë ose në opozitë. Kjo është çështje shtetërore.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë të atyre zhvillimeve që na kanë sjellë deri këtu dhe në kuadër të kësaj, secili e ka meritën dhe i ka aksionet e veta dhe në kuadër të kësaj është shumë e domosdoshme që ne të rezonojmë si shtet. Që ne të rezonojmë atë çka përfaqëson kjo Republikë jona dhe sa më shumë që jemi unikë, sa më tepër të jemi të bashkuar, aq më të fuqishëm do të jemi edhe në bisedimet me Serbinë.

Mendoj që më së shumti duhet të na bashkojë kjo çështje dhe në kuadër të kësaj unë, edhe nga kjo foltore, siç kam bërë ftesë, siç kam bërë thirrje edhe më herët, edhe në emër timin, edhe në emër të grupit parlamentar u bëj ftesë partive opozitare që të bëhen pjesë e Delegacionit Shtetëror, të respektohen Kushtetuta dhe të respektohen ato çfarë ne kemi krijuar vetë. Kushtetuta e thotë shumë qartë, kush do t'i prijë këtij vendi dhe kush e ka përgjegjësinë më të madhe rreth këtij vendi.

Dhe unë mendoj që ky ligj do ta dëshmojë që secili përfaqësues i Kosovës që do të shkojë në Bruksel ose ku do qoftë për të biseduar për të ardhmen e këtij vendi, për raportet me Republikën e Serbisë që nuk mund t'i kalojë asnjë vendim, asnjë qëndrim dhe asnjë fjalë që është në kundërshtim me këtë ligj, me Kushtetutën dhe me atë çka kemi votuar këtu.

Besoj që koha, duke pasur parasysh edhe insistimet që të vazhdojë dialogu, që të përmbyllet dialogu, që të finalizohet dialogu, është kohë që neve po na dëshmon dhe po na kërkon ajo si kohë, se ne duhet t'i përshpejtojmë hapat dhe sa më shpejt duhet të ndërtojmë unitetin...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të nderuar të këtij Kuvendi,  
Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Nuk mund të flasim për ligjin në veçanti, pa folur për dialogun në përgjithësi. Pra, po flasim për dialogun me Serbinë.

Bile, ky ligj, me sa më kujtohet, si motiv të sponzorizimit, dhe po më kujtohen debatet atëherë kur ndodhnin lidhur me këtë ligj, pra për nevojën e një ligji të tillë, gjithmonë motiv me sa më kujtohet ka qenë kjo aventura e presidentit për të hapur tema kaq të paparashikueshme sa që Kosova paska nevojë që me ligj ta normojë dialogun Kosovë-Serbi.

Po ku është ironia lidhur me këtë ligj? Në të njëjtën ditë që u zgjodh Delegacioni Shtetëror për dialogun me Serbinë, bash në mbrëmjen e asaj dite kryeministri dha një intervistë në televizor dhe tha që në asnjë mënyrë nuk cenohet nëpërmjet këtij ligji, roli i Presidentit që e ka në dialogun me Serbinë.

Pra, shikojeni ironinë, vetë motivi të vihet te ky ligj ka qenë që kjo iniciativë e rrezikshme e presidentit, kurse në të njëjtën kohë, ky ligj, me formulime të tij nuk e ka prekur fare punën e presidentit dhe projektin të cilin e përfaqëson.

Ky Delegacion Shtetëror dhe Qeveria kurrë nuk e ka qartësuar dilemën: a është ky delegacion ekip mbështetës i presidentit, ashtu siç e koncepton partia e presidentit, apo është me arsyetimin që t'i merret nga duart dialogu me Serbinë presidentit tonë.

Unë mendoj që është e para, që ky Delegacion është ekip mbështetës i Thaçit, kështu po mendon edhe shefja e dialogut, Federica Mogherin. Sepse në letrën që ia ka dërguar këtij ekipi shtetëror sapo këta janë zgjedhur, pra të nesërmen e zgjedhjes ekipi shtetëror për dialogun, shefja e dialogut, Federica Mogherini, e dërgoi një letër, ku u tregoi këtyre qysh ajo i trajton. E nuk mendoj që kjo është e parëndësishme, çka mendon Mogherini, se Mogherini e ka organizuar dialogun me Serbinë.

Këta iu kanë përgjigjur ftesës së Mogherinit, nuk e kanë thirrur këta Mogherinin për t'i treguar qysh bëhet kjo punë, Mogherini i ka ftuar këta. Edhe natyrisht në cilësinë që ajo të fton, nuk mund t'i tregosh asaj qysh të organizohet dialogu dhe formati.

Formatin e organizon Mogherini, pra BE-ja, Departamenti i Politikës së Jashtme i Sigurisë dhe ti ose mund të shkosh atje qysh të thërret ajo, ose të refuzosh të shkosh.

Mirëpo, letra e saj, për mendimin tim, ishte pa ekuivokë, që ky është një 'suportin tim' i Hashim Thaçit, dhe kështu ma merr mendja është edhe në të vërtetë.

Ne ju patëm thënë që kështu është edhe para se të shkruante letrën Mogherini, por nuk besonin, tash kanë kohë ta vërtetojnë.

Prandaj, duhet të konstatojmë që Qeveria po i mashtron qytetarët sa i përket kufizimit të presidentit. Presidenti nuk ka kurrfarë kufizimi prej këtij ekipi shtetëror.

Ai do t'i vazhdojë negociatat me Vuçiqin kurdo që ata e konsiderojnë që janë pjekur rrethanat dhe, bile këtë edhe ligji e pranon që mund të jetë ashtu, varësisht kush e pranon ftesën, thotë ligji, shkon atje dhe takohet me Serbinë.

Nëse e merr ftesën Hashim Thaçi, shkon Hashim Thaçi. Çfarë kufizimi i presidentit është ky, nuk po e kuptoj? Qysh ia keni marrë prej duarve Hashim Thaçit dialogun me Serbinë?

Ky ekip shtetëror sapo u mandatua, nuk e zgjodhi rrugën e konfrontimit me projektin e presidentit, por përkundrazi, rrugën e oportunitetit dhe të bashkëpunimit me të.

Unë mendoj që është shumë reprezentative ajo fotografia duke u dhënë Hashim Thaçi instruksione Shpend Ahmetit edhe Fatmir Limajt.

Nuk ka nevojë të bëhet lajm ajo fotografi hiç, thotë ajo shprehja e njohur: “Një fotografi është më shumë se 100 fjalë”. Këta duke e dëgjuar Hashim Thaçin, Hashim Thaçi duke u dhënë instruksione.

Unë mendoj që për dy arsye Kuvendi i Kosovës duhet të nxjerrë një dokument, i cili ia ndalon negociatat me Serbinë Hashim Thaçit. Domethënë, ajo për të cilën kemi nevojë në këtë Kuvend është një dokument që ia ndalon atij çfarëdo negociata me Serbinë.

Për mendimin tim janë dy arsye, dy argumente, shumë të fuqishme pse duhet kjo të ndodhë.

E para, ka të bëjë me temat që ai po i hap në dialog me Serbinë. E kemi një president, i cili, më falni, po në muajin shtator të vitit të kaluar ka thënë që është duke e negociuar me Vuçiqin kufirin e gjatë 430 kilometra mes Serbisë e Kosovës.

Qysh e thotë edhe shkenca e gjeografisë, kufiri mes Kosovës dhe Serbisë është diku rreth 370 kilometra katrorë, kah i dolën 60 kilometra më shumë presidentit tonë?

Qysh mund të shkojë presidenti ynë deri në këtë pikë të negociatave me Serbinë të flasë për 430 kilometra kufij Kosovë-Serbi. Tash veç ka mbetur të na tregojë, ata xhepat që e ka mendjen me gërrshërë bashkë me Vuçiqin t'i krijojë, a janë brenda Kosovës, a do të jenë brenda Serbisë, ato 60 kilometra shtesë, atë s'na e ka treguar.

Edhe e dyta, pse duhet t'i ndalohet Hashim Thaçit të diskutojë me Serbinë është Gjykata Speciale.

Se këtu presidenti ynë është në konflikt total të interesit.

Në kuptimin formal juridik, ne e dimë që Gjykata Speciale është gjykatë e Bashkimit Evropian.

Federica Mogherini në të njëjtën kohë është edhe shefe e dialogut, ku është Thaçi aty brenda, edhe në të njëjtën kohë i ka mandatuar prokurorët dhe gjyqtarët e Gjykatës Speciale, të cilët edhe mund të merren me presidentit tonë një ditë, të gjithë ekspertët kanë thënë që nuk përjashtohet mundësia.

Me vetë faktin që Federica Mogherini është mandatuere e prokurorëve që pasnesër mund të merren me Hashim Thaçin, Hashim Thaçi nuk bën të shkojë në negociata me Serbinë, është konflikt interesi, konflikt i qartë i interesit.

Pra, e para është për temat që ai po i hap, e dyta është konflikti i interesit! Pse? Pse Mogherini në dorën e djathtë e ka marrëveshjen me Serbinë, a në dorën e majtë e ka padinë për Hashim Thaçin.

Kështu që, për këtë arsye unë mendoj që në vend të këtij ligji shumë të dobët që është propozuar, shumë më mirë është Kuvendi i Kosovës të formulojë një qëndrim shumë të qartë, ku votohet prej shumicës së deputetëve të këtij Kuvendi që thotë “ky njeri nuk bën asnjë muhabet të bëjë me Serbinë, ku e përfaqëson Kosovën”, për këto arsye që unë i thashë.

Kështu që ato tjerat te ligji s'po hyj fare, se i përmendi edhe Vjosa, duke u nisur prej Ligjit për marrëveshjet ndërkombëtare, ligjit organik në Kosovë, i cili ka referencë drejtpërdrejt në Kushtetutën e Kosovës, e deri te ajo tallja që bën me reprezentim ky ligj.

Për shembull, LDK-ja e Vetëvendosja ejani, po nëse nuk vini ju, shkojmë ne, prapë i plotësojmë ato vende. Domethënë bëjnë hajgare edhe me parimet universale të reprezentacionit, ka defekte të tilla.

Ne nuk do ta votojmë këtë ligj.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Gorani e ka fjalën.

**DUGAGJIN GORANI:** Të nderuar deputetë,  
Projektligji për dialogun paraqet një përpjekje për bashkërendim politik e ndërpartiak në një kohë të ndjeshme për shoqërinë dhe në një moment kritik për shtetin.

Është përpjekje për ta ndërprerë praktikën e protagonizmit dhe për ta afirmuar transparencën parlamentare e llogaridhënien publike. Uroj që ta kuptoni kësi soj.

Synimi i këtij projektligji është detyrimi në bashkëpunim dhe ndarje të përgjegjësive politike. Është detyrimi në baraspeshë të përfaqësimit dhe në unitet të veprimit.

Andaj, mbi të gjitha, uroj që të interpretohet si përpjekje për t'i tejkaluar tifozeritë partiake e sedra personale për hir të obligimeve kombëtare që i mbajmë ndaj të ardhmes së shtetit.

Gjatë kësaj jave ky projektligj u miratua me shumicë votash në Komisionin për Punë të Jashtme, edhe pse në një atmosferë të rënduar panevojshëm mes akuzave politike dhe ofendimeve personale.

Shpresoj që një qasje e tillë të mos përsëritet edhe sonte, përplasjet ndërpartiake dhe ngritjet ndërnjerëzore nuk ofrojnë zgjidhje përballë një obligimi vendor, rajonal e ndërkombëtar, çfarë është arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse, ndërkombëtarisht të pranueshme dhe ligjërishme e obligueshme mes Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë.

Një marrëveshje e tillë patjetër duhet të arrihet përmes një procesi negociator, i cili del të jetë i paevitueshëm dhe nga i cili as mund të ikim, e as mund të vonohemi.

Për këtë arsye synim parësor i këtij projektligji është insistimi në baraspeshë e korrektësi përfaqësuese mes subjekteve politike dhe institucioneve kushtetuese, cilado qofshin ato.

Sipas Partisë Socialdemokrate që e propozoi dhe e hartoi këtë dokument, kjo mundësohet duke themeluar një entitet të vetëm negociues, e që është Delegacioni shtetëror.

Në projektligj ky përkufizohet si adresa e vetme, nga e cila do të zhvillohet procesi i dialogut.

Në Delegacion do të hartohet strategjia negociuese, do të zhvillohen diskutime dhe do të propozohen vendime.

Sipas këtij projektligji, askush nuk mund të angazhohet në proces nëse nuk është anëtar i Delegacionit, apo nëse nuk është i ftuar nga ai. Kjo vlen barabarësisht si për përfaqësuesit partiakë, ashtu edhe për institucionet kushtetuese.

Krejt në fund, Delegacioni shtetëror nuk është entitet i pavarur dhe nuk mund të funksionojë si i tillë. Ai i obligohet Kuvendit të Republikës dhe nuk mund të marrë asnjë vendim për çfarëdo marrëveshje pa miratim paraprak parlamentar.

Në anën tjetër, asnjë miratim i tillë nuk mund të pritët pa raportim të rregullt, pa shpjegim të saktë dhe pa përkrahje nga shumica e deputetëve.

Andaj, përmes bashkëdrejtuesve të tij, Delegacioni obligohet që t'i raportojë Kuvendit gjatë secilit fazë të procesit dhe sa herë që Kuvendi e sheh të udhës një veprim të tillë.

Për Partinë Socialdemokrate, ndërtimi i një strukture dhe procedure të këtillë përfaqësuese, transparente e llogaridhënëse, ishte parim udhëheqës edhe gjatë hartimit të rezolutës mbi dialogun.

Miratimi i saj parlamentar, sado i kontestuar e i kritikuar, ishte po ashtu edhe një sinjal i një vullneti modest për arsyeshmërinë politike, sado që kjo ishte e vonuar.

Por, megjithatë, ishte shenjë e një gatishmërie për të pranuar faktin se punët e përbashkëta nuk mund të kryhen vetëm.

Se për çështjet madhore të një populli nuk mund të flet vetëm një njeri, një parti, e as vetëm një koalicion qeveritar.

Deputetë të nderuar,

Me miratimin e këtij projektligji synojmë që ky vullnet politik të shndërrohet në detyrim juridik.

Përmes tij synojmë ta saktësojmë mandatin, ta definojmë mënyrën e funksionimit dhe ta përcaktojmë procedurën e vendimmarrjes brenda një procesi të bisedimeve ndërshtetërore.

Përmes tij raportimi para Kuvendit dhe llogaridhënia para shoqërisë shndërrohet në obligim.

Me miratimin e Ligjit për dialogun, shkelja e këtij obligimi tërheq pas vete edhe ndëshkim shoqëror, edhe dënim ligjor.

Andaj, ju ftoj që sot ta votoni këtë projektligj, duke kuptuar si mundësi të bashkëpunimit mes partive, e jo të nënshtrimit ndaj pushtetit.

Ju ftoj që ta shihni si përpjekje për përfaqësim të barabartë, e jo për thellim të përçarjeve.

Delegacioni shtetëror mund dhe duhet të jetë i të gjithëve dhe për të gjithë.

E tëra që duhet ta bëni sonte është ta zgjidhni pjesëmarrjen në vend të refuzimit, ta zgjidhni bashkëpunimin, në vend armiqësimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Shumicën e parafolësve nuk e dita a jemi duke folur për një projektligj, a jemi duke folur për debate të tjera politike, a për dialog, a për presidentin, se patën tema të ndryshme. Mirë boll se gjithmonë po gjejnë tema refuzuese e kundërshtuese, e kurrë s'po afrojnë alternativa, e lehtë është të kundërshtosh e të mos marrësh asnjë përgjegjësi, lehtë është të këqyrësh prej largësie se çka po bëhet, e ta lësh vendin e të thuash hajt ta marrë lumi ose dreqi, veç unë të mos jem pjesë e saj. Kështu po bëjnë këto partitë opozitare, e na kënaqën llafe!

Ne e kemi një projektligj, e projektligji i ka disa procedura parlamentare. E kemi shqyrtuar edhe në Komisionin Parlamentar, e kemi votuar në parim.

Ka mundësi ndryshimi, sepse mes dy leximeve, nëse dakordohemi si komision, po jo dakordancë veç për qëllime politike, po për ta bërë një projektligj që është i mirë, sepse deri sot kemi kërkuar transparencë e llogaridhënie dhe tash është momenti, sepse kjo është forma që të kërkohet prej këtij delegacionit edhe llogaridhënie, edhe transparencë.

Nuk po pajtohem me atë çka thanë parafolësit se Qeveria po i mashtron qytetarët, jo, qytetarët po i mashtron opozita me fjalimet e tyre populiste, e pa bërë bashkë asnjë send për këtë vend.

Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe do ta japë kontributin në mes të dy leximeve. Shpresoj se kolegët e mi nga komisioni të gjitha këto që i thanë këtu do të jenë shumë aktivë edhe do të mundohemi që kur bëhet ligj, të bëhet një ligj i mirë, një ligj i implimentueshëm dhe një ligj që do të jetë në shërbim dhe në interesat e shtetit të Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Berisha e ka fjalën.

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Unë në emër të Nismës edhe në Komisionin për Punë të Jashtme kam mbajtur këtë qëndrim, për afërsisht që do ta përsëris edhe këtu.

Mendojmë se Kosova nuk mund të vazhdojë gjatë gjithë kohës të vajtojë situatën në të cilën gjendemi, po paralel me këtë vajtim, ne duhet të mendojmë edhe për ngritjen e seriozitetit dhe rikthimin në fushën e betejës politike dhe diplomatike të të gjithë aktorëve politikë e qytetarë.

Ne mund të mbajmë këto qëndrime që i kemi mbajtur deri tash, por koha ka treguar se duke pasur divergjencë të panevojshme rreth një çështje fundamentale, siç janë bisedimet përfundimtare me Serbinë, mendoj se jemi duke rrëshqitur aty ku nuk e meritojnë qytetarët e Kosovës, nuk e meriton Kosova.

Besoj se të gjithë e dinë se tashmë në raport me Serbinë kemi dy agjenda dhe këto dy agjenda nuk u shërbejnë objektivave, synimeve që i ka vendi ynë.

Po mendoj se agjenda e Qeverisë, e institucioneve, duke përfshirë edhe Parlamentin, meqë e ka votuar një delegacion shtetëror dhe agjenda e presidentit që është krye më vete, por nuk është kjo ndonjë risi, ai vazhdon një kohë të gjatë kështu, duhet të bëhet një.

Dhe, agjenda e një pjese të opozitës të bashkohemi që thjesht, ato që kemi t'i themi për njëri-tjetrin t'i lëmë për një moment tjetër, sepse problemi i Kosovës nuk është problem që mund të vlejë vetëm për një vit ose për një mandat të qeverisjes. Problemi i Kosovës duhet të zgjidhet dhe, natyrisht zgjidhja e problemit të Kosovës në raport me Serbinë mendoj se mbyll një kapitull, i cili në rast se lihet hapur, paraqet pasiguri për të ardhmen.

Unë po besoj se tashmë të gjithë janë të bindur se prekja e kufijve ose copëtimi i kufijve nuk mund të ndalen me deklarata, por mund të ndalen duke qenë pjesë e betejës, e cila është duke u zhvilluar, gjithmonë po flasim në kontestit politik dhe diplomatik.

Kështu që kisha ftuar edhe kolegët nga subjektet opozitare që të jemi bashkë në këtë betejë politike dhe t'i lëmë pak anash teket dhe ndoshta inatet, diku edhe me arsye ndaj njëri-tjetrit, për shkak se është në pyetje, po e përsëris, Kosova.

Mendoj se koha e ka dëshmuar qartë se kur kemi qenë bashkë si faktorë politikë, në një moment të caktuar edhe ushtarak në Rambuje, pastaj në Vjenë, faktori politik e qytetar, kemi dalë triumfues në tavolinën e bisedimeve me Serbinë dhe si të tillë e kërkoj të jetë edhe në këtë moment Kosova. Por e kemi edhe një moment tjetër, kur nuk kemi qenë unikë, kur nuk kemi qenë bashkë, Kosova ka pasur debakël në raport me Serbinë sa u përket bisedimeve, siç është rasti i bisedimeve në Bruksel, fillimisht të filluara si teknike, por të cilat kanë qenë më shumë se teknike dhe koha ka dëshmuar, të filluar nga Hashim Thaçi dhe të pasuara nga Isa Mustafa, me kryeneqësi, duke mos e krijuar atë unitet, i cili po kërkohet tash, thjesht kemi dështim të shtetit të Kosovës në raport me Serbinë dhe kemi regres në disa gjëra që janë arritur më herët dhe në format të tjera, nga Kosova dhe qytetarët e Kosovës.

Kështu që unë po shpresoj se ligji do t'i paraprijë edhe një platforme që duhet ta nxjerrë dhe ta miratojë ky Kuvend për bisedimet me Serbinë, sepse ligji, në rast se e vendos një kornizë, unë mendoj se platforma do të jetë një rrugëtim nga i cili nuk mund të lëvizet, cilido qoftë që e përfaqëson Kosovën në bisedime. Dhe, në këtë rast, edhe një herë po e përsëris qëndrimin e Nismës Socialdemokrate, se ne do të vazhdojmë të jemi në krye të përgjegjësive që na e ka dhënë qytetari, por natyrisht do të jemi përballë asaj që është nevojë e vendit dhe nevoja e vendit është për t'u përballur me sfidat që i kemi në raport me Serbinë dhe diplomacinë e jashtme që lidhet me Kosovën. Faleminderit!



KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit, kryesues!

Sigurisht që sot është një ditë e veçantë, është debat prej mëngjesit me shumë propozime, kisha thënë edhe këtu, kam bërë thirrje edhe më herët që të bëhemi unikë dhe të japim kontributin tonë për të gjitha nevojat e shtetit dhe të mos bëhemi vetëm kritikë, por të bëhemi unikë.

Kritika është e shëndoshë, por derisa ne nuk unifikohe mi, sigurisht që asnjë dialog dhe askund nuk do të jemi me një rezultat që e dëshirojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Enver, e deshe fjalën? Zoti Hoxhaj!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Nuk dua t'ju marr shumë kohë, por dua të jem shumë i qartë, nuk e kam ndërmend të polemizoj shumë për përmbajtjen e ligjit, por dua ta shpreh vullnetin tonë që ne jemi të gatshëm, sido që ju mendoni që ky ligj do të duhej të dukej ta shkruajmë, merreni dhe hidheni në shportë, jemi të gatshëm t'ia nisim prej fillimit së bashku me ju këtë projektligj. Ajo se çka është e rëndësishme është ta kemi një pjesëmarrje edhe nga kolegët e opozitës. Nuk është luftë për opinion publik, nuk është politikë partiake, por ne mund ta formësojmë projektligjin sikurse ju keni dëshirë, nuk ka kurrfarë vlere, kurrfarë relevance, vetëm të mos e lejojmë një situatë që tema të politikës së jashtme të përdoren për qëllime të brendshme, si e kemi pasur në vitet e fundit dhe të qëndrojmë në vend.

Së dyti, mendoj që edhe qëndrimi i subjektit tim politik është i qartë, ne duam ta përmbyllim shtetndërtimin e Kosovës në këtë territor, në këta kufij dhe ta përmbyllim sovranitetin e Kosovës dhe jemi të gatshëm të bashkëpunojmë së bashku me ju. Çfarë pozite ka Presidenti, Qeveria, është e rregulluar me Kushtetutë dhe ky ligj nuk mund të jetë mbi Kushtetutën, por ky ligj e rregullon një kërkesë, e cila ka qenë permanente në Kuvendin e Kosovës gjatë vitit 2018, që Kuvendi i Kosovës të jetë pikënisja dhe pikërritja e dialogut. Ma merr mendja që këtë e arrijmë, jemi të gatshëm që ta shkruajmë dhe ta rishkruajmë. Sikurse unë jam i gatshëm që po ashtu t'ia lë vendin një kolegu deputet, ma merr mendja që edhe zoti Haliti, si deputet, mund ta zëvendësojë përfaqësimin tim të Partisë Demokratike të Kosovës, nuk është e thënë të jenë krejt prej Qeverisë së Kosovës.

Por, ne e kemi sot për debat projektligjin, a jemi të gatshëm ta sjellim kurdo që juve ua merr mendja edhe platformën. Po, jemi të gatshëm edhe platformën ta shkruajmë së bashku me ju, paragraf për paragraf. Arsyeja pse dola në foltore është më e thjeshtë, të mërkurën e ardhshme, sot është e shtunë, të mërkurën e ardhshme në Bruksel ambasadorët e NATO-s e nënshkruajnë protokollin e fillimit të anëtarësimit të Maqedonisë në NATO. Mandej, parlamentet nacionale të

shteteve anëtare të NATO-së brenda 12 muajsh deri në 18 muaj mund ta ratifikojnë këtë anëtarësim. Po e them për një arsye, se Shkupi nuk është larg, edhe në vendin tonë fqinj ka pasur disa legjislatura, disa qeveri, disa parti politike, të cilat këtë të mërkurë të javë së ardhshme kanë mundur ta kenë para 27 vjetësh, para 20 a para 10 vjetësh, por kanë vendosur ta lënë për javën e ardhshme. Ne që 10 vjet jemi shtet sovran dhe i pavarur, arritjet tona janë këto që janë, unë s'e kam ndërmend të flas para jush si para ndërkombëtarëve dhe jam për t'i ruajtur këto arritje, por nëse na vyejnë neve edhe 10 vjet të tjera që të anëtarësohemi në OKB, ta ndjekim këtë rrugë që e kemi ndjekur deri më tash, unë ju pyes juve, e pyes edhe veten, cila është shpejtësia me të cilën ne po lëvizim? Prandaj, nëse qëllimi i dialogut është njohja e ndërsjellë, është anëtarësimi i Kosovës në OKB dhe 2019-tën e shoh si mundësi për marrëveshje, nuk po dua të them që do të ketë marrëveshje, vetëm e shoh si mundësi për të pasur një marrëveshje, unë mendoj që 2019-tën duhet ta përdorim për një gjë të tillë. Natyrisht që jemi kundër çdo skenari të një marrëveshje të keqe, të një marrëveshjeje, e cila është e pazbatueshme dhe disa prej kolegëve që janë këtu e dinë që edhe Pakoja e Ahtisarit ka dështuar në dy dimensione: ka dështuar të na anëtarësojë në OKB dhe ka dështuar në shtrirjen e sovranitetit në veri të Kosovës.

Prandaj, e kam një ftesë, apel, ejani të bëhemi së bashku në dialog. Harrojeni projektligjin, mund ta harrojmë dhe platformën, por ma merr mendja që duhet pasur vullnet politik që këtë temë në 2019-tën ta mbyllim.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Limaj e ka fjalën.

**FATMIR LIMAJ:** Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Sot para jush është miratimi i Projektligjit për dialog, pasi që është projektligj për dialog, unë e kuptoj që nganjëherë kur flasim për projektligjin, është e pamundur pa u lëshuar gjatë diskutimit e të dalim jashtë asaj temës dhe të kthehemi në platformë të flasim. Ne sot nuk jemi duke trajtuar platformën e dialogut, platforma e dialogut do të vijë, siç e tha edhe zëvendëskryeministri Hoxhaj, ajo pothuajse është gati, do t'i silltet këtij Parlamenti dhe aty do të kemi mundësi për të biseduar gjerë e gjatë rreth platformës, rreth dialogut, rreth gjithë asaj që duhet të dialogohet me Serbinë.

Parlamentit të Kosovës për herë të parë po i afrohet një mundësi që përmes ligjit të fusë fuqishëm në këtë proces të rëndësishëm që do të shënonte përmbylljen e etapës së etapës së dialogut Kosovë-Serbi. Përmes këtij projektligji ose kompetencave të delegacionit për bisedime, praktikisht po ma merr mendja që është një hap serioz i futjes në binar të kësaj teme, në binarët normalë, ku të gjitha institucionet e vendit janë të inkorporuara dhe marrin pjesë aktive në këtë temë të madhe nacionale. Natyrisht, nëse kthehemi tërësisht në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ne kemi biseduar edhe përpara këtu, dihen qartë cilat janë kompetencat e institucioneve.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka mundur të udhëheqë, s'ka pasur nevojë të vijë me një projektligj këtu, s'ka pasur nevojë të kërkojë një delegacion të miratohet nga Parlamenti për faktin që ka kompetencat, por ne jemi duke folur për një situatë krejt specifike. Ajo që është, e që mbi të gjitha neve na intereson dhe na duhet konsensusi, sa më shumë të bëjmë përpjekje të ndërtojmë një konsensus. E dyta, na duhet një proces transparent, një proces i përgjegjshëm, e që është shumë i ndjeshëm, nuk është njëra nga temat e trajtuara dialogu, nuk është njëra nga temat që kanë ardhur dhe i vijnë Parlamentit përditë siç ka qenë në të kaluarën. Ne duam t'ia japim krejt peshën, përgjegjësinë dhe rëndësinë kësaj teme të quajtur "dialog me Serbinë", duke inkorporuar të gjitha institucionet e vendit. Prandaj, ftesa ime është që sot, duke marrë parasysh që keni pasur një ditë të lodhshme dhe pret edhe një Ligj për buxhetin që po aq është i rëndësishëm, temën rreth dialogut, si do të dialogohet, çka do të dialogohet, të gjitha këto t'i lëmë e të flasim kur të vijë platforma. Të koncentrohemi në projektligjin, i cili parasheh qartësisht rolet e tyre dhe kompetencat e delegacionit që do të dialogojë.

Dhe, unë kam besim fort që kur të vijë tema e platformës, aty secili nga deputetët e Parlamentit të Kosovës do të ndihmojë shumë, qoftë me kritikën, qoftë me sugjerimet e tyre, qoftë me propozimet e reja do ta ndihmojnë shumë për të ndërtuar përfundimisht një pozicion zyrtar të Republikës së Kosovës për dialogun. Dhe, kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme, edhe rezoluta që është miratuar kohë më parë, edhe kompetencat e Delegacionit bazohen ose kufizimet e angazhimeve dhe kompetencave të tyre duhet të jenë në përputhshmëri dhe janë në përputhshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Platforma do të jetë në tërësi, zemra dhe fryma e saj do të jetë Kushtetuta e Republikës së Kosovës, besoj kur të vijë do të flasim më gjerësisht për këtë temë dhe me kohë deputetët do ta kenë draft platformën para jush për të pasur mundësi, siç thashë, për të debatuar, për ta përmirësuar dhe për të nxjerrë një dokument përfundimtar që do të jetë dokumenti zyrtar dhe pozicioni zyrtar i Republikës së Kosovës. Apeli im është, të nderuar kolegë deputetë, që të jepni mundësinë dhe të votohet Projektligji i propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për dialogun. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Lumir Abdixhiku e ka fjalën.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,  
Kabinet qeveritar,  
Qytetarë të Republikës,  
Kolegë deputetë,

Unë para se të flas për ligjin, në fakt dua të flas për dialogun në përgjithësi, sepse besoj që substanca e diskutimit të sotëm ndërlihet më tepër me procesin e dialogut dhe rrugën që Kosova ka vendosur ta ndjekë në këtë drejtim dhe për kohën që flasim ne sot këtu në Parlament, politika kosovare e dialogut është e fragmentuar dhe pak a shumë kaotike, e ky fragmentim është i theksuar brenda vetë institucioneve të Republikës së Kosovës. Janë tri qëndrime kundërtëse

njëra me tjetrën: qëndrimi i parë, më i shprehuri, është ai i Presidentit dhe ky qëndrim konvergjon me idenë e korigjimit territorial të Kosovës. Marrëveshjet territoriale sot po diskutojmë, e hartat janë vënë në tavolinë.

Qëndrimi i dytë është ai i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i shprehur ndërmjet draft marrëveshjes gjithëpërfshirëse midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, një lloj i marrëveshjes 'merre ose leje'.

Dhe, qëndrimi i tretë është në hartim e sipër nga Delegacioni shtetëror për dialog me Serbinë, për çfarë ne po diskutojmë sot këtu. Pra, në rrethana të tanishme Kosova ka tri qëndrime politike nga tri institucione shtetërore. Përderisa Presidenti flet për territor, kryeministri prezanton një marrëveshje finale, e Kuvendi, në anën tjetër, harton parimet e negociatave eventuale. Asnjëherë më parë Kosova nuk ka pasur kaq shumë fragmentim politik e përmbajtjesor siç ka sot në politikën e jashtme. Të tri qëndrimet, përveç se janë përjashtuese në substancë njëra me tjetrën, janë edhe në diskrepancë kronologjike kohore. S'mund të kesh edhe negociata për territor, edhe marrëveshje që ruan territorin. S'mund të kesh marrëveshje përfundimtare të Qeverisë, në njërën anë, e hartim të parimeve e platformës dialoguese nga Parlamenti, në anën tjetër. Dialogu s'është një poligon ku institucionet shtinë me propozime sipas qejfit, ato normalisht do të duhej të kishin vetëm një zë. Do të duhej të kishin një palë parime, e do të duhej të kishin një qëllim përfundimtar. Natyrisht për t'i pasur këto do të duhej të silleshim fillimisht si shtet.

Dhe, kaosi dialogues i tashëm buron prej faktit që partitë në pushtet në masë të madhe nuk dinë të sillen si shtet. Pra, ne sot kemi tri qëndrime, tri institucione dialoguese, e tri kundërthënie propozuese, sepse në thelb, në rend të parë Qeveria e Kosovës ka vendosur të abstenojë nga mandati i vet Kushtetues që e ka. Ditën që Qeveria e Kosovës, Kryeministri i Kosovës ka refuzuar të merret me dialog, po atë ditë është larguar edhe Qeveria e Kosovës nga procesi në fjalë. Me largimin e Qeverisë, është larguar edhe shteti i Kosovës, rrjedhimisht. Ky abstenim i kryeministrit dhe i Qeverisë është i paprecedent për Kosovën, as në Qeverinë Thaçi, as në Qeverinë Mustafa, as në Presidencën Jahjaga nuk ka ndodhur që Kosova të mos përfaqësohet në dialog nga kryeministri i vendit. Jo, sepse është zgjedhje kjo, por sepse është obligim kushtetues. S'mund të zgjedhësh funksione që ushtron si kryeministër: ose ushtron funksionin në tërësi, ose dorëhiqesh nga pozita ushtruese që mban dhe mes këtu nuk ka. Obligimet kushtetuese as nuk kontraktohen te ekipet e tjera dhe as nuk delegohen te figurat e tjera, kryeministri s'mund të delegojë një kryetar komune të përfaqësojë Kosovën në dialog.

Abstenimi i kryeministrit është përcjellë natyrisht me imponim të Presidentit dhe këtu fillon kaosi institucional në vend. Këtu fillojnë më pas edhe derivimet e alternativave kontroverse nga Kosova që i paraqesim jashtë. Presidenti për arsye e motive krejtësisht personale ka vendosur që të kapërcejë nga pozicioni përfaqësues i politikës së jashtme, në pozicionin e krijuesit të saj dhe sërish si asnjëherë më parë, si në asnjë qeveri më parë, rolet kushtetuese janë ndryshuar mes

kryeministrit dhe presidentit. Unë besoj se, në thelb të një ndryshimi të tillë është kërcënimi që presidenti i ka bërë Qeverisë. Pra, arsyeja pse ne e kemi një temë territoriale në tavolinë, është sepse kemi një president mbi Kushtetuese në përfaqësim, e arsyeja pse kemi një president mbi Kushtetuese në përfaqësim, është sepse Qeveria është e dobët në numra. Pra, në legjitimet.

Po të kishim një qeveri të fortë në numra, me përfaqësim të pavarur politik dhe të pandikuar nga presidenti, ky fragmentim do të ishte inekzistent. Pra, është prezent, sepse Qeveria e tanishme nuk ka shumicë dhe për ta bërë gjithë skenën edhe më kaotike, Qeveria e Kosovës, pasi ka abstenuar nga dialogu dhe roli udhëheqës që ka, ka vendosur të krijojë një institucion paralel shtetëror në Kuvend, ka vendosur ta kontraktojë funksionin e vet kushtetues te një ekip tjetër dialogues, këtij ekipi i ka dhënë emrin “ekip shtetëror” dhe i thotë se ka legjitimitet e konsensus. Tash, ekipi s’është as shtetëror, s’ka as legjitimitet, edhe për më pak është konsensual. S’është shtetëror, sepse sipas definimit kushtetues dhe këtë s’e definon asnjë ligj tjetër, përfaqësues kushtetues i Kosovës është veç kryeministri dhe Qeveria. Në tavolinë kur flitet për shtet, për këtë Kosovë, duhet të ulet vetë kryeministri, jo si figurë e si emër i përveçëm, por si institucion i Kryeministrit. Këtë institucion s’e zëvendëson as një, as dy bashkëdialogues, as kryetarë komunash, e as ministra e zëvendëskryeministra, s’e zëvendësojnë edhe tetë burra të tjerë që në përgjithësi s’i kanë më tepër se 5-6% vota, dorën në zemër.

Institucioni qeverisës është i pazëvendësueshëm dhe ai zgjidhet me shumicë dhe duhet të ketë shumicën gjatë gjithë kohës. Mbi të gjitha, ekipi negociator nuk i plotëson kriteret minimale të legjitimitetit partiak a përfaqësimit konsensual politik, nuk e plotëson kriterin e legjitimitetit partiak, meqë është i ndërtuar me votat e deputetëve që s’përfaqësojnë shumicë dhe nuk përfaqëson kriterin e konsensusit politik meqenëse i njëjti nuk e ka mbështetjen e opozitës, e që në këtë rast është shumica qytetare në vend. Pra, në rrethana të tanishme, zëri i Kosovës në dialog jo vetëm që është i fragmentuar, por se i njëjti nuk arrin të artikulohet nga institucione kushtetuese të Kosovës, pra nga Qeveria dhe, mbi të gjitha, ky zë s’është as legjitim, as konsensual. Dalja nga situata e tanishme nuk kërkon shumë mund, dorën në zemër, në fakt kërkon të sillemi minimalisht si shtet dhe janë tre hapa që duhet, unë argumentoj, t’i ndjekim: e para, dialogu duhet të udhëhiqet nga kryeministri, nga Qeveria. Për ne, udhëheqja e dialogut nga Qeveria është pa alternativë, sepse Kosova është shtet dhe si shtet, ka institucionet kushtetuese të thirrura për përfaqësim vendor dhe ndërkombëtarë, përfshirë edhe dialogun me një shtet tjetër, siç është Serbia.

Dhe e dyta, sepse nëpërmjet Qeverisë sigurohet raportimi në këtë Kuvend dhe në këtë Parlament. Nuk ka nevojë për trupa të tjera raportuese, për komisione e grupe tjera punuese, kur Kosova ka institucione e veta në Parlament, e kur ka ministri brenda Qeverisë. Çdo paralelizëm i tillë është i panevojshëm në këtë fazë.

E dyta, Qeveria duhet të ketë legjitimitet, ky është kusht minimal, rrethanat e tanishme politike e bëjnë këtë kërkesë edhe më të domosdoshme, për arsye që shihen tashmë, kjo qeveri nuk e ka shumicën e numrave.

Dhe, kushti i tretë, meqenëse ballafaqohemi me një rast, po them, historik, për mendimin tim faza e ardhshme duhet të ketë gjithëpërfshirje dhe jo vetëm konsensusi parcial, por se pjesëmarrje nëpërmjet institucioneve të Kosovës të të gjitha partive politike në vend. Në momentin e tanishëm dialogu as nuk udhëhiqet nga Qeveria, Qeveria as që ka legjitimitet, e në këtë përfaqësim as nuk kemi gjithëpërfshirje. Prandaj, është e kotë të flasim për ligj, dorën në zemër, dhe është esenciale që ky ligj të kthehet në pikën zero. Me kthimin e ligjit në pikën zero, t'i hapet rrugë një dialogu të ri brendapartiak në Kosovë, në mënyrë që të dalim me një alternativë më të shëndoshë dhe më të qëndrueshme përballë negociatave me Serbinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Qytetarë të Republikës,  
Deputetë të Kuvendit,  
Kabinet i Qeverisë,

Ky projektligj përgënjeshtrohet tri pozicione paraprake që i kishin iniciuesit e tij. E para, dialogun e udhëheq delegacioni, na thuhej. Kjo nuk qëndron, meqenëse në çdo rast, kur flet për delegacionin shtetëror, ky projektligj flet për delegacionin në bashkërendim me institucionet e tjera kushtetuese, si Presidenti, dhe aq më shumë, i jep të drejtë një trupi jashtë Kosovës të përcaktojë se kush përfaqëson Kosovën në dialogun me Serbinë, e kjo thuhet në nenin 11.2, po e lexoj: “Në rastet kur ndonjërit nga institucionet Kushtetuese të Republikës së Kosovës (Presidenti, Kryeministri, Kryeparlamentari etj.) i dërgohet ftesë formale nga ana e ndërmjetësuesit në procesin e dialogut, vendimi për të do të merret gjithnjë në bashkërendim dhe dakordim ndërmjet Delegacionit Shtetëror dhe institucionit kushtetues të ftuar”. Pra, një instancë jashtë shtetit që përcakton përfaqësimin tonë dhe, më tutje, vazhdohet me fjalinë se në çdo takim të tillë, përveç institucionit të ftuar të pranishëm do të jenë edhe bashkëdrejtuesit e Delegacionit Shtetëror. Ky është neni kryesor. Kërkohej të jenë të pranishëm. Pra, duan që të jenë dëshmitarë. Kaq. Është kërkesë për të qenë dëshmitarë.

Më tutje, pozicioni tjetër paraprak publik që përgënjeshtrohet me këtë projektligj është ai se vendimmarrja do të jetë unanime. Nuk është e vërtetë, sepse kuorumi duhet të jetë 50% + 1. Shiheni nenin 13, nga 12 anëtarë që ka ekipi, në raundin e tretë të vendimmarrjes i jepet mundësia që me dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm të marrin vendim, që i bie me pesë anëtarë. Pra, nuk mund të ketë unanimitet kur me pesë anëtarë prej 12 gjithsej merren vendimet.

Neni 13, pika 2, thotë që: vendimet në Delegacionin Shtetëror merren me unanimitet, pajtueshmëri të të gjithë anëtarëve të tij. Pra, 100%. E, më pastaj, një pikë më vonë, kjo degradon në 42%, sepse thuhet: Nëse pas dy tentimeve për vendimmarrje dëshkohet se unanimiteti është i pamundshëm, një vendim konsiderohet i miratuar kur i fiton votat e dy të tretave e të gjithë anëtarëve të pranishëm. Dy të tretat e shumicës së thjeshtë, e shumica e thjeshtë prej 12 anëtarëve është 7. Dy të tretat e shtatë anëtarëve janë pesë veta, dhe pesë veta pra të delegacionit që përbëjnë dyzet e dy për qind të delegacionit, marrin vendim në emër të shtetit të Kosovës si pjesëtarë të një delegacioni, i cili nuk i ka 50% të këtij Kuvendi. Delegacioni Shtetëror, në natën e 15 dhjetorit 2018, i ka marrë 59 vota, jo 61. Pra, nuk e kanë as shumicën e thjeshtë. Me 42% të delegacionit, i cili nuk i ka as 50% të Kuvendit. Ja çfarë konsensusi do të kemi ne, nacional e shtetëror, për të cilin është trumbetuar kaq shumë!

Dhe, pozicioni i tretë që përgënjeshtrohet është që opozita është përcaktuese në vendimmarrje. E pavërtetë sërish, sepse opozita i ka 4 anëtarë, dhe, siç e shpjeguam, këta kanë lënë mundësinë që vendimmarrja të mundësohet me 5 anëtarë prej 12 sosh sa janë total, dhe, në këtë rast, 4 votat e opozitës s'kanë asnjë mundësi të bllokimit të procesit. Kjo është pra 5 anëtarë, që është më shumë se 4 anëtarë të opozitës. Prandaj, nuk mund të quhet delegacion shtetëror. Realisht, është delegacion qeveritar. Le t'ia themi emrin siç e ka përmbajtjen.

Më tutje, është e rëndësishme të theksohet që çdo herë në Kuvendin e Republikës kur u delegohet një mision a një funksion i rëndësishëm emrave të përveçëm, atëherë duhet të vendoset me dy të tretat. Dy të tretat janë të domosdoshme pra, kur votohet për emra të përveçëm, sepse shteti ngelet në mëshirë të karaktereve njerëzore të individëve të veçantë. Pra, dy të tretat prej fillimit, jo dy të tretat në fund. Nëse duam konsensus nacional, shtetëror, për këtë çështje kaq të rëndësishme, të cilën e pohojmë të gjithë, me dy të tretat prej fillimit: dy të tretat platforma, dy të tretat ekipi negociator. Jo dy të tretat vetëm në fund. Konsensusi progresiv e do shumicën prej dy të tretave prej fillimit, jo vetëm në fund.

Dhe, vëreni me kujdes, këtu përmenden dy të tretat, por a e dini për çfarë? Për koordinatoren administrativ, neni 12, pika 1, thuhet që ai vendoset me dy të tretat. Koordinatori administrativ i delegacionit, po, dy të tretat! Dhe, kur nuk merren vesh bashkëdrejtuesit për përfaqësuesin e shoqërisë civile, Neni 6, pika 2, thuhet që sërish ai përfaqësues i shoqërisë civile përcaktohet me dy të tretat. Pra, administratori kryesor i delegacionit dhe përfaqësuesi i shoqërisë civile me dy të tretat e delegacionit, por jo delegacioni me dy të tretat e Kuvendit. Kjo tregon që janë të interesuar për konsensusin e delegacionit përbrenda e jo për konsensusin e Kuvendit mbi delegacionin. Dy të tretat përmenden vetëm për çështjet e brendshme të delegacionit, jo për delegacionin në Kuvend.

Më tej, neni 11, thuhet që “Të gjitha Institucionet Kushtetuese të Republikës së Kosovës obligohen që t'i vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin e prodhuar gjatë procesit të

deritashëm të Dialogut Teknik, si dhe t'i mundësojnë të gjitha resurset e nevojshme sipas kërkesave së Delegacionit Shtetëror.” Po pra, Neni 11, pika 4 e dëshmon që nevojitet kthim te dialogu gjashtëvjeçar. Kjo thuhet si nevojë, por paraprakisht është obligim. Është raporti qeveritar 41 faqesh mbi arritjet dhe sfidat e dialogut në Bruksel, 41 faqe për 33 marrëveshje. Unë nuk e kuptoj pse kryeministri me 9 korrik të vitit kaluar na e sjellë atë raport dhe nuk insiston që ai të vijë për shqyrtim në seancë plenare këtu. Edhe Kryetari i Kuvendit njësoj. Sot një javë, bëhen shtatë muaj, që ka ardhur raporti qeveritar, por nuk trajtohet në Kuvendin e Kosovës.

Më tej, te Përkufizimet, neni 3, thuhet: faza përmbyllëse e dialogut me Serbinë. Po pra, pranohet dialogu paraprak, se quhet fazë përmbyllëse. Kjo është edhe një thirrje që duhet t'i kthehemi fazave paraprake. Nuk po thuhet që është dialog i ri, është faza përmbyllëse e të njëjtit dialog. Prandaj duhet të kthehemi te raporti qeveritar, 41 faqësh, i 9 korrikut 2018, për 33 marrëveshjet e deritanishme të Brukselit.

Në nenin e parë, thuhet “Kjo marrëveshje gjithëpërfshirëse do të nënkuptojë njohje formale dhe reciproke mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.” Nuk përmendet fjala pavarësi. Vëreni me kujdes se ka shtete të pavarura që nuk janë republika, si puna e monarkive, por ka edhe republika që nuk janë shtete të pavarura, qysh kanë qenë ato në Federatën jugosllave. I lihet hapësira modelit të dy Gjermanive nga viti 1972. Nuk thuhet njohja reciproke ose njohja e pavarësisë së Republikës së Kosovës, por njohja reciproke e dy republikave! Po, dy republika kanë qenë edhe në Federatën Jugosllave. Është gabim të mos theksohet fjala pavarësi. Dhe, e vërejtja, as serbisht as anglisht nuk thuhet fjala pavarësi, pra nuk është gabim. Dikush është kujdesur që ajo fjalë të mos jetë aty.

Më tej, në Nenin 5, thuhet që “Përfaqësuesi i shoqërisë civile do të emërohet nga Delegacioni Shtetëror.” Shumica e anëtarëve të delegacionit shtetëror, siç po quhet, kanë qenë pjesëtarë të shoqërisë civile dikur. E kanë lënë shoqërinë civile, dhe, tash këta duan ta përcaktojnë se kush do të jetë përfaqësues i shoqërisë civile. Kjo është konflikt interesi dhe diktat. Ata që e braktisën shoqërinë civile duan ta përcaktojnë tash se kush do të jetë ai i shoqërisë civile i cili vjen.

Neni 5, Përbërja e Delegacionit Shtetëror, thuhet që delegacioni përbëhet nga përfaqësues të koalicionit qeverisës dhe të Opozitës. Unë besoj që duhet të definohet çka quajmë opozitë. Nuk mundemi kështu. Qysh është definuar çka quajmë dialog, duhet të definohet edhe çka quajmë opozitë. Aktualisht, 3 anëtarë të delegacionit shtetëror janë në një parti e cila si pjesë e koalicionit PAN ka garuar në fushatën zgjedhore të qershorit 2017. Ne duhet ta definojmë çka quajmë opozitë. Nuk mundemi kështu.

Dhe, më tej, në Nenin 5, pika 6, thuhet që delegacioni shtetëror është ai i cili mund të shkarkohet nga 50% +1, të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Po, këta nuk i kanë pasur 61 deputetë kur janë ngarkuar, pse do të duhej t'i kenë 61 kur shkarkohen? Nga 22 deputetë të Partisë Demokratike të



Kosovës, në mbrëmjen e 15 dhjetori 2018, 21 kanë votuar për delegacionin shtetëror. Vetëm zonja Flora Brovina ka abstenuar. Dhe, na thoshin që kjo është për ta kufizuar Presidentin. Edhe mbesa e tij, zonja Thaçi, që është deputete, po ashtu e votoi delegacionin shtetëror. Edhe një dëshmi më shumë, pra, se nuk është për ta kufizuar Presidentin, por për t'ia thyer embargon atij në cilën ndodhej paraprakisht.

Dhe, në fund, thuhet që, pika 7.5 e nenit 5, “Kërkesën për shkarkim të Delegacionit shtetëror, ose të anëtarëve të veçantë të tij, mund ta paraqesin Bashkëdrejtuesit e Delegacionit, si dhe 1/3 e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.” Pse duhen dyzet deputetë, 40 deputetë, si për seancë të jashtëzakonshme?! Mezi i bënë 59, nuk ka nevojë për një numër kaq të madh. Këta janë më shumë të brengosur për unitetin e brendshëm dhe për vetveten sesa për Kosovën.

Përfundimisht, qysh është i papranueshëm ky delegacion, dhe i pavlefshëm, unë besoj që edhe ky projektligj do të duhej të konsiderohej i tillë dhe të kundërshtohet. Me këtë rast, unë besoj që pati të drejtë në ofertën e tij Zëvendëskryeministri, i cili tha që duhet të përfundojë në shportë ky dhe t'ia fillojmë nga fillimi. E, fillimi është 33 marrëveshjet e deritanishme t'i shqyrtojmë, kërkesat tona ndaj Serbisë për të cilën mund të krijojmë konsensus, zgjedhjet e lira demokratike, platforma me parime, dhe ekipi negociator me udhëheqje kredibile. Ky është rendi i duhur i gjërave. Përndryshe, qasja antishtetërore po pasohet me procedura antidemokratike që ne, jo vetëm sot, por gjithmonë duhet t'u themi jo.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka Faton Topalli. A është Faton Topalli këtu? Zoti Visar Ymeri.

**VISAR YMERI:** Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Nënkryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar, ju ministra që jeni këtu e që po merrni pjesë në këtë diskutim,

Mendoj që siç e thanë me gjasë edhe disa prej parafolësve këtu, kemi megjithatë një përmbysje të temave të diskutimit. Pra, po diskutojmë ndonjëherë për çështje të cilat nuk janë temë e diskutimit në pikën e sotme të rendit të ditës dhe disa prej deputetëve dua të them që dolën nga kjo dhe diskutuan për dialogun në përgjithësi, e cila natyrisht që është pra një temë jashtëzakonisht e rëndësishme e që duhet të diskutohet shpeshherë e shumë herë në Kuvend, gjë që edhe parashihet me këtë mënyrë të qasjes karshi dialogut me Serbinë që është ravijëzuar në rezolutën që kaloi me 15 dhjetor e që tash po përcillet me Ligjin për delegacionin shtetëror. Këtu mendoj që duhet t'i ndajmë këto çështje.

Pra, diskutimi, ose pyetja e parë e përgjigjja e parë që duhet të jepet nga Kuvendi është ajo nëse duhet të vazhdojmë me dialogun me Serbinë tash. Pra, nëse duhet të vazhdojmë me dialogun me Serbinë, ose nëse duhet të ndërmarrim diçka për ta ndryshuar rrënjësisht atë, në mënyrë që të mund ta quajmë një dialog të ri, dhe në këtë natyrisht që ka qëndrime të ndryshme. P.sh.

qëndrimi i Lëvizjes Vetëvendosje është që ta bëjmë ndryshe, pra të merremi njëherë me të kaluarën e deritashme të dialogut e pastaj të shohim se çfarë dialogu duam. Ky është qëndrim politik. Mundësia e realizimit të tij megjithatë mund të vihet në pikëpyetje, por kjo s'ka rëndësi. Është qëndrim politik i njërit prej grupeve parlamentare. Pas kësaj përgjigje, për ata që thonë po duhet të vazhdojmë me procesin e dialogut, atëherë duhet të flasim sesi duhet ta trajtojmë këtë proces të dialogut. Pra, institucionalisht në raport me vendimmarrjen karshi procesit të dialogut. Dhe ne kemi qenë në një situatë të tillë që procesi i dialogut vazhdonte dhe ky proces drejtohej kryekëput, ekskluzivisht nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Tash, Partia Socialdemokrate që tash e mora vesh që paska qenë në koalicion me PAN-in, e ka pasur një propozim prej muajit korrik, në mos gabofsha, mesit të korrikut, kur është diskutuar këtu në Kuvend dhe ku pikërisht propozimi ynë ka qenë që platforma duhet votuar me dy të tretat, pastaj delegacioni shtetëror duhet votuar me dy të tretat. Ky ka qenë propozimi i Partisë Socialdemokrate që ka pritur në Kuvend gati se gjashtë muaj. Pra prej korrikut, ta abstraktojmë muajin gusht që ka qenë muaj pushimi, pastaj shtator, tetor, nëntor edhe dhjetor. Edhe natyrisht që një rezolutë e tillë nuk do të mund të miratohej me votat e koalicionit qeverisës, sepse koalicioni qeverisës e shihte veten absolutisht të dobësuar në kuadër të kësaj. Kjo rezolutë ka qenë dashur të votohet nga grupet parlamentare të opozitës, të cilët atëherë thoshin që kjo rezolutë i ndihmon Hashim Thaçit dhe tash të njëjtit po na thonë kështu do të mund ta ndalnim Hashim Thaçin. Ku ishit në korrik, kolegë deputetë të opozitës?

Pra, atëherë nuk donit ta votoni, sepse nuk donit ta votoni një dokument që e propozonte Partia Socialdemokrate, pra për një farë inati kryekëput fëmijëror dhe personal që e keni, dhe tash po thonë që ashtu ka qenë më së miri që t'ia bëjmë dialogut. Pra, tash po duket se është pak vonë për t'ia bërë ashtu, po sidoqoftë nëse keni ndërruar mendje, edhe mund të bëhet ashtu. Po duhet të tregoni që keni ndërruar mendje dhe që jeni të gatshëm ta bëni një gjë të tillë. Dhe, kur dakordohemi edhe për këto të dyja, pra së pari kohën, a duhen negociatat tash apo mund të shtyhen pafundësisht. Apo në anën tjerët, dhe pastaj nëse po, atëherë si t'i bëjmë negociatat, këtu duhet të flasim për Ligjin për dialogun, pra për Ligjin për delegacionin shtetëror. Sepse Ligji për delegacionin shtetëror është njëri prej dokumenteve që buron nga rezoluta e miratuar me 15 dhjetor të vitit 2018 dhe i cili e paraqet dhe e sanksionon me ligj për herë të parë në Republikën e Kosovës procedurën vendimmarrëse, përbrenda së pari organit të delegacionit shtetëror dhe pastaj raportin që ky delegacion shtetëror e ka me institucionet e tjera kushtetuese.

Tash nëse këtu mendon që institucionet kushtetuese do t'i shuajmë me një ligj ose me një rezolutë, unë mendoj se kjo është dëshirë, por që nuk kurrfarë efekti juridik e as mundësi praktike që të zbatohet. Pra ligji e thotë shumë qartë për sa i përket vendimmarrjes për dialogun dhe këtu disa nene u lexuan dhe mendoj që qëllimisht askush nuk e preku njërin prej neneve që është më i rëndësishmi e që është në fillim të Ligjit për delegacionin shtetëror, dhe i cili thotë kështu, të nderuar deputetë të Kuvendit: Delegacioni shtetëror do të jetë organi i vetëm i

autorizuar për ta drejtuar dialogun. Në këtë drejtim delegacioni shtetëror konsultohet me institucionet kushtetuese të Republikës së Kosovës. Pra edhe një herë, organi i vetëm i autorizuar për ta drejtuar procesin e dialogut me Serbinë. Të tjerat që i lexoni ju, ose që i interpretoni pa i lexuar, e që ndërtoni kësi të vërteta hyjnore prej tyre, pra që i shpërfillin absolutisht faktet, po mund t'i thoni si qëndrime politike, po nuk qëndrojnë fare në raport me ligjin. Pra në ligj është ravijëzuar qartë, ka tri nivele të vendimmarrjes ose raportit që delegacioni shtetëror i ndërton me institucionet e tjera kushtetuese. Për sa i përket vendimmarrjes për dialogun, pra për cilësinë e marrëveshjes, për çfarë marrëveshje, për çka diskutohet, për çka nuk diskutohet e kështu me radhë, kjo vendimmarrje, këtë vendimmarrje në fakt e ka ose e gëzon me këtë ligj ekskluzivisht delegacioni shtetëror. Për sa u përket takimeve pastaj, kjo bëhet në koordinim me institucionet kushtetuese të cilat shihen si të domosdoshme, nëse shihen si të domosdoshme që të përfshihen në procesin e dialogut. Prandaj, aty figuron fjala bashkërendim, për çfarëdo ftese e për çfarëdo takimi në procesin e dialogut.

Së treti, vendimmarrja për çështje të caktuara të dialogut bëhet në konsultim siç e lexova edhe më herët me institucionet shtetërore. Natyrisht, bashkërendimi as konsultimi nuk e kanë nivelin e njëjtë të fuqisë dhe peshës, siç e ka fakti se delegacioni shtetëror me ligj përcaktohet si organi i vetëm kryesor dhe ekskluziv për ta drejtuar procesin e dialogut me Serbinë.

Një vërejtje që e dëgjova këtu e që është vërejtje që qëndron dhe kjo ka ndodhur për shkak, është më shumë përvjedhje kështu teknike, është ky dallimi te numri i anëtarëve të delegacionit në mes të 11 anëtarëve që është me fjalë dhe numri 12 që figuron si numër. Po, delegacioni shtetëror është i përbërë nga 12 anëtarë, pra 11-shi është gabim në fjalë, duhet të shndërrohet në 12, sepse delegacioni shtetëror siç është miratuar këtu në ditën kur është votuar rezoluta, i ka 12 anëtarë, prej të cilëve pra 7 janë nga koalicioni qeverisës, 4 nga partitë politike të opozitës dhe një përfaqësues i shoqërisë civile. Prej këtyre dyve, pra prej 7 më falni të anëtarëve të delegacionit shtetëror që vijnë nga koalicioni qeverisës, siç është miratuar edhe me rezolutë, dy prje tyre janë përfaqësues të komuniteteve joshumicë, njëri i komunitetit boshnjak që është në Republikën e Kosovës dhe tjetri i komunitetit turk po ashtu nga Republika e Kosovës.

U dëgjua këtu më herët, e dëgjova njërin prej parafolësve deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës duke thënë që kjo nuk është mënyrë si të them kështu ose standard institucional për ta drejtuar dialogun, ose për t'iu qasur dialogut me Serbinë, gjë që është e vërtetë, nuk është standard. Pra, natyrisht që një delegacion shtetëror në kohën kur i kemi institucionet do të kishte me qenë mbase mund të thuhet i panevojshëm. Mirëpo ne e kemi pasur një situatë konkrete në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe kjo situatë konkrete ka mundur të shfrytëzohet dhe është shfrytëzuar nga opozita për t'ia rritur peshën vendimmarrjes në një proces i cili megjithatë pajtohemi të gjithë pra nuk është njëri prej proceseve të zakonshme me të cilat merren institucionet e Republikës së Kosovës.

Meqenëse nuk është një proces i zakonshëm, atëherë natyrisht që nuk kemi saktësime të qarta as në Kushtetutën e Republikës së Kosovës e as në dokumentet e tjera se kush do të duhej të ishte ai që e drejton dialogun me Serbinë. Po ka mund të jetë kryeministri, sepse është mandatar kryeministri me rezolutën nëse ju kujtohet edhe vitin 2011, edhe vitin 2012. Po ka mundur të jetë edhe Presidenti po ta merrte mandatin nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, po ja që mandati nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për ta drejtuar procesin e dialogut me Serbinë e ka marrë delegacioni shtetëror. Dhe kjo kolegë të nderuar nga LDK-ja dhe Vetëvendosja nuk është aspak e ndryshme me marrëveshjen e VLAN-it. Nëse ju kujtohet edhe aty u patëm dakorduar që Lëvizja Vetëvendosje e merr dhe e drejton procesin e dialogut, apo jo, edhe pse Lëvizja Vetëvendosje nuk e kishte Kryeministrin, edhe pse në atë marrëveshje të VLAN-it prapë kryeministër e kishin Ramush Haradinajn.

Mirëpo ne u morëm vesh dhe u dakorduam në një marrëveshje politike se këtë nuk do ta bëjmë përmes Kryeministrit, por do ta bëjmë ndryshe. Tash, ju mund të thoni ajo ka qenë vetëm marrëveshje politike. Dakord. Pra, çka nënkupton? Që po të bëhej qeveria e VLAN-it e paskeni pasur me qëllim për ta shkelur atë pikë të marrëveshjes, paska qenë e papranueshme edhe atëherë për ju? Dhe po, Qeveria nuk i ka numrat. Do të kishte qenë mirë ta kishim një qeveri siç e tha edhe z. Abdixhiku që e ka shumicën e numrave. E kemi pasur në mandatin e kaluar një qeveri me 87 deputetë, a e keni...

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)*

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e ka deputeti Milaim Zeka. Replikë, Evgjini? Milaim një minutë. Replikë dy minuta. Evgjeni Thaçi-Dragusha.

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit për mundësinë e replikë.

Me të vërtet ky Albin Kurti është shumë paranojak. Hyn këqyr listat e deputetëve kush çka ka votuar. Shyqyr që s'do t'i vijë radha kurrë për ta drejtuar këtë vend, përndryshe nuk do të bëjmë pjesë në paranojat e tij. Unë është e vërtetë jam mbesa krenare e Hashim Thaçit, jam deputetja krenare e Partisë Demokratike të Kosovës dhe këtu i përfaqësoj qëndrimet e Partisë Demokratike të Kosovës, parti shtetformuese, shtetndërtuese, parti e cila merr përgjegjësi për të udhëhequr proceset edhe pse ndoshta nuk janë populiste, mirëpo e ruajnë substancën e këtij vendi dhe i ruajnë raportet me aleatët tanë strategjikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Milaim, e ke fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Unë i kam përcjellë me vëmendje të gjitha fjalimet dhe shumica prej tyre më kanë shti të mendoj, imagjinojeni të vijë Behgjet Pacolli këtu, të dalë në foltore dhe të flasë për veprat e Ismail Kadaresë sa qesharak kishte dalë, ose të fliste gjyshja ime për atomet në fizikë. Ne jemi para dy

autostradave, a duam dialog a s' duam dialog? A duam të shkojmë në Bruksel, a s' duam të shkojmë në Bruksel? Në qoftë se duam dialog, kemi për ta dëgjuar Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës se çfarë na thonë. Disa pionierë të Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk e dinë fuqinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, po unë do t'ua përkujtoj këtyre një ngjarje të dt. 01.03.2006 dhe këta kurrë s'kanë guxuar të kundërshtojnë hiç asnjë ambasador të huaj, se lë më ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke e përfshirë z. Kujtim Shala, që ky nganjëherë di t'u thotë të huajve edhe jo.

Nexhat Daci në atë kohë pat ardhur Filip Goldberg edhe Frank Vizner, e kishte pas thënë Dacit kqyri këtu i ke diku pesë-gjashtë pika i kemi ne amerikanët që duhet t'i shqyrtoni ju. Daci, një njeri shumë i nderuar dhe i respektuar për mua, pak si nervoz, ka qenë vdekja e presidentit Rugova, i ka thënë Frank Viznerit ne nuk kemi kohë të merremi me këto sende. Në Brezovicë ka qenë kur i kanë thirrur telefon e jeni tubuar rrap e rrap, e ngadalë Eqrem Kryeziu e ka shkarkuar profesorin prej të gjitha posteve. Bile ai s'e ka ditur hiç në Brezovicë. I kanë thënë, o profesor të shkarkuan more, jo more hajgare po bëni ju. Kur e ka marrë vesh, u trishtua. Kështu, ju heronjtë që dini t'i thoni Amerikës jo, po Amerika juve ju fut në autostradë, e neve pa fut hiç ne po duam të hyjmë, kjo ishte e para.

E dyta, Alija Izetbegoviqi ka thënë në Dejton më 1995, i është drejtuar kombit boshnjak: E kam Zotin dëshmitar që nuk kam mundur të bëj më shumë!

Kur e kanë thirr Milosheviqin në Dejton edhe Tugjmanin, asnjëri nuk kanë qenë presidentë të Bosnjës dhe Hercegovinës. E kanë thirr krejt dikë tjetër edhe e kanë ulur në tavolinë që ta ndajnë tri-copësh Bosnjën dhe Hercegovinën, dhe nuk kanë mundur asnjëri që ta kundërshtojë.

Prandaj, dëshiroj t'ju them diçka; që këto fuqitë e mëdha sikur ai Boltoni që shkoi në Siri edhe ju tha kurdëve a po dëshironi kështu apo dëshironi ashtu. Fuqitë e mëdha Shtet e Bashkuara të Amerikës së bashku me Bashkimin Evropian janë sponsorizuesit më të mëdhenj të lirisë dhe të pavarësisë së vendit tonë, dhe ata do ta diktojnë edhe dialogun. Ata do ta diktojnë edhe formacionin e delegacionit.

Unë jam shumë i bindur që sot po binden Thaçi, presidenti më i dashur i Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, domethënë ju jeni dashuruar në të, se ju e keni zgjedh si hamburgerin. E Thaçi paska lobuar shumë kundër këtij ligji, se më ka thirr edhe mua dhe më ka thënë; e di si, hidheni, hiç mos e votoni atë farë ligji.

Tash, Partia Socialdemokrate atje na e sollën këtë ligj, Qeveria e aprovoi. Në vend që ne të ulemi të gjithë bashkërisht edhe të themi, ejani ta rregullojmë ligjin. Hajde e ndërtojmë platformën. Hajde e bëjmë delegacionin. Po çohemi dhe po themi këtu që s' duam ligj, s' duam bisedime, se duam këtë!

Ju e keni Thaçin, kur doni që ta vëni këtë vend në katër rrotë e ta lëshoni teposhtë në humnerë, atëherë ju del juve tabela me emrin e Hashim Thaçit.

Kur doni ju që t'i mbyllni sytë para një gjendjeje shumë të rënd brendapërbrenda vendit, atëherë çoheni dilni dhe ju e keni veç një tabelë, veç e shani Thaçin. Më shumë e shani Thaçin se Vuçiqin.

Qysh nuk është more më i zi, bile është shumë më i zi se edhe plotë të tjerë që kanë luftuar që ne të flasim shqip këtu në Parlament. Shumë s'ka ma i zi se ai. Bile-bile nuk ka nevojë Gjykata Speciale do duhet që ta arrestonte shumë më parë edhe Thaçin edhe Sylejman Selimin edhe plotë komandantë të luftës që kanë luftuar.

Ai njeri që e krahason Thaçin me Vuçiqin për mua është; pa koment. Nuk dua të flas fare për atë.

Sa i përket politikës së brendshme, mund të bëjmë seanca e seanca e seanca, dhe ju tregoj unë se kush janë shkaktarët kryesorë të gjendjes kaq kaotike brendapërbrenda Republikës së Kosovës. Por, vetëm dëshiroj t'ju them qytetarëve të Republikës së Kosovës që; populli kurd janë popull shumë i madh e nuk janë askund hiç, sepse fatin e tyre e përcaktojnë fuqitë e mëdha.

Dëshiroj t'ju them diçka që, ai Gadafi e Saddam Hyseini që kanë qenë 1 miliard herë më të fuqishëm sesa ne, sa herë e kanë ngritur kokën në raport me fuqitë e mëdha, fuqitë e mëdha ua kanë prerë kokën.

Dëshiroj t'ju them që, Milosheviqi i ka ikur dialogut dhe bisedimeve me bashkësinë ndërkombëtare, sepse sikur të bënte Zoti vaki, sikur t'i bënte Burdushi atij sehire që të mos i ikte dialogut në Rambuje, e sikur ta nënshkruante Milosheviqi ne sot akoma do të ishim në robëri.

Prandaj, mbi bazën e kësaj po e përfundoj fjalimin tim me një thirrje publike edhe për Lidhjen Demokratike të Kosovës edhe për Vetëvendosjen edhe për të gjithë neve; hajde të bëhemi bashkë në politikën tonë të jashtme të dialogut.

Por, ata që mendojnë që mund ta stopojnë presidentin Thaçi që të mos takohet me Vuçiqin. Ata që mendojnë që ne mund t'i themi Mogherinit mos e thirr Hashim Thaçin po thirr Milaim Zekën, ata për mua janë njerëz të cilët politikisht mendojnë sikur bebja ime që i ka tri vite.

**KRYESUESI:** Zoti Rugova e ka fjalën.

**NASER RUGOVA:** Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Personalisht mendoj që s'ka pasur nevojë fare për këtë projektligj dhe as që ka qenë e nevojshme një projektligj i tillë të vjen në Kuvend, sepse konsideroj që ne jemi shtet i pavarur dhe sovran. Kemi Kushtetutë dhe kemi institucione shtetërore si kategori e veçantë kushtetuese.

Kjo çështja e dialogut Kosovë - Serbi që po prolongohet, zvarritet dhe po e dëmton funksionalizimin dhe përmbylljen e etapës së fundit shtetndërtuese për Kosovën dhe është bërë fatkeqësisht edhe barriere për proceset integruese të Kosovës në Bashkimin Evropian, si për çudi është bërë një "Trekëndësh i Bermudeve" për politikëbërjen në Kosovë për institucionet e Kosovës dhe për spektrin politik në përgjithësi.

Si duket kjo temë për dialogun, rreth dialogut, për një platformë, për një konsensus nacional, për një unifikim të qëndrimeve po e ndërron gëzofin, varësisht se kush janë partnerët e koalicionit qeverisës.

Prandaj, në prag të përfundimit të dekadës së dytë të çlirimit të Kosovës dhe fillimit të dekadës së dytë, po i bëjmë 12 vjet pothuajse shtet i pavarur dhe sovran, klasa politike në Kosovë, qarku intelektual, akademik, e në veçanti institucionet shtetërore të Kosovës vërtetë duhet të merren me këtë çështje seriozisht dhe konform kompetencave dhe përgjegjësi kushtetuese që i kanë.

Zoti kryeministër, po ta merrnit rolin përgjegjës, kushtetues dhe institucional nuk do të hapeshin tema dhe as që do të na vinin drafte të tilla në Parlament dhe as nuk do të diskutohej për njëfarë ekipi shtetëror të negociatave me fqinjën tonë veriorë, dhe as nuk do të konfrontoheshim madje edhe me partnerët tanë strategjikë në lidhje me këtë çështje, raporte këto me miq tanë që e kanë hisen më të madhe thënë me fjalë popullore për lirinë dhe pavarësinë e shtetit tonë.

Mua më intereson ta di se, cili është protokoll i përfaqësuesit i dy shteteve në dialog me ndërmjetësimin e palës së tertë? Dhe, cili është roli i këtij delegacioni shtetëror dhe për çka janë ato vajtje-ardhje, dy nga të cilat i pamë?

Vajtja e dytë në Bruksel e dy bashkëkryesuesve, sepse shteti ynë dhe institucionet tona nuk janë në gjendje që asnjë kryesues, një përfaqësues legjitim institucional ta dërgojnë atje, u bë me një pritje të nivelit të dytë dhe të tretë protokollar.

Përfaqësuesja e politikës së Jashtme të Bashkimit Evropian, zonja Mogerini e ka bërë të ditur nivelin përfaqësues se kush e përfaqëson Kosovën dhe kush Serbinë.

Tani, partnerët e koalicionit që nuk e dimë a kanë mazhorancë apo nuk kanë. A e kanë 50% plus 1 të deputetëve a jo, dhe disa partnerë njëri nga ata që është opozitë dhe e ka një bashkëkryesues, a janë pjesë e kësaj mazhorance a jo, të na tregojë?

Vallë, kryetari i Serbisë a do të pranojë të ulet me një zëvendëskryeministër dhe me një kryetar komune apo do të pranojë vetëm me homologun e tij? Kur e analizon në detaje logjikën e këtij ligji, ku në njëfarë formë përshkruhet në mënyrë teknike dhe forma e vendimmarrjes, vërtetë është për të të ardhur keq për gjendjen se në çfarë pozite kanë ranë institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës.

Këtu nuk mund ta anashkalojmë çakordimin e plotë të tre krerëve institucional sa i takon artikullimit të saktë politik dhe institucional lidhur me dialogun me Serbinë. Dikush përmend shkëmbime terriroresh. Dikush korrigjime. Tjetri kërcënohet se do del keq nëse dikush tenton të bëjë korrigjim apo shkëmbim terriroresh. Një nga krerët e tretë institucional as mish as peshk, as me të parin as me të dytin. Dhe tani e presim një platformë të famshme nga ky ekipi shtetëror i negociatave.

Nuk është çështje numrash përfundimi i një armiqësie shekullore me Serbinë në rrethana të reja historike, territoriale, gjeopolitike po edhe demografike, po edhe strategjike për këtë pjesë të Ballkanit Perëndimor.

Prandaj, partnerët e koalicionit duhet t'i lënë lojërat që të blejnë kohë në mënyrë që edhe ndonjë ditë të qëndrojnë në pushtet. T'i thërrasin mendjes. Ta lënë arrogancën politike dhe logjiken e numrave 50% plus 1. Të ulen ta respektojnë Kushtetutën e vendit. T'i marrin krerët shtetërorë, krerët institucionalë përgjegjësitë e veta që i kanë me Kushtetutë. Ta heqim këtë mjegull dhe t'i ndërpresim këto improvizime të zbehta dhe shumë të lodhëta me gjuhë të popullit, dhe vërtetë ta luajnë rolin kushtetues që do duhej ta luanin institucionet e shetit.

Përndryshe, po e dobësojmë rolin e Kosovës. Imazhin e Kosovës dhe këtu as që bëhet fjalë për parim reciprociteti.

E fundit. Dikush e potencojë; po na ngutet! Pse? Kjo është çështje e ndjeshme, duhet analizë. Duhet gjithëpërfshirje. Duhet strategji shtetërore dhe duhet që në radhë të parë të respektohet sovraniteti, kushtetutshmëria dhe interesi strategjik nacional i shtetit të Kosovës. Faleminderit!

**KRYESUSI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Lajçi.

**ALI LAJÇI:** Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Sot kemi një ligj para nesh i cili faktikisht tenton ta zëvendësojë rolin e Kushtetutës së vendit tonë. Në vend të Kushtetutës pra ky del si një ligj i cili faktikisht del si absurd dhe del në një mënyrë mund të themi lirisht se del “outside” jashtë kushtetuese dhe obligimeve që i ka Kushtetuesja si një akt më i lartë i administrimit të vendit.



Mund të themi po ashtu se ky dialog nuk mund të mbërthehet brenda një kornize ligjore, sepse nuk ka askund ligj i cili do të merrej me dialog. Por, një gjë e tillë, e cila shkon si Ligji për demarkacionin e kufijve me Malin e Zi dhe që po ashtu ky ligj e arsyeton një delegacion i cili faktikisht nuk është as legjitim si për kah struktura dhe obligimet që i merr, sepse nuk ka një kryetar të delegacionit, por ka dy bashkëkoordinues dhe faktikisht nuk dihet se kush është kryetar i këtij delegacioni, e që faktikisht në një mënyrë dihet!

Në një mënyrë tjetër, nuk e di nëse kryeministri është këtu a po jo? Nuk është. Kryeministri është tërhequr prej obligimeve të veta kushtetuese që ta udhëheqë dialogun dhe në këtë rast e kundërshton edhe lojën e ndërrimit të kufijve, madje të korrigjimit edhe deri te ndarja e Kosovës, kurse synon për ta ndaluar atë projekt që është mirë, por faktikisht nuk e bën sepse nuk hyn në obligimet kushtetuese.

Prandaj, kryeministri Haradinaj do duhej të ishte në krye të delegacionit dhe në qoftë se e ka njëmend që të ndalen këto projekte fatkeqe për Kosovën, atëherë ai do duhej të ishte aty. Përndryshe, ai po e legjitimon mund të themi edhe korrigjimet edhe prekjen e integritetit territorial.

Në këtë rast, negociatat që bëhen, bëhen për ta gjetur një marrëveshje të dyanshme, të mirëqenë etj. Por, cila do të ishte ajo? Sigurisht ajo e cila i shkon për hatër dhe shkon për interesa të Serbisë, sepse nuk ka marrëveshje të njëanshme.

Prandaj, në këto negociata pritet një rënie e niveleve kushtetuese dhe shumë projekteve të cilat prekin tërësinë territoriale të Kosovës. Prandaj, duhet të kërkohet njohja e pavarësisë së Kosovës, por jo negociata për pavarësi, sepse nëse ne negociojmë për pavarësi nënkupton se po negociohet, por ajo duhet të jetë e njohur.

Njohja e pavarësisë, por jo atje sikurse që është në projektligj ku thuhet; njohja e statusit, sepse ka shumë staturë të vendeve të ndryshme, por pavarësia është status i definuar, pra sovran dhe do duhej të prekej.

Në projektligj e kemi, Neni 3 ku thotë; mendohet, nënkuptohet. Me ligje nuk ka që të mendohet e nënkuptohet, por duhet të jetë i definuar saktë.

Prandaj, shpesh këtu kemi vetëm improvizime, madje ky ligj del si një lloj proze e cila faktikisht nuk e trajton objektin e negociatave dhe s'mund ta mbërthejë.

Për t'i rënë shkurt, ne duhet që në vend të këtyre eksperimenteve territoriale të shkojmë në strategjinë e sovranitetit të Republikës së Kosovës dhe më tej.

Në vend të kompromiseve të dhembshme apo ndërrimeve apo të korigjimeve të territoreve që e zë pjesën bazike, ndërkaq politika jonë për sovranitetin e republikës...

Unë do t'i thosha kryeministrit se është bërë mirë që FSK ka marrë rolin dhe ka marrë misionin ushtarak të vetin të vendos në dobi të sovranitetit dhe jo të ndarjeve dhe të korigjimeve, njësitet e FSK-së në Kullë në Çakorr dhe Mokna, kurse t'i vendosë njësitet e FSK-së edhe në Pançiq, Leposaviq e gjetiu rreth vijave ku supozohet se mund të luhet me territor.

Në vend të dialogut të dështuar ku na ka sjellë një fusnotë e cila na ka sjellë në pozitë të denigrimit dhe të përfaqësimit tonë ndërkombëtarë të dinjitetshme të jetë sovraniteti, pra pavarësia e Republikës së Kosovës dhe vetëm sovraniteti i saj. Pastaj mund të bisedohet. Pa status politik, bisedohet në ajër, dhe vazhdimi në ajër i bisedave është i pakuptueshëm dhe i papranueshëm për mua.

Ndërkaq, njohja e statusit të pavarësisë është bazë juridike, ku ky vend mund të hyjë pastaj në biseda teknike. Pra, pa status të pavarësisë ka biseda dhe negociata politike. Me statusin e pavarësisë ka reciprocitet dhe biseda teknike. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Besa Gaxherri e ka fjalën. A është këtu? Nuk është! Atëherë, zoti Korab Sejdiu.

**KORAB SEJDIU:** Të dashur qytetarë,  
Kryesues e kolegë të nderuar,  
Kabinet qeveritar ju që keni mbetur pak më strikt,

Është tipike e kryetarit edhe e kësaj kryesie që temat që janë me rëndësi vitale për shtetin të tentohet të përvidhen në ditët ku vërtetë ka një ngarkesë të madhe në Kuvend, me shpresë që të mos adresohen në mënyrën e duhur ose të mos kenë vëmendjen e deputetëve dhe të kalojnë pa asnjë problem.

Mirëpo, fatkeqësisht për atë dhe ata dhe fatmirësisht për vendin, besoj që edhe ne i gjetëm i rikuperuam energjitë tona që t'i japim kontributet tona lidhur me këtë temë jetike për vendin tonë dhe për të ardhmen e Kosovës.

Unë desha ta trajtoj sot, këtë çështje më shumë në formë të pyetjeve. Fillimisht kë e përfaqëson delegacioni shtetëror i ashtuquajtur? Në rrethana normale do të kërkohej përfaqësim i tërë spektrit politik, por edhe më gjerë. Por, fatkeqësisht në vendin tonë për arsye të disa rrethanave të krijuara, disa ngjarjeve, nuk e di se në fakt edhe ky Parlament a është vërtetë përfaqësues i vullnetit të qytetarëve. E aq më pak një institucion i tillë, një delegacion i cili synon të krijohet

me këtë ligj që në fakt nuk krijon edhe nuk tenton të krijojë rrethana për përfshirje me të gjerë sesa një grup i vogël të njerëzve të cilët mbajnë të uzurpuara postet kyçe në vendin tonë.

Çështja tjetër apo pyetja tjetër shumë e rëndësishme është se, a bënë atë që është në interesin më të madh të Kosovës ky delegacion? E ajo është a ndalë ky ligj që tenton ta bëjë këtë delegacion, a e ndalë Hashim Thaçin? Edhe a i ndalë aventurat e tij për të krijuar atë që të gjithë po i druhen? Pra, që ta dëmtojë Kosovën dhe ta dëmtojë tërë atë që kemi tentuar ta arrijmë në këto vitet e pasluftës.

Nëse shikohet më tutje, duhet pyetur se a reflekton vërtetë ky ligj, unitetin që do duhej ta kishte edhe ta ngërthente brenda vetvetes.

U fol edhe më herët që edhe nga vet fakti sesi është dizajnuar vendimmarrja këtu shihet qartë që mundohet të tejkalohet pjesa dërrmuese e qytetarëve të Kosovës që sot ulen në dy krahët e këtij Kuvendi dhe që në fakt gjenden në opozitë dhe jo pjesë e pozitës.

Glauku më herët e përmendi faktin se po dizajnohet në njëfarë mënyre sikur njolloj “supporting team”. Me tregu të drejtën, nuk besoj që do t’ju lejohet që as mbështetja apo “supporti” që t’i jepet presidentit Thaçi. Do t’i japin aq “support” sa ai ju lejon.

Nëse lexohet ky ligj, shihet qartë që përderisa siç u përmend më herët ndoshta edhe mvishet me njëlloj tentative për ta drejtuar dialogun, askund nuk përmendet që vendimi përfundimtar mbetet te Kuvendi dhe tek përfaqësuesit legjitim të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Po ashtu u sugjerua që të përmirësohet ligji. Edhe është e vërtetë që ky ligj mund të përmirësohet me dy fjali të vetme; 1. Që e përjashton presidentin Thaçi nga vendimmarrja e çfarëdo forme në këtë proces dhe 2. Që obligon çdokënd në Republikën e Kosovës që të mos diskutojë integritetin territorial të Republikës së Kosovës.

Shtrohet pyetja; a do të kalonte ky projektligj, a do të votohej prej pozitës nëse do të ndodhet një përmirësim i tillë? Dhe, vërtet nuk besoj që do të votohej.

Tash, çka nënkupton ky projektligj nëse nuk po i bëka të gjitha këto gjëra që janë të domosdoshme për vendin tonë? Implikon edhe një ngarkesë në buxhetin e Republikës së Kosovës. Implikon edhe një delegacion i cili mvishet me detyrën për të shkuar për foto-sesione dhe për shopping në Bruksel, përderisa presidenti Thaçi brenda dyerve merr vendimet e kobshme për Republikën e Kosovës.

Të nderuar kolegë, për fund, po e thjeshtoj pak, po them se kur dikush del dhe do ta vrasë dikë, nuk dënohet vetëm vrasësi, njëkohësisht dënohet edhe ai i cili e nxit atë, edhe ai që ia mundëson këtë vepër penale.

Dhe, shumë vjet prej tash kur shkruhet historia e Republikës së Kosovës ndoshta shumë prej nesh edhe nuk do të jemi gjallë në atë kohë, në faqet e errëta të kësaj historie nuk do të gjendet vetëm ai që ka ndërmarrë të gjitha veprimet për të dëmtuar dhe copëtuar Kosovën. Aty do të jenë gjithë deputetët, të cilët përmes këtij veprimi ose edhe veprimeve të tjera i mundësuan pikërisht këto gjëra. Faleminderit!

KRYETARI: Hajdar Beqa, urdhëro!

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

I nderuar nënkryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne sot në seancë plenare kemi Shqyrtimin e parë i Projektligjit për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.

Me këtë ligj rregullohet funksionimi i delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës për dialogun me Serbinë, duke përcaktuar strukturën organizative, veprimtarinë, kompetencat dhe përgjegjësitë e Delegacionit shtetëror.

Nga praktika e kaluar, kur kemi ligje në lexim të parë, mendoj që deputetët duhet ta japin kontributin e vet me ato vërejte që i kanë në ligj apo të flasin për materien, e jo krejt këtu çka po flitet, kush çka të ndalojë, e ne e dimë që as nuk mund ta ndalojmë e as nuk mund të bëjmë lirime, sepse ne këtu jemi shtet, e kemi një Kushtetutë, edhe ky ligj për të qenë funksional duhet të jetë në harmoni me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Edhe kompetencat janë të ndara me Kushtetutë dhe secili institucion e ka kompetencën e vet, edhe presidenti, edhe kryeministri, të cilit nuk mund t'ia marrim as t'ia shtojmë me një ligj të veçantë, sepse nëse kemi ligjin dhe Kushtetutën, ne obligohemi para Kushtetutës se ne nuk mund ta bëjmë asnjë ligj, i cili nuk është në frymën kushtetuese.

Megjithatë, unë e përgëzoj Qeverinë, në këtë rast, për ligjin edhe grupin negociator, ka vend për ndryshime ky ligj dhe do ta japim kontributin mes dy leximeve.

Kemi edhe ne vërejtjet tona, ku duhet të ndryshojmë këtë ligj. Po nuk e kam të qartë, për shembull, gati secili deputet, edhe nga deputeti i fundit, zoti Sejdiu, thotë si ta ndalim presidentin Thaçi. E ne duhet, së pari zoti Sejdiu më duket është edhe jurist, është mirë të shihet Kapitulli V i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku janë edhe kompetencat e presidentit, është neni 84, ku pika 1, do të thotë, e këtij neni është që presidenti përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë vendit.

Kemi pikën 10, nuk po i them pikat e tjera, udhëheq edhe politikën e jashtme të vendit. Ne gjithë ditën flasim këtu për unitet të brendshëm, kurse në të njëjtën kohë të gjithë japim kontribut qysh të mos ketë unitet.

Konsideroj që duhet të marrim praktika edhe nga e kaluara. Ne si vend kemi pasur përvoja në negociata, dialogu konsideroj që është rruga e vetme për të zgjidhur problemin mes Kosovës dhe Serbisë. Besoj se për këtë të gjithë pajtohen dhe duhet ta japin kontributin e vet, sepse nuk ka rrugë tjetër, nëse ka ndonjë rrugë tjetër që mund t'i zgjidhim këto probleme, atëherë është mirë të na tregojnë edhe neve e të shikojmë a është rrugë e mirë dhe po i bashkohem.

Si vend e kemi një përvojë në të kaluarën në negociata që nga Rambujeja, edhe atëherë ka pasur skeptikë, por kemi pasur vendime dhe nga ato vendime kemi ardhur deri ku jemi sot. Kemi pasur dhe negociatat e Vjenës, ku në atë kohë Partia Demokratike e Kosovës ishte opozitë, po ka dhënë kontributin e vet, tash jemi në negociatat në Bruksel. Konsideroj se si vend por kemi pasur vendime edhe nga ato vendime kemi ardhur deri ku jemi sot.

Ne flasim këtu nga disa parafolës pse nuk e merr kryeministri përgjegjësinë? Atëherë pse s'e merr LDK-ja dhe Vetëvendosja përgjegjësinë? A i ka votuar qytetari për të marrë përgjegjësi, apo i ka votuar qytetari të nënshkruajnë dhe në momente të caktuara të dalin jashtë, sepse nuk donë të japin kontribut.

Unë mendoj që është momenti i duhur nëse ky ligj nuk i bie tamam delegacionit, ta ndryshojmë këtë ligj, është momenti i duhur ta japim secili kontributin.

Unë ftoj personalisht që secili koleg ta japë kontributin e vet dhe të bëjmë një ekip negociator gjithëpërfshirës, ta kem një unitet, sepse dikush thotë çka po na ngutet.

Ndoshta ne si deputetë nuk po na ngutet, se e kemi diku kah 2000 euro pagën, edhe sot ndoshta e kemi rregulluar edhe pak, po qytetarëve të vendit iu ngutet. Kemi mbetur një vend i izoluar në rajon.

Të vetmit qytetarët e këtij vendi nuk kanë të drejtë të lëvizin lirshëm, të vetmit studentët tanë nuk kanë të drejtë të shkojnë në universitete të tjera. Kem probleme tjera, kem probleme ekonomike,

kem probleme të cilat ne vetë po i krijojmë. Ne qytetarët nuk na kanë votuar për t'ia komplikua jetën, po na kanë votuar për të bërë zgjidhje.

Andaj, nëse ky delegacion duhet të jetë më i kompletuar, unë mendoj që duhet, mendoj që duhet të ketë përfaqësues nga të gjitha subjektet politike, edhe ashtu siç është edhe me ligj. Atëherë është mirë secili nga ne të japim kontributin tonë. Unë nuk e di që asnjë deputet i opozitës, as nga Vetëvendosja e as nga LDK-ja që foli pa e përmendur Hashim Thaçin, po më vjen mirë që po luani një farë roli të zëdhënësit të zotit Thaçi, po është mirë të jepet kontribut dhe të na tregoni për përvojat tuaja në negociata. Cilat janë ato përvoja, apo cilat kanë qenë kontributet tuaj në shtetformimin që e kemi sot.

U tha edhe nga disa të tjerë këtu, kemi pasur raste kur ka qenë VLAN-i atëherë, Vetëvendosja e pati kushtëzuar atëherë atë koalicionin, ne e votojmë zotin Haradinaj për kryeministër, po bisedimet me Serbinë do t'i udhëheqë Albin Kurti. Tash thotë pse, edhe atëherë nuk ka pasur të bëhej Albin Kurti kryeministër, po zoti Haradinaj.

Unë kisha thënë që të mos bëjmë politikë për vota, sepse qytetarët tonë po ikin prej këtij vendi, nuk jemi duke e bërë joshës vendin tonë, sot e kemi nisur mirë, i kemi bërë tri ligje të rëndësishme për vendin, e të vazhdojmë tutje me një unitet në interes të qytetarëve, e jo t'i shikojmë interesat individuale apo interesat partiake në raport me interesat nacionale dhe interesat shoqërore.

Kontributin tonë do ta japim mes dy leximeve. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Nga Lëvizja Vetëvendosje, Albulena Haxhiu.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Së pari e përmendi edhe kryetari i Vetëvendosjes që në kohën kur ky projektligj është propozuar, është thënë që i mbron tri pozicione dhe i përmendi cilat kanë qenë ato pozicione që thuhej se do t'i mbronte.

Pra, që negociatat t'i udhëheqë vetëm Delegacioni shtetëror, pra si autoritet i vetëm. Vendimmarrja është unanime dhe cakton pozicione të qarta në raport me çështjet apo vendos kufizimet.

Pra, nëse e lexojmë me kujdes të shtuar përmbajtjen e këtij projektligji, shihet qartë se ky projektligj rregullon vetëm disa veprime tërësisht të parëndësishme dhe procedurale, por ama përmban edhe dispozita që janë tejet të dëmshme.

Po e nis me nenin 3, ku përkufizohet dialogu.

Në fillim të këtij përkufizimi flitet për fazën përmbyllëse të këtij dialogu, por a e dini se çka do të thotë kjo. Kjo do të thotë që ata të cilët po thurin lavde për këtë projektligj, i konsiderojnë të mirëqena marrëveshjet e deritanishme, madje për ta ato marrëveshje të dëmshme qenkan të pranueshme, pra të gjitha fazat e dialogut po i konsiderojnë si të drejta dhe tashmë po flitet vetëm për fazën përmbyllëse, përfshirë këtu edhe marrëveshjen e prillit, ku gjashtë prej pikave të asaj marrëveshjeje kishin të bënin me ‘Zajednicën’, apo bosnjëzimin e Kosovës.

Po ashtu i pranon dhe i konsideron të mirëqena të gjitha koncesionet e tjera që janë bërë në kurriz të Republikës dhe në kurriz të qytetarëve të Republikës.

U përmend këtu marrëveshja e shtatorit të vitit 2014. Mirëpo ka një dallim të madh dhe unë ju kisha lutur që ata të cilët i referohen asaj marrëveshjeje, t’i referohen vetëm kuptim pozitiv dhe jo në kuptimin negativ, siç u tentua të bëhej këtu, sepse aty është kërkuar komision hetimor për marrëveshjet, njëra prej pikave të asaj marrëveshjeje kërkon krijimin e komisionit hetimor, i cili do të merrej me atë se çka është nënshkruar, kush ka nënshkruar, çka ka pësuar Kosova nga ato marrëveshje, madje edhe dërgimin e marrëveshjes së prillit në Komisionin e Venedikut.

Pra, ne në atë kohë kemi shkëputje nga dëmet e negociatave që i ka bërë Hashim Thaçi dhe tash është situata krejt ndryshe. Pra, ata që dikur i kundërshtonin këto negociata, tanimë e kanë prezantuar kinse një projektligj, por duket që ky projektligj është shkruar nga vetë Hashim Thaçi, pra vetëm lexoni prej nenit 1 deri te i fundit, duket komplet sikur se është shkruar nga vetë ai.

Më tutje ky projektligj nuk rregullon asnjë veprim, sjellje gjatë dialogut. Madje nuk vendos as vijë të kuqe se çka dhe për çka mund të bisedohet me palën tjetër.

Ky ligj nuk ka për qëllim të ndalojë ndonjë konsekuencë në cenim të Kushtetutës.

Ky ligj ka për qëllim që t’i mëveshët një përgjegjësi Kuvendit përmes votimit të tij, e cila e dërgon në pranim të konsekuencave të dëmshme për vendin, të cilat do të rrjedhin nga procesi i dialogut me Serbinë.

Për të bërë këtë sponsorizuesi i këtij ligji, përmes nenit 1, paragrafi 2 ka dhënë statusin e veçantë ose special këtij ligji. Aty theksohet se ky ligj e ka statusin ‘lex specialis’ në rast të kolizionit të ndonjë dispozite tjetër ligjore me këtë ligj, do të mbizotërojnë nenet e këtij ligji.

‘Lex specialis’ është parim i përgjithshëm i së drejtës ndërkombëtare, i cili është pranuar nga kombet e qytetëruara në sistemet e tyre juridike.

Ky parim është krijuar për të zbatuar në favor të mbrojtjes së interesit të përgjithshëm dhe në favor të zgjidhjes së rasteve individuale, duke mos cenuar interesat e palëve të tjera. Pra, kjo

dispozitë që jep karakter ‘lex specialis’ tentohet t’i mbivendoset Ligjit të marrëveshjeve ndërkombëtare, pasi që të dyja këto ligje rregullojnë çështjen e njëjtë, madje i mbivendoset edhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjegjësisht i mbivendoset neni 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, atë që po tenton ta bëjë Hashim Thaçi me Gjykatë Kushtetuese, sepse ju e dini që Hashim Thaçi ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese interpretim të nenit 18, pra ka kërkuar ta dijë se kush e ka autoritetin apo të drejtën të negociojë për territorin dhe kush e ka të drejtën apo përgjegjësinë të vendosë firmë në një marrëveshje që fal territor.

Sipas doktrinës juridike, ‘parimi i specialitetit’ nënkupton kur dy norma ligjore rregullojnë të njëjtën lëndë apo të njëjtën çështje, zbatohet norma e posaçme, e cila ka përparësi dhe shmang normën e përgjithshme.

Sipas praktikës ndërkombëtare, ‘parimi i specialitetit’, i cili është zbatuar në rastet e ndryshme, mund të zbatohet vetëm në rast të ndonjë dispozite ligjore e ndonjë ligji që bie në kundërshtim me ndonjë normë të ligjit tjetër.

Pra, sipas këtij ligji ose sipas kësaj, ligji në tërësi nuk mund të ketë status të veçantë ose status special.

Kësi soj vetëm dispozita ligjore mund të ketë status ‘lex specialis’ kundrejt ndonjë dispozite tjetër të ligjit.

Mirëpo, ajo që duhet të theksohet në këtë rast është ligji si i tillë dhe dispozitat e këtij ligji nuk mund të kenë status ‘lex specialis’ kundrejt Ligjit të marrëveshjeve ndërkombëtare, sepse Ligji për marrëveshjen ndërkombëtare është ligj organik. Neni 18 i Kushtetutës përcakton natyrën e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe mënyrën e votimit të tyre.

Në paragrafin 5 të këtij neni përcaktohet se parimet dhe procedurat e ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare rregullohen me ligj. Pikërisht mbi bazën e kësaj reference kushtetuese është hartuar dhe ka hyrë në fuqi Ligji për marrëveshje ndërkombëtare, i cili përcakton mënyrën e rregullimit të procedurës së lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare, e deri te tërheqja nga marrëveshjet ndërkombëtare.

Pra, një ligj i tillë, i cili ka referencë kushtetuese dhe i cili rregullon në mënyrë të detajuar këtë fushë mjaft të rëndësishme, quhet ligj organik dhe si i tillë nuk mund të shmanget nga zbatimi.

Prandaj, çdo përpjekje për t’i zënë vendin e zbatimit të ligjit të marrëveshjeve ndërkombëtare si ligj organik, i cili ka referencë kushtetuese dhe drejtpërdrejt nga ligji i sponsorizuesit në fjalë, përbën shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.



Paradoksi tjetër qëndron në atë se ligji nuk e përcakton në mënyrë eksplicite ndalimin e negociimit të territorit, si pjesë të pakos së marrëveshjes finale me Serbinë.

Domethënë, parimi i pacenueshmërisë dhe pandashmërisë territoriale nuk janë të sanksionuara dhe po ashtu nuk ofron mekanizëm të garantuar për autorizim të Kuvendit për parimet negociuese, domethënë e lë Kuvendin thjesht në rolin e një ratifikuesi potencial të marrëveshjes, por jo të autorizuesi të parimeve mbi të cilat Kosova mund të negociojë.

Përfundimi i Kuvendit nga një autorizim i tillë është po ashtu kundërkushtetues, sepse Kuvendi gëzon kompetencë të përfaqësimit më të lartë popullor dhe sa herë që pikë diskutimi janë çështjet e sovranitetit kushtetues, është Kuvendi si autoriteti i vetëm.

Njëjtë ishte rasti i Dhomës Kryesore në Parlamentin britanik ndaj Brexit-it.

Pra, në asnjë vend nuk ceket një rikonfirmim i tillë, këtu shprehet edhe vlera e dispozitave të këtij projektligji, i cili nuk përcakton asgjë tjetër përveç dëshirës për të iniciuar projektligje, përmes të cilave do të tentohet të legjitimohet dhe legalizohet cenimi i territorit të shtetit apo defunksionalizimi i shtetit.

Ne kemi edhe shumë dispozita të tjera, të cilat i kontestojmë, por unë e shoh këtu që nuk kam mundësi dhe kohë për shkak të minutave, por më përpara u tha këtu që vullnetin politik po duan ta shndërrojnë në normë.

Ata që për mbijetesë mundësuan zbutjen e vetmisë së Hashim Thaçit, janë deputetët që votat i kanë marrë nga Lëvizja Vetëvendosje. Pra, votuesit e Vetëvendosjes i kanë votuar ata, edhe për shkak se i kanë kundërshtuar marrëveshjet e dëmshme apo negociatat pa parime dhe pa kushtet. Ata që i kanë marrë votat e elektoratit të Vetëvendosjes nuk kanë të drejtë të hyjnë në pazare dhe nuk kanë të drejtë ta legjitimojnë Thaçin, nëse duan ta legjitimojnë atë, le të shkojnë në zgjedhje dhe pastaj e shohim kush ku është.

Pra, nuk ka të drejtë askush të marrë vendime të tjera për sa kohë është deputet me votat e votuesve të Lëvizjes Vetëvendosje.

Në fund, ky projektligj është skandaloz në aspektin politik, por po ashtu edhe kundërkushtetues.

Në emër të Grupit Parlamentar ju njoftoj se ne do ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese. Dikush mund të thotë që edhe PSD-ja e 'ka kapur' Gjykatën Kushtetuese, jo. Ama PDK-ja po punon shumë mirë për PSD-në, sepse kështu po i përshtatet edhe Thaçit, edhe PDK-së. Faleminderit!

KRYETARI: Frashër Krasniqi, më fal, Korabi e paska kërkuar, Frashër, kërkoj falje se ka kërkuar Korabi replikë më herë. Urdhëro, fjala për ju.

KORAB SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Nuk desha t'ia ndërpres më herët Albulenës, Frashër na fal për ndërprerje tash, do të mundohem të thjeshtësoj pak një diçka që është goxha e komplikuar, por do të mundohem për Hajdarin, pasi veç hyri në një territor që nuk besoj që është dashur të hyjë.

Çështja e republikave parlamentare është që përfaqësimi i popullit bëhet përmes deputetëve dhe janë pikërisht deputetët ata të cilët ose vetvetiu nëpërmes Kuvendit, vendimeve që marrin në Kuvend ose përmes ekzekutivit që në një farë mënyre është vartës i Kuvendit, i përcaktojnë politikat e brendshme dhe të jashtme.

Ndërsa sa i përket rolit të presidentit, presidenti në një Republikë parlamentare, e vërtetë është që është përfaqësues, po përfaqësues ose reprezentues jo i vullnetit të tij personal, por është përfaqësues i politikave, edhe në sferën ndërkombëtare ose sferën e jashtme, të politikave të përcaktuara nga përfaqësues të qytetarëve.

Pra, edhe një herë po ta shpjegoj, që nuk është ai i cili e krijon politikën e jashtme, është thjesht një përçues i politikave të shtetit karshi shteteve të tjera. Ky është dallimi, do të thotë, a e bën vetë apo thjesht e përçon një politikë dhe këtë ta konfirmojnë kushdo që është marrë me këtë temë dhe e ka analizuar pak më shumë në detaj se ju.

KRYETARI: Zoti Beqa, kundër-replikë!

HAJDAR BEQA: Faleminderit! Edhe unë një sqarim për zotin Sejdiu.

Edhe pse zoti Sejdiu nga mandati që është prej fillimit është konfuz, është konfuz në qëndrim politik, në grup parlamentar, herë i pavarur, herë i varur, edhe në komision atje herë e përfaqëson LDK-në, herë thotë s'jam LDK, është çështje e tij personale.

Po flas tash për atë çka e thashë më herët. Është e qartë për të gjithë se ne jemi Republikë parlamentare, unë thashë neni 84, pika 10, thotë: "Udhëheq politikën e jashtme të vendit", nuk thashë diçka tjetër, po thashë çka thotë Kushtetuta.

Pika 1 thotë: "Përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë vendit", ne jemi Republikë parlamentare dhe secili pushtet i ka kompetencat e ndara dhe të qarta me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ju çka thatë aty, nuk thatë asgjë më shumë se të jesh vasal s'di as i kujt, as ti se di se kujt po i thua, vetëm nja tridhjetë herë e ke përmendur presidentin Thaçi dhe... *(Ndërprerje nga regjia)*

KRYETARI: Frashër Krasniqi, fjala për ju!

FRASHËR KRASNIQI: Të nderuar deputetë,  
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Prej diskutimeve të sotme, po edhe të ditëve të mëhershme në lidhje me çështjen e përfshirjes së PSD-së në delegacion dhe në lidhje me ligjin për dialogun, në lidhje me ligjin për negociatat, për platformën që do të bëhet, e kemi kuptua një të vërtetë që, në fakt, Vetëvendosja, po edhe LDK-ja, po sidomos VV-ja faktikisht do të kishte dëshirë të mos bëjë fare ky ligj, e Thaçi të shkonte i vetëm në dialog e ta prodhonte një marrëveshje të keqe, që në fund të realizoheshin profecitë e tyre se gjoja ne ia kemi qëlluar çka ka ndodhur në Kosovë.

Pra, saktësisht këta kanë dashur që të mos bëhet ligji, të mos ketë përfshirje të Kuvendit në dialog, të shkojë Thaçi vetë që të bëhet një marrëveshje e keqe, s'ka rëndësi që Kosova dëmtohet, me rëndësi është që i kanë dalë fjalët profetit të tyre, profetit të këtij sektori politik që është VV-ja.

Pse është më i keq një proces negociator nëse ka transparencë më shumë, pse është më i keq një proces negociator nëse për të vendos Kuvendi, pse është më i keq një proces negociator nëse Thaçi, në krejt takimet do të ketë të pranishëm edhe Delegacionin shtetëror dhe nuk mund të marrë vendime pa miratimin e këtij Delegacioni. Pse është më i keq një proces negociator nëse i nënshtrohet në fund referendumit. Pra, pse qenka më i keq procesi negociator me këtë ligj se sa pa këtë ligj? Sepse, po, po të ndalet Thaçin, të cilin e kemi bakshish prej partnerit tuaj tash, LDK-së, do të ishte ideale dhe do ta kishim ndalur dhe sot nëse e keni një plan qysh të ndalet Thaçi, ne jemi pro.

Problemi është që mes asaj që s'po mund ta ndalim Thaçin dhe asaj që të bëjmë procesin më të mirë dhe ta ketë nën kontroll Kuvendi, normalisht që ne e zgjedhim këtë të dytën. Ju keni zgjedhur të vajtoni, sepse s'po mund të bëni tjetër gjë, vazhdoni, po për PSD-në është e rëndësishme procesi të dalë i mirë.

Gjashtë muaj opozitë të PSD-së, kemi prodhuar sende që nuk i ka prodhuar Vetëvendosja që gjashtë vjet, bile ndoshta edhe më shumë dhe po flas vetëm për procese politike, pozitive për Republikën e Kosovës.

Për herë të parë Kosova ka ligj për dialog, për herë të parë Kosova ka platformë për dialog që nuk e ka pasur kurrë. Nëse kjo po ju pengon, sepse po tuteni që rezultatet e këtij dialogu do të jenë pozitive dhe juve nuk u dalin fjalët, atëherë na s'kemi çka të bëjmë.

KRYETARI: Driton Selmanaj e ka fjalën.

DRITON SELMANAJ: Përshëndetje, i nderuar!

Kolegë deputetë,

Në fakt, ne po trajtojmë sot një projektligj, sipas vlerësimit tim është një ndër projektligjet më kotë që ndonjëherë ka pasur Kuvendi i Kosovës. Besomëni kur po e analizoj për nga përmbajtja, më i rëndësishëm dukej Ligji për fara kur miratohej, se sa ky ligj. Në fakt, unë me këtë projektligj po e shoh një tendencë për t'u suprimuar normat kushtetuese dhe rendi kushtetues në Kosovë, qoftë kur preket hierarkia shtetërore, sepse sistemin politik e kemi të etabluar në Kushtetutën e Kosovës, por qoftë kur preket edhe mandati i këtij Delegacioni.

Dhe, unë përgjigjja ime pse, në fakt, ka ardhur ky ligj, përgjigjja është shumë e saktë, është dashur të normohet pazari i PSD-së me PAN-in. Dhe, tash PSD-ja kur erdhi në një situatë ku do të duhej të bëhej levë e pushtetit, atëherë zgjodhi, çka? Të provojë ta kapitalizojë edhe në normë, në mënyrë që t'i japë peshë kësaj tematike. Ky asnjë efekt nuk e ka tjetër, përpos normim i pazareve të ulëta politike që PSD-ja i bën me PAN-in. Dhe, unë mendoj që presidenti Hashim Thaçi, para se të ndodhte themelimi i këtij ekipi, ka qenë në situatën më të keqe dhe kredibiliteti i tij më i keq prej ekzistencës së tij në politikë. Dhe, tash kur partitë politike opozitare i dërgonin letra në vazhdimësi Zyrës së BE-së dhe shteteve të Kuintit, nga ana tjetër, kryeministri Haradinaj kishte qëndrimin e qartë kundër idesë së rrezikshme për ndarjen e territorit, atëherë Hashim Thaçit i duhej një levë dhe themelimi i ekipit negociator është fuqizimi i presidentit Thaçi, nuk është dobësim i tij, përkundrazi, ai është më i fortë tash, sepse tash kur shkon atje, thotë: “Jo, jo, unë jam kredibil, sepse mandati im ekziston, por e kemi edhe një ekip atje shtetëror, për të cilin kur vijmë ata të bisedojnë me juve, unë shkoj në ...”, kështu e tha, më 8 janar tha ata vijmë e takohen me juve e unë shkoj në skijim, se kam punë të tjera.

Dhe, kjo në fakt tregon krejt rëndësinë që ky projektligj e ka. Një arsye tjetër që ky ekip shtetëror, i cili quhet “shtetëror”, sepse për mendimin tim më tepër i ngjan një ekipi turistik, i cili do të ketë kosto të madhe financiare për Kosovën, edhe pas themelimit të këtij ekipi, edhe kryeministri Haradinaj, edhe presidenti vazhdojnë dërgojnë letra qoftë presidentit Tramp, qoftë zyrave ndërkombëtare që, në fakt, e kanë vendosur nën hije këtë ekip. A është ky ekip që bart këtë proces? Apo, ky ekip është në funksion të asaj që, unë jam i bindur, është në funksion të presidentit Thaçi. Dhe, tash po flasim këtu, do ta kemi një platformë politike të bisedimeve, sepse në ligjin aktual që na ka ardhur këtu askund nuk flitet cilat janë temat, të cilat nuk guxojnë të preken nga ky ekip.

Po e lexoj vetëm rezolutën e sponsorizuar nga PSD-ja, çka thoshte: “Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta votojë Ligjin për dialogun, me të cilën do të sigurohet vlefshmëria juridike dhe sanksionimi ligjor i përmbajtjes së platformës së dialogut dhe përgjegjësive të përfaqësuesve të delegacionit shtetëror”. Neve nuk ka ardhur fare ai dokument, pra e aprovojmë ligjin, ku nuk po vendosim vija të kuqe fare, ndërkohë po themi platforma do të na vijë më pas, e platforma, të nderuar kolegë deputetë, nuk e ka statusin e ligjit, ai është një dokument më tepër fakultativ, që

normat e saj më pas nuk janë detyruese për askënd, por e kanë karakterin edhe të rezolutave, të cilat, në fakt, kemi miratuar shumë shpesh në Kuvendin e Kosovës.

Dhe, tash edhe një çështje tjetër që lidhet në ligj thotë: “Mbledhja konstituive e ekipit do të bëhet shtatë ditë pas themelimit”, domethënë një fakt që ka ndodhur në të kaluarën, akoma ekziston në ligj. Domethënë, ekipi do të konstituohet dhe do të takohet shtatë ditë pas themelimit, a ne jemi duke folur dy muaj pas, kur në fakt, kjo veç është themeluar. Neni 6 thotë: “Përfaqësuesi i shoqërisë civile”, të cilin zoti Kurti e tha “e zgjedh Shpend Ahmeti me Fatmir Limën”, por mos kështu! Kush janë këta të zgjedhin përfaqësuesin e shoqërisë civile, edhe nëse do të donim ta kemi një përfaqësues të denjë të tyre, atëherë ka edhe brenda shoqërisë civile mekanizma se si delegohet një përfaqësues i tyre në këtë proces. Dhe, jo vetëm në këtë proces, sepse unë sa kam qenë pjesë e shoqërisë civile, kemi ndërtuar mekanizma se si t’i delegojmë njerëzit në institucionet tona përfaqësuese, por kjo nuk guxon të mbetet në ingerenca të këtyre dy, të cilët pretendojnë që udhëheqin një ekip turistik.

Një element tjetër që është i dëmshëm ky ekip, i cili them krejt angazhimi i tyre më tepër është edhe të rehatojë njerëz të tyre politikë, kanë planifikuar ta bëjnë një administratë të madhe, komisione punues, zyra të koordinorit, administrata e delegacionit dhe krejt këta, nëse i shihni, ju garantoj që pjesa dërrmuese e tyre do të jenë njerëz të PSD-së, sepse ky ka qenë kushti që ata i kanë vendosur ose shantazhi që i kanë vendosur PAN-it, këta nga frika që kanë mbetur kur kryeministri, duke mos guxuar të merret me këtë temë, atëherë ta largojmë prej vetes dhe i fus këta aty. Thonë që do ta themelojmë një komision ad hoc parlamentar dhe që, në fakt, kjo i bie që PSD-ja, përpos Delegacionit të bisedimeve, tash edhe komisionin parlamentar po duan ta uzurpojnë.

Çka thotë ligji? Ligji thotë: “Komisioni ad hoc Parlamentar për Mbikëqyrjen e Dialogut do të udhëhiqet nga një përfaqësues i partive opozitare, pjesëmarrëse në procesin e dialogut”, që i bie këta të tre të PSD-së që janë pjesë të negociatave i raportojnë PSD-së në komisionin parlamentar. Por, për çka është Komisioni për Politikë të Jashtme? Për çka është Komisioni për Integritet Evropian? Për çka janë komisionet e tjera parlamentare, të cilat kanë mandat kushtetues për të ushtruar funksionin e tyre? Prandaj, këto manovra, këto lojëra politike të paskrupullta, po ndaluni, ose së paku dilni edhe në publik thoni: “Jemi në shërbim të tyre”, por jo me këso demagogji për të cilën besomëni po janë edhe të bezdisshme. Se ky ekip as që e ka të bëjë me ekip shtetëror, por është ekip në funksion të Hashim Thaçit, e tha zonja Mogerini, tha: “Ekipi shtetëror është ekip mbështetës i presidentit Thaçi”, e çka po doni diçka tjetër. Nëse s’e keni kuptuar këto, ja po jua thotë zonja Mogerini. Kur dolën nga takimi me presidentin Thaçi, zoti Limaj tha “po kthehem në pikën zero”. Kam përshtypjen që po ktheheni te idetë e që janë në fakt patentim juaj që mendoni se historia fillon me juve, po e keni gabim.

Në vitin 2012 kanë filluar negociatat me Serbinë, zonja Edita Tahiri në një emision televiziv tha: “Jam befasuar qysh askush nuk erdhi te unë të marrë pranim-dorëzimin e punës që e kam bërë. Kam punuar gjashtë vjet, e dorëzova zyrën, kurrkush s’ka ardhur t’i kërkojë dokumentet tek unë”, e kur dolën këta nga zyra e presidentit s’morën asnjë dokument, tha: “Po fillojmë prej pikës zero se nuk ishte bërë kurrgjë”. Dhe kjo tregon logjikën, në fakt, që historia fillon me këta, a që në fakt është gabimi themelor. Dhe, tash unë duke e parë krejt këtë situatë, sepse ligji po them është aq i kot sa që nuk ia vlen shumë edhe të komentohet, neve na duhet sot një bashkim, po është e vërtetë që na duhet një bashkim, por bashkim ndaj kujt, kundër trinomit Hashim-Edi Rama- Aleksandër Vuçiq. Kemi një projekt shkatërrues për Kosovën përpara dhe ne duhet t’i dalim ballë. Unë mendoj që është qasja më patriotike, më kombëtare dhe më e ndershme për popullin e Kosovës që ne si klasë politike t’u dalim përballë këtyre njerëzve që, për fatin e keq duket sikur do të sjellin pasoja tragjike për Kosovën. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Dardan Sejdiu, nuk qenka. Atëherë, mos i largo, regjia, emrat, se po i harroj. Rexhep Selimi. LDK-ja, Vetëvendosja ka më së shumti deputetë që kanë kërkuar fjalën, duhet pak të kombinohen.

**REXHEP SELIMI:** Faleminderit! Qysh në fillim të kësaj seance u dëgjua fjalia më e pritur në këtë rast nga partitë e koalicionit qeverisës, pra me një thirrje që partitë politike opozitare të bëhen pjesë të dialogut. Zaten, prej fillimit ekziston kjo ofertë, e cila qysh në fillim dihej që nuk është ofertë e singertë, edhe sikur të mendonim ashtu. Sepse, kjo ofertë nuk po bëhet që ata e duan opozitën, e as që e duan opozitën të jetë në pjesë të proceseve, por kjo është një ftesë për bashkëfajësi, duke ditur fajin që po bëjnë ata. Veç edhe kur e shohim këtë projektligj, ligji më i pakuptimtë që me e përkthyer popullorçe i bie “ligj më pa lidhje”, nuk e di kur ka ardhur ndonjëherë në këtë Kuvend. Ligj për dialogun me Serbinë, tash po të kishte zbatim të Kushtetutës nga ana e Qeverisë, atëherë pse duhet ky ligj, mjafton të respektohet Kushtetuta, e në kuadër të saj të respektohet sovraniteti i Republikës. Pra, ky projektligj tenton edhe ta shkelë Kushtetutën ose paradoksalisht edhe ta zëvendësojë atë. Pastaj, kur po shoh dhe kur dihet se kush e ka sponsorizuar, kush e ka draftuar këtë projektligj, dihet edhe qëllimi i këtij projektligji.

Por, nuk mund ta ndajmë këtë ligj me të gjitha rrjedhat e tjera që kanë të bëjnë me dialogun, ndonëse u kërkua këtu që ne t’i shmangemi, pra të flasim vetëm për projektligjin dhe të mos flasim për dialogun. Na u kërkua të flasim vetëm për projektligjin e të mos flasim për Delegacionin shtetëror, na u kërkua të flasim vetëm për këtë projektligj e mundësisht ta kalojmë e të mos flasim as për mungesën e platformës, por të mos harrojmë që Delegacioni shtetëror i duetit Limaj-Ahmeti s’mбетet asgjë tjetër vetëm një kopje e dobët e Edita Tahirit. Edhe e dobët, edhe kopje, tash kuptohet se çfarë po them, por për aq sa isha në sallë dhe për aq sa i dëgjova deputetët e mazhorancës, përfshirë këtu edhe ministrat që folën, më shumë se 10 herë na ftuan që të jemi pjesë e këtij Delegacioni. Atëherë në mënyrë legjitime vjen në shprehje një pyetje: pse po na ftoni? A pse na doni kaq shumë, a? Natyrisht, që jo. Por, ta zëmë se kaloi ky ligj, ta zëmë që

ju nuk po doni Thaçin ta lini të vendosë për Kosovën, pa më thoni, të nderuar kolegë deputetë të mazhorancës, edhe eventualisht pas miratimit të këtij ligji, kush do të takohet me Vuçiqin? Ju apo Thaçi? E nëse jeni aty për ta penguar, ju lutem, na tregoni si do ta pengoni? Normalisht që atje gaz nuk do të gjuani.

Pra, ky delegacion thjesht është një 'bek vokal' i Thaçit dhe i Vuçiqit në takimet e tyre dhe eventualisht edhe një prapaskenë e fotografisë së Thaçit dhe Vuçiqit, nëse mund të bëni diçka më shumë, na thoni! Por, është i veçantë ky ligj edhe për shumë gjëra të tjera, nuk shihet që ka pasur ndonjë shembull të këtyre ligjeve, së paku nuk njoh, por meqë u dashka të bëhet ligji për raportet me një shtet të caktuar, këtë rast Ligji për raportet me Serbinë, ose siç e keni përshkruar, Ligji për bisedimet apo negociatat me Serbinë, a më thoni ky Parlament që ka shumicë shqiptare a ka ndonjë ligj për ndërtimin e raporteve me Shqipërinë? Jo, nuk ka!

Pra, ky përkushtim kaq i madh që ne të kemi një listë të veçantë për raportin me Serbinë nuk e nderon këtë Kuvend. Një farë forme nuk po e shoh se çka keni marrë yrysh kaq shumë që t'i shkoni në tavolinë Thaçit dhe Vuçiqit, një tavolinë të cilën nuk do ta prekni kurrë për shkak se thjesht, siç thashë, ju do të jeni prapaskena e asaj çka flitet këtu. Por, ju që nuk guxoni t'i thoni jo Thaçit, nuk do ta keni kurrë po-në tonë, ta keni të sigurt për këtë punë, e në këtë rast, nuk do ta keni as opozitën aty, pra ky delegacion as nuk e ka, e as nuk do ta ketë opozitën në këtë përbërje, sidomos në këtë qasje. Por, në mungesë, sepse kështu dëgjova, ju më ndihmuat ta bëj këtë fjalim, ju deputetë të mazhorancës 'en quo', ju thatë që në mungesë të mundësive për ta ndalur Thaçin duhet t'i bashkohen atij ekipi, i bie që 'një dorë që nuk thyhet, duhet të puthet'.

Mirë, bëjeni kështu, por pa opozitën, e sidomos pa Lëvizjen Vetëvendosje. Shkoni, veç do takohemi edhe kur të ktheheni. Faleminderit!

**KRYETARI:** Besa Gaxherri e ka fjalën.

**BESA GAXHERRI:** Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Pas gjithë këtyre debateve, unë po mundohem të mos i përsëris gjërat, megjithatë nuk mund t'u ikim përsëritjeve. Kur ju dëgjon një pjesë e popullatës me këto demagogji tuaja, mund të lajthitet se vërtet ky koalicioni qeverisës dhe PSD-ja, e Presidenti i vendit e keni vërtet hallin për të zgjedhur problemin me Serbinë, por hapat apo veprimet tuaja me plot intriga, kushtëzime e shantazhe në mesin tuaj, na dëshmon se ju të gjithë aktorët e kësaj loje bashkë ju mban vetëm pushteti.

Deklarimet e rrezikshme të Presidentit të vendit me muaj të tërë dhe të finalizuar me përgjigjen në letrën e Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zotit Donald Tramp, ku presidenti ynë i thotë pa fije turpi se 'unë jam i gatshëm për kompromise', kjo na jep të kuptojmë se

Hashim Thaçi nuk e njeh apo nuk e respekton Kushtetutën e këtij vendi. Presidenti ynë e ka shpallur veten monark, edhe pse nuk ka monarki. Ndërsa, koalicioni qeverisës, kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, zëvendëskryeministri Limaj dhe kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, deklarojnë se nuk ka asnjë kompromis me kufijtë e territorin e vendit, si dhe sovranitetin dhe për t'ia bërë me dije këtë presidentit dhe Serbisë, kjo Qeveri gjoja mori vendimin e taksës 100%, pra kundrejt Serbisë. Por, ky ligj këtë nuk e konfirmon. Shtrohet pyetja: vërtet ky veprim a u mor për Serbinë apo për Hashimin? Me qëllim që të mos mund të realizojë marrëveshjen e dëmshme për Kosovën.

Tani kur kemi kërkesa nga partnerët tonë ndërkombëtarë për heqjen e taksës, partneri i kësaj qeverie, PDK, zoti Veseli, që e mbronte me çdo kusht dhe deklaronte që ky e ka propozuar taksën 100%, deklaroi se do ta tërheqë taksën, sepse po kërkon, thotë, SHBA-ja. Ndërsa, kryeministri deklaroi 'nuk e tërheq taksën', sepse rrezikohet territori i Kosovës me marrëveshjet që janë përgatitur në dëm të Kosovës përmes Thaçit. E, në mesin e këtyre lojërave të ulëta e të rrezikshme, na ka dalë shpëtimtari imagjinar, PSD, e cila përmes këtij ligji legjitimon veprimet e presidentit, duke u bërë argat në tërë këtë maskaradë dhe duke shfrytëzuar situatën që të realizojë lloj-lloj kërkesash, deri aty që në krye të këtij delegacioni të jetë PSD që ende as vetë nuk e di forcën e vet elektorale.

Në tërë këto akte të dramës tuaj, e cila gjithsesi është komedi tragjike për vendin, është koha që të ndaleni. Zoti kryeministër Haradinaj, në qoftë se nuk je pjesë e kësaj maskarade, loje të rrezikshme e tejet të dëmshme për vendin, duhet të marrësh menjëherë këtë vendim. Kosova nuk mund të funksionojë e as të ekzistojë pa partnerët e saj, BE-në dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shtetet e Bashkuara, e cila është më shumë se partner i Republikës së Kosovës, po kërkojnë pezullimin e taksës, ju duhet ta merrni përgjegjësinë kushtetuese dhe obligimin e rezolutës së Kuvendit që t'i udhëhiqni bisedimet, ta pezulloni taksën aq sa ka nevojë, në të kundërtën ju duhet të jepni dorëheqje. Vendi duhet të shkojë në zgjedhje dhe kryeministri i ardhshëm duhet të përfaqësojë vendin në këtë dialog. Kështu largohet Hashim Thaçi nga skena dhe evitohet rreziku për Kosovën.

Mjaft më me këso lojërash e deklarata kundër njëri-tjetrit, ndërsa Kosova çdo ditë po futet në krizë ekonomike, sociale e degradim i politikës së jashtme dhe dëmtim i raporteve me shtetet mike. Është më shumë se qesharake që sillni në Kuvend ligj për dialogun. Është krejtësisht e papërgjegjshme që t'i ikni përgjegjësisë kushtetuese, duke u munduar të arnoheni me këso pamfletesh. Zoti kryeministër, më vjen keq që nuk je për momentin në sallë, po ju drejtohem shumë sinqerisht: dy rrugë i ke, ta udhëhiqni, ta merrni përgjegjësinë kushtetuese dhe përgjegjësinë, të cilën jua ka dhënë Kuvendi përmes Rezolutës, ta kryesoni dialogun, ose të jepni dorëheqje dhe vërtet vendi të shkojë në zgjedhje dhe të kemi një kryeministër legjitim, i cili do të guxojë dhe do të dojë t'i marrë përgjegjësitë kushtetuese. Faleminderit!



KRYETARI: Zonja deputete Besa Gaxherri, si një nga deputetet më devotshme, më intelektuale, më patriote, dëshiroj të të pyes: çka kam deklaruar unë për taksën, se s'po i besoj gojës time, ti më mirë ma ke interpretuar, ndoshta, po ta di? Çka kam deklaruar për taksën? A ka mundësi, pastaj e kam edhe një kundër-replikë se do t'i referohem pastaj fjalimit tënd, unë qëndroj prapa teje fuqishëm.

BESA GAXHERRI: Zoti kryetar, nuk ke faj se ti nuk mban mend shumë dhe u bie shumë shpesh pishman fjalëve tuaja. Nuk e marr për kompliment kur më vlerësoni ju, se s'keni aq kapacitet për të vlerësuar, por po të them edhe një herë, nuk e di tash datën e saktë, veç përmes studiove televizive ju personalisht keni dalë dhe keni thënë: "Unë jam ai i cili kam kërkuar 100% taksën me Serbinë" dhe nuk janë hiç shumë ditë që keni dalë e keni thënë: "Duhet me e tërheq" dhe ke kërkuar edhe ke thënë, je zotuar.

KRYETARI: Ju lutem regjia, të lutem deputetes mos ia ndal dhe theksoma fuqishëm se po kam dëshirë, se për atë po dua të flas. Çka kam thënë unë, se s'po di, po harroj, edhe s'i kam kapacitetet tua? Më trego!

BESA GAXHERRI: S'ke faj! E dinë të gjithë që s'i ke, po çka të bëjmë, nganjëherë 'vakti e ha kashtën', o Kadri. Edhe ty të ka ardhur momenti të jesh aty! Edhe tash çka ke thënë ti, lëshoi studiot, ato emisionet që ke qenë atje dhe dëgjoi vetë çka ke thënë. Unë s'po e ndiej më obligim t'i përsëris ty çka ke thënë!

KRYETARI: Faleminderit!

BESA GAXHERRI: E dinë qytetarët!

KRYETARI: Kundër-replikë, regjia!

BESA GAXHERRI: E di edhe kryeministri që është ulur aty çka ke thënë, të kallëzon ky!

KRYETARI: Zonja Gaxherri, me respektin e madh, krejt çka kam thënë në televizion, veç a dinë pse ta thashë, se gabove për arsye se unë kam thënë çka ke folur atë të dytën, e ti më duket e gabove me qëllim a jo, po merre, dëgjo e shiko edhe një herë, në qoftë se kam thënë të tërheq taksën, unë jap dorëheqje nga kryetari i Kuvendit. Shiko sa mirë, a po e sheh, pozicion i mirë është ky, më së miri prej juve paguhem, por në qoftë se nuk kam thënë ajo e dyta, edhe janë dokumente 10 faqe që i ka edhe kryeministri, edhe zëvendëskryeministrat, edhe partnerët, ku flitet edhe kemi për të folur pasi ta kryejmë sonte buxhetin, për atë punë do të flas unë më shumë. Kështu që, jo, e mbyllim me kaq, s'ke të drejtë. Dëgjo, unë jap dorëheqje në qoftë se qëndron çka the ti, po ti kërko falje në seancën e radhës, në qoftë se e ke mashtruar opinionin, kaq.

A e lejoni? Unë e lejoj! Jo, jo prit, unë e lejoj. Për besë, zonja Gaxherri, kërkoj falje, edhe kështu këtë Rregullore për hir të respektit nganjëherë, zonja Gaxherri, urdhëro!

BESA GAXHERI: Zoti Veseli, ju si njeri “i mençur”, bëma dallimin në mes të shfuqizimit dhe pezullimit të taksës!

KRYETARI: Unë në publik thashë, po e ndërron, as shfuqizim s’di as ku e gjeti, po unë kam respekt për ty shumë, dhe po e lë me kaq, mediat e kanë atje, po koncentrohuni në objektivitet, për hir të fjalës publike dhe përgjegjësisë që keni para qytetarëve, mos flisni për njerëzit çka janë gjallë, flisni për njerëzit që kanë vdekur, manipuloni, por çka janë të gjallë, besa edhe goxha gjatë e kemi ndërmend, edhe fort s’po na bën përshtypje as kjo Gjykata Speciale, i bëj të fala, pesë pare për të s’i japim. Unë s’i jap. Hajde kush do tjetër të flasë?

Haxhi Avdyli. Jo, le të shkojë LDK-ja, se foli PDK-ja. Fjalën e kam edhe unë, ta keni parasysh, s’e kam marrë fjalën. Ishte replikë, se fjalën për këtë pikë të rendit të ditës e kam edhe unë. Tash të mos keqkuptohemi. Jo, jo! Replikë ishte.

HAXHI AVDYLI: Të nderuar kolegë!

Të nderuar qytetarë,

Dialogu me Serbinë është nisur keq dhe tani po duan ta bëjnë edhe me ligj të keq. Duke shfrytëzuar edhe dobësinë e vendimmarrjes së Kryeministrit, apo për shkak të ndonjë marrëveshje individuale të Kryeministrit për të hequr dorë nga udhëheqja e dialogut. Ky proces i nisur keq mund ta ilustroj kështu. Së pari, ka filluar dialogu, u fol dhe u proklamua edhe sesi do të duket kjo marrëveshje në terren. Bile kjo edhe u vizatua edhe në harta të ndryshme jozyrtare dhe krejt kjo thelbi i kësaj marrëveshjeje ishte territori e jo ndonjë përmirësim i marrëdhënieve ndërfaqjësore.

Pastaj si akt i dytë pas fillimit të dialogut të Hashim Thaçit dhe Vuçiqit, i ra ndërmend dikujt që duhet të formohet një delegacion uniteti, i cili herë quhej ekip uniteti, herë ekip negociator, por nga Mogherini dhe organet evropiane u quajt ‘supporting team’, e ky më shumë i përngjan një ekipi të ekskursioneve dhe përbëhet edhe si një ekip ku rehatohen edhe shumë militantë të tjerë, të cilët kinse luajnë rolin e tyre në hartimin e platformave të ndryshme.

Akti i tretë pas formimit të delegacionit, i ra ndërmend pastaj që të formohet edhe platforma, edhe ligji. Pse po e them kështu? Sepse ky proces do të ishte më së miri të nisej nga platforma, nga ligji, pastaj të pasohej me ekipin mbështetës, pastaj të vinim te kryenegociatori dhe në fund të fillohej me dialogun, e jo të bëhet dialogu edhe deri aty sa, shkuan deri aty sa u fol edhe për territor, e ku dimë ne pastaj, thanë hajde tash ta ambalazhojmë këtë marrëveshje me disa ekipe formale, me disa ligje e platforma në mënyrë që me këtë marrëveshje të krijohen kushtet për një amin të kësaj marrëveshje nga Kuvendi tashmë i delegjtitimuar edhe nga një Qeveri tashmë e

delegjitimuar nga numrat të cilët nuk i kanë. Çka është më e keqja u tha që ky dialog tani kinse po fillon nga zero dhe nuk ekziston asnjë dokument dhe nuk u dorëzua asnjë dokument të dialogjeve të mëhershme dhe kjo i bie se ne po ia nisim këtij dialogu nga pika zero, por kjo faktikisht dihet që dialogu ka pasur shumë faza të mëhershme dhe nuk ka filluar nga tani.

Ky ligj po duket që është krijuar për legalizimin e institucionit kushtetutës të ftuar, i cili ceket po ashtu edhe në ligj, që i bie legalizim i pazareve të filluara të Presidentit Thaçi dhe Vuçiqi. Prandaj, ky ligj nuk jep aspak shpresë për forcimin e Kuvendit dhe të kryeministrit, por forcimin e rolit të Presidentit Thaçi. Është për keqardhje që një parti opozitare, e cila si duket është e frikësuar nga zgjedhjet e reja, është e gatshme për të votuar çdo iniciativë joligjore vetëm e vetëm për të ruajtur mandatet, edhe atëherë kur edhe ata e dinë që po bëjnë gabim dhe me të dy duart po votojnë mandatin e Thaçit për korrigjimin e kufijve.

Pyetja ime meqenëse edhe e kemi edhe Kryeministrin këtu, më intereson të dijeë, meqenëse ky ligj po bëhet për dialog, e po bëhet ekipi, ndërsa Serbia po e thotë hapur se as nuk e ka ndërmend që të vjen në dialog derisa është taksa në fuqi. E Kryeministri po ashtu po deklaroi se ne do të shkojmë në dialog, por nuk do ta heqim taksën pa u njohur Kosova si shtet. Tash më intereson kush do të jetë, çfarë dialogu do të bëhet, kush do të lëshojë pe, a do të lëshojë Serbia apo Kosova, dhe a do të shkojmë në dialog pasi të njihet Kosova si shtet, apo do të shkojmë në dialog pasi të hiqen taksat. Tani këto fjalë si thuhet janë dhënë peng në opinion dhe më intereson të di ku do të jetë dhe si do të filloj dialogu me taksë apo pa taksë, me njohje të Kosovës apo pa njohje të Kosovës? Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Liurn Aliu. Janë edhe katër deputetë që janë lajmëruar, në qoftë se s'ka tjetër, unë i pesti.

**LIBURN ALIU:** Faleminderit!

Sa i përket këtij projektligji, nuk mua nuk po më pëlqen këtu që po kemi shpeshherë edhe ndërprerje edhe njëfarëlloj përpjekje për ta bërë pak më interesante, të cilën pastaj edhe portalet e shfrytëzojnë edhe bëjnë lajme, dhe në fakt ndodh një shkëputje nga realiteti dhe diskutimi ku ne jemi, pikërisht për faktin se ky ligj që po trajtohet vërtet është diçka jashtëzakonisht serioze. Për mendimin tim, përpos që është serioze, është tejet e rrezikshme për vendin, për Kosovën, karshi Serbisë, pikërisht ardhja e këtij Projektligji. Pse? Këtu po flitet për një proces të rëndësishëm. Po thuhet finalizimi i negociatave me Serbinë, po thuhet që kemi për të pasur marrëveshje në fund. I bie që po kemi marrëveshje me Serbinë me të cilën luftojmë që një shekull dhe që shumë vite negociojmë me ta dhe dalim gjithmonë humbës. Tash kemi këtu një ligj, i cili po e zgjidhka këtë problem. Po thuhet për kthim të procesit të dialogut apo ardhje të procesit të dialogut në Kuvend, po flitet për transparencë, ndërsa realisht ky Projektligj saktësisht e bën të kundërtën. E bën saktësisht të kundërtën. Nëse e krahasojmë cilëndo fazë të dialogut, pikërisht në këtë fazën e tanishme të dialogut rrezikohet transparenca më shumë se në cilëndo fazë të mëhershme.

Pikërisht në këtë fazë të dialogut, rrezikohet ndikimi i Kuvendit më shumë se në cilëndo fazë të mëhershme.

Këtu, për këtë proces të rëndësishëm që po thuhet, vendimet merren dhe ky proces trajtohet me shumicën e thjeshtë në Kuvend dhe në diskutime këtu po e dëgjoj shpesh të thuhet shumica e deputetëve. Po shumica e thjeshtë nuk është shumica e deputetëve. Shumica e thjeshtë është kur prezentë janë 61 deputetë dhe me 31 merret vendim. Pra, ky është niveli i seriozitetit se si trajtohet tash ky procesi tejet i rëndësishëm serioz për Kosovën me këtë ligj, pra me shumicë të thjeshtë. Me shumicë të thjeshtë bëhet platforma. Kemi një komision ad hoc, Komisioni i cili paska për të bërë monitorimin, i cili realisht de fakto është një mashtrim prapë tjetër i radhës, për shkak se mu në këtë ligj e kemi një nen jashtëzakonisht skandaloz, i cili nuk është skandaloz, po pikërisht këtu qëndron edhe rreziku, është neni 15. Neni 15 ku flitet për diskrecionin publik dhe ruajtjen e të dhënave.

Sikur të ishte ky proces në duart e Kuvendit, Kuvendi do të kishte të drejtën që në çdo kohë të kërkonte raportim, pra të futej ndërmjet procesit dhe të shikonte se deri në çfarë faze ka mbërrirë. Po një gjë të tillë nuk do të mund ta bëjë, sepse këtë punë e vendos vetë ky delegacioni me 59 vota, pra me atë shumicën e thjeshtë që është zgjedhur. Ky e vendos a t'i qes publike, a t'i bëjë publike se çka bisedohet atje apo jo. Pra, këta shkojnë atje flasin me Serbinë, nuk e dimë çka merren vesh, nuk ia tregojnë as grupit të Komisionit ad hoc, sepse e kanë të drejtën as atij Komisioni ad hoc, i cili është i thirrur gjoja për mbikëqyrjen e këtij procesi t'i tregojnë diçka se çka kanë bërë atje bisedë dhe tek në fund të procesit, në fund fare, ata mund ta sjellin atë marrëveshje që merren vesh që këtu ta votojmë me dy të tretat. E ku dallon kjo prej procesit të mëhershëm. Pra me këtë dy të tretat, edhe këtë e kishin bërë me shumicë të thjeshtë, por një gjë e tillë përcaktohet edhe me Kushtetutë.

Ne e dimë që kur të bëhen marrëveshjet, në fund me dy të treta ato do të votohen, po i rrezikshëm është procesi se si ndodh, dhe pikërisht këtë rrezik për Kosovën karshi Serbisë, mos të harrojmë, ky Projektligj është duke ia lehtësuar këtij procesi kompromiset e dhimbshme. Përndryshe nuk kishin mundur aq lehtë të bëhen në proceset të tjera të rregullta kompromiset e dhimbshme, po pikërisht me këtë Projektligj i lehtësohet Kosovës koncesioni karshi Serbisë. Ky Projektligj është projektligj proserb, mos të harrojmë. Pse? Sepse një delegacion i krijuar me shumicë të thjeshtë mund ta mbajë të mbyllur komplet procesin karshi Kuvendit, dhe prandaj nuk duhet të votohet ky Projektligj.

E dyta, kalojmë në pjesën tjetër. Në shtator kemi pasur projekt-rezolutë e cila thuhej që me dy të tretat do të mund të krijohej grupi negociator dhe ne si grup parlamentar kemi qenë kundër. Shumë e qartë. Kemi qenë atëherë kundër, jemi tash edhe më shumë kundër. Atëherë kemi qenë kundër, sepse s'ka pasur as fije reciprociteti në atë rezolutë, qysh s'ka as në këtë. Pra, heqja e reciprocitetit tregon një lëshim pe të madh, një dorëzim të madh karshi pozicioneve sesi do të

duhej të ishin. Pastaj, mosprerja e qartë e pozicionit të Kosovës, të negociatave me të kaluarën, tregon qartë që është njohje e procesit në të kaluarën dhe përpjekje për vazhdim të procesit nga e kaluara. Prandaj, këtu e kemi shumë të qartë ne, që e kemi pasur të qartë edhe atëherë. Pa pasur prerja të qartë me negociatat e deritanishme, nuk mund të ketë vazhdim të negociatave. Do të ketë vetëm kompromise të reja. Pa pasur reciprocitet me Serbinë, ne do të përfundojmë në kompromise çfarë kemi përfunduar deri tash çdoherë.

Mendoj që ka qenë një rast jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe vazhdon të jetë. Pra Serbia kur vjen në pyetje çështja e shkëmbimit të territoreve, e përmend Preshevën. Për Serbinë ka çështje të Preshevës, kur bëhet fjalë për shkëmbim. Epo meqenëse paska çështje të Preshevës, pse të mos futet reciprociteti i të drejtave, pse të mos futet reciprociteti në të gjitha fushat mu në këtë ligj, e në atë projekt-rezolutë që e patëm e që i mungonte reciprociteti, e cila nga a kaluara prapë nuk dallon asgjë sepse në fund e përmend një njohje të ndërsjellë të cilën e ka thënë përherë Kryeministri kur ka qenë kryeministër Hashim Thaçi kur shkonte në negociata. Në atë aspekt, nuk kemi asnjë ndryshim. Tash e kemi edhe një dorëzim edhe më të madh, një tërheqje edhe më prapa. Nëse atëherë, s'keni mundur me dy të tretat, sepse keni shpresuar se mos rastësisht, mos rastësisht Vetëvendosja apo edhe LDK-ja do ta votojnë, dhe do të mund ta vazhdojmë një proces asisoj ashtu, atëherë keni thënë dy të tretat. Por kur e keni parë që nuk po mund të ndodhë, atëherë ju po tregoni dhe keni treguar një moskokëçarje të madhe. Ju doni ta vazhdoni procesin, pra punë e madhe se çka thonë të tjerët. Ne po e bëjmë një grup negociator me shumicë të thjeshtë, ne po i vazhdojmë negociatat me shumicë të thjeshtë, ne s'kemi nevojë askujt asgjë t'i tregojmë sepse e qesim aty një nen sikurse është neni 15, dhe kësaj krijohet kushte që të vazhdojë ky proces negociator, në ndërkohë që tërë kohën flitet Kuvendi, transparenca e kështu me radhë e këto terma që janë jashtëzakonisht mashtrues dhe të ëmbël që duken në dukje.

Tash, pse ka ndodhur ky ligështim, unë nuk e di pse ka ndodhur ky ligështim. Nuk e di a është për ato arsye që po fliten nëpër Komisione të ndryshme, nuk e di a janë ato arsyeja e vërtetë apo cila është arsyeja e këtij ligështimi të madh, po ky ligështim ka ndodhur. Andaj, ligështimi vërehet edhe kur vjen fjala, kur diskutohet edhe për taksën. Pra, kryesuesi i delegacionit thotë që duhet të hiqet taksë. Edhe më poshtë më, më s'kemi ku shkojmë edhe më, po biem edhe më poshtë. Ky dobësim i vazhdueshëm tregon një gjë të qartë, këtu duhet së pari të bie ky ligj, të merret një rezolutë e qartë e këtij Kuvendi e cila e ndalon Presidentin të shkojë e të negociojë, e ndalon këtë proces negociator, fillojmë, ulemi e flasim për të kaluarën dhe për procesin negociator të deritanishëm, flasim edhe çka kemi për të kërkuar prej Serbisë, shkojmë në zgjedhje dhe me një legjitimitet të plotë mund të ecim para pastaj.

Nëse procesi do të duam të jetë tamam i trajtuar sipas rëndësisë që e ka, ky proces duhet ta ketë legjitimitetin e plotë dhe nivelin e plotë të kontrollit. Ky kontroll me këtë ligj, me këto grupe ad hoc, me këtë grup delegacion shtetëror, absolutisht nuk është as kontroll, e nuk ka as legjitimitet për ta vazhduar këtë proces. Faleminderit!

KRYETARI: Dardan Molliqaj. Pesë deputetë janë, Visar Ymeri më fal, replikë!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Një qartësim duhet ta bëjmë nga kjo që e tha edhe deputeti Aliu tash, po edhe më herët që e dëgjova. Shihni çka thotë ligji, te neni 10, te kompetencat e delegacionit shtetëror, pra pika 4.6: i raporton Komisionit mbikëqyrës të Kuvendit pas çdo takimi me delegacionin e Republikës së Serbisë dhe ose me lehtësuesit-ndërmjetësuesit e dialogut. Nuk është zgjedhje e delegacionit a i raporton a jo, është i obliguar me ligj t'i raportojë pas secilit takim. Ky Komision është i përbërë nga 11 anëtarë dhe drejtohet nga opozita. Pra, drejtohet nga opozita. Ideja pse shkruan aty që do të drejtohet nga opozita, pjesëmarrësit në delegacion, është për shkak se delegacioni është menduar t'i ketë të gjitha partitë e opozitës brenda. Pra, po, ky Komision duhet dhe mund të drejtohet edhe nga dikush nga ju, edhe nëse nuk vini në delegacion dhe ju do t'i keni anëtarët në këtë Komision, anëtarët siç i keni nëpër komisionet e tjera. Por nëse ju nuk i besoni Komisionit që do ta themelojë ky Kuvend për mbikëqyrje, i bie që pjesërisht nuk i besoni as vetes.

Tjetër, rezoluta ka qenë me 20 korrik e dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga unë, në emër të GP të PSD-së, e cila rezolutë kërkonte dy të tretat së pari për platformë dhe pastaj dy të tretat për delegacionin shtetëror. Është menduar, siç e kam shpjeguar edhe atëherë në Kuvend, që në platformë të ravijëzohen vijat e kuqe edhe po ashtu çështjet që Kosova do t'i diskutojë me Serbinë dhe ato që i përjashton së diskutuari me Serbinë. Po, ose nuk dini të lexoni, ose nuk keni aftësi të kuptoni çka lexoni, ose jeni thjesht e keni nevojë të dilni të tregoni të pavërtetën në publik për t'i përmbushur atyre fantazmagorive tuaja, pra me një fjalë rreni qëllimisht duke e ditur që po rreni sa për të manipuluar opinionin publik.

KRYETARI: Liburn, urdhëro fjala për ju, po përmbahuni nga shprehjet, s'kam dëgjuar as...

LIBURN ALIU: Unë mbase nuk di të lexoj, mbase edhe nuk kuptoj, po unë së paku pra po e lexoj atë çka e kam këtu përpara. Por, mua po më duket që ta keni shumë probleme dhe kur po u thuhet e vërteta në sy, atëherë kaloni me ofendime, e me këso gjërash të tjera. Ju e dini shumë mirë Visar se sa kuptojmë e sa dimë. Mbledhjet e delegacionit shtetëror janë të mbyllura, përveç në rastet kur delegacioni vendos për seancë të hapur. Delegacioni shtetëror mund të vendosë për mbledhje të hapur me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të tij. Kërkesë për mbledhje të hapur mund të bëjë një anëtar i pranishëm i delegacionit, vendimin për mbledhje të hapur mund të bëhet i ditur nga njëri nga bashkëdrejtuesit, mbledhjet e delegacionit shtetëror incizohen vetëm përmes mjeteve elektronik zyrtare të Kuvendit dhe ruhen si sekret zyrtar, përveçse nëse delegacioni vendos ndryshe. Anëtarët e delegacionit shtetëror dhe...

KRYETARI: Zakonisht, rregullorja e thotë qartë, s'mund të lejoj. Ju kisha lutur, të paktën tregoni korrektësi sa të mundni, kjo politika është kështu nganjëherë. Ndonjëherë pak për

elektorat mundohen kështu, por mirë të fyesh nuk është mirë edhe të flasësh diçka çka është e pavërtetë nuk është mirë.

Sami Kurteshi. Prit pak. Më fal Dardan, se po ka qenë mirë, po keni mbetur vetëm Lëvizja Vetëvendosje, PSD-ja edhe unë. Sami a po e merr se ishte Lëvizja Vetëvendosje, a t'ia kaloj PSD-së, pastaj menjëherë ti.

Atëherë Dardan Molliqaj, pastaj menjëherë.

**DARDAN MOLLIQAJ.** Përshëndetje të nderuar deputetë!

Qytetarë të cilët e kanë përcjellë sot këtë seancë,

Thënë të drejtën, për një moment, deputetë të dy partive opozitare ma mbushën mendjen. Edhe më bindën që ne si delegacion dhe parti që e mbështesim delegacionin edhe jemi të këqij, edhe të shitur, edhe proserbë, e besa edhe e kemi keq. Edhe thash ngadalë se nuk është mirë të jesh pjesë e këtij grupi. Edhe për një moment po dua ta dijë çka e kanë në plan të bëjnë këta? Unë kur kam besuar bashkë me shokët e mi që po vjen një e keqe e madhe, kemi dhënë gjithçka dhe e kemi quar vendin në zgjedhje, edhe i ka pasur Parlamenti 87 deputetë, e s'ka mundur ta miratojë as demarkacionin e as Zajednicën. Unë isha duke u bërë me juve, po a e di pse s'u bëra, se më ra në mend, se a e dini çka keni krejt në plan të bëni ju? Veç të thoni ti je i mirë, ti je i keq, unë e kam ditur, unë ia kam qëlluar, qe çka ju thash unë, e Kosova të shkojë. Pra njeriu në politikë duhet ta ndajë mendjen. Nëse s'bëhet pjesë e diçkahit, e kundërshton shumë nëse është rrezik, nëse s'është rrezik, bën edhe lehtë. Veç qysh ky rrezik që ju po e paraqitni, e pastaj veç fjalime në Kuvend, e shkoni te shtëpia e flini rehat e besa edhe ndonjë pushim për vikend që iu ka prishur, vallahi nuk është në rregull. Kështu që ndajeni mendjen, në u pafsha ndonjë ditë që e keni në plan përnjëmend me ndalë, me juve jam, prej sot po ju them, jam mësuar tash të dalë prej partive, dal edhe prej PSD-së, kthehen prapë në Vetëvendosje ose në LDK, veç kisha pasur qejf të shoh çka keni në plan të bëni. A nëse e keni në plan veç të ankoheni kështu si zakonisht, ju rrit nderi se nuk mund të jem me ju.

Ajo çka mund të flasim tutje është, ka një problem me atë që dëgjova deri tani, legjitimiteti. Me aq sa marr vesh unë në demokraci, legjitimiteti është vetëm çështje e zgjedhjeve. Me zgjedhje vendoset legjitimiteti. Për juve të LDK-së, legjitimiteti është kështu keni dalë koalicioni i tretë në zgjedhjet e fundit. Ky është vendi që qytetarët për shkak të qeverisjes ua kanë treguar. Ky është legjitimiteti që e kemi deri në zgjedhje të tjera. Nëse doni të flisni për sondazhe se po keni shumë qejf të flisni për sondazhe, atëherë unë po ju bëj ftesë publike, prej janari të vitit 2018 në janarin e vitit 2019, LDK-ja le t'i publikon sondazhet, LDK-ja në janarin e vitit 2019 është 23,8, afër 10 për qind i keni humbur të mbështetjes qytetare për sondazhe. Në zgjedhje ndodh i fitoni 32 për qind. Unë po flas veç për sondazhe tash.

Sa i përket legjitimitetit, ju zonja Osmani e dini shumë mirë. Mandati i deputetit me Kushtetutë është i pavarur. Në momentin që e bën betimin deputeti, është mandati i tij dhe ti e di këtë punë. Sa i përket asaj që LDK dhe Vetëvendosje e përfaqësojnë 60 për qind të qytetarëve të Republikës, me çka jeni duke u matur. Nëse jeni duke e matur me sondazhe, ky është trend, mund të jetë edhe i vërtetë, por nuk i keni as 50 për qind më. Të dyja bashkë jeni 45 për qind në sondazhe, i keni humbur nga 10 për qind për një vit. Për në zgjedhje, këqyrim ishalla fitoni, e shohim edhe këtë punë. A e di çka m'u duk interesant. Lumirin e kam kryetar në Komision për Buxhet dhe Financa dhe Lumiri pat thënë që me këta që i kanë dy për qind e tre për qind, s'flasim edhe s'merremi. Krejt seanca sot shkoi, krejt kolegët e Lumirit duke u marrë me PSD-në. Tash ose Lumiri le të kërkojë falje që e ka pasur gabim, ose ju mos flisni se s'ka kuptim. Të flasësh dhe të humbësh kohë kaq shumë për dy për qind, jeni duke i marrë në qafë edhe qytetarët. Nëse ju e keni bindjen që e keni veç mirë, vazhdoni.

Sa i përket ligjit, kur e kemi propozuar ligjin, gjeni deklaratat publike, eksponentët e të dyja partive kanë thënë kurrë ky ligj nuk bëhet. Kurrë ky ligj nuk bëhet, kurrë PDK-ja edhe Hashim Thaçi këtë ligj nuk e pranon. Janë deklaratat publike. Tash që e ka pranuar, tash ky i shërben Hashim Thaçit. Deklarata publike kanë qenë që kushtet e PSD-së nuk realizohen dhe ta shohim a i përpijnë këta PSD-ja fjalët e veta. Unë kisha pasur qejf që ai që ka folur për përbirje të fjalëve, të qohet ai tash e t'i përpijë ai fjalët e veta, të thotë qytetarë me vjen keq, kam dyshuar që s'bëhen, Qeveria ka për t'i mashtruar, e tash po del tjetra.

Po flisni edhe për çështjen se qysh duhet ky proces të përfundojë ose jo. Nuk ka kuptim ta personalizosh ose ta reduktosh politikën vetëm në personalizim. Ligji është për herë të parë që e rregullon vendimmarrjen. Dëgjova deputetë që thoshin këtu, cilat janë vijat e kuqe me ligj. Po ai nuk duhet të jetë deputet, ai që thotë kështu. Ligji e rregullon funksionimin, procesin e vendimmarrjes së delegacionit, e jo temat. Ajo është rezoluta, e keni platformën që do t'ju vijë javën tjetër ose kurdo nga delegacioni edhe aty paraqiten këto çështje. Pra, keni problem esencial sa i përket kësaj.

Tjetër, të gjithë keni kërkuar komision ad hoc të Kuvendit për mbikëqyrje të dialogut e tash jeni kundër. Ta përfundoj, ju dëgjova deri tash. Keni kërkuar nuk po dëshironi. Tash, a po doni që të vini në Komision për Politikë të Jashtme ose në cilindo komision? Thërrisni delegacionin dhe mos thoni se s'po vijnë pa i thirrur.

Delegacioni duhet të vijë dhe ka obligim që të vijë dhe do të vijë.

Ana tjetër e transparencës, më duket që ka një keqkuptim këtu thelbësor. Nëse dikush e kupton transparencën që çdo fjalë që flitet në negociatë serioze mes dy shteteve, dhe të dalë në secilin medium, kjo nuk ka lidhje me transparencë.



Nuk ndodh asnjëherë në asnjë rast një gjë e tillë. Në cilin shtet demokratik, ju e dini, që gjithçka publikon sa herë që flet. Po ka një arsyes pse mbledhjet e komisionit ad hoc janë paraparë që të jenë të mbyllura, sepse ne jemi të interesuar që t'i informojmë deputet dhe jo të publikojmë gjithçka në media që mund ta dëmtojë procesin.

Këto janë rregullat bazë të transparencës. Transparenca nuk nënkupton që gjithçka të jetë në media dhe ju këtë e dini.

Tash, pyetja shtrohet se çfarë do të bëjë opozita në rast që ne po flasim? Sigurisht që tash do të votojë kundër këtij projektligji. Sigurisht që opozitës tash nuk po i pëlqen as shkarkimi i Rikalos. Se është bërë vonë, u bë si kusht e u bë të tjera.

Po shpresoj që është hera e fundit po s'kam qare se e kam thënë publikisht në televizion e po dua që ta them edhe këtu. Nëse vazhdoni, e di që disa këtu do të thonë se po na shantazhon po herën tjetër nuk ju shantazhoj hiç, sikurse ia kemi bërë klanit Pronto, a e di ata altoparlantët që i vendosnim këtu për ato bisedat, nëse doni prej mbledhje së ardhshme do të flasim; kush ka qenë në SHIK, që e ka pas shef atë atje. Kush ka qenë në SHIK prej atij rendit tuaj. Kush ka marrë para prej Devollëve. Edhe për këtë, edhe për secilën gjë që doni.

Ama ato nuk do t'i bëjmë me 'më the e të thashë'. As nëpër emisione. Por, do t'i bëjmë këtu me altoparlant t'i dëgjojnë të gjithë dhe tua përsërisim sikurse atyre.

A nëse ju keni diçka qitni krejt? Por, jo nëpër Facebook duke u fshehur nëpër bira. Këtu dilni publikisht thoni diçka. Ato, unë mendoj që nuk duhet të përdorën për shkak se ka qenë çka ka qenë. Nëse vazhdoni që të shpifni edhe pas një viti. Unë ju njoh juve edhe sa jeni kombëtar. Edhe sa jeni kundër Serbisë. Edhe sa keni guxuar kundër PDK-së. Edhe sa keni guxuar kundër AAK-së. Të gjithë prej jush ju njoh. Edhe ju mua më njihni.

E nëse po dëshironi që ta bëni politikën, t'i qesim këtu, atëherë po i qesim. Po hajde vëlla flasim për politika. Mos i thoni njerëzve pro serb e të tilla gjëra sepse i dimë këto.

Ju njohim secilin dhe na njihni secilin. Flisni për politika. Për ligj. Për programe. Kundërshtonani, në rregull jemi. Përndryshe, atëherë do t'ju bëjmë juve, sikurse ia kemi bërë klanit Pronto, edhe këtij klanit tjetër do tua qesim këtu me altoparlant të shohim krejt çka ka ndodhur edhe te ju.

KRYETARI: Vjosa, unë besoj atë çfarë e thua. A ta ka përmendur emrin? Urdhëro, fjala për ty. Replikë, Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Ndoshta, mund ta sqarojë zoti Molliqaj pse iu referua fjalimit tim kur fliste për mandatin e deputetit si mandat të lirë.

Unë, absolutisht nuk fola për këtë temë. Dhe për më tepër pajtohem plotësisht që mandati i deputetit sipas Kushtetutës është mandat i lirë. Nuk e kuptova pse iu referove, ndoshta mundesh ta sqarosh këtë punë.

Sa i përket sondazheve, unë nuk besoj që duhet t'ia mbash gajlen partive që së paku e kanë përkrahjen në popull dyshifrore, përderisa ju e keni akoma njëshifrore. Besoj, edhe ky sondazhi i fundit me rreth 7 mijë respondentë, se ju Dardan i gjen të gjitha, e ka dëshmuar këtë.

Kurse te temat edhe kufizimi i temave me ligj, arseja pse ne po insistojmë është për shkak se ju vet me rezolutë keni thënë që platformës do t'i jepni fuqi juridike përmes ligjit. I asaj nuk i jepet fuqi juridike pa qenë pjesë e këtij ligji. Rrjedhimisht, një platformë që miratohet si rezolutë, edhe në qoftë se i vendos të gjithë kufijtë e temave për të cilat ne po kërkojmë, nuk mund ta ketë fuqinë e njëjtë që e ka kjo që po e miratoni ju sot.

Ky ligj, në qoftë se shkon kështu, i jep hapësirë të madhe kujtdo që shkon në Bruksel, qoftë ai presidenti me ftesë ose dikush tjetër, që të hap cilëndo temë nëpërmjet negociatave.

Kurse sa i përket komisionit ad hoc, LDK-ja nuk e ka përkrahur kurrë. Ideja për herë të parë publikisht është përmendur nga njëri prej këshilltarëve të presidentit.

KRYETARI: Dardan Molliqaj, kundër-replikë!

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit zonja Osmani për sqarimin e çështjes së mandatit të deputetit. Të këshilloj që t'ju flasësh edhe kolegëve të tjerë nëse ata të dëgjojnë dhe respektojnë, në mënyrë që tua mësosh këtë aspekt në mënyrë të mos e përsërisin më.

Sa i përket platformës është e vërtetë. Me ligj, nëse e ke lexuar ligjin, janë dokumentet bazë që obligohen që delegacioni t'i ketë. Për herë të parë delegacioni shtetëror që shkon në negociata është obliguar me ligj që të ketë platformë.

Dokumenti-platformë është obligim ligjor prej sot e tutje kur votohet ligji për Delegacionin Shtetëror. Nuk mund të zgjedhin ata që ta bëjnë ose mos ta bëjnë. Në fund, meqenëse ju jeni njohëse shumë e mirë, të paktën pretendon, e Kushtetutës, ju e dini që Kuvendi i Kosovës me 2/3 mund ta ndërrojë Kushtetutën.

Unë nuk e di pse po frikësoheni ju njëmend! Jo ju personalisht. Ngase ke dëshmuar nganjëherë se ke votuar kundër asaj që ka dashur partia jote.

KRYETARI: Glauk, replikë a po? Replikë Glauk Konjufca. A po e dëshironi fjalën, meqë është Samiu pastaj.

GLAUK KONJUFCA: Jo, një herë kam folur, po tash më takon më duket vetëm replika, sepse një herë kam folur këtu.

KRYETARI: A ta përmendi emrin? Nëse nuk ta ka përmendur emrin mos të merr të lutem.

GLAUK KONJUFCA: Subjektin politik.

KRYETARI: Subjektin nuk është mirë. A ta ka përmendur emrin, bëhu korrekt? Në qoftë se ta ka përmendur përgjegjësia jote e merr, nëse jo e merr Samiu...

GLAUK KONJUFCA: S'e di a po e kupton. Unë nuk jam shef parlamentar i Glauk Konjufcës. Unë jam shef i Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje.

KRYETARI: Nuk ka subjekt në bazë të Rregullores...

GLAUK KONJUFCA: Nuk jam shef parlamentar i vetvetes!

KRYETARI: Glauk, Rregullorja nuk përcakton asnjë subjekt grup parlamentar. Deputetin për replikë, jo grupet parlamentare. E ke të sigurt. Ja ku e ke Komisionin për Legjislacion le ta lexojë, në qoftë se ka unë marr përgjegjësi. Glauk a dëshiron ta marrësh fjalën si deputet, ke të drejtë? I ke 10 minuta. Glauk Konjufca si deputet 10 minuta. Jo, jo nuk ka folur.

Vetëm pak! A ka mundësi vetëm diçka? Po reagoni. Glauk Konjufca ka folur si Shef i grupit parlamentar dhe si deputet ka të drejtë edhe 10 minuta. Kjo është. Urdhëro, Glauk Konjufca!

GLAUK KONJUFCA: Krejt halli i qytetarëve edhe shqetësimi i vërtetë pse po ia vlen të flasim ne në këtë diskutim parlamentar dhe për temën që është shtruar është ky; që këtu kemi të bëjmë me diçka më të thellë se thjesht prezantimi i këtij ligji.

Kjo është pjesë e pakos në pazari, nuk është thjesht një ligj për të cilin po flasim. Është diçka që ka ndodhur një ndryshim radikal në skenën politike të Kosovës, dhe ky ndryshim i ka shpjegimet e veta politike edhe motivet të cilat ma merr mendja që është mirë t'i shpjegojmë.

Që ta kuptojmë pse kemi ardhur deri në këtë fazë kur përfaqësues i opozitës po quhet edhe një person i cili nuk është deputet fare, as i zgjedhur i popullit e po do që të na sjellë vendimmarrje në Kuvend, ky që nuk i përket Kuvendit hiç.

Përfaqësuesi i krejt opozitës është një njëri që nuk është në Kuvend. A keni dëgjuar kësi paradoksi? Po, pse po ndodhin këto anomali? Këto anomali janë pjesë e një pakos së pazareve që përfshinë më shumë 5-6 pika. E këto pazare nuk kam nevojë që tua shpjegoj në detaje.

Këto pazare i keni parë nëpër mesazhe. Nëpër mesazhe kush kujt i rri gatitu. Kush kë e ka referencë. Fol si Kadri Veseli. Se Kadri Veseli e di sesi bëhet kjo punë. Meqë ai po e dika më së miri Kadri Veseli, të veprojmë qysh thotë shoku Kadri.

Ai e sjell politikën në këtë vend. Edhe është përnjëmend e vërtetë qysh tha Dardani më herët, që tha: Unë nuk e kam gajle tash ta ndërroj edhe PSD-në. Është zor hera e parë. Hera e parë e ki pak si siklet e kur t'ia nis pastaj t'i ndërrosh...Hiç nuk e kam unë atë problemin nëse e ndërrosh ky këtë tjetrën.

Çka është këtu pazari që po dua ta shpjegoj? Pazari është; prej marrëveshjeve që i keni bërë për buxhetin e shtetit. Kushteve për të cilat jeni marrë vesh paraprakisht se cilat me qenë ato të atyre, ngase s'janë ato origjinal të atyre. Ju jeni ulur dhe keni diskutuar se cilat duhet të jenë kushtet e atyre. E deri te ajo që ta dëmtoni Vetëvendosjen me buxhet, kjo është pakoja e pazarit që ata e kanë me pushtetin.

Tash, ku përfundojnë këto pazare? Unë nuk mund ta di ku janë kufijtë e këtij pazari. Mirëpo, kur njerëzit që bëjnë pazare i referohen vet legjitimitetit që buron prej zgjedhjeve, unë nuk e di qysh ka etikë ta bëjë këtë një njeri i cili i ka fituar votat e qytetarëve me Lëvizjen Vetëvendosje dhe pastaj këto vota mendon t'ia dërgojë zonjës Kaçusha Jashari.

Bile-bile jo veç t'ia dërgojë votat po mundësisht t'ia nxjerrë asaj edhe në pleqëri një rrogë prej pareve të Vetëvendosjes. Shihe, t'i dalë një rrogë Kaçusha Jasharit prej fondit të Vetëvendosjes. Domethënë deri këtu shkon projekti i pazarit që janë duke e bërë këta njerëz.

Sa i përket sondazheve, nuk e di pse i referohet një njeri sondazheve, ku në çdo sondazh që e bëjmë edhe vet mund ta bëjë një, nuk dalin më shumë se 1,8 deri në 2,4.

Po të kishte qenë ashtu siç po mendon ai, që kjo punë shkon me deputetë, PSD-ja do duhej t'i kishte pasur 11-12%. Se po i llogarisin me vota. Dardani për shembull, shumë i suksesshëm ka qenë 50 mijë vota i ka marrë vota. 50 mijë vota ej, emri personal i Dardan Molliqajt i ka marrë 50 mijë vota. E tash nëse do që t'i përkthesh në sondazhe ato 15 mijë vota 11% do duhej të dilte PSD-ja. 11% do duhej të dilte PSD-ja. E pse po del 2% a thua?

Do të thotë nuk qenka deputeti emri personal apo? Domethënë votat i paske marrë përmes një subjekti politik. E votat m'i mbledh përmes një subjekti politik e pastaj t'ua kthesh shpinën qytetarëve të Kosovës. Ky qenka mandati i lirë i deputetit të Republikës së Kosovës.

Ky qenka shembulli sesi duhet të arsyetohet liria e deputetit. Kjo nuk ka lidhje me liri të deputetit. Liria e deputetit është kur subjekti politik të imponon bindjet. Dhe kur ju keni për të votuar diçka nuk i nënshtrohesh askujt, as autoritet, as partisë politike dhe askujt.

Nuk është mandat i lirë i deputetit t'i gënjesh qytetarët. Kjo nuk ka lidhje me gjërat që po i thoni ju.

**KRYETARI:** Replikë, Dardan Molliqaj!

Sa i përket sondazheve dhe zgjedhje shihemi në zgjedhje dhe flasim. Sa i përket ndërrimit të partive, Glauku prinë. S'e di a dini, po Glauku ka qenë edhe PDK, edhe në AAK, e tash është në VV.

Po, meqenëse Glauku flet për etikë. Glauku flet për guxim edhe për sinqeritet. Unë e ftoj Glauk Konjufcën që ta marrë guximin edhe të ballafaqohet me të vërtetën dhe jo të fshihet sikurse shefi i tij të cilit u dashtë t'ia qesim videon, edhe të tregojë sesi 1 vjet ditë ka qenë SHIK.

1 vjet ditë Glauk Konjufca, s'e di a dinë kolegët, unë e kam marrë vesh dy javë para së të dalë nga Vetëvendosje prej Glauk Konjufcës, dhe pastaj ma kanë konfirmuar. 1 vjet ditë Glauk Konjufca ka qenë në Shërbimin Informativ të Kosovës.

Do të ishte mirë që ta marrësh guximin edhe të tregosh. Kur ka qenë Glauku në SHIK nuk ka qenë Vetëvendosje. Kur ka qenë Glauku në SHIK, s'ka qenë në Vetëvendosje edhe unë s'e kam problem. Veç a di çka kam pasur problem? Që s'ka pasur guximin të tregojë dhe të thotë; njerëz kam qenë këtu, kam punuar 1 vjet, këtë punë e kam bërë, ditën e mirë!

Meqenëse po flisni si Kadriu, e shef Kadriun, është mirë të tregosh ti e nëse do që herën tjetër edhe për të tjerët po tregojmë, një nga një që keni qenë në SHIK o Glauk.

Ti personalisht Glauk Konjufca. E po dua që ta shoh edhe etikën edhe guximin, edhe moralin tënd, nëse je i gatshëm ta pranosh këtë gjë ju e dini dhe që ju e keni thënë, dhe mund të vërtetohet nëse ju e mohoni.

Po ashtu, meqë veç po dëshironi t'i hyni këtyre punëve, flasim edhe për Devollët ose në këtë ose në seancën tjetër. Po, më mirë ndaleni me këtë se nuk ju del mirë kjo punë.

**KRYETARI:** Glauk Konjufca kundër-replikë një minutë, dhe kthehuni në temë, ju kisha lutur që të ktheheni në temë, më së miri.

**GLAUK KONJUFCA:** I pranoj pretendimet e Dardanit vetëm me një kusht. Nëse ka ndonjë fakt ose argument për shpifjen, unë i pranoj. Në qoftë se ka!

KRYETARI: Ruajuni se mos po kërkoni më vonë që të jeni! A kthehemi në temë? Hajde Doruntinë... më fal, jo Doruntinë... Samiut ia kam marrë fjalën. Ia kam larguar fjalën Sami Kurteshit dhe pastaj ju Doruntinë bëheni gati.

SAMI KURTESHI: Faleminderit zoti kryetar!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

S'keni faj se është shndërrua pak në cirkus, po kur ta shohim sesi është bërë dhe si është ligji, asgjë nuk është ky cirkus çfarë duhet të bëhet.

Unë e dëgjova prej fillimit të gjithë diskutimin në lidhje me këtë çështje. E kam dëgjuar prej fjalës së paraqitjes së ligjit. O kolegë, dëgjoni se pastaj po thoni s'po dëgjojmë. Pastaj kërkoni replikë, po dëgjoni mirë.

Edhe zoti zëvendëskryeministër tha; ky ligj i ka vënë vijat e kuqe të dialogut. Tash, përfaqësuesin ose propozuesin e ligjit e dëgjova duke thënë; qysh ligji i vë vijat e kuqe.

Pyetja ime është, veç tregoni se ai vë apo nuk i vë? Çfarë keni bërë?

Unë e dëgjova zotin Gorani me një fjalim relativisht të mirë dhe të edukuar. Edhe bëri ftesë për depersonalizim. Shumë bukur! Bëri ftesë për mirëkuptim. Boeri ftesë për kulturë dialogu. Edhe për urtësi diplomatike. Edhe për disa gjëra të tjera.

Edhe kur e dëgjova zëvendëskryeministren Hoxhaj i cili nganjëherë nuk e di se çfarë thotë dhe si e thotë, ky ligj është pikënisje dhe pikarritja e Kuvendit, unë nuk e di se çfarë ka dashur të kuptojë me këtë, por sigurisht se na e sqaron ai.

Mirëpo, kur e dëgjova zotin Gorani u gëzova. Veç kur i kam dëgjuar kolegët e pozitës duke fyer në baza personale, deri tash kolegu Molliqaj, i cili filloi të shantazhojë, e na i nxori sikur topuzët, për besë unë jam duke u habitur se çfarë është duke ngjarë këtu.

Nejse, zoti Molliqaj e di se çfarë ka. Sigurisht, ka topuz dhe tomahovka. Le t'i qesë krejt për besë se nuk ka dert. Bash kurrjë nuk bëhet. Bile është mirë t'i qesë edhe ato që si di.

Se nëse është seanca që të shantazhohet, grahni sa të mundeni.

Çështja e dytë, paraqitja e ligjit prej zëvendëskryeministrit Hoxhaj, unë po ju them ishte skandaloze. Për një arsye, zëvendëskryeministri Hoxhaj nuk e ka lexuar ligjin. Kjo është çështja.

Kjo Qeveri e ka deleguar dikë që ta paraqesë ligjin që nuk e ka lexuar dhe nuk e di çka flet. Kjo është çështja kryesor.

Çështja e tretë, këtu kemi të bëjmë me një ligj që e keni quajtur lex-specialis. Në filozofinë e së drejtës një ligj lex-specialis, i ka dy kuptime, dy qëllime; 1. Që të shmangë konfliktet ndërmjet ligjeve ose të mbivendoset mbi ligjet tjera.

Është mirë të tregohet se cilat konflikte do t'i shmangë apo cilave ligje do t'ju mbivendoset. Nëse i vendoset Ligjit mbi Marrëveshjet Ndërkombëtare, ky është gabimi më i madh që mund ta bëjë një Qeveri. Një delegacion apo një parti politike.

Por, nëse vërtetë ky ligj është pikënisja dhe pikarritja e Kuvendit. Nëse është ligj që mbivendoset. Që krijon një delegacion, domethënë shihet kur e dëgjon, e sheh ligjin, krijon përshtypjen se është topuz-ligj.

Do të thotë topuz që nuk njeh kurrkënd. Edhe gjuha me të cilën po flitet është topuz- gjuhë. Ky topuz-ligj e krijon një topuz-delegacion që nuk dëgjon për askënd edhe pastaj e krijon një topuz-komision që nuk dëgjon për askënd, as për Parlamentin dhe i nxjerrë të gjitha jashtë ligjit dhe vendos si të dojë vet.

Kur e lexon ligjin me kujdes, e sheh që në të vërtetë e kanë krijuar në topuz prej letre, dhe ky topuz prej letre siç duket do t'ju vyej vetëm për ta fshirë ndonjë bankë ose diçka ngjashëm, meqë nuk iu nevojitet diçka tjetër.

Ky ligj për dialogun me një shtet lex-specialis, që nxjerrë jashtë përdorimit, mbivendoset mbi ligjet tjera veç për një dialog me një shtet, kjo është vërtetë një çudi, një veprim i jashtëzakonshëm. Dhe s'kanë faj këta. Vërtetë ne jemi bërë sui generis.

S'ka njeri që na bie në fije neve. Për çdo gjë kur na konvenon, kur bëjmë ndonjë marrëveshje që nuk dihet prej nga vjen, atëherë bëjmë diçka që është sui generis.

Neve na ka hije siç duket, edhe këtij Kuvendi i ka hije të flasë për ligjin. Këta kolegë e kolege deputete të pozitës thonë pse po merreni me ligjin. Me fol për dialogun, thonë merruni me ligjin dhe mos u merrni me dialogun. Kur merremi me ligjin, thonë merruni me dialogun. Edhe një drej nuk iu bie në fije se çfarë duan.

Një po e themi, ky ligj nuk ka asnjë vlerë nëse nuk saktësohet se cilit ligj i mbivendoset. Cilin ligj e suspendon edhe cilat norma i nxjerrë jashtë ligjit dhe jashtë vlefshmërisë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Doruntinë Maloku e ka fjalën.

**DORUNTINË MALOKU:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Sivjet kur Kosova po e mbush dekadën e dytë të fitores së saj të madhe në historinë e vet, çlirimin nga një regjim vrasës, duket se ne sërish jemi kthyer në pikën zero, për shkak të gatishmërisë së kreut të shtetit për ta tërhequr njohjen ndaj shtetit të vet dhe për ta vënë statusin e Kosovës sërish në tavolinë me Serbinë.

Se është kështu, u konfirmua sot edhe nga deputetët e partisë së Thaçit të cilët thanë se statusi i Kosovës është i hapur dhe se ai duhet të mbyllet me këtë proces.

Unë ua përkujtoj kolegëve të mi se Kosova edhe dy javë e shënon 11-vjetorin e mbyllës së statusit të saj final, shpalljen e pavarësisë. Pra, statusi final i Kosovës dhe pozicioni i saj fillestar negociator është mbyllur më 17 Shkurt 2008.

Pra, në kushte normale, tani ne do duhej të flisnim për njohjen reciproke. Të pagjeturit. Kompensimin e dëmeve të luftës. Mospengimin e njëra-tjetrës në anëtarësim në organizata ndërkombëtare etj.

Pro, në këtë projektligj pretendohet që pozicionet fillestare negociuese do të miratohen nga ky delegacion i cili me të drejtë këtu u quajt jo shtetëror, por qeveritar sepse pjesë e tij janë vetëm përfaqësuesit e partive në pushtet dhe tre përfaqësues jozyrtarë të pushtetit që zyrtarisht janë ende në opozitë.

Projektligji nuk i përcakton prerë as kufijtë e negociatave. As vijat e kuqe dhe as mandatin e delegacionit. Kjo do të thotë që këta që e kanë hartuar këtë dokument totalisht të pavlerë dhe antikushtetues janë përpjekur që të vënë në lajthitje deputetët e Kuvendit, dhe tua servojnë këtë si një përpjekje të tyre për ta ndaluar presidentin.

Etja e atyre që e kanë hartuar këtë dokument shkon deri aty sa që në njërin nga dispozitat e projektligjit thuhet se, delegacioni e propozon edhe emëron edhe përfaqësuesin e shoqërisë civile në delegacion. Çka do të thotë kjo? Që përfaqësuesin e vet nuk do ta zgjedhë shoqëria civile, por pjesëtarin i cili do jetë anëtar i delegacionit do ta përcaktojë pushteti.

E kur jemi te demokracia, pjesë themelore e saj është transparenca e proceseve dhe institucioneve karshi qytetarëve dhe përfaqësuesve të popullit.

Me këtë projektligj, transparenca do të mbetet veç një dëshirë e jona për ta monitoruar dhe mbikëqyrur procesin më të rëndësishëm të pasluftës në Kosovë. Sepse, me këtë dokument gjithçka që ndodh brenda dyerve të mbyllura të mbledhjeve të delegacionit, do të konsiderohet sekret shtetëror.



Atëherë, si do ta mbikëqyrim ne këtë proces? Si do t'ju tregojmë qytetarëve se çfarë është biseduar aty, kur kjo sipas këtij dokumenti do t'i sanksionojë me ligj ata që japin informata për ato që kanë ndodhur brenda mbledhjeve të delegacionit. Pra, kjo që i është servuar sot deputetëve është komplet një farsë.

Ky projektligj është përpjekja e radhës për vulosjen e fatit të vendit i ideuar dhe negociuar nga presidenti i cili po mëton që fatin e Kosovës ta vendos vetë, sipas tekës së tij.

Të nderuar deputetë,

Qeveria e Kosovës duhet të rreshtohet krah popullit dhe ta marrë përgjegjësinë e saj në këtë proces ose të heq dorë nga pushteti për të mirën e vendit të vet dhe të popullit të vet.

Kosovës i duhet qeveri që ka legjitimitet popullor. Që i merr përgjegjësitë kushtetuese dhe i kryen detyrat e veta konform vullnetit të popullit të Kosovës.

Për fund, ata që e kanë sponsorizuar këtë projektligj, e sidomos ata që do ta votojnë këtë projektligj nuk do ta ndalojnë presidentin, por do ta ndihmojnë atë që ta ketë ekipin mbështetës teknik në angazhimin e tij antikushtetues.

**KRYETARI:** Bilall Sherifi nga Nisma. Bëhet gati Dardan Sejdiu. Le të kthehet në sallë!

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Debati i sotëm për Ligjin për Dialogun më shumë e konsumoi pikën e rendit të ditës që do të vijë në një seancë të radhës e që ka të bëjë me platformën.

Po mirë, patëm një seancë, që ndryshe quhet dy në një. Pra, brenda një seance po i konsumojmë të dy termat, edhe ligjin edhe platformën. Pra, në ditët në vijim, platforma e cila është duke u hartuar, të vijë në Kuvendin e Kosovës, unë pres debate më të shkurtra, sepse të gjitha çka është dashur të thuhet në atë seancë janë thënë këtu.

Por, gabimi është që në vend që të pritët dhe të shihet se çka do të diskutohet atje, për çka ky Kuvend do të jep leje të diskutohet në Bruksel apo kudo që të zhvillohen bisedimet, këtu kemi hyrë në fushë të spekulimeve dhe se çka do të ndodhë, çka mund të ndodhë, çka nuk do duhej të ndodhte dhe çka duhet të ndodhë.

Pra, një mishmash i asaj që asnjëri nuk e dimë se çka. Pra, le ta presim platformën dhe do të shihni se a do të diskutohet për territorin, dhe do të shihni se do të diskutohet për autonominë, për shkëmbimin, për ndarjen apo ku ta di unë për çka.

Unë jam shumë i sigurt që platforma, e cila shumë shpejt do t'i paraqitet Kuvendit, asnjëherë nga këto të cilat u thanë këtu në Kuvend nuk do të jenë pjesë e saj.

E tash, a është folur, a janë duke folur, a kanë folur aktorët e ndryshëm të skemës publike, duke filluar nga presidenti, kryeministri, e ministra, e kryetarë partish edhe për temën e shkëmbimit, edhe për temë e korrigjimit, unë nuk mund ta përjashtoj, por ajo nuk më obligon mua, ajo nuk e obligon asnjë deputet, madje as ta trajtojë këtu përderisa një delegacion, përderisa një platformë e miratuar në Kuvend nuk e ka filluar këtë proces.

Kur gjithçka të përfundojë në këtë Kuvend, të kalojë ligji, pra kemi delegacionin, të miratohet ligji, i cili është një lloj udhërrëfyesi se si do të zhvillohet i tërë procesi, kush çfarë përgjegjësisë ka dhe platforma se çka ata duke u mandatuar nga Kuvendi dhe nga ky ligj, do të kenë të drejtë të flasin.

Nëse, siç shpesh rëndomë flitet këtu, të mandatuarit do të dalin nga mandatet, është shumë e thjeshtë, me aq vota sa e kanë marrë mandatin, me aq do të mund të shkarkohen, me aq vota, 61 pra, do të mund t'u hiqet mandate, nuk kemi çka të shqetësohemi, e të mos flasim më që për të miratuar cilindo marrëveshje që ata mund ta arrijnë atje, ky Kuvend duhet ta votojë me 2/3 e votave të deputetëve.

Mirëpo, ajo që unë do t'ju kisha lutur është që të mos i shmangeni debatit, po mos iu shmangeni përballjes. Unë shoh këtu për juaj dhe po thuaj se një vit që ka shpërthyer ky debati i brendshëm që kemi gatishmëri për ikjen nga përballja. Në emër të asaj se nuk duam të përballemi, përderisa jemi në opozitë.

Pra, do të pranoni të përballemi, por duam të jem në pushtet dhe nuk duam të marrim pushtet tash, por duam të shkojmë në zgjedhje. Dhe, nëse hyjmë në këtë qark, ku askush nga pozicioni i opozitës nuk do të përballet me Serbinë, kjo i bie që çdo gjashtë muajt duhet të mbajmë zgjedhje, sepse dikush duhet të jetë në opozitë.

Po, nëse të qenit në pushtet është kusht për të marrë pjesë në përballje me Serbinë, se për mua kjo është përballje me mjete të tjera, duhet çdo kush të jetë pjesë e Qeverisë, atëherë le të bëjmë një qeveri të koalicionit të madh, të gjerë, ashtu siç e kemi pasur në koalicionin e parë, nëse ju kujtohet, aq parti kanë qenë, tri: PDK, LDK dhe AAK, ju kujtohet, tash jemi gjashtë a shtatë, le ta bëjmë pra një Qeveri, ku do të jenë të përfaqësuar të gjitha grupet parlamentare, të gjitha partitë politike dhe kështu përmbushet kushti i përballjes me Serbinë apo i gatishmërisë për t'u përballur me Serbinë përmes të qenit në pushtet, le ta bëjnë, ne jemi të hapur, Nisma do të ishte e gatshme këtë ta bëjë.

Ndërsa pak fjalë sa i përket legjitimitetit.

Ramush Haradinaj është kryeministër i mandatuar nga tri parti politike para zgjedhjeve, Fatmir Limaj është zëvendëskryeministër i një koalicioni, i dalë në zgjedhje para zgjedhjeve. Pra, qytetarët kur kanë votuar këtë koalicion, kanë pasur parasysh që kryeministër do ta kenë Ramush Haradinajn, nuk e kemi mashtruar qytetarin, bile nuk ka transparencë më të madhe se sa t'i tregosh që në fillim kush do të jetë kryeministri.

Bile-bile koalicioni i kaluar ka qenë një mashtrim për zgjedhësit, sepse kryeministër është bërë dikush që nuk e ka mandatuar koalicioni, pra nuk e ka mandatuar qytetari. Është rezultat i tavolinës, shumë në rregull, kemi bërë përpjekje të kemi dikën tjetër, nuk kemi arritur, u arrit pastaj një tjetër, Ramush Haradinaj është kryeministër i paralajmëruar, i votuar nga qytetarët e Republikës së Kosovës me 39 mandate, nuk ka aty 10 ai i ka, 20 ky i ka, 6 ky i ka. Sikur të kishim dalë veç e veç, do të kishim më shumë se 39, pra, ne kemi paguar çmimin e asaj që jemi bërë bashkë, edhe pse jemi përzgjedhur, edhe pse kemi pasur përplasje para zgjedhjeve.

Tash, kushdo që flet për legjitimitet, duhet ta ketë parasysh këtë këndvështrim: 39, 32, 27 a 28 sa ishin të tjera dhe me radhë. Pra, kryeministri i vendit është koalicioni, i cili ka marrë 39 mandate, se të kujt kanë qenë votat e grumbulluar brenda koalicionit, pak ka rëndësi, rëndësi ka që qytetarët dhe ju e dini ata që thirren, sidomos këta të cilët kanë dëshirë të thirren në CDU, ju e dini që Shtojver ka qenë një nga kandidatët për Kancelar të Gjermanisë që ka ardhur nga CSU-ja, partia motër e vogël e të djathtës gjermane dhe nuk është dëgjuar ndonjëherë ndonjë fjalë atje që nuk mund të kandidohet një kandidat për kryeministër i një partie më të vogël se sa të kësaj të madhe, kjo vetëm te ne dëgjohet, askund tjetër.

Leni këto legjitimitete, sepse kjo qeveri legjitimitet ka dhe legalitet derisa këtu në këtë Kuvend të sillen një mocion mosbesimi dhe të rrëzohet.

Kur kjo Qeveri të rrëzohet, kjo mazhorancë të rrëzohet me 61 vota, atëherë mund të flasim për fazën e ardhshme të rilegjitimitetit, ku sot në sondazhe dikush është 24, dikush 10, dikush 12, por popullit ynë, zgjedhësit tanë kanë ditur shumë, shpesh befasojnë sondazhet, prandaj mos u inkurajoni shumë.

Për fund do të kisha thënë që kjo përballje do të ndodhë me Serbinë, në fushëbetejën diplomatike do të dalim, deshëm apo nuk deshëm ne. Mirëpo, në fund, do të matemi me atë kush ku ishte në kohën kur ndodhi përballja dhe jo çka ndodhi në atë përballje, kush ku ishte.

Është ajo poezia e famshme, sidomos kjo vlen për Glaukun, mikun tim filozof, Brehtin kur thotë: “Të qëndrosh në shtëpi kur lufta fillon, është t'i shërbesh kauzës së armiku”. Pra, më mirë është të hysh në luftë të përballësh, se sa të qëndrosh në shtëpi, se duke qëndruar në shtëpi, nuk e ke shmangur luftën dhe përderisa nuk e shmang luftën, je në funksion të kauzës së armikut. Faleminderit!

KRYETARI: Jo, unë i besoj. Glauk, fjala për ju, replikë!

GALUK KONJUFCA: Bilall, presidenti na ka thanë që s'ka luftë, bile që po do ta ndalë. Edhe për ta ndalur luftën duhet dhënë territor, kështu vjen paqja mes Serbisë dhe Kosovës. Domethënë presidenti po flet për paqe, jo për luftë. A nëse ju nuk e bëni këtë që po thoni ju, atëherë do të ketë luftë, nuk po di a po jam i qartë, Bilall, domethënë me të vërtetë ju po shkoni në këtë projekt që të mos kërcasë lufta, ashtu qysh na ka thënë presidenti. Unë po e përjetoj pak si shantazh atë çka po na thotë presidenti.

Nëse doni të shpëtoni prej luftës, duhet dhënë veriun e Kosovës, ky Bilall, është projekti i shokut tonë të dikurshëm, presidentit Hashim Thaçi. Ti e njeh më mirë se ne, sepse nëpër organizime politike me të ke qenë qysh prej viteve '80-a. Tash ju po shkoni me atë projekt me presidentin Thaçi. Unë nuk po e di pse po e përdor ti metaforën e luftës që dikush po shkon në shtëpi, e po dezerton, kur në të vërtetë këtu po flitet për dezertim të shtetit, edhe të territorit shtetëror.

Ky dezertim i territorit edhe i sovranitetit është projekt të cilin e kemi dëgjuar, tash presidenti veç po do ta ambalazhojë sa më mirë, por po më vjen keq që edhe ti je bërë pjesë e asaj. Ndoshta me taktikë, a e di me atë taktikën të shikojmë deri kah gjysma, e nëse presidenti bash është në gjendje të shkojë, ne dalim prej ekipit negociator. Ama atëherë mund të jetë vonë, Bilall, e nuk mund të ikësh prej përgjegjësisë që e ke përkrahur goxha shumë.

KRYETARI: Besa me Bilallin, pa folur edhe ai edhe një herë nuk bën, kundër-replikë, Bilall.

BILALL SHERIFI: Besoj që sipas Rregullores më takon fjala, nëse s'më takon, mos ma jep, kryetar.

Në bazë të kësaj që e tha Glauku, po shihet që vërtet paska mësuar mirë në SHIK, se po i merr gjysmat e asaj që i thashë unë. Pra, i ik me qëllim fjalës përballje, edhe luftë diplomatike, pra ik me qëllim dhe e përkthen këtë në luftë në kuptim e ushtrisë, përballjes ushtarake. Unë thashë, Glauk, përballje diplomatike dhe luftë politike.

Pra, shpeshherë fjala luftë përdoret edhe për zgjedhje, luftë për zgjedhje, përdoret edhe në futboll, Glauk, po gjaku nuk del, thuhet kanë luftuar lojtarët, kanë luftuar me zemër në fushë, pra mos e dëshmo kështu që vërtet ke punuar, se po më del që në bazë të kësaj qysh e trajtove këtë që ke punuar në propagandë.

KRYETARI: Besa, Bilall, gjaku del edhe në futboll nganjëherë po të shtyhesh shumë. I kemi edhe sa deputetë, Liburn, t'i ke folur, Liburni nuk qenka, veç i ka mbetur emri, Fitore Pacolli Dalipi, i kemi edhe tre deputetë, me mua edhe katër pastaj.

FITORE PACOLLI DALIPI: Të nderuar qytetarë të Republikës,

Të nderuar deputetë,

Siç ju kanë gënjyer dhe manipuluar me ju rreth liberalizimit të vizave, loja e kësaj Qeverie dhe e këtij grupi të ashtuquajtur Delegacion shtetëror po vazhdon me territorin e Republikës së Kosovës.

Premtuan liberalizimin e vizave në vitin 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, 2017 e 2018, e tani jemi në vitin 2019 dhe ende nuk ka viza. I falën edhe 8200 hektarë tokë, por vizat nuk erdhën, i falën Malit të Zi pika strategjike, burime ujore, territor e zona turistike. E sot ende në këtë foltore marrin guximin e flasin për liberalizim të vizave.

Tani qytetarë të Republikës,

Këta po na premtojnë se marrëveshja me Serbinë po i hap rrugë Kosovës drejt integritit në Bashkimin Evropian, edhe kjo është një lojë.

Më duhet t'ju përkujtoj se gjithë ky siklet për dialogun e për këtë Projektligjin për dialogun nuk është për t'i hapur rrugën Kosovës drejt integritit evropian, por Serbisë. Serbia nuk mund të përmbyllë kapitullin XXXV pa pajtim me Kosovën. Pra, Serbisë po i ngutet, e jo Kosovës.

Strategjia për zgjerim e publikuar në vitin 2018 thekson qartë rrugën e Serbisë drejt Bashkimit Evropian dhe kushtëzon Serbinë me marrëveshjen me Kosovën. E vë Serbinë në kategorinë e parë, ndërsa Kosovën e lë në kategorinë e fundit dhe nuk përmend fare integritin e Kosovës në Bashkimin Evropian.

Integriti i Kosovës në Bashkimin Evropian nuk e garanton arritja e marrëveshjes me Serbinë.

Integriti i Kosovës varet nga pesë shtetet anëtare të BE-së, të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën.

Kjo Qeveri ka arritur të stagnojë marrëdhëniet e Kosovës me shtetet, të cilat e kanë njohur Kosovën.

Tani i ashtuquajturi Delegacion shtetëror për dialog i është bashkuar Hashim Thaçi në lojën e rrezikshme të ndryshimit të kufijve.

Po thonë ne jemi për ta ndaluar Thaçin, këta po shkojnë në Bruksel të dialogojnë me asistent të Megerinit e Thaçi po vazhdon takimet me Vuçiqin, Putinin e të tjerë.

Është mirë të na tregoni se a ju ka konsultuar si Delegacion shtetëror Thaçi kur ia ka dërguar letrën e tij presidentit amerikan Trump para disa ditësh. Në atë letër Thaçi tha se ai është i gatshëm për kompromise të nevojshme, e ka kritikuar këtë edhe Jakup Krasniqi.

Ju jeni vënë në shërbim të Thaçit jo për të mbrojtur interesat e Republikës së Kosovës, por për të realizuar planin e Vuçiqit, që korrigjimi i kufijve është ide e Serbisë, nuk po e themi vetëm ne, e kanë thënë dhe vazhdojnë ta thonë shumë akademikë e profesorë ndërkombëtarë, e para pak ditëve e tha edhe profesori i shkencave politika nga Luksemburgu, Florian Biver, se kjo është ide e Serbisë dhe e rrezikshme për Kosovën e rajonin.

Pse po ngutemi për një marrëveshje me Serbinë, pse pikërisht tani kur kapaciteti i Kosovës për negociim asnjëherë nuk ka qenë më i dobët. Kosova asnjëherë që nga shpallja e pavarësisë nuk ka pasur reputacion më të dobët se sa që ka tani në arenën ndërkombëtare.

Marrëdhëniet bilaterale me shtetet që na kanë njohur nuk kanë qenë asnjëherë më keq se sa që janë tani.

Shtetet që na kanë njohur e përkrahur më nuk po na mbështesin, bile edhe po i tërheqin njohjet.

Kushdo që sadopak e ka përcjellë politikën aktuale të shteteve të Bashkimit Evropian, të Britanisë së Madhe dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e di shumë mirë se tani është momenti më i keq për Kosovën të ngutet në një dialog të tillë.

Ne të gjithë e dimë që Bashkimi Evropian ka filluar përgatitjet dhe do të jenë në proces zgjedhor deri në verë të vitit 2019.

Problemi me rritjen e partive të djathta ekstreme dhe kriza me emigrantët, kriza politike në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Brexit-i në Britani të Madhe, të gjitha këto kanë bërë që shtetet të cilat e kanë përkrahur Kosovën të kenë vëmendjen e tyre te problemet e veta dhe jo te Kosova.

Gjermania është shteti më i fuqishëm i Bashkimit Evropian, e cila e ka përkrahur dhe vazhdon ta përkrahë Kosovën, ka dalë kundër iniciativës së presidentit dhe shërbëtorëve të tij.

Britania ka qëndrim kundër marrëveshjes që këta deputetë e presidenti po e shtojnë me kaq vullnet.

Më falni, harrova se e lashë pa e përmendur, ata të cilët po ju përkrahin, e a e dini kush po ju përkrah, Putini dhe Vuçiqi, po edhe Federika Mogerini, CV-ja e së cilës varet nga marrëveshja Kosovë-Serbi.

Këto janë pra disa arsye pse nuk duhet të ngutemi. Siç ju treguam për liberalizimin e vizave që nuk do të ndodhë as në vitin 2019, ju treguam edhe për faljen e 2800 hektarëve tokë, po ju themi edhe tani se ky president dhe këta shërbëtorët e tij po punojnë kundër Republikës së Kosovës.

Prandaj, ky projektligj nuk duhet të votohet. Presidenti dhe i ashtuquajti Delegacioni Shtetëror duhet të ndalen.

Qytetarët e Republikës,

Nga sot duhet ta dini që listës së tradhtarëve të këtij vendi po i shtohen emra të rinj, e ne i dimë, por gjeneratat e reja do t'i mësojnë nga historia. Faleminderit!

**KRYETARI: Faleminderit! Daut Haradinaj, urdhëro!**

**DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!**

Po mundohem të jem i shkurtër, shumica e debatit u orientua në forma personale dhe shumë pak është duke u folur në temë, për të cilën është ky debat. Në kuptimin e drejtë, ne jemi duke folur për ligjin.

Përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror, po dëgjoj që nuk ka mandat ose nuk i kanë dhënë besim Delegacionit shtetëror, këtu është votuar, pikërisht në Kuvendin e Kosovës është votuar edhe i është ruajtur edhe e drejta e opozitës që të jetë pjesë e këtij ekipi.

Por, unë pse e mora fjalën, unë mendoj që sot e arritura më e suksesshme mendoj në këtë legjislaturë është sot e PSD-së, pikërisht për shkak se kanë arritur qoftë për pakon e ligjeve që i patëm, qoftë për Ligjin për delegacionin, qoftë që janë bërë pjesë e përgjegjësive në Delegacionin shtetëror dhe kur e dimë që ky dialog nuk është duke u bërë mes vetëm Kosovës dhe Serbisë, por është duke u bërë edhe Perëndim e Lindje, këtë duhet ta dini, e për këtë arsye do të ishte shumë e udhës që të jenë edhe LDK-ja, edhe VV-ja pjesë e këtij delegacioni, sepse nuk do të vendoset për këtë koalicion ose për këtë Qeveri, po do të vendoset për Republikën e Kosovës.

Në rast se ne jemi unikë, atëherë jam i bindur që edhe sukcesi nuk do të mungojë nga ana e këtij delegacioni.

Po desha të them edhe diçka. Nuk po diskutohet këtu a jemi pro a kundër shkëmbimit të territoreve, e që po dëgjoj nga pak që disa deputetë të opozitës po flirtojnë edhe me presidentin, e po negociojnë.

Nuk e dëgjova këtu a janë kundër a pro heqjes së taksës. Nuk e dëgjova këtu a janë pro dialogut a janë kundër dialogut dhe sa për atë se kush i kujt është i Putinit, me keqardhje e them po është

e pandershme t'i thuhet dikujt sot në këtë Parlament, në këto institucione që ne një farë forme u shërbejmë politikave të Vuçiqit ose të Putinit, është gabim dhe mendoj që po koriteni.

Ndërsa më tregoi edhe Hajdar Beqa kush ishte SHIK këtu, boll shumë ishit, gjysma e Parlamentit ishin SHIK, marrja e Zotit. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë, urdhëro!

HAJDAR BEQA: Kryetar, sa i përket SHIK-ut, po më duket ka këtu...

KRYETARI: Jo për atë punë nuk të bjen ty të flasësh, jo, jo.

HAJDAR BEQA: Dauti tha, Dauti e përmendi.

KRYETARI: Le, mos hy aty!

HAJDAR BEQA: Po më duket ka këtu që kanë qenë e nuk e dinë që kanë qenë. Faleminderit!

KRYETARI: Ka tjerë që flasin, këqyr aty edhe brenda klubit atje. Po bëjmë shaka nga pak, të kthehemi në temë, ju kisha lutur.

Sali Zyba, janë edhe Dardan Sejdiu, vetëm prej deputetëve të lajmëruar, të keni parasys.

SALIH ZYBA: Të dashur qytetarë,

Të nderuar të pranishëm,

Draftligjin e paraqiti ministri Hoxhaj, thuhet se ligji është i PSD-së, ndërsa në fakt, është ligj i Hashim Thaçit dhe për Hashim Thaçin.

Dukagjin Gorani tha se PSD-ja e propozoi dhe e hartoi këtë draft, Enver Hoxhaj, sikurse edhe Dukagjin Gorani, të dytë pjesë të këtij delegacioni, Enver Hoxhaj tha sikurse që e përmendën disa kolegë tha, merrne, hidhne në shportë nëse doni dhe e fillojmë prej fillimit.

Ndërsa Visar Ymeri më shumë se dy herë, me gjasë, e përmendi se propozimi i rezolutës së PSD-së që ka ardhur në korrik i ka pasur 2/3. Ia rikujtojmë ose duhet të deklarojë vetë Visar Ymeri arsyen pse e ka tërhequr atë rezolutë që e ka propozuar në formën që ka qenë, ndërsa sikurse ky ligj, edhe ajo rezolutë e kaluar që i ka paraprirë këtij ligj është rezolutë për Hashim Thaçin dhe për negociatat.

Ky draftligj, për të cilën do të flas shumë pak për të, edhe është i kotë, po përveç që është i kotë, është shumë i rrezikshëm, aq sa është i kotë, më shumë është i rrezikshëm.



Po kaloj shumë shkurt për të, e kanë përmendur shumë kolegë, por po e përmend edhe unë shumë shkurtë.

Te neni 1, për fushëveprimtarinë e ligjit për të cilin u tha se ky ligj e ka statusin e “lex speciales”, pra ky ligj u mbivendoset të gjitha ligjeve të tjera.

Te neni 4, procedurat për ngritjen e Delegacionit shtetëror, ku thuhet “Delegacioni shtetëror për dialogun me Republikën e Serbisë do të mandatohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës”.

Ky delegacion ka bërë së paku dy takime, prandaj nuk mund të parashikohej që përmes këtij ligji në këtë formë të thuhet kështu.

Në nenin 5, pika 1, “Delegacioni shtetëror përbëhet nga 11 anëtarë”, jo rastësisht në shkronja është njëmbëdhjetë anëtarë, ndërsa në numër 12 anëtarë. Nëse e shohim pikën katër, për të cilën këtij të njëjtit, e lexoj, ku thotë se “pjesë e Delegacionit Shtetëror do të jetë edhe një përfaqësues nga shoqëria civile, e cila do të jetë anëtare e rregullt e Delegacionit Shtetëror. Përfaqësuesi i shoqërisë civile do të emërohen nga Delegacioni shtetëror”. Të keni parasysh fjalën “do të emërohet”, jo do të pranohet, mirëpritet, zgjidhet e në forma të tjera, po “do të emërohet”.

E veçanta e këtij ligji është pika 3. Po e lexoj së pari për të mundur të bëhet një diskutim rreth kësaj pike. “Delegacioni shtetëror bashkëdrejtohet barabartë prej dy përfaqësuesve në këtë rast, njëri nga radhët e opozitës, ndërsa tjetri nga radhët e pozitës ose qeverisjes”.

Të keni parasysh diçka, 2-3 ditë para se të vijë ky ligj në votim, njëri nga bashkëdrejtuesit, në këtë rast Shpend Ahmeti, i cili është bashkëdrejtues, e paralajmëroi mundësinë e tërheqjes, në një emision, mundësinë e tërheqjes, tha në rast se fillojnë të vijnë letrat në mënyrën qysh kanë ardhur deri tash. Këtu, ju lutem, sidomos për PSD-në është më se e rëndësishme arsyeja pse e ka paralajmëruar Shpend Ahmeti. Sepse e ka kuptuar që hapi i parë i radhës në mënyrën qysh e ka pranuar këtë bashkëpunim është forma që sikur disa të tjerë presidenti Thaçi sikur limonin e shtrydhtë do të shfrytëzojë dhe do ta hedhë Shpend Ahmetin. Nëse e shohim arsyen, sepse nëse e shohim nenin 10, po e lexoj, e keni lexuar, por po e ndiej obligim ta lexoj, ku thotë, pika 2: “Delegacionin shtetëror nuk mund ta udhëheqë ose ta përfaqësojë vetëm njëri nga bashkëdrejtuesit”, domethënë këtu e ka kuptuar Shpend Ahmeti, sepse për sa të qëndrojë ky delegacion në raport me bisedimet me Serbinë, i njëjti do të jetë vetëm opozitë. Andaj, e ka kuptuar këtu një lojë.

Do të jem i shkurtër, se e shoh vetëm si një kontribut, po kaloj shumë të tjerë që i kam nënvizuar për të folur, po e shoh shumë të nevojshme një gjë, te neni 19, në fakt, është pjesë e dispozitave përfundimtare, po te hyrja në fuqi kontributin që e jap unë tash në veçanti është nëse e plotësojmë këtë ligj me një shpjegim përmbajtje të shkurtër, me një propozim që e kam shumë

konkret, ku thotë se ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare. Propozimi im është që të thuhet kështu: “Ky ligj hyn në fuqi 15 vjet...”, për faktin se shpresoj që ky president dhe ky delegacion nuk do të jenë në momentet kur do të duhej të hyjë në fuqi. Në të kundërtën, ky ligj nuk do duhej të vinte fare në votim, ndërsa sa u përket atyre që kanë dalë prej Lëvizjes Vetëvendosje, e që kanë ndryshuar, ua kujtoj një aktivitet, një gjest, sepse në këtë rast Dardan Molliqaj kërcënoi me aktivitete qofshin ato simbolike, duke e ditur që ata që kanë dalë prej Lëvizjes Vetëvendosje kanë hequr dorë prej aktiviteteve, qofshin edhe simbolike, e sidomos prej demonstratave e protestave. Jua rikujtoj se Hashim Thaçi në kohën kur Lëvizja Vetëvendosje, pjesë e të cilës ishin edhe vetë këta, në aksione, protesta, në demonstratën shumë të rëndësishme që ka qenë atëherë, më 10 shkurt, në të cilën ka pasur edhe të vrarë, tash të vijë Ligji për delegacionin, ligje për të cilat nuk do duhej të ekzistonin, sepse e shihni që qeveritë vijnë e shkojnë, Dardan, të lutem, nëse ka qenë arsyeja monetare pse keni dalë prej Lëvizjes, sikur që e thanë disa prej kolegëve këtu dikush tjetër, të lutem, ta kesh parasysh që edhe ato obligime duhet t’i ktheni, sepse deklarimi ose arsyeja juaj është që keni hequr dorë prej aktiviteteve, sikur që ka pasur ose që mbetet Lëvizja Vetëvendosje. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Replikë, Dardan Molliqaj.

**DARDAN MOLLIQAJ:** Faleminderit! S’di pse po të mendojnë, Sali, se s’është mirë të të mendojnë, të shtinë të flasësh e tani të mos mund t’i thuash ato që po të thonë, kështu që mos i jep zor, se e di, edhe në këto protestat e fundit gati asnjëri prej juve këtu s’ka qenë në burg. Kur është zgjedhur Hashim Thaçi president disa prej neve kanë qenë në burg, disa të tjerë kanë qenë duke shëtitur nëpër Prishtinë, i keni gjuajtur nja dy molotova, keni shkuar në shtëpi ia keni futur gjumë. Kështu që leni këto punë, leni këtë muhabet, kryejeni këtë muhabet, s’po mund ta tejkaloni, mbylleni ose pastaj secilën herë më rëndë e më rëndë po duhet, se s’po di njeriu qysh të flasë me juve. Unë ju them lene, ju vazhdoni. E, nëse po doni të flisni për para, hajde folim edhe për para, a po doni? Veç thoni po duam të flasim për para dhe për Devollt, po flasim. Se keni qenë në mbledhje aty dhe e dini shumë mirë, secili prej juve këtu, kështu që mosni, lene këtë muhabet, flisni për politika dhe jemi në rregull, vazhdojmë përpara, grahni punës.

**KRYETARI:** Kundër-replikë!

**SALI ZYBA:** Ju lutem për një vëmendje, kështu i njëjti parafolësi im, i njëjti ka qenë sekretar i organizatës tonë, unë kur flas për këtë temë, flas i shqetësuar, jo pse më ka thënë dikush ose më ka mësuar dikush, po Dardani i keqpërdorur edhe ndjenjat dhe shqetësimin tonë të vazhdueshëm për këtë punë. I njëjti në vazhdimësi po kërcënon me çka po di unë, incizime, pamje a diçka. Kini parasysh, edhe sa ka qenë, pa qenë deputet, i njëjti ka pasur rrogën e njëjtë, të përafërt me deputetin, ndërsa i njëjti e ka keqpërdorur pozitën tonë në organizatë, e ka keqpërdorur arkivin tonë, me të cilin me të njëjtin po shantazhin, po i njëjti nuk ka çka thotë. Kam qenë pjesë e

strukturës dhe e organizatës tonë me krenari, andaj lutem, Dardan, nëse ke diçka, kurdo jo vetëm për mua, por për secilin prej neve...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYETARI:** Faleminderit! Dardan Sejdiu është deputeti i fundit që e ka kërkuar fjalën.

**DARDAN SEJDIU:** Faleminderit, kryetar! Do të mundohem të jem sa më i përpiktë, besoj edhe sa më konciz në atë që do të them.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot, me këto ligje, edhe atë për paga, edhe për Administratën Shtetërore, edhe për ligjin sot për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, i kemi shkaktuar çarje rendit simbolik të pushtetit. Pra, e kemi mbushur me përmbajtje dhe nëse deri më tash kemi pasur një Administratë Shtetërore, e një Ligj për pagat s'kemi pasur fare, tash kemi vendosur sistem. Në këtë sistem nuk ka më vendime elektorale, por ka vendime, të cilat merren me sektorë strategjikë. E njëjta po përsëritet dhe po e shtyjme tutje me Ligjin për dialog, që po i thonë, po është për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit shtetëror.

Sot, të nderuar deputetë, po votojmë për një ligj, i cili e kthen dialogun në binarë të duhur, në Kuvend, i definon kompetencat, i definon përgjegjësitë, detyrat e secilit prej neve deputetëve, secilit prej institucioneve në vend dhe mënyrën e vendimmarrjes edhe në delegacion, edhe në komisione, edhe nga institucionet e tjera me të cilat koordinohet Kuvendi, ky delegacion, e pra mundohemi të ndërtojmë një zë, i cili në këtë përballjen me Republikën e Serbisë nuk mund të bëhet më në mënyrë të monopolizuar. Pra, nuk mundet një person, kushdo qoftë, ai pa Delegacion shtetëror dhe nuk mundet pa Kuvend. Në anën tjetër, është gjithashtu tepër me rëndësi, e që besoj që secili prej nesh duhet ta ketë parasysh që ky ligj e krijon një komision, i cili udhëhiqet nga opozita, komision mbikëqyrës, komision në të cilin raportohet, ndërton komisione funksionale për të mbushur me përmbajtje Delegacionin shtetëror pasi të ndërtohet platforma, e cila është obligim nga ky ligj dhe në këtë mënyrë, përsëri e bëjmë një çarje të madhe në mes të diskutimeve të kota mbi, të themi protagonizma, të ndryshme dhe një përmbajtje që mund delegacioni ta sjellë në Kuvend, e Kuvendi ta mbikëqyrë me mekanizmat që po ndërtohen me këtë ligj.

Rrjedhimisht, të nderuar deputetë, në fakt, janë dy rrugë: një rrugë është pjesëmarrje e përmbajtje, një rrugë tjetër është, besoj ta lëmë si është. Duke e lënë si është, nuk ka as kontroll, as mbikëqyrje, e as imput në përmbajtjen e në platformën, e cila duhet të vijë në Kuvend. E kështu atëherë nuk jemi duke i bërë detyrat tona si deputetë, atëherë kështu po e lejojmë që të vazhdojë në rrugën e cila na ka sjellë deri këtu, e kundërta është ligji, kompetencat e definuara,

detyrat e definuara, përgjegjësitë e definuara, mekanizmat e definuar në Ligjin për dialog. Rrjedhimisht, besoj që duke e votuar këtë ligj, ashtu sikurse me Ligjin për Administratën Shtetërore, ashtu sikurse me Ligjin për paga, vendosim binarë në të cilat secili prej nesh si deputet mund të vendosë të marrë përgjegjësi me pjesëmarrje apo përgjegjësi në mospjesëmarrje, sepse edhe aty ka përgjegjësi, edhe në mospjesëmarrje ka përgjegjësi.

Kështu që këtu, ky është vendimi dhe rrjedhimisht, meqë këtë ligj e kemi draftuar ne, përkatësisht disa deputetë të Partisë Socialdemokrate, kërkoj nga deputetët e Kuvendit që ta votojnë dhe që të ndërtojmë një strukturë, me të cilën mund së bashku të përballemi në këtë dialog me Republikën e Serbisë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Armend Zemaj e ka fjalën, edhe po e shoh Xhelal Sveçlën.

**ARMEND ZEMAJ:** Faleminderit!

Kolegë deputetë, e di që pak është vonë, edhe në emër të Grupit Parlamentar saktë dhe qartë u prezantua qëndrimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, që të mos e përsëris edhe atë çka thanë kolegët deputetë, edhe në aspektin individual, unë e kam një lutje kështu kolegjiale, se ne po debatojmë dhe sigurisht që edhe ky ligj i propozuar nga mazhoranca, me atë pjesën plus, që e quajta edhe një ditë tjetër, normalisht që duhet të arsyetohet në njëfarë forme. Por, ju kisha lutur që interpretimin kushtetues mos e bëni, është një organ tjetër ai që e bën interpretimin kushtetues dhe t'u thuhet deputetëve të Kuvendit të Kosovës se ky ligj ia përcakton detyrat secilit deputet, është e padrejtë dhe është e pandershme. Detyrat na i ka caktuar Kushtetuta, mandatin na e ka dhënë populli, qytetari i Republikës së Kosovës dhe punën tonë e bëjmë sipas Rregullores së Punës së Kuvendit.

Atë që ju po e bëni me këtë ligj jeni duke ndërhyrë direkt në pavarësinë kushtetuese të institucioneve në Republikën e Kosovës. Pse po e them këtë? Edhe ju e dini, edhe ne e dimë, edhe të gjithë e dinë që deputeti nuk mund të kryejë detyra qeveritare. Çdo njëri këtu e di që pushteti lokal nuk mund të ketë edhe pushtet ekzekutiv, e keni vendosur një kryetar komune në detyrat qeveritare, apo po tentoni ta vendosni. Nuk mund të na shitni këtë si Delegacion shtetëror, nuk mund të thoni se është ligj special, sepse edhe këtu e keni huqur bazën kushtetuese dhe, për këtë arsye votojeni ashtu siç ju e dini që do ta implementoni, por mos na thoni që ky ligj neve na i cakton detyrat apo na lë anash nga detyrat, përdorni arsye të tjera, përdorni arsye të momentumit, të faktit politik çfarë koalicioni keni, votat shpeshë çfarë i merrni dhe implikime të tjera politike se si ju dëshironi t'i menaxhoni. Kjo është ajo që e pata për obligim ta them dhe, e dyta, fyerjet dhe adresimet në mungesë të fakteve, sidomos gjuha e ulët që përdoret duke u munduar që të arsyetojnë disa veprime apo, t'i quaj ata që shpeshherë brenda ditës u bien pishman veprimeve të tyre, të mos i adresohen Lidhjes Demokratike të Kosovës.

**KRYETARI:** Xhelal Sveçla e ka fjalën.

XHELAL SVEÇLA: Faleminderit, kryetar! U tha prej shumë parafolësve se sa i dobët është ky ligj, po unë po dua t'i theksoj disa, të cilat i kam vërejtur unë, e ndoshta edhe mund të përsëritem.

Tek neni 5, u vërejt që në fillim diferenca midis numrit në shkronja dhe numrit 12 në kllapa, e pastaj u mor vesh që është realisht 12 anëtarë. Por, në të njëjtën pikë, pak më poshtë po thuhet se diferenca e përgjithshme e anëtarëve në proporcion Qeveri-opozitë në kuadër të delegacionit nuk mund të jetë më shumë se 2 anëtarë të Delegacionit shtetëror, e na u tha që përbërja do të jetë 7 pozitë, 4 opozitë dhe 1 do të jetë i shoqërisë civile. 7 dhe 4 diferencën e kanë 3 e nuk e kanë 2. Po ashtu, na u tha që qenkan 2 prej 7 të pozitës, të minoritetit boshnjak dhe turk, kurse fare nuk u fol për minoritetin serb, a e kanë planifikuar që qytetarët serbë të Kosovës t'i qesin në anën tjetër të tavolinës, apo si kanë menduar ta bëjnë këtë dialog, nuk e di.

Është me të vërtetë e çuditshme se si kërkohet që ky delegacion apo ky ligj që mbulon punën e këtij delegacioni të votohet me 31 vota, kurse delegacioni të shkarkohet me 61 vota. Do të thotë, aq shumë po e lakmojnë emërimin, e po i frikësohen pastaj shkarkimit, kjo është e çuditshme. Te neni 5, pika 8 thotë: “Delegacioni shtetëror mund të shkarkohet, prapë po them me 61 vota kur evidentohen shkelje të procedurave të vendosura me këtë ligj”. Do të thotë, këta mund ta thyejnë edhe ligjin, përderisa ne nuk mund t'i arrijmë 61 vota për t'i shkarkuar, e vendosin veten edhe mbi ligj. Tek çështja e opozitës tashmë është e ditur se vetëm një subjekt “opozitar” është i kyçur në këtë proces. I bie që këta do të kenë një kryesues dhe tre anëtarë të tjerë të delegacionit, plus 50% të drejtuesve të komisioneve punuese, plus kryetarin e Komisionit ad hoc, si dhe një anëtar të Komisionit ad hoc dhe në këtë sekretariatit disa të tjerë. Çështja është, po më duket se këta me këtë aktivitet po duan me të vërtetë ta zbrazin autobusin.

Tek çështjet apo dokumentacioni me të cilin ky delegacion do të punojë, flitet për sekret zyrtar. Me këtë iu kufizohet qasja ndaj informatave dhe këtyre dokumentacioneve vetëm atyre që kanë certifikatë të sigurisë, në bazë të Ligjit për qasje në dokumente zyrtare. A thua kush e ka kaluar verifikimin e sigurisë nga deputetët, pasi që sipas ligjit, vetëm kryetari, kryeministri dhe kryeparlamentari nuk kanë nevojë për certifikatë të sigurisë për t'iu qasur dokumenteve të klasifikuara si zyrtare. Me kaq kjo nënkupton edhe gatishmërinë për të kyçur të tjerët në këtë proces apo për të informuar drejt këtë Kuvend. Me 5 faqe ligj kaq të dobët, nuk mund të kamuflohen faktet se PSD-ja po e bën për interesa të mbijetesës politike, e po i bashkohet një koalicioni të një qeverie të dështuar, me qindra skandale që së bashku po tentojnë ta heqin Hashim Thaçin prej izolimit popullor, në të cilën pak më herët ndodhej dhe persekutimit potencial ligjor ndërkombëtar. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Fjalën e ka kryetari i Kuvendit, zoti Kadri Veseli.

KRYETARI KADRI VESELI: Mirëmbërëma të gjithëve, kolegë deputetë, e di që jeni lodhur, ju falënderoj shumë për kontributin, punën e jashtëzakonshme. Edhe ky debat në këto orë të vona, edhe pse shpeshherë i rëndë, besoj se do t'i shërbejë interesit dhe transparencës, të cilën e kemi para qytetarëve të vendit tonë.

E kam parë nga përvoja ime këto vitet e fundit çdoherë sa herë i marrim gjërat seriozisht dhe orientohemi drejtpërdrejt për përgjegjësitë që na takojnë, që janë qytetare, kombëtare, jemi më seriozë. Do të jem shumë i drejtpërdrejtë, kur fillon ai rebelizmi, në gjuhën popullore po më vjen keq ta them, ai virusi, s'po e them prapë në gjuhën popullore se më ndryshe, kur na rrokë sherri mundohemi ta shkatërrojmë krejt njëri-tjetrin, po të mundemi nuk e lëmë as të marrë frymë aty për aty. Kjo nuk besoj që ka për ta dëmtuar tjetër kënd më shumë se sa vetë neve dhe këtë vend, të cilin e përfaqësojmë ne. Ne sonte kemi një temë debati, i kaluam disa ligje të reformës, të Administratës Publike që për dy dekada kanë qenë në pritje, është shumë me rëndësi historike, por sonte kemi pjesë të debatit edhe këtë dialogun. Ka që nja 9 muaj aq shumë na ka marrë energji, edhe s'ka mbetur kush prej neve njëri-tjetrin duke mos e quajtur 'i ligë' a 'tradhtar', fjalët më të rënda të mundshme, as nuk përzgjedhen dhe, më duket, sikur që po e kundërshtojmë pavarësinë e shtetit, po u munduam të hulumtojmë nëpër ndonjë arkiv prej Bizantit, Stambollit dhe këtyre të Beogradit, s'di a kishim mundur ta damkosim njëri-tjetrin më shumë.

Unë po e them këtë, ne duhet të marrim një vendim, nuk është çështja e dialogut si dëshirë, rotacioni i pushteteve do të ndodhë, por gjendjen në Kosovë, të cilën e kemi si situatë reale, unë nuk e besoj që vetëm përmes karrigeve që i ndërrojnë mes vete do të na ndërrojë gjendja reale. Për 19 vjet, i 20-i vit, tani këtë vit ne do ta kremtojmë çlirimin e vendit tonë. Kemi një situatë reale në vendin tonë, kemi arritur progres, sukses, liri, e kemi shpallur shtetin, po ne e kemi një situatë, e cila është reale. Kemi do probleme kur agresioni i Serbisë është bukur demonstrues në shumë pjesë të atdheut tonë, për fat të keq. Dikush mund të thotë po të kishim qenë më burra i kishim kryer, po të ishin më burra ata në të '99-ën e kishin kryer, ose në 2008-ën, 2018-ën, por kjo është situata, këta çka jemi, kjo është situata reale. Në të njëjtën kohë, gjithmonë po flas për dialogun, ka një situatë shumë reale dhe qëndrim të bashkësisë ndërkombëtare, të cilin çdonjëri prej neve e kam vërejtur, për fat të mirë, po nganjëherë edhe për manipulim, e kanë marrë vesh edhe ndërkombëtarët, çdoherë thërrasim për partneritet me bashkësinë ndërkombëtare. Ne e kemi plot fjalën, plot gojën SHBA, ia nisim me SHBA, dalim te gjermani, te anglezi, italianin e francezin, pastaj varet, po sido që të jetë, edhe ata kanë një qëndrim, i cili është bukur i vendosur, nuk ka të partive politike, lider në Kosovë, pozitë e opozitë, që nuk na kanë thënë, ju duhet të futeni në këtë proces, nuk është dëshirë jona, e kurrkujt, të shkojmë e të takohemi, nuk e besoj që ka njeri që ka qejf aq fort, aq shumë, s'dua ta fyej, po ka qenë zëdhënës i politikës së Milosheviqit Aleksandër Vuçiqi. Po tenton të moderohet, është bërë njëfarë perfidi, ka krijuar, duhet pasur parasysh, ka krijuar një avantazh, një avantazh bile që nja 1 vit, e ka marrë shumë si i moderuar, për herë të parë pas tri dekadave ne nuk jemi për dialog. Ne nuk po e dimë, besa, as vetë, se as për luftë nuk jemi, por nuk po e dimë për çka jemi.

Si do të jetë tash në këtë situatë, një pjesë prej neve e ka marrë një vendim që është mirë të hyjmë në këtë proces të dialogut. Më e mira do të ishte të jemi të gjithë bashkë, pozitivë dhe opozitë, bashkërisht ta ndërtojmë një platformë, një qëndrim, përmes të cilës ne ishim ballafaquar me këtë agresionin e Serbisë, s'e kishim dëmtuar shumë njëri-tjetrin. Sido që të jetë, kjo është situata në të cilën jemi edhe sonte. Krejt debati ishte në vend se të përgatitemi për hapat e të forcohet ky delegacion të marrë përgjegjësi, ne prapë u munduam ta damkosim njëri-tjetrin. Jemi duke i frikësuar qytetarët, s'jemi duke lënë trima në Kosovë, s'jemi duke lënë të pasur në Kosovë, jemi duke i frikësuar në aspektin, edhe agresioni i Serbisë për pjesën veriore, më konkretisht. Çka u fol këta nëntë muaj që po shitet Kosova, që po i jepet një pjesë, Presidenti i vendit, imagjinojeni Presidenti i vendit, të gjithë jemi me njëri-tjetrin, e dimë edhe të djeshmen edhe të sotshmen, që po ia jep Serbisë, se ka zor, se krejt ata që janë qyqarë kurrkund mendjen s'e kam veç çka tutën vetë. Nuk kishin mundur të fënë natën po të ishin luftëtarë të UÇK-së se po i ndjek Gjykata Speciale. Po mos u bëni, more, qyqarë, se kurrkujt s'i bën për atë punë. Ai që ka qenë luftëtar, nuk mërzhitet, e di pse ka luftuar...

Çka keni? A po mendoni që dikush prej neve tutet prej asaj pune, a? Marre ju qoftë kush mendon. Shkoni denonconi çka të doni, prej ditës së parë kam qenë në UÇK. Nuk di kur s'kam qenë, çdo kund kam luftuar ku ka qenë kërkesë e kombit tim, aty kam qenë. Edhe jam krenar për atë histori, edhe i përgjigjemi çdo sekonde të historisë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, e besoj kështu e bën edhe Presidenti i vendit. Mosni se po e teproni, a e dini se ka prind, a e dini se ka fëmijë, a e dini se po gaboni. Po nesër të dalë që jeni gabim. Marre! Turp! Leni mundësi, lëruni mundësi të gjithëve le ta kenë një propozim edhe le të mundohen, të ndikojnë me patriotizëm për kombin e vet.

Pastaj, në fund, mesazhi është ky për qytetarët. O qytetarë të vendit tim, s'ka për të mbetur nga kjo botë, s'ka për të mundur të dalë askush ose me krenarinë ose me marren që e ka. Po vendimmarrja ndaj këtij procesi që lidhet me dialogun, që lidhet me të ardhmen e vendit tënd, ke për ta vendosur ti vetë, ka për ta vendosur qytetari çdo vendimmarrje. Le të shkojë në delegacion kush të dojë, le të flasë çfarë të dojë, e ka për obligim që të vijë në mënyrë transparente të tregojë çfarë bisedohet këtu. Do ta vendosë dy e treta e këtij Kuvendi. Në qoftë se s'janë të mjaftueshme, unë besoj që s'është e mjaftueshme, pse nuk shkojmë edhe në referendum. Shkojmë në referendum. Mos e frikësoni popullin, se populli është më trim se ne. Edhe është më i mençur se ne. Lejoni mundësi, edhe sonte do të ishte mirë po të ishim bashkë opozitë e nderuar. Ka qenë mirë të ishim bashkë për vendin.

Për neve, për politikë, quana çka të doni, fyena sa të doni, pak ka rëndësi, veçse ne e kemi një kundërshtar veç të Kosovës, ajo është Serbia dhe aktualisht një perfid i cili është, i ka promovuar politikat e gjenocidit mbi shqiptarët e ai është presidenti aktual Aleksandër Vuçiqi. Kjo është kundërshtar. Nuk shoh te asnjë prej juve kundërshtar. Ju shikoj ndonjëherë, mund t'ju respektoj,

mund edhe të mos pajtohem me mendimin e juaj, po ju e përfaqësoni edhe vullnetin e qytetarëve. Secili e përfaqëson vullnetin e vet. Kështu që kisha pasur dëshirë që pas natës së sontme, çka do që të merret vendimi, mirë nuk është. Borxh askush ku ia ka askujt t'ia fyejë gjenin, t'ia fyejë familjen, t'ia fyejë veprimtarinë, për arsye se ka diçka. Populli ynë e ka një fjalë, dy duar janë për një krye. Duhet ruajtur secili identitetin, dinjitetin dhe krenarinë e vet. Kur vjen puna për aty, pastaj po detyrohesh nganjëherë të skuqesh që t'u kërkosh falje qytetarëve, se ata që provokojnë si manipulojnë edhe si krijojnë situata që paqena fare hiç.

Edhe një herë ne po shkojmë në votim, mirë ka qenë të jemi bashkë, po sido që të jetë, të ndarë kemi për të qenë më të dobët, mbajeni në mend, Serbia ka për të përfituar, e asnjë prej partive tona politike këtu, kushdo që është sot në pushtet, ose nesër në pushtet edhe anasjelltas opozitë. Faleminderit shumë!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Replikë, z. Kurti a? Ok, replikë, pastaj Kujtim Shala e ka fjalën.

**ALBIN KURTI:** Së pari, megjithatë mendoj që është e rëndësishme që të sqarohen disa dilema. Meqenëse paska qenë kryetari i Kuvendit bashkëluftëtar i Presidentit, pse ai ka deklaruar për Euronews që ka qenë larg vijave të frontit? A është e vërtetë kjo? Pse ai ka deklaruar? Nga cili pozicion i trimërisë vjen një deklaratë e tillë? E para. E dyta, ne mund të bëjmë konsensus këtu në Kuvendin e Kosovës, po mund të bëjmë konsensus për kërkesat ndaj Serbisë. Pse ne nuk ulemi bashkë për t'i shkruar diku dhjetë kërkesa Serbisë si Kuvend, si Qeveri dhe t'i tregojmë asaj që si borxhliu më i madh i shqiptarëve dhe i Kosovës, këto janë ato që duhet të na dëmshpërblejë, reparacioni, sukcesioni, të pagjeturit. Pse ne s'po ia kërkojmë borxhin Serbisë? Pse po hyjmë në dialog pa ia kërkuar borxhin njëherë? Unë besoj që edhe LDK-ja, edhe PDK-ja, edhe ne, të gjitha partitë që janë në Kuvendin e Kosovës mund të arrijnë konsensus mbi kërkesat tona ndaj Serbisë. Njohja e pavarësisë së Kosovës, reciprociteti, suksesioni, reparacioni, të pagjeturit, plaçkitja e fondit të kursimeve pensionale, artefaktet kulturore, depozitat bankare. Le ta arrijmë aty konsensusin. A sa për Presidentin, ai ka thënë që ka qenë larg vijave të frontit. Ju këtë gjë e dini. Pse ka deklaruar që ka qenë larg vijave të frontit, ndërkaq Jeta Xharra kur e ka intervistuar në një emision i thotë komandant Gjarpri, jo thotë s'kam qenë unë komandant, drejtor i Drejtorisë Politike, pjesa ushtarake është tjetër. Pse i tha këto? Nga çfarë trimërie jep deklaratatë të tilla?

**KRYETARI:** Dhashtë Zoti mos të ketë më kurrë luftë në Kosovë, por në qoftë se do të ketë, jam shumë i sigurt që përkrah atij, unë e ai përkrah meje do të jemi prapë ndër të parët që të shkojmë e të japim jetën. Ishalla s'vjen kurrë, por ajo çka është kryesore, është mirë që të jemi bashkë, t'iu përgjigjemi qytetarëve, e jo as Presidentit, as Kryetarit të Kuvendit, as Kryeministrit, por veç qytetarëve, se ai është sovrani për neve. Kjo është. Çka do të thosha, sido që të jetë secili e mban mendimin për vete. Faleminderit nënkryetar, se e pash, po urdhëro!



KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Në këtë fjalë timen të vonë duhet të bëjë disa referenca, jo pse dëshiroj, po sepse është e domosdoshme sepse ka qenë një ditë e gjatë dhe me fjalë ose paraqitje shumë të rëndësishme.

Zoti kryetar, më duket që kjo çështje, d.m.th. procesi i dialogimit, procesi i Brukselit, procesi në të cilin ne dialogojmë me Serbinë nuk është çështje biografish dhe nuk duhet të shtrohet si çështje biografish. Kjo është çështje funksionesh dhe çështje e përfaqësimit. Nëse kthehet në çështje të biografisë, unë kam frikën që do të krijojmë situata të cilat janë tepër të rrezikshme, sepse në ato ne do të merremi me biografitë tona dhe jo me procesin i cili shkon përtej kësaj.

Tani pse është e rëndësishme kjo? Sepse funksionet nënkuptojnë institucione të shtetit e që s'kanë të bëjnë me fatet e personave, qoftë edhe mëkatet e personave të cilët i drejtojnë institucionet. Kjo është thelbësore dhe brenda këtij koncepti që vërtet është koncepti i rregullimi kushtetues dhe politik të Kosovës, duhet të shihni edhe qëndrimin e opozitës dhe funksionin e opozitës dhe ekzistencën e saj si kategori, d.m.th. funksionin e saj. Ju po kërkoni që të jemi bashkë, po ne bashkë jemi. Çështja është se për disa probleme mendojmë ndryshe. Ju po kërkoni që ne të kemi një konsensus. Po s'mund të kemi konsensus sepse mendojmë ndryshe. Dhe ne jemi këtu që t'ju themi se mendojmë ndryshe. Nëse eliminohet një kategori e tillë që është thelbësore për shtetin tonë, do të bëhen jofunksionale dhe institucionet. Pse? Sepse do të kalojmë në rrafsh arbitraritetesh.

Tani ju keni sjellë një ligj, projektligj vërtet. Unë s'do ta diskutoj burimin. Ajo është çështje politike, është shumë e rëndësishme, por u diskutua shumë, nga disa pozicione, u mbrojt apo jo, është çështje tjetër. projektligjin e kemi përpara. Çka nënkupton kjo? Që ju do të vendosni me votë. D.m.th. shumica dhe duket se gjithçka është në rregull. Por këtu ka një problem. Shumica në rregullimet politike si ky i shtetit tonë, që të mos jetë arbitrare, ka kuptim kur ka mbështetje në Kushtetutë dhe në ligje. Ky ligj në esencë dhe si përmbajtje, në pika të rëndësishme, në nyjat themelore të tij është kundërkushtetues. Merreni nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shikojeni Ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare dhe do të kuptoni. Tani ju duke dashur që të zgjidhni situatën po e quani një 'lex specialis', që d.m.th. një ligj special. Nuk mund të miratojmë ligje speciale. Kuvendi s'mund të miratojë ligje speciale për çështje të cilat i rregullon Kushtetuta dhe këtë çështje e ka rregulluar Kushtetuta e Kosovës.

Politikisht po tentoni që të na bëni bashkë me anë të këtij Ligji. S'mund të bëhet kështu. Normat nuk vendosen që njerëzit të bëhen bashkë, por që t'i respektojnë. Po nëse unë kam qëndrim tjetër, detyrohem të respektoj normën, po unë prapë s'mund të mendoj si ju. Pse këto janë të rëndësishme, sepse pas këtij procesi ju do të ktheheni këtu dhe unë e kuptoj që institucionet si Kuvendi i Kosovës, qoftë kur inicion Qeveria diçka të tillë ose jo, miratojnë projektligje që i

kthejnë në ligje për t'i ratifikuar marrëveshjet, po jo ligje që të fillojnë procese, sepse ajo është një çështje totalisht e ndryshme.

Është biseduar shumë për funksionin dhe për angazhimet e Presidentit, edhe sot, edhe lidhur me biografinë. Në rregull, kur njerëzit janë gjatë në politikë, edhe biografia që është krejt personale përkthehet në politike. Unë megjithatë, abstenoj të flasë në këtë rrafsh. Po unë do të shpjegoj pak më ndryshe funksionin e Presidentit. Presidenti i Kosovës do të ishte si President për të tjerët, në funksion unifikues, që është simbolik dhe honorifik, dhe do të kthehej në një figurë të cilën do ta pranonin dhe do ta respektonin, do ta nderonin të gjithë për sjelljen në përputhje me Kushtetutën. Po pse Presidenti i Kosovës shkon përtej Kushtetutës? Në këtë rast, sepse këtë e lejon, ose këtë e mundëson Qeveria e Kosovës, që është Qeveri e një koalicioni. Kryeministri s'ka hequr dorë kot nga detyrat dhe përgjegjësia e tij kushtetuese. Kryeministrit i kërkohet dhe problemi është krejt tjetër, origjina është diku tjetër, është te përfaqësimi politik përbrenda koalicionit. E cili është ai problem, pak më shqip? Partia Demokratike e Kosovës përbrenda koalicionit. Dhe, kjo është mbështetja politike kryesore në këtë proces.

Tani, çfarë është diskutuar dhe çfarë s'është diskutuar, ne nuk e dimë, sepse s'kemi dokumente. Unë me hamendësime nuk mund të flas sepse jam përfaqësues politik, përfaqësues i qytetarëve dhe i një subjekti politik të cilin e respektojnë edhe kundërshtarët, ashtu siç i respektojmë edhe ne. Por ne patëm ofruar zgjidhjen që të jemi bashkë si opozitë. Një rezolutë të thjeshtë, një tekst të thjeshtë, për të cilin edhe ju shumica, d.m.th. anëtarët e koalicionit që qeveris vendin nuk kishit kurrfarë kundërshtimi. Dhe cila ishte kërkesa jonë? Që të mos negociohet territori, sovraniteti dhe karakteri unitar i shtetit tonë, kaq kishte. Ju të gjithë dëshmoni, betoheni se kjo s'do të ndodhë. Në rregull. Pse s'e bëmë atë? Ajo ka qenë dera ose hyrja që në këtë proces ne të jemi bashkë. Kjo nuk do të thotë që ne do të përfshiheshim në ekipe të kësaj natyre, edhe pse ekipi është formuar përpara, ligji vjen prapa, që s'ka asnjë logjikë elementare e asnjë logjikë juridike, prapëseprapë ne s'do t'i bashkoheshim ekipeve të tilla. Pse? Sepse ne na duhet të ruajmë një funksion themelor që e kemi; ne jemi opozita. S'kemi marrë besimin që të udhëheqim këto procese.

Por, ne kemi detyrim që të përpiqemi të korrektojmë dhe s'mund të korrektojmë nëse hyjmë, ose përfshihemi, ose iniciojmë mekanizma siç është ky ekip që s'kanë një bazë kushtetuese. Procesin duhet ta udhëheqin institucionet dhe ne duhet të diskutojmë këtu. D.m.th. në një institucion. S'mund të marrë këtë kompetencë Kuvendi i Kosovës me kurrfarë ligji. Pse? Sepse është legjislativ. Kjo është çështje politike, pastërtisht ekzekutive. Kuvendi mund ta kodifikojë në fund me votë ose jo. Nuk ka kompetencë tjetër në këtë rrafsh. Pse? Sepse është legjislativ. Prandaj, unë ju kërkoj që shumica të ketë mirëkuptim për funksionin që kemi ne si pakicë, d.m.th. për opozitën e vendit dhe të na dëgjojë me kujdes, sepse ato që themi ne janë të dobishme nëse kuptohen drejt. S'është shumë e rëndësishme kujt çfarë i pëlqen, sepse ne s'jemi për atë punë

këtu. Është shumë e rëndësishme nëse jemi të vërtetë dhe pranojemi ashtu siç jemi. Faleminderit!

**KRYETARI:** Enver Hoxhaj dhe nuk ka tjetër deputet.

**ENVER HOXHAJ:** Faleminderit, kryetar!

Unë nuk e pata ndërmend të flasë, por ju kam dëgjuar me vëmendje se kam qenë në Kuvend, ju dëgjova edhe tash. Shih, ne mund të flasim shumë gjatë dhe ma merr mendja që secili prej nesh mund ta ushtrojmë këtu edhe oratorinë, edhe dijen, edhe shkathhtësinë politike, po i tërë debati përmbledhet në dy fjalë, a ka besim mes forcave politike të mshelet çështja e shtetndërtimit të Kosovës, të kompletohet sovranitetin dhe a ka vullnet politik. Unë dhe disa kolegë në këtë ndërtesë jemi goxha do vite. Ju sot patët dilemë për një projektligj të cilin e ka iniciuar PSD-ja dhe është meritë e tyre dhe kanë bërë punë brilante. Atë Projektligj ne si Qeveri e kemi sjellë në Kuvend të Kosovës, por më lejo deputet Shala dhe miku im Kujtim, të kujtoj se vendi ku ulesh ti, unë kam qenë i ulur në vitin 2006 e 2007 dhe në vend ku ulem unë, është ulur Lutfi Haziri. Në atë kohë s'kemi pasur ligj për negociatë, kemi pasur rregullore të Qeverisë. Në atë kohë, neve na ka rënë tamam rregullorja për të negociuar me Serbi. Në atë kohë, s'kemi pasur Kushtetutë, kemi pasur kornizë kushtetues. Kjo ka të bëjë me vullnet politik. Keni vullnet politik për ta mbështetur këtë proces, është në rregull. S'keni vullnet politik, s'kemi çka bëjmë, edhe ajo është në rregull.

Po tema është pak më e thjeshtë. Në 2006-ën dhe 2007-ën, kemi qenë nën administrim ndërkombëtar, kemi qenë një entitet pa identitet shtetëror. Sot jemi shtet. Nëse forcat politike nuk kanë mundësi të projektojnë vullnet politik, në një kulturë shtetërore dhjetëvjeçare, çka t'ju them unë juve. Unë mund të flas shumë gjatë, po vullneti politik nuk ekziston. Një gjë e di që në këto shtatë-tetë vitet e dialogut, këtu në këtë Kuvend ka pasur të afatizohet procesi, mos të ketë një dialog pa fund. 2019-ta e ka një afat. Nuk po dua të them që afati është në pranverën e vonë, as në verë, as në vjeshtë, po 2019-ta e ka një mundësi. Nëse ne kemi mundësi që, nëse ne duam që ta shfrytëzojmë këtë mundësi, është historike. 2011-ën, 2012-ën, 2013-ën, askush në Bashkimin Evropian nuk ka pritur që ne mund të bisedojmë me Serbinë për njohje të ndërsjellë, në 2019-ën e kanë parë edhe kolegët që ishim në Bruksel që kryetema e procesit është njohja e ndërsjellë, nëse ne duam ta mbyllim këtë punë.

Prandaj unë e dëgjova edhe z. Kurti. Krejt parimet të cila i përmendi z. Kurti do t'i kemi në platformë. Unë pres prej tij edhe prej Vetëvendosjes ta votojnë platformën. Nëse vërtet e ka përnjëmend. Po pres prej juve, dhe ju thash në fillim të fjalës sime, merreni këtë ligj dhe nëse s'ju pëlqen gjuajeni në shportë, e shkruajmë prej fillimit, si të doni ju, po hyni në proces nëse e keni përnjëmend, nëse nuk e keni përnjëmend është punë e juaja.

**KRYETARI:** Faleminderit! Nënkryetar të ka përmendur, replikë!

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Zoti zëvendëskryeministër, problemi themelor është ky, që ju po silleni dhe po i shpjegoni situatat tona sikur të ishim në vitin 2006, d.m.th. në një situatë kur Kosova s' ishte shtet fare. Dhe ju po bëni thirrje që ne të jemi bashkë të përmbyllim procesin e shtetndërtimit të Kosovës. Ajo çështje ka marrë fund. Është mbyllur, është përmbyllur në të gjitha kuptimet. Nëse e shtroni kështu, ju e hapni, dhe kjo është tepër e rrezikshme. Kështu cenohet subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës dhe një zyrtar i lartë çfarë jeni ju, një zyrtar i lartë i Republikës së Kosovës nuk guxon në asnjë rast ta shtrojë në këtë mënyrë dhe s'mund ta mendojë kështu.

Tani, pse është vendimtar viti 2019? Çfarë po ndodh, sepse ne nuk e dimë? Unë mendoj që nëse ne do të ecim në një proces të shpejtë, në situatën kur subjektiviteti ndërkombëtar i vendit tonë është më i dobëti në dekadën e pavarësisë së këtij shteti, është e vështirë që ne të kemi një marrëveshje të favorshme për ne. Nëse ky është procesi i Serbisë, është problem i Serbisë, sepse ne kemi çështjet tona.

A duhet të hapim ne çështjen e shtetësisë së Kosovës, pse Serbia krijon probleme qoftë dhe brenda territorit të Kosovës? Unë mendoj se jo. D.m.th. sikurse një person problematik, edhe një vend problematik duhet të mënjanohet dhe të shmanget me mençuri. Po të jetë ashtu, po qe se shpërblehet Serbia për problemet e saj në dëm të Kosovës, kush garanton që s'do të krijojë probleme të reja? Dhe ne s'mund të lejojmë që të bëjmë zgjidhjet të cilat i kërkon Serbia. Ndërkaq sa i takon platformës...

KRYETARI: Urdhëro nënkryetar, mos ia ndal regjia.

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Në këtë pikë z. zëvendëskryeministër, unë ju jap të drejtë, sepse ju po kërkonit që ne të ushtrojmë funksionin tonë dhe ky është funksioni jonë. Nëse ju do të keni, do të sillni një platformë, e cila do të ketë përbrenda dhe kërkesat e opozitës, do të reflektojë në thelb atë që kërkojmë ne dhe po e përsëris edhe një herë që në këtë proces s' do të prekte, ose edhe më shqip s' do të hapet çështja e sovranitetit, e integritetit territorial dhe e karakterit unitar të shtetit tonë. Çështjet e tjera janë të gjitha të debatueshme dhe të zgjidhshme edhe për opozitën, por kjo pikë nuk mund të diskutohet. E kjo duhet të kodifikohet, nëse doni edhe me ligje, por edhe në këtë rast, unë besoj që nuk ka nevojë. Mjafton ta reflektojë platforma, sepse edhe këtë çështje e ka përcaktuar Kushtetuta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Me kaq përfundoi debati. A ta ka përmend emrin. Në qoftë se ta ka përmendur, merre përgjegjësinë publike. Jo, nëse s'ta ka përmendur, mos më fut. Në qoftë se ta ka përmendur, merre fjalën. A të ka përmendur emrin? Mbiemrin, njëjtë është. Regjia, të lutem.

ALBIN KURTI: Zëvendëskryeministri na ofroi që të hyjmë në proces, mirëpo ne kemi vërejtje të mëdha për premisat e procesit. Pra, nuk mund të thuash eja hyjmë në proces, kur ne kemi kaq shumë vërejtje për premisat e procesit. E para.

E dyta, ne besojmë që është duke u bërë gabim në hapa. Gjashtë vjet ka pasur negociata. 33 marrëveshje janë bërë. as gjashtë orë diskutim nuk i kemi këtu. Prandaj, unë kam një pyetje për Kryeministrin dhe zëvendëskryeministrin. Pse raporti 41 faqesh i Qeverisë suaj i 9 korrikut 2018 nuk vjen në Kuvend të diskutohet? Pse? Edhe një javë bëhen shtatë muaj. Pse nuk e sillni në Kuvend raportin 41 faqesh. Neve nuk na mungojnë marrëveshjet me Serbinë, 33 marrëveshje i kemi. Le të mos shtiremi. Unë nuk po them të obsesionohemi me të kaluarën, por nuk mund të vozitësh pa retrovizor. Duhet ta dimë prej nga po vijmë, në cilën gjendje jemi.

Prandaj, unë dhashë një propozim konkret, shqyrtim i dialogut të deritanishëm në bazë të raportit të juaj, t'i bëjmë kërkesat ndaj Serbisë. Me dy të tretat mund t'i miratojmë bashkërisht kërkesat tona ndaj Serbisë.

Është gabim të fillohet me emra të përveçëm të ekipit negociator, në vend se me parime dhe me kërkesa dhe pyetja që e kam për zëvendëskryeministrin Hoxhaj është: Si anëtar i delegacionit shtetëror siç po e quani, a ju ka konsultuar presidenti Hashim Thaçi për letrën që ia ka dërguar presidentit Trump, e ku shkruan që është i gatshëm për kompromis të nevojshëm? Po ose jo? A ju ka konsultuar juve si anëtar i delegacionit shtetëror? Po ose jo?

KRYETARI: Faleminderit! Janë pyetje që janë në interes edhe të publikut. Urdhëro, zoti zëvendëskryeministër.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI ENVER HOXHAI: E kam kaluar moti atë farë faze që të jap përgjigje po ose jo. Moti! Kështu që s'ma merr mendja që do të hyj me po ose jo.

Më lejoni t'ju jep idenë kështu më bazike dhe që të mos keqkuptohem.

Më 2019 mund ta kompletojmë sovranitetin e Kosovës duke u bërë shtet anëtar i OKB-së. Ne jemi shtet, edhe pse nuk jemi në OKB. Shtetet ekzistojnë edhe jashtë OKB-së, edhe brenda OKB-së.

Tash, nuk je serioz! Po shihet që nuk je serioz. Jo, nuk je serioz. Më lejoni nuk dua të zgjerohem në gjeografi, por po dua t'ju jap dy-tre shembuj. E dini, mendohet që Serbia si shtet kundërshtar i yni 1815, 1835-tën është bërë shtet. Kushtetuta në 35-ën në 15-ën është një kryengritje e parë.

E dini pse ne e vajtojmë Kongresin e Berlinit? Se atëherë Serbia është pranuar në sistemin ndërkombëtar. Kongresi i Berlinit ka qenë sistem ndërkombëtar. E dini që Shqipëria është bërë shtet më 1912-tën, por është anëtarësuar në Lidhjen Kombeve më 1921.

Ne e kemi shpallë pavarësinë në 2008-ën, jemi në shkurt të 2019-tës dhe mund t'i japim drejtim kësaj pune; a po duam të hyjmë në OKB në 2019-tën apo po duam ta lëmë këtë temë për 2029-ën?

**KRYETARI:** Jemi kah përfundimi. Armendi po thotë garanto Mitrovicën. Veç pa Mitrovicë nuk ka Kosovë Armend, harroje, mos u frikëso fare. Bashkë ne të gjithë. Për atë edhe po e ruajmë bashkë. Për atë thashë s'kemi me të mundur, bashkë. A shkojmë në votim tash? Po shkojmë votim se mos...Besoj se të gjithë e kemi të njëjtën gajle.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Regjia, administrata a ka mundësi që t'i thërrisni. 89 deputetë janë në sallë. Është ora 22:20. Kush po thotë që nuk po punojnë deputetët?

Faleminderit! Jo, unë gjithnjë po them se po punojnë. U jam shumë falënderues.

Veç do ishte mirë që mos ta shajmë njëri-tjetrin se... Jemi para votimit. A presim një minutë, se mos është ndonjëri prej deputetëve në bufe. Ja nënkryetari po vjen. Pas një minute futemi në votim për arsye se kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve.

91 deputetë. Regjia dhe deputetët përgatiten për votim, votojmë tash!

Atëherë ky është rezultati. Edhe njëherë do të votojmë. Nuk prish punë Dëgjoni, opozitë. Kolegë të opozitës kisha kërkuar korrektësi. Nuk lejoj manipulim në proces, por transparencë. Prisni pak! A jeni lodhur o gazetarë?

Kryetarja e komisionit po thotë s'ka kaluar. Interpretoma se të kam kryetare të Komisionit për Legjislacion. Pse s'ka kaluar me 60 deputetë? Se unë s'po di si kryetar i Kuvendit. Pse?

**ALBULENA HAXHIU:** Deputetët votuan, nuk janë për këtë projektligj. Dhe rrjedhimisht nuk ke asnjë të drejtë që ta vendosësh prapë në votim.

**KRYETQARI:** Pse?

**ALBULENA HAXHIU:** Sepse nuk po votojnë. A e pe rezultatin, 60 janë. Pra, është vullnet i deputetëve që ky projektligj mos të kalojë. Tash cila është mënyra e votimit e vendosim ne vet.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja deputete, kryetare e komisionit je. Të ruhemi te morali politik në kuptimin e interpretimit të Rregullores.

Unë e pata një deputet i cili tha me dhjetëra herë të votojmë me dorë. Nuk po dëshiroj me dorë, por shikoje elektroniken. Në qoftë se nuk punon, Muharrem Nitaj, atëherë e konstatoj. A po punon?

Janë 91 deputetë janë në sallë.

MUHARREM NITAJ: Në votimin paraprak nuk më ka punuar kartela. E ndërrova të shohim nëse po punon tjetra.

KRYETARI: Më rregull! Regjia, deputetë. Edhe kështu, 60 deputetë nuk ka kuorum për ta konstatuar votimin. Të jemi korrekt. Mos u bëni të padurueshëm. Votojmë edhe njëherë projektligjin. Përgatitemi për votim, votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 61 për. Kaloi projektligji në lexim të parë.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e Delegacionit Shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.

Ngarkohen Komisioni Funkcional edhe Komisionet e Përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

**5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122, si dhe Ligjin nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256**

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë së Republikës së Kosovës që ta marrë fjalën dhe ta arsyetojë projektligjin.

Kryeministër, cili prej ministrave e arsyeton? Kryeministri e përcakton tani.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Atëherë, se sot kam duruar. Kam qenë dëgjues i mirë. Më lejoni që në këtë seancë plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës ta paraqesë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122, si dhe Ligjin

nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256, pra në tekstin e mëtejme projektligji.

Ky projektligj është miratuar nga Qeveria me vendimin nr. 02/7.3 më datë 30.10.2018.

Qeveria e Republikës së Kosovës bazuar në dokumentin e Agjendës për Reforma Evropiane (ERA), ku është paraparë që subjektet politike në Republikën e Kosovës të ofrojnë transparencë të plotë dhe llogaridhënie. Fillimisht ka iniciuar hartimin e një koncept-dokumenti për fushën e subjekteve politike.

Në këtë drejtim Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar opsionin 2 të këtij koncept-dokumenti, ku është paraparë ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për financimin e subjekteve politik.

Duke e pasur parasysh këtë, Qeveria e Republikës së Kosovës menjëherë ka themeluar komisionin përkatës për hartimin e projektligjit në bashkëpunim me të gjithë aktorët e paraparë në komisionin dhe me përkrahjen e vazhdueshme të UNDP, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e BE-së, OSBE-së dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile ka përgatitur këtë projektligj.

Nevoja për nxjerrjen e këtij projektligji konsiston në qartësimin e dispozitave ligjore të ligjit bazë në fuqi, si dhe përcaktimin e dispozitave ligjore me theks të veçantë të kontrollit financiar të subjekteve politike, auditimit të raporteve financiare të subjekteve politike dhe publikimet e tyre dhe përcaktimin e dispozitave ndëshkuese për subjektet politike të cilat nuk i zbatojnë kërkesat e dala nga ky ligj.

Miratimi i këtij ligji, nënkupton edhe një kontroll më të fortë të institucioneve përkatëse, kompetente ndaj subjekteve politike si në procesin e financimit të tyre, po ashtu edhe auditimit të raporteve financiare nga auditorët profesionalë, të cilët do të përzgjidhen në pajtim me dispozitat e këtij ligji, si dhe publikimi i atyre raporteve në mënyrë që procesi të jetë transparent dhe i hapur.

Qeveria e Republikës së Kosovës zyrtarisht i është drejtuar Komisionit të Venedikut me qëllim që ky komision ta shqyrtojë draftin e projektligjit dhe të ofroje rekomandimet dhe sugjerimet e nevojshme lidhur me dispozitat e këtij ligji.

Në këtë drejtim, Komisioni i Venedikut më datë 25 qershor 2018, ka ofruar rekomandimet përkatëse lidhur me draftin e projektligjit të cilat rekomandime më pastaj në tërësi janë inkorporuar në draftin final të projektligjit.



Projektligji është në harmoni të plotë me rekomandimet e Komisionit të Venedikut, të cilat në tërësi janë inkorporuar në versionin final të projektligjit. Projektligji është përgatitur nga Zyra e Kryeministrit dhe është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me legjislacionin në fuqi.

Kam nderin që pata rastin që t'ju informoj në pika të shkurtra për përmbajtjen e këtij projektligji dhe ju propozoj që të njëjtin ta miratoni në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë projektligj të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, zoti kryeministër!

E ftoj zëvendëskryetaren e Komisionit FunkSIONAL, zonjën Safete Hadërgjonaj, për arsyetimin e raportit të komisionit.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, kryetar!

I nderuari kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Ndryshimet dhe plotësimet kryesore të propozuara në projektligjin nr. 06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122 ka të bëjë me forcimin e mekanizmit ligjor dhe institucional të kontrollit dhe raportimit financiar të subjekteve politike.

Subjektet politike janë të obliguara t'i përgatisin raportet tremujore, vjetore financiare dhe t'i publikojnë ato raporte në ueb-faqen e tyre.

Me këtë projektligj është propozuar kalimi i kompetencës së zhvillimit të procesit të auditimit të subjekteve politike nga Kuvendi në Komisionin Qendror Zgjedhor, respektivisht në Zyrën për Certifikim të subjekteve politike.

Me këtë projektligj, po ashtu janë bërë ndryshime dhe plotësimet në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe si rezultat është ndryshuar roli dhe përgjegjësia e Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike në çështjen e dhënies së kompetencave për zhvillimin e procesit të auditimit të subjekteve politike, publikimin e raporteve financiare dhe monitorimin e procesit të raportimit financiar ndaj subjekteve politike.

Zyra në fjalë, raportet i publikon në ueb-faqen e saj.

Po ashtu janë përcaktuar dispozitat ndëshkuese shtesë nga ato që parash ligji bazik për subjektet politike dhe zyrtarët përgjegjës të këtyre subjekteve.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 19. 12. 2018 e ka shqyrtuar në parim projektligjin dhe ka vlerësuar se projektligji i plotëson kushtet formale dhe juridike të përcaktuar me Rregulloren e Kuvendit dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta miratojë në lexim të parë.

Me rastin e shqyrtimit të projektligjit në komision, janë paraqitur vërejtjet dhe sugjerimet për nevojën e ndryshimit dhe harmonizimit të dispozitave të projektligjit dhe vërejtjet dhe rekomandimet që do të bëhen sot gjatë këtij leximi të parë do të analizohen me kujdes në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe do të bëhen amendamentet ashtu siç deputetët e shohin që është e arsyeshme për t'u amendamentuar ky projektligj. Faleminderit!

**KRYETARI:** Në emër të grupeve parlamentare tani. Lutfi Zharku në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Urdhëro, zoti Zharku.

**LUTFI ZHARKU:** Faleminderit, kryetar!

Kryeministër,  
Ministra,  
Kolegë të nderuar,

Projektligji për financimin e subjekteve politike duhet të nisët nga parimi bazë i rritjes së transparencës në financimin e subjekteve politike, por e cila nuk mund të arrihet përmes aplikimit të kufizimeve të ndryshme e në veçanti në raportimin e tejngarkuar financiar.

Në këtë aspekt, qëllimi i mirë pengohet nga rregullat e tepërta të cilat do të mund të nxisin financim jashtë kornizës ligjore që eventualisht mund të pasohet me gjoba, me gjobitje administrative të paarsyeshme për subjektet politike.

Kështu projektligji në disa raste, jo vetëm që nuk përcakton si duhet financimin, por edhe krijon dispozita të cilat kundërshtojnë njëra-tjetrën.

Më lejoni të filloj me përkufizimin e ri të kontributit i cili tash zgjeron format e tij duke krijuar konfuzion mbi aktivitetet e lejuara fitimprurëse që nuk janë të përcaktuara me ligjin bazik.

Kështu, ligji bazik përcakton se subjektet politike mund të ushtrojnë veprimtari financiare fitimprurëse, përveç shitjes së të mirave siç janë publikimet, botimet, shitja e materialeve reklamuese, posterëve me emblemë ose akronim të subjektit politik.

Përkufizimi, kontributi në projektligjin aktual në mënyrë indirekte lejon subjektin politik që të merret me veprimtari fitimprurëse pasi që si kontribut konsiderohen ndër të tjera, përfitimet përmes pronës, huas apo kredisë, si dhe huas së gjeneruar nga veprimtaritë ndërmarrëse.

A nënkupton kjo se subjektet politike mund të angazhohen edhe në aktivitete ndërmarrësie, përkatësisht biznese.

Në anën tjetër, projektligji nuk rregullon ende çështjen e ndërrimit të formës së pasurisë siç është rasti i shitjes së asetëve të përdorura apo që dalin jashtë përdorimit.

Natyrisht se duhet përkrahur heqjen e shërbimeve vullnetare nga vlerësimi si kontributi në natyrë nëpërmjet përkufizimit të ri.

Më tutje, projektligji jo që nuk sqaron, por krijon konfuzion me përcaktimin e obligimit të lëshimit të faturës nga ana e personave fizikë dhe juridikë me rastin e dhënies së donacioneve monetare.

Nuk mund të lëshojë faturë ai që jep para, por është e kundërta ai që merr para lëshon fature ose defter mbi pranimin. Për më tepër kjo dispozitë ka kuptime të ndryshme në versionin anglisht dhe serbisht.

Edhe deklarata e qëllimit të kontributit monetar është plotësisht e pakuptimtë. Nuk ka nevojë një person që jep donacion një subjekti politik të nënshkruaj kurrfarë deklarate mbi qëllimin, për shkak se ligji e përcakton sesi mund të shfrytëzohen kontributet dhe donacionet.

Po ashtu është për t'u përkrahur heqja e kufizimit të lartësisë së kontributit monetar apo në natyrë po i cili është devaluuar në kufizimin për pagesë të gatshme jo më të lartë se 50 euro. Kjo shumë duhet të rritet duke e marrë si shembull praktikën tashmë të përcaktuar në Ligjin mbi Tatimin në Vlerën e shtuar i cili përcakton se fatura mbi 500 euro duhet të paguhet përmes transferit bankar apo Ligjin për parandalimin e shpëlarjes së parave që lejon pagesa deri në 1 mijë euro në të gatshme.

Në vijim të kësaj nuk shoh kurrfarë arsye që në ligj të përdorë shprehje si, ndalohet rreptësisht, kur dihet se aktivitet apo veprimet e ndaluara nuk mund të kategorizohen si të buta, të mesme apo të rrepta.

Projektligj ndryshon formën aktuale të përgjegjës-auditorëve për auditimit e raporteve financiare duke e bartur këtë proces nga Kuvendi për në Zyrën për Regjistrim të subjekteve politik ku ka qenë edhe më parë, por duke e ruajtur përcaktimin me short të tyre nëpër subjekte politike.

Por, konflikti i interesit të auditorëve nuk është definuar siç duhet. Çka nënkupton? A është konflikt interesi kur anëtarët e familjes së auditorit janë anëtarë të partive politike apo në rastet kur publikisht dihet se anojnë nga parti të caktuara politike.

Obligimi i publikimit të shpenzimeve mbi 100 euro në faqen zyrtare brenda 15 ditëve është plotësisht i panevojshëm, duke e marrë parasysh se Komisioni Qendror Zgjedhor, mund të vendosë rregulla që në raportimin tremujor financiar të përfshihen çfarëdo shënimesh, detaje që ai e konsideron të arsyeshme.

Raportimi i rregullt në detaje si dhe publikimi i tyre duhet të jetë mënyrë e rritjes së transparencës e jo rritje e punëve administrative. E njëjta gjë vlen edhe për publikimin e listës së kontribuuesve çdo dyjave gjatë fushatës.

Sa i përket Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme më duhet t'i theksoj dy-tri çështje.

Së pari, pa mohuar të drejtën e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike që të bëjë kontrollimin e raporteve dhe dokumenteve të tjera financiare. Autorizimi i saj për verifikimin e ankesave anonime konsideroj se e shndërron zyrën në organ hetues apo të prokurorisë.

Ky karakter edhe më tepër forcohet me të drejtën e zyrës për të thirrë dëshmitarë për dhënien e dëshmisë.

Duke e marrë parasysh karakterin administrativ të zyrës si dhe përcaktimi i qartë që veprimet e caktuara paraqesin vepra penale të cilat trajtohen nga organet gjegjëse të rendit, ky autorizim jo që është panevojshëm, por edhe i dëmshëm për zhvillimin e demokracisë.

Nuk dua të paragjykoj se në çka në shndërrohet kjo zyrë në situata të tensioneve të mëdha ndërpartiake për të cilat jemi të gjithë dëshmitarë.

Së dyti, konsiderojmë se dispozitat të cilat përcaktojnë përzgjedhjen edhe emërimin e drejtorit të zyrës duhet të mos krijojë dilema në zbatimin e legjislacionit. Kështu sipas projektligjit, drejtori i zyrës emërohet nga kryesuesi i KQZ-së në përputhje me legjislacionin për emërimin në pozita të larta drejtuese. Por, në anën tjetër thuhet se proceduar e përzgjedhjes dhe e emërimit përcaktohet me akt nënligjor të miratuar nga KQZ, çështje që është e rregulluar me Ligjin për shërbyes civilë dhe aktet nënligjore që dalin prej tij.

Në fund, nuk shohim kurrfarë arsye që drejtori të ketë shtesa për rrezikshmërinë në pagën e tij, duke e marrë parasysh natyrën tipike administrative sikurse të çdo drejtuesi të lartë në institucione tjera. Po ashtu e konsiderojmë të panevojshme ndalimin i punësimit dhe shërbimi publik në periudhë prej tre vitesh në rast të shkarkimit të drejtorit. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit, Lutë! Safete Hadërgjonaj, në emër të grupit parlamentar.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për financimin e subjekteve politike dhe ka vlerësuar se plotësim-ndryshimet e bëra janë shumë të rëndësishme për ta përmirësuar ligjin aktual.

Ndryshimet e bëra në Projektligjin për Financimin e subjekteve politike e bëjnë atë më të zbatueshëm dhe më transparent gjë që duhet të vlerësohet, sepse në këtë fushë ne kemi marrë vërejtje nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian.

Me gjithë përmirësimet e bëra, prapë ky projektligj duhet të punohet në mënyrë që të jetë në harmoni me Kushtetutën dhe ligjet e vendit tonë, sepse kështu siç është hartuar prapë nuk arrihet të ndalet financimi joformal i partive politike.

Me këtë projektligj duhet të rriten limitet e donacioneve dhe jo ato të kufizohen, sepse kështu u japim mundësi partive politike që të gjejnë mënyrën të financohen në rrugë informale.

Partitë politike duhet t'i publikojnë raportet e tyre, por në përputhje me standardet e raportimit të institucioneve dhe jo subjektet politike të kenë standarde të dyfishta me rastin e raportimit.

Nëse e analizojmë projektligjin dhe komentet e Komisionit të Venecias vërehet se ka mospërputhje.

Në projektligj ka disa nene që janë në kundërshtim me Kushtetutën, si nenet që i japin rol kryesuesit të Komisionit Qendror Zgjedhor që nuk është pajtim me Kushtetutën. Sipas projektligjit i jep rol vendimtarë në përzgjedhje të drejtorit, në vlerësimin e tij, ndërsa në bazë të Kushtetutës, Komisioni Qendror Zgjedhor është organ kolegial dhe kryesuesi nuk është organ vendimmarrës.

Përmes neneve të këtij projektligji, hiqen autorizimet e Komisionit Qendror Zgjedhor dhe i kalohen Zyrës për Certifikim dhe Regjistrim të subjekteve politike.

Kjo rrezikon që të ketë arbitraritet të drejtorit të zyrës dhe duke mos krijuar një balancë dhe kontroll adekuatë të zyrës.

Projektligji e ngarkon Buxhetin e Kosovës në mënyrë të panevojshëm. Zyra për Regjistrim dhe Certifikim të Subjekteve Politike në mënyrën siç është konceptuar këtu, krijohet si agjenci e pavarur që i përgjigjet një individi dhe kjo është e papranueshme.

Në ligjin aktual është shumë mirë e rregulluar një gjë e tillë, sepse parasheh në mënyrën më të mirë që zyra të funksionojë në kuadër të sekretariatit dhe i siguron pavarësinë në vendimmarrje. Ne nuk duhet të krijojmë institucione të tilla që janë në dorë të një individi.

Bazuar në këto vërejtje që theksova më lartë, është e domosdoshme të bëhen përmirësimet në këtë projektligj. Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës do t'i paraqesim amendamentet tona për të përmirësuar projektligjin gjatë shqyrtimit në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ndryshime këto që shpresoj shumë që do të pranohen edhe nga deputetët, anëtar të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

**KRYETARI:** Arbërie Nagavci, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje!

**ARBËRIE NAGAVCI:** Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje, grupi ynë parlamentar e kemi shqyrtuar Projektligjin për ndryshimet dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike dhe konsiderojmë si një ndër ligjet shumë të rëndësishme.

Duke pasur parasysh se adreson rritjen e transparencës për financat e subjekteve politike, si për të dhëna, kontributet, donacionet apo përfitimet e tjera, po ashtu edhe për destinimin e mjeteve të një subjekti politik dhe kontrolli financiar dhe kjo duhet të bëhet domosdoshmëri.

Andaj, ne mbështesim në tërësi dhe tashmë është paraqitur disa herë dhe nga organizata të ndryshme që monitorojnë subjektet politike dhe financat e tyre, se Lëvizja Vetëvendosje është subjekti më transparent në këtë drejtim.

Në fjalën e tij hyrëse kryeministri Haradinaj e përmendi se në lidhje me këtë projektligj i janë drejtuar edhe Komisionit të Venedikut për konfirmim dhe kanë marrë përgjigje pozitive.

Por, kryeministri Haradinaj nuk e përmendi një element të rëndësishëm se pas konfirmimit nga Komisioni i Venedikut, janë bërë ndryshime, të cilat janë paraqitur në nenin 6 të këtij ligji, ndryshime këto të bërë me kërkesën e PSD-së, ku përcaktohet se në rast se nga një subjekt largohen 6 apo më shumë deputetë pas vërtetimit të mandateve, atëherë këta deputetë mund të bartin edhe mjetet në një subjekt tjetër politik të regjistruar pranë KQZ-së, ose në një subjekt të ri politik që regjistrohet në KQZ.

Këtë gjë, pra, se konfirmimi për këto ndryshime të këtij neni nuk kanë qenë pjesë e konfirmimit që është marrë nga Komisioni i Venedikut, e ka përmendur edhe zoti Besnik Tahiri, në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa, ku është shqyrtuar ky projektligj.

Ne mendojmë se neni 6 që adreson transferimin e parave për deputetët që ndërrojnë një grup parlamentar është antikushtetues dhe se e deformon vullnetin e votuesve.

Në radhë të parë për të argumentuar këtë kemi identifikuar nenin 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, e cila e përcakton se Kuvendi i ka 120 deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë, bazuar në lista të hapura, se vendimet në Kuvend ndahen midis të gjitha partive koalicioneve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarur në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme, të fituara prej tyre në zgjedhjet për Kuvendin.

Kjo, pra, e bën të qartë se si duhet të duket Kuvendi i Kosovës në raport me kushtetutshmërinë dhe institucionet e tjera, por edhe me të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Në të njëjtën linjë, edhe Ligji për zgjedhjet, neni 111 pika 1, e thekson se vendet në Kuvend ndahen sipas sistemit të përfaqësimit të caktuar sipas nenit 64 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Duke i ndarë 100 vende midis të gjitha subjekteve politike të certifikuara në raport me numrin e votave të vlefshme që i kanë marrë ato.

Ky paragraf i përmban tri attribute vendimtare:

Së pari, se vendet në Kuvend ndahen midis subjekteve politike.

Së dyti, se ato duhen të jetë të certifikuara nga KQZ-ja për zgjedhje përkatëse, dhe

Së treti, se vendet ndahen në bazë të numrit të votave që kanë marrë subjektet politike, dhe jo deputetët.

Pra, kurrfarë subjekti politik në kuptimin e Kushtetutës dhe të ligjit nuk mund të konstitutohet jashtë zgjedhjeve të rregullta. Duke grumbulluar kështu deputetët individualisht, përderisa subjekti në fjalë nuk është i certifikuar nga ana e KQZ-së për ato zgjedhje.

Ndërkaq në lidhje me Ligjin për financimin e subjekteve politike, duhet të kihet parasysh po ashtu se kur bëhet fjalë për subjektet politike, të drejtat dhe detyrimet e tyre në bazë primare kanë përcaktime të Kushtetutës dhe të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

Vetë emërtimi i ligjit e determinon bazën se kush janë entitetet që mund të përfitojnë nga Fondi për Demokratizim. Pra, bëhet fjalë për Ligjin për financimin e subjekteve politike dhe jo për Ligjin për financimin e grupeve parlamentare.

Për më tepër, ky ligj e mbulon edhe fushën e financimit të subjekteve politike që kanë fituar vende në Kuvend, ndërsa për financimin e subjekteve politike joparlamentare parashihet një tjetër rregullim.

Në linjë të njëjtë bëhet fjalë për financimin e subjekteve politike parlamentare, qartësohet se burimi për përfitimin e të drejtës nga Fondi për Demokratizim për subjektet politike është numri i vendeve që kanë fituar dhe jo numri i deputetëve që kanë përfituar.

Rrjedhimisht, paragrafi 6 për plotësimin e nenit 9 të ligjit bazik në konsiderojmë se është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës dhe me gjithë frymën e Kushtetutës dhe me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, me të cilën përcaktohet kriteri i definimit të grupit parlamentar.

Po ashtu është e rëndësishme që të bëhet edhe dallimi në mes të grupeve parlamentare, të cilat krijohen përbrenda Kuvendit dhe që janë të vlefshme vetëm në kuadër të dinamikave të funksionimit të Kuvendit, por që nuk përfaqësojnë subjektivitet juridik në raportet ligjore apo kontraktuale me palët e jashtme, pra jashtë Kuvendit apo me grupe të tjera të përputhura me subjektin politik, qofshin ato parti politike, koalicion, iniciativa qytetare, e kështu me radhë, të cilat janë të regjistruara në KQZ.

Dhe veçmas është certifikuar nga ana e KZQ-së për pjesëmarrje në zgjedhje, me emrin e të cilit ka figuruar në fletëvotim.

Rasti i grupit të deputetëve të PSD-së, pra bëhet fjalë për një subjekt politik, i cili në zgjedhjet e fundit ka kandiduar në kuadër të koalicionit PAN.

Dhe nëse bëhet fjalë për mandatin e lirë të deputetit, është e qartë se kjo ka kuptim në funksionimin brenda Kuvendit, pra për respektimin e të drejtave të veta të mandatit, siç e përcakton Kushtetuta, se deputetët e Kuvendit janë përfaqësues të popullit dhe nuk i nënshtrohen asnjë mandati detyrues, që do të thotë se ata mund të votojnë sipas bindjeve të tyre, duke përfshirë edhe anëtarësimin apo kalimin nga një grup në një grup tjetër parlamentar, por që kjo nuk duhet të prekë çështjet e Kushtetutës që i përmenda më herët.

Pra, nuk mund të përdoret për të pakësuar të drejtat, por edhe detyrimet e një subjekti politik që ka dalë nga zgjedhjet me një numër të caktuar të deputetëve. Për të drejtat që burojnë nga numri i votave të qytetarëve që janë marrë në zgjedhje dhe për një rezultat, i cili është certifikuar me përfundimin e zgjedhjeve nga ana e KQZ-së.

Është e rëndësishme të përmendet edhe një detaj tjetër në këtë drejtim, për shembull, gjobat që shqiptohen për subjektet politike që kanë marrë pjesë në zgjedhje për veprat që janë shkaktuar



nga kandidatët e tyre, qofshin ata edhe deputetë që janë larguar nga subjekti politik, duhet t'i paguajë vetë subjekti politik dhe jo kandidati.

Për më tepër, edhe nëse i kemi parasysh aspektin e administrimit, sa i përket përfitimit të financimit mbi bazën e krijimit të grupeve parlamentare, KQZ-ja bën llogaritjen dhe alokimin e mjeteve në fillim të viteve buxhetore dhe në bazë të kësaj praktike, në Parlament është e mundur që brenda vitit të ketë ndryshime, gjegjësisht ndërrim të grupit të deputetëve në periudha të ndryshme kohore, gjë që do të prishte edhe aspektin e administrimit, gjegjësisht alokimin të mjeteve sipas rregullave të KQZ-së.

Në përgjithësi, sa i përket ligjit, ne i kemi identifikuar, këtij projektligji pra, edhe disa çështje të tjera të cilat do t'i adresojmë në mes të dy leximeve, duke u mundur që të japim kontributin tonë që ky ligj i rëndësishëm të ketë vërtet rëndësinë, vlerën që e ka dhe të mos lejohet që të deformohet apo të keqorientohet vullneti i qytetarëve i shprehur në zgjedhje të lira. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Dardan Molliqaj, Partia Socialdemokrate.

**DARDAN MOLLIQAJ:** Faleminderit!

Partia Socialdemokrate e ka shqyrtuar projektligjin sa i përket ndryshimit të Ligjit për financimin e subjekteve politike, besojmë që edhe ato që i kemi thënë në komision, problemi më i madh i këtij ligji, i cili nuk është adresuar edhe me këto ndryshime mjaftueshëm, është auditimi.

Për të gjithë ata që e përcjellin financimin e partive politike e dinë që ka një problem.

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës nuk ka të drejtën t'i auditojë partitë politike, për shkak se një pjesë e fondeve që i shpenzon subjekti politik janë edhe fonde që vijnë nga donacionet, qofshin nga subjekte juridike apo fizike.

Dhe, në mungesë të auditimit nga Auditori i Përgjithshëm, ka pasur gjithmonë auditor të kontraktuar nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave, për disa vjet nuk ka pasur fare të interesuar, kompani që bëjnë auditimet dhe, si rezultat nuk ka pasur as auditime për disa vjet për subjektet politike.

Unë besoj që duhet të ndërrohet edhe ky ligj në atë pikë, po edhe Ligji për auditorin e përgjithshëm dhe unë besoj që zgjidhja më e mirë është që të kemi auditim nga Auditori i Përgjithshëm, si institucion i dalë edhe nga Kuvendi, po edhe i pavarur në kuadër të sistemit juridik të Kosovës, sepse ajo garanton shumë më shumë paanësi, po shumë më shumë cilësi dhe nuk kemi nevojë të hapim oferta ose tenderë, të cilat shumë shpesh edhe kanë dështuar.

Në anën tjetër, shumë lehtë edhe mund të keqpërdoret një kompani private, e cilat mund të jetë afërt me cilëndo parti, s'po pretendoj tash në askënd, edhe e cila mund të raportojë për një subjekt më mirë ose për një tjetër më keq.

Besoj që problemin më të madh partitë politike e kanë që për një fushatë të caktuar të deklarojnë 300 mijë euro shpenzime, ndërsa vetëm nga monitorimi që janë bërë nga organizatat e huaja dhe vendore të fushatës, edhe ato që duken publikisht, pra shpenzime të mediave, kryesisht edhe propagandës, ka dalë se kanë shpenzuar 330 mijë, pra më shumë se sa ka deklaruar vetëm nga ajo që është parë nga jashtë.

Në Kosovë ekziston një kufizim se sa ka të drejtë të shpenzojë subjekti politik në garën zgjedhore, po duke qenë se ekonomia e zezë është shumë e madhe në Kosovë, atëherë një pjesë e madhe e parave për subjektet politike kalon në mënyrë të padeklaruar.

Kështu që një auditim nga Auditori i Përgjithshëm i Kosovës dhe një raport i tij do të hapte rrugën për hetime për secilin subjekt sa i përket keqpërdorimit të mundshëm.

Sa i përket fondit, i cili është ndryshuar me kërkesën edhe të PSD-së, ky ligj ka qenë në procedurë, edhe PSD-ja si të gjitha subjektet e tjera janë ftuar nga Qeveria për të dhënë kontributin në këtë ndryshim-plotësim të Ligjit për financimin e partive politike.

Ne besojmë që praktika në Kosovë është e padrejtë sa i përket ndarjes së fondeve në rastin për të cilin ne po flasim.

Nëse ke të drejtë të krijosh grup parlamentar, nëse ke të drejtë që atij grupi parlamentar t'i japësh emrin e subjektit, i cili është i regjistruar në KQZ, siç është rasti me neve, po siç ka pasur disa raste në të kaluarën, nëse ai grup parlamentar ka të drejtën e përfaqësimit në të gjitha komisionet në bazë të fuqisë që ka dhe përfaqësim të subjektit politik, ne e përfaqësojmë Partinë Socialdemokrate dhe njihemi edhe në KQZ, edhe në Kuvend, edhe kudo. E vetmja fushë e cila nuk mbulohet janë financat.

Unë pajtohem në mënyrë absolute që lëvizja 1, 2, 3 deputetëve prej një subjekti në një subjekt tjetër nuk duhet bartë fondet, por ne konsiderojmë që një kriter, i cili është legjitim, është grupi. Pra, nëse prej të njëjtit subjekt ka më shumë se gjashtë deputetë, atëherë ne konsiderojmë që atij subjekti të ri që do ta krijojnë ose t'i bashkohen duhet t'i takojnë edhe fondet që vijnë për subjektet parlamentare, të cilat i njeh edhe ligji.

Nuk e përjashtoj mundësinë, jemi të hapur që çështjen ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese, nëse Gjykata Kushtetuese vendos sipas pretendimeve të atyre që e kundërshtojnë, ne nuk e kemi problem, përkundrazi do ta respektojmë. Po mos harroni të njëjtit na patën lodhur duke thënë

edhe për çështjen e nënkryetares së Kuvendit që është antikushtetuese, e prej që është marrë vendimi i Kushtetutës, asnjë fjalë nuk e kanë thënë më, se e kanë parë që e kanë hapur e tash veç rrinë. Po ne jemi të hapur edhe të kërkojmë falje nëse Gjykata Kushtetuese tregon që ka shkelje.

Bindjet tona, për aq sa e njohin aspektin e Kushtetutës së Kosovës, janë që s'ka asnjë problem. Megjithatë ne nuk jemi ata që e bëjmë interpretimin dhe jemi të hapur që këtë çështje ta marrim si rezultat edhe të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

Në të njëjtën kohë, prej leximit të parë në leximin e dytë Partia Socialdemokrate do t'i ofrojë edhe amendamentet shtesë, të cilat konsiderojmë që e përmirësojnë dhe e fuqizojnë ligjin.

Unë në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate i jap mbështetje këtij projektligji në lexim të parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike dhe konsideroj që kontributin tonë do ta japim në fazën e amendamentimit dhe e përkrahim në parim. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit. Urdhëro, zoti Hoti!

ENVER HOTI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi Parlamentar Nisma Socialdemokrate e ka trajtuar propozimin e Qeverisë për plotësim-ndryshimin e Projektligjit për financimin e partive politike, mendoj që është një hap mjaft i rëndësishëm dhe i domosdoshëm, sepse mendojmë që do t'i plotësojë dhe do t'i bëjë transparente dhe llogaridhënëse të gjitha burimet për financimin e partive politike dhe të kandidatëve, të cilët do të marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme dhe kontributin tonë do ta japim mes dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja Lirije Kajtazi e ka fjalën.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Meqë jemi në shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike, dhe meqë po bëjmë një ndryshim, i cili kënaq ndoshta edhe shumë subjekte, të cilat ndërkohë edhe mund të ndahen, pavarësisht qasjes fillimisht dhe hyrjes në Kuvend.

Unë do të kisha prekur një çështje, të cilën e kemi identifikuar si problematike, të gjitha subjektet politike me shumë gra deputete dhe me shumë gra, të cilat kanë ndikim në jetën politike në përgjithësi, të cilat kanë vëmendje të shtuar apo kanë fokus demokratizimin e shoqërisë tonë në përgjithësi.

Ajo çfarë ne e kemi parë të nevojshme në këtë demokratizim shoqëror është edhe financimi i partive politike dhe ndarja buxhetore, e cila në një farë forme është edhe obligim ligjor nga Ligji për barazi gjinore, të cilin partitë politike nuk e kanë respektuar.

Do të ishte shumë e nevojshme për arritjen e objektivave të kësaj barazie që partitë politike të ndajnë një pjesë të mjeteve, të cilat do t'u ndihmonin forumeve partiake që t'i realizojnë agjendat e tyre që i kanë paraparë brenda subjekteve të tyre për avancim të demokracisë së përgjithshme.

E dimë që neni 14 dhe i Ligjit për barazi gjinore obligon partitë politike që në aktet e tyre të brendshme t'i marrin të gjitha masat që do të ndihmonin me promovimin dhe pjesëmarrjen e barabartë, po ashtu siç thotë edhe neni 6 i Ligjit për barazi, i cili kërkon edhe masa të veçanta, të cilat do të ndihmonin afirmimin e një aspekti dhe në këtë rast aspekti gjinor.

Prandaj, do të ishte më se e nevojshme që partitë ta mendojnë këtë çështje. Mendoj se secili subjekt mendon kështu, është një çështje që e kemi identifikuar së bashku dhe na ndihmojnë edhe modelet e shoqërive më të avancuara.

Modeli i Norvegjisë i ndihmon forumet partiake, si atij të rinisë, si atij të grave që të aplikojnë në Qeveri për grante, në mënyrë që të orientohen në agjenda specifike të kësaj gjithëpërfshirjeje.

Prandaj, mendoj se një nen në këtë ligj do të ndihmonte përgjithësisht në demokratizimin e shoqërisë tonë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zonja Albulena Haxhiu e ka fjalën.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Nëse lexohet edhe ky projektligj, në fakt, një nen i këtij projektligji, për të cilën edhe zonja Nagavci foli, po për të cilin do të ndalem edhe unë.

Kuptohet qartë që një subjekt pseudoopozitar ka hyrë në pazare të mëdha dhe kur hyn në pazare, pastaj s'ke tavan, sepse s'di të ndalesh.

Po i përmend vetëm disa çështje ose vetëm pazare që tash janë bërë së fundi.

E para, ka qenë për anëtarin në KQZ, ku në mënyrë jokushtetuese, për shkak pikërisht të këtyre pazareve, Hashim Thaçi ia dërgon edhe Nismës, edhe PSD-së kërkesën për të propozuar anëtarin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Pavarësisht faktit që kjo nuk u takon as me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e as me Ligjin për zgjedhje, e as me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese. Pastaj për çështjen e nënkryetares së Kuvendit, zonja Dërguti është propozuar si deputete e Vetëvendosjes, në momentin që ka ikur nga Vetëvendosja është dashur ta dorëzojë mandatin edhe të nënkryetares, edhe të deputetes. Edhe të tjerët, natyrisht. Dhe, pazari tjetër është me financat, ku këta po duan t'ia marrin paratë që i takojnë Lëvizjes Vetëvendosje. Pra, nëpërmjet këtij ndryshimi, PSD-ja po synon që në mënyrë legjitime të paguhet për shërbimet që po ia bën koalicionit qeveritar.

Koalicioni qeverisës po e blen PSD-në, por po tenton ta paguajë me financat e një partie opozitare. Po paguan gjithashtu edhe duke e lënduar gjithë frymën demokratike të Kushtetutës, meqë e bën të pakuptimtë jetën politike në vend. Me këtë ndryshim, KQZ-ja do t'u ndante mjete edhe subjekteve që as nuk ekzistojnë, e as nuk garojnë në zgjedhje, por sigurojnë financa duke blerë deputetë. Ky nen krijon edhe një absurditet të tillë, kur një grup deputetësh të pavlerë në mënyrë artificiale ia rritin pagën vetes për 150%. Mjafton që ta tradhtojnë subjektin politik dhe të themelojnë një pseudo-parti dhe me automatizëm ia shtojnë të ardhurat vetes për diku 30 mijë euro në vit. Si mund të flitet për nocion të demokracisë me këso fizkulture, ku për hir të një aprovimi të buxhetit vetëm për një vit rrezikohet e gjithë fryma demokratike, e ndërtuar deri tani.

Madje, unë këtu do të doja të shtoja edhe diçka. Zoti Visar Ymeri ka qenë në një takim me tre përfaqësues të Komisionit të Venecias, meqë po përmendet këtu Komisioni i Venecias, më 15 maj 2018, bashkë me Dardan Sejdiun dhe, në anën tjetër, kanë qenë edhe Besnik Bislimi, nënkryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, dhe Adnan Rrustemi. Takimi ka qenë në vazhden e takimeve që përfaqësuesit e Komisionit të Venedikut i kanë organizuar me subjektet politike për Ligjin për financimin e partive politike, pas ftesës së bërë nga vetë kryeministri, më 16 prill 2018.

Në këtë takim, zoti Ymeri ka shprehur brengën e tij për pamundësinë që fondet të barten te subjekti i ri në rast se disa deputetë largohen nga subjekti i tyre dhe përgjigjja e kryesuesit të delegacionit ka qenë shumë precize. Ai ka thënë “normal që nuk munden, se përndryshe deputetët e kanë lehtë ta tradhtojnë subjektin e tyre politikë”. Nuk duhet që tradhtia të nxitet me ligj, por e kundërta, dhe e ka lënë krejtësisht të skuqur edhe Visar Ymerin, edhe Dardan Sejdiun.

Por, kjo si duket nuk e ka penguar as Dardan Sejdiun, as Visar Ymerin që ta keqpërdorin plogështinë e kryeministrit Haradinaj për ta imponuar vjedhjen e fondeve. Është jetike që deputetët të mos e lejojnë një degradim të rrezikshëm të jetës politike në vend. Dhe, po ky nen është kundërkushtetues dhe ne do ta dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese edhe këtë, përveç Ligjit për dialogun.

E përmenda edhe në fjalimin tim kur ishte Projektligji për dialogun në diskutim. Tash po thonë që Gjykata Kushtetuese nëse vendos sikur po kërkon, ose sipas pazareve të PSD-së, tash ne kinse u themi që ju e keni kapur Gjykatën Kushtetuese. Jo, nuk e keni kapur Gjykatën Kushtetuese, por Hashim Thaçi e Kadri Veseli dhe të tjerë që tashmë e kanë kapur Gjykatën Kushtetuese, tash po e kapin për PSD-në, sepse kështu po i bëjnë pazaret dhe kështu po i bëjnë favore njëri-tjetrit. Pra, mjafton që kontrolli i PDK-së të jetë mbi Gjykatën Kushtetuese dhe mbi gjykatat tjera, në mënyrë që kështu të punojë dhe të veprojnë në bazë të pazareve që PSD-ja po i bën. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Molliqaj ka kërkuar replikë.

**DARDAN MOLLIQAJ:** Është interesant një fakt që kur deputetët e Parlamentit të Kosovës prej një partie të caktuar shkojnë në Vetëvendosje, ata edhe nëse kanë bërë gjithçka, e kanë votuar Planin e Ahtisarit, çka do që kanë mundur të votojnë, ata tashmë bëhen atdhetarë. Edhe nuk ka nevojë ta dorëzojnë mandatin, edhe s'janë tradhtarë, edhe është gjithçka në rregull.

Kur dikush del prej Vetëvendosjes, ata edhe duhet ta dorëzojnë mandatin, edhe janë mashtrues, edhe nëse s'kanë bërë kurrgjë janë kështu, megjithatë është mënyrë e të folurit të tyre që le ta vazhdojnë. Shumë mirë, dërgojeni në Gjykatë Kushtetuese, ndoshta del qysh po thoni ju dhe ne nuk e përjashtojmë, ndoshta del qysh themi ne. Dhe, vazhdojmë tutje sa i përket kësaj çështjeje. Por, është mirë t'u tregohet prapë qytetarëve qysh keni shkuar në Qeverinë e Kosovës dhe i keni kërkuar kryeministrit Haradinaj që ta tërheqë Ligjin nga rendi i ditës. Keni shkuar, keni ofruar keni thënë që për ligje të caktuara votojmë, votojmë kundër e bëjmë kuorumin, veç hiqeni ligjin, a po e din. Bëhuni sikur ne dhe themi, "po, ka qenë kërkesë e PSD-së për fonde" se është legjitime, s'të takon, s'takon. A e din sa kërkesat i ka PSD-ja, e s'bëhen. Po mos shkoni aty tinëz ta lutni kryeministrin dhe Qeverinë dy herë, e sot disa herë, që ta heqë ligjin dhe ofroni shërbime për këtë punë, e tash bëni këso deklarimesh.

Pse po shqetësoheni nëse jeni të bindur që në gjykatë do të fitoni. Lëreni këtë punë! Aty në gjykatë fitoni dhe në rregull jemi.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Haxhiu!

**ALBULENA HAXHIU:** Është e sata herë me radhë kur Dardan Molliqaj e keqpërdor foltoren e Kuvendit, përkatësisht mikrofonin për të shpifur kundrejt Lëvizjes Vetëvendosje, siç bëri edhe

më përpara me Glaukun, vetëm për shkak se konsideron se për deklaratimet brenda Kuvendit të Kosovës ka imunitet. Edhe në këtë radhë shpifim kundrejt Lëvizjes Vetëvendosje. Prite Dardan, prite edhe Ligjin për Buxhetin a votohet a s'votohet dhe cili do të jetë qëndrimi i Vetëvendosjes dhe e kuptojnë edhe qytetarët që je duke shpifur, siç po shpif në vazhdimësi.

Dhe tjetra, po është e vërtetë që kur dikush vjen në Lëvizjen Vetëvendosje bëhet i mirë, ama kur dikush largohet nga Vetëvendosja shembullin po e tregoni ju. Ja ku keni ardhur! keni degraduar, Dardan. Prandaj, në mungesë të argumenteve edhe shpifni, edhe bëni pazare, por kot e keni. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Fikrim Damka.

**FIKRIM DAMKA:** Teşekkür ederim Sayın Meclis Başkanı yardımcım.

Siyasi partilerin finansman Yasa Taslağının değişikliği ve bu Yasanın düzenlenmesi özellikle donatörler tarafından yapılan bağışların partiler tarafından daha şeffaf bir şekilde gösterilmesi çok önemli olaydır. Bu Yasayla birlikte 6+ Parlamenter grubu olarak önereceğimiz bazı öneriler arasında seçim dönemi içerisinde partilerin devlet bütçesi tarafından ek kaynaklarla desteklenmesidir. Bu şekilde partiler kendi seçim kampanyalarını daha düzenli ve olumlu bir şekilde gerçekleştirmesini sağlamış olacaklardır. 6+ Parlamenter gurubu bu Yasa değişikliğinin ilk okunuşunu desteklemektedir.

**KRYESUESI:** Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

**MILAIM ZEKA:** Faleminderit, kryesues!

E para, pajtohem komplet me kolegun tim turk çka tha, edhe pse s'e kam kuptuar, por e di që ka folur mirë. S'e di që ka thanë, veç paratë i ka përmendur diqysh dhe këta vëlla e kanë Erdoganin me vete, unë shqyr që e kam prapa kurrizit.

Dua të flas shumë shkurt, s'kam çka t'u shtoj fjalëve të Dardan Molliqajt, por veç të flasësh edhe ti pak, dëshiroj të them një diçka, për mendimin tim duhet t'i heqim kufizimet. Më mirë është që njerëzit të gjuajnë para në konto sesa të japin nëpër zarfe e nëpër kafe, nëpër klube, e tani besa po sjellin natën të shkretit duke u frikuar andej-këndej. Këta njerëz që na japin para për fushatë mund t'i heqin prej tatimit, kështu e ka bota perëndimore të rregulluar këtë farë pune, të bëhet çdo gjë transparente dhe në fund kjo ndarja që ishte atje, njëfarë neni nuk e di cili ishte, por të ndahen 6 veta, 7 veta. Do të bëj luftë që kur të ndahet një deputet, qoftë edhe një deputet, ta marrë pjesën e parave me vete. E di unë që s'e lejon ligji, por ne po duam ta ndryshojmë ligjin, se po e di që s'e lejon, po duam ta ndryshojmë, se po t'i kishe ti paratë me vete s'kishe qëndruar hiç në PSD, as unë në Nismë, por s'po na i japin këta paratë.

E, tash është problemi që këtë duhet rregulluar me ligj, që edhe Muharremi do të kishte ardhur me mua, do ta kishte lëshuar menjëherë AAK-në. E, krejt në fund do të luftojmë tani kur të vijmë te Ligji zgjedhor edhe prapun ta heqim, se shumë bre gjashtë veta, diqysh na i keni prishur krejt matematikat. Kështu që do të kontribuojmë, mendoj që pas Ligjit të pagave, ky është njëri prej ligjeve më të rëndësishme.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Driton Selmanaj e ka fjalën.

**DRITON SELMANAJ:** Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, kur përmendet Ligji për financimin e partive politike, normalisht që është një ndër ligjet me një ndjeshmëri të madhe dhe normalisht që ngjall edhe interes, jo vetëm te organizatat vendore, por edhe te organizatat ndërkombëtare.

Por, unë dua të shpreh fillimisht shqetësimin tim rreth atyre juristëve të Qeverisë që na e sjellin këtë ligj, veç shiheni me çfarë emërtimi, veç keni durimin edhe dëgjomëni: “Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122, dhe Ligjin nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256”. Po, a kanë lidhje këta njerëz me proces ligjberës, apo jo?! Nëse një ligj ndërrohet katër herë brenda një periudhe kaq të shkurtër, duhet të vijë ligj i ri, por jo kështu.

Tjetra? Ku ka praktikë që me një ligj, e ndryshon një ligj tjetër? Me këtë ligj ndryshohet edhe Ligji për zgjedhje, po s’mund kështu, duhet sjellë edhe Ligjin për zgjedhje dhe ndryshuar disa nene, të cilat e prekin Ligjin për zgjedhje. Po, a ka juristë në Qeveri dhe a ka juristë në këtë Kuvend, të cilët merren me këto çështje?

E para, sa vështirësi mund të ketë një person i cili ka interes ta kuptojë se çka ndodhë me këtë materie? Katër herë ligj i ndryshuar dhe në fund del i ndryshuar, një ligj i ndryshon katër ligje tjera, domethënë krejtësisht pa kuptim në kontekstin e ligjberjes.

E dyta, normalisht që kjo më pas ngjall edhe dilema, mos ne si parti politike kemi interes të krijojmë këso paqartësish, me qëllim po e bëjmë, sepse kur preket financa e partive politike sikur ne nuk kemi dëshirë shumë të jemi transparentë, e të merren të tjerët me neve, e kështu e kështu me radhë, e më pas mesazhi bartet si i tillë. Unë i lexova me kujdes edhe ndryshimet, të cilat janë propozuar, por ajo çka më bëri përshtypje është që në koncept-dokumentin e Qeverisë flitet se ky ligj ndryshohet vetëm në një element, dhe cili është ai? Te kontrolli financiar. Kemi bërë eksperiment, një herë KQZ-ja e ka zgjedhur auditor, më pas e kemi sjellë te Kuvendi dhe tash po kthejmë përsëri te KQZ-ja. Po vazhdojmë me eksperimentin e radhës. Por, përkundër që në koncept-dokument nuk ekziston fare çështja se si të shpërndahet fondi për mbështetjen e partive



politike, këtu del gati substanciale që paska qenë kjo dhe menjëherë normalisht ngjallen dilemat a mos edhe këtu pazar.

Dhe, tash kemi filluar pazarin po e them edhe një herë ta bëjmë normë. Nuk është problem sot PSD-ja, nesër mund të jetë një subjekt tjetër politik, i cili e shantazhon Qeverinë dhe mund të sjellë këso lloj projektligjesh, të cilat më pas besomëni që përfundimin e kanë të pakuptimtë.

Po qysh po e shoh këtë qeveri, aq shumë është e shantazhuar, uroj që PSD-ja ose një parti tjetër nuk propozon të hiqet dita e diel krejt se këta bën vaki e pranojnë edhe atë, na lënë pa vikend fare. Nëse mendojmë që ta vendosim një praktikë, ku koalicionet parazgjedhore, pasi të futen në Kuvend, partitë politike t'i marrin paratë si subjekte politike, jo si koalicion, i cili ka fituar zgjedhjet, unë mendoj që ne i stimulojmë pazaret paraelektorale. Domethënë, njerëzit, partitë politike bëhen pjesë e një subjekti vetëm për t'i marrë më pas paratë, të cilat i jepen nga fondi për mbështetje. E, aq më keq nëse ne stimulojmë që individë të caktuar të largohen nga partitë politike, sepse tek e fundit organizimi politik kështu kuptohet, gara ndërmjet partive politike, ose eventualisht kandidatëve të pavarur, nëse duan të hyjnë në zgjedhje.

Por, unë mendoj që nëse provojmë me këtë qasje, sado që mund të duket demokratike, mendoj që ne e stimulojmë shkatërrimin e mëtutjeshëm të këtij koncepti të ndërtuar të grupit parlamentar, sado që mund të jetë i pakuptueshëm edhe me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Çështja e cila normalisht është përmbajtjesore në këtë projektligj është Zyra për Regjistrimin dhe Certifikimin e Subjekteve Politike, e që në këtë fakt, me këtë rast, i është shtuar edhe kontrolli financiar si kompetencë shtesë. Komisioni i Venecias ka dhënë disa kritika për këtë çështje, ka thënë që edhe pse kjo zyrë po i ngre të them kapacitet e saj, ose fushëveprimtarinë e saj, megjithatë duhet edhe më tutje që kjo zyre të ketë kapacitete edhe në hetim, në mënyrë që të monitorojë nga afër se si partitë politike po i shpenzojnë paratë. Prandaj, ne duhet të kemi kujdes gjatë fazës që ne po e draftojmë këtë projektligj, ta bëjmë vërtet këtë zyrë me pavarësi funksionale, sepse nëse e lëmë Zyrën për Regjistrimin e Partive Politike në vartësi të plotë të shëfës së KQZ-së, unë mendoj që ne nuk kemi bërë asgjë, përkundrazi vetëm çka kemi e provuar edhe një eksperiment të radhës, e cila më pas mund të jetë përsëri e pasuksesshme.

Ne po provojmë që për shkak të pazotësisë institucionale t'i mbikëqyrim partitë politike, ndoshta edhe për shkak të mosgatishmërisë së vet partive politike, për të qenë të sinqertë edhe për t'i deklaruar drejt financat, të cilat ne i marrin nga shteti, sikur po krijojmë situata eksperimentale për të provuar hajt ta bëjmë edhe një eksperiment për të parë në fund se si do të përfundojë.

Prandaj, unë mendoj që ndërveprimi institucional këtu është i domosdoshëm, Zyra duhet të ngrihet në nivel të kapaciteteve të plota, e cila garanton pavarësinë funksionale të saj, e cila mund t'i monitorojë partitë politike, mund t'i përzgjedhë auditorët kompetentë, mund t'i trajtojë

ato raporte dhe më pas duhet të ndërveprojë me institucionet ndjekëse Prokurorinë, Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe institucionet tjera.

Po them, ndoshta ne mund ta shfrytëzojmë këtë rast, meqenëse ky ligj ka ardhur në trajtim për ta parë edhe mënyrën sesi trajtohen kontributet, apo edhe a duhet të ketë kufizime për financim, megjithatë ajo çka për mua paraqet shqetësim është që të bëjmë ligje, të cilat i qëndrojnë kohës, i rezistojnë kohës, por jo ligje që pas një ose dy vjetëve, jemi të detyruar t'i trajtojmë edhe një herë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Replikë, Dardan Molliqaj!

**DARDAN MOLLIQAJ:** Faleminderit!

Po dua të shpresua që një pjesë të atyre që i tha Dritoni, meqenëse e njoh, janë për shkak se nuk e ka marrë mjaftueshëm në shqyrtim atë që tha më herët dhe atë që është në ligj. Nëse është e kundërta, atëherë po më vjen keq për nivelin që ka përfunduar Dritoni. Driton, nuk flitet të mblidhen deputetët prej secilës parti dhe të krijojnë grup parlamentar dhe të marrin fonde. Për tjetër gjë flitet, Driton. Nëse prej të njëjtit subjekt dalin së paku gjashtë e më shumë, atëherë garanton kjo e drejtë, nuk ka kurrfarë norme as universale, e as të Kushtetutës së Kosovës, se pse është vendosur më herët të mos ketë një grup të ri parlamentar.

Unë e thashë edhe më herët, meqenëse të takon e drejta për t'u anëtarësuar në një subjekt të ri, ose atë ekzistues, meqenëse Kuvendi ta njehë atë të drejtë, ke të drejtë të përfaqësimit nëpër krejt komisionet, fondi është për demokratizim, pra për t'i demokratizuar subjektet. Ti po i thua subjektit të ri "i ke krejt, por paratë jo". Çka bëjmë në një situatë kur prej 30 deputetëve, dalin 29 dalin, thonë "s'po duam të rrimë këtu". Tash ai një deputet i merr krejt fondet, a? Edhe vazhdon ai deri në fund të mandatit. S'ka kuptim kjo, ju lutem!

Edhe tjetra, po e shoh, mund të jetë në kuadër të betejës politike, që është në rregull, po ta kishte PSD-ja për përfitim. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Dardan Molliqaj, ke kërkuar replikë, unë s'e dëgjova që ta përmendi emrin.

**DARDAN MOLLIQAJ:** Faleminderit!

Zoti Hasani besoj që ka dallim mes asaj që po themi ne e çka po thua ti. Të paktën sipas meje. Ai fond është për subjekte politike, nuk është për individë dhe as për deputetë. Është për subjekte, fondi për demokratizimin e subjekteve politike. Unë në këtë kuvend, qysh po e sheh atje si po shkruan Dardan Molliqaj PSD. Në këtë Kuvend, si Parti Socialdemokrate i drejtojmë dy komisione, i kemi dy nënkryetarë, i kemi të drejtat e barabarta si Partia Demokratike, si LDK-ja, si Vetëvendosja, si AAK-ja e si të tjerët. Krejt. PSD shkruan gjithkund. Jo, jo gjithkund shkruan,

pra e njeh të drejtën e regjistrimit të një partie të vjetër, ose parti të re. Kjo është praktika jo veç me PSD-në, shihni historinë edhe më përpara. E keni kështu. Kështu, që kjo është.

E dyta, është problem të barazosh kërkesën e grupit që është parimore, e shtruar në një nivel parimor, mund të mos pajtohet njeri, se parimet e majta e të djathta kanë dallim, edhe të qendrës, me kërkesat individuale. S' di a e pe ku rrëshqite. Nëse doni t'ia votoni, unë e dua këtë për vete. Krejt kërkesat tona që ishin deri tash, ishin kështu: Ligji për financimin e partive politike nuk është kërkesë. Sot mos e votoni hiq, ne e votojmë buxhetin. Kërkesat tona kanë qenë të tjera. Po ne besojmë se na takon. Hiç bre asnjëri mos e votoni. Kurrë. Kjo është çka na takon sipas neve. Përndryshe sot mos e votoni hiq këtë ligj, ne e votojmë buxhetin, sepse kërkesat tona politike që kanë fituar qytetarët e jo ti, i kemi votuar më herët. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Hajde Nait, kundër-replikë!

**NAIT HASANI:** Faleminderit shumë Dardan! Është interesant kjo çështje, që krejt individët i bëjnë subjektet. Subjektet nuk formohen në mënyrë, po individ - individ bëhet subjekti. Ju kur keni ardhur këtu, keni ardhur si Vetëvendosje. Ne ju kemi përgëzuar dhe e kemi formuar koalicionin, ndarje të tjera nuk janë një rregull që formohen. Por, sikur ti ke të drejtë të formosh një grup, po edhe unë si individ kam të drejtë. Çdokush ka të drejtë. Nëse ti ke ardhur nga zgjedhjet dhe ke ardhur si subjekt, edhe ne kemi ardhur si subjekt. Prandaj, ti tash je ndarë, ti kërkon fonde. Po nesër dikush tjetër nuk pajtohet, çka do t'i bëjmë atij? D.m.th. ti domosdo gjenden pesë vetë të tjera ta fitojmë të drejtën e subjektit. Përkundrazi, secili individ, nëse doni ata t'u votohen, unë po ta them publikisht, nëse do ta votosh atë pikë, vendose pikën...

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Haradinaj e ka fjalën.

**DAUT HARADINAJ:** Faleminderit kryesues!

Unë po mundohem të jem shumë i shkurtër. Ligji, në fakt Projektligji është në lexim të parë dhe Naiti ka të drejtë të bëjë amendament nëse e vlerëson, pse jo. Por në praktikën e të kaluarës ne e kemi pasur LB-në për shembull që është sjellë nëpër gjykatë për të fituar të drejtën e buxhetit kur janë larguar prej një subjekti politik. Në anën e djathtë këtu, p.sh. e kam Alternativën, po ashtu edhe këta bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të përfituar të drejtat e veta që ju takojnë si deputetë. Tash kur flasim për pse numri 6, edhe me rregulloren e Kuvendit i kemi gjashtë deputetë të cilët formojnë grup parlamentar. Do të thotë një grup parlamentar i cili emërohet, p.sh. e kemi 6+, e kemi PSD-në që janë 12 deputetë. Unë mendoj që në rast se kemi ndonjë paqartësi, ose ndonjë kërkesë, t'i bëjmë amendamente, t'i drejtojmë në Komisione, në rast se Komisionet iu japin përkrahje dhe t'i sjellin në Kuvend, edhe këto në lexim të dytë i japim besimin siç e do edhe Rregullorja.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Kurteshi e ka fjalën.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Unë e mora fjalën vetëm të kërkoj një sqarim që unë vërtet e kam një paqartësi. Këtu u tha se gjashtë deputetë nëse dalin prej një subjekti kanë të drejtë të bëjnë një grup parlamentar, që është e vërtetë, dhe kanë të drejtë t'i tërheqin mjetet. Mirëpo nëse gjashtë deputetë dalin prej më shumë subjekteve, u tha se nuk kanë të drejtë t'i tërheqin mjetet. Si vlerësohet pesha e deputetëve? A vlerësohet me numër, apo vlerësohet sipas disa standardeve për mua të pakuptueshme. Kush mundet t'ua ndalojë gjashtë deputetëve që dalin p.sh. prej gjashtë partive, nëse kjo kalon, t'i tërheqin edhe mjetet prej partive të tyre, edhe tamam ta bëjnë një grup parlamentar edhe me financa. Është mirë ta shpjegojmë. Jo të lutem, Dardani e tha, edhe le ta shpjegojë qysh ia merr të drejtën gjashtë deputetëve të dy-tri partive, e të një partie i vlerëson pak më shumë?

KRYESUESI: Urdhëro, zoti Molliqaj.

DARDAN MOLLIQAJ: Për shkak të z. Kurteshi, po shpjegoj pse unë besoj që kështu është e drejtë. Pra po them është besim i imi i cili përfaqëson PSD-në. Ne e dimë dhe jemi këtu në Kuvend. Ka deputetë individualë të pakënaqur për arsye personale me një subjekt, me një koleg, me kryetarin edhe me çkado, edhe mund të bëhen lehtë të pakënaqurit e të gjithëve t'i marrin fondet. Por të pakënaqur për arsye, po them mundet edhe individi të jetë i pakënaqur për politikë, po ka gjasa që është kështu. Kur dalin gjashtë prej një subjekti, unë nuk mendoj se është veç pakënaqësi personale. Ata mund të jenë tradhtarë e mashtrues, çka doni ju thoni, por kanë një arsye. E unë besoj që kanë një arsye politike, se krijojnë subjekt politik, kanë koncept politik. Është e vërtetë që individët e krijojnë subjektin, por mbi të gjitha është koncepti që i bashkon. Nuk shkon secili me idenë e vet dhe të thotë po e bëjmë subjektin. Shkojnë me ide të majtë, që djathtë, të qendrës dhe është ombrella që i bashkon individët, jo mendimi i secilit aty individual. Kështu që për këtë arsye, për të mos e nxitur daljen e deputetëve nga grupet, por kur ka çarje konceptuale dhe politike, mendojmë që është e drejtë. Përndryshe, nëse ju mendoni që duhet ta bëjmë ashtu, urdheroni bëjeni një amendament edhe në rregull jemi.

KRYETARI: Po, kundër-replikë, urdhëroni z. Kurteshi!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Së pari mendoj që prej subjekteve të tyre politike dalin vetëm të pakënaqurit. Ata që janë të kënaqur rrinë brenda subjektit të vetë ku kanë qenë, prandaj ky argument për mua nuk është argument. Edhe nëse një gjë e tillë vërtet kalon, atëherë numri i grupeve parlamentare, Kuvendi mund të fillojë punën e vet me pesë grupe qysh e kemi filluar ose gjashtë sa jemi e të përfundojmë me diku 16. Faleminderit!

KRYETARI: Tani Naser Rugova, urdhëro!

NASER RUGOVA: Faleminderit, kryetar!

Është mirë që si organi më i lartë legjislativ në vend, vërtet ta ndjekim një agjendë racionale edhe kur duam të reformojmë ligje në fusha të caktuara, e në veçanti ligje të ndjeshme që i monitoron edhe bashkësia ndërkombëtare, e në veçanti mekanizma të caktuar të Bashkimit Evropian. Së pari, duhet një reformë në Ligjin për zgjedhjet. Kemi paqartësi, kemi konfuzion, kemi vakume ligjore, i cili pastaj prej atij rezultati zgjedhor po na interferon edhe me lëvizje të caktuara politike që po ndodhin post festum procesit elektoral. Prandaj, konform Kushtetutës, Ligjit për zgjedhje dhe Rregullores së punës së Kuvendit që është bukur e qartë, duhet të orientohemi dhe të bëjmë ligje që të mos detyrohemi për grupe të caktuara politike, për grupe interesi, se vetëm në Kosovë, brenda dy apo tri viteve ndodh plotësim-ndryshimi i një ligji. Një debat publik për plotësim-ndryshim të një ligji në Britani të Madhe zgjat tri vjet dhe po shkaktojmë konfuzion, vakum, paqartësi edhe te udhëzimet administrative pastaj që ta implementojnë ligjin në realitet.

Unë kisha propozuar që të mos procesojmë me ligje nën presion, por vërtet të hartojmë ligje të mira, të organizojmë debat të gjerë me të gjitha fokus-grupet dhe të mos detyrohemi pastaj me një qeveri tjetër pas gjashtë muajsh apo një viti të hyjmë në plotësim-ndryshim, duke shkaktuar një kaos në legjislacionin e shtetit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë, ka mbaruar debati, nuk ka asnjë deputetë të paraqitur. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën.

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit. Administrata, sa deputetë janë në sallë edhe shkojmë në votim. Në qoftë se ka mundësi deputetët të cilët janë në pjesën e pasme të sallës të kthehen në Kuvend. Presim derisa të kthehen.

Të nderuar kolegë deputetë, përgatitemi për votim. Votojmë tash!

64 deputetë kanë votuar, 61 për, 1 kundër, 2 abstenime.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr.06/L-137 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058 dhe Ligjin nr. 04/L-122, si dhe Ligjin nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-256.

Ngarkohen Komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit ia paraqesin raportet me rekomandime.

## **6. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social**

Kryetarët e grupeve parlamentare të PDK-së, PSD-së, AAK-së dhe NISMA-s dhe 6+ kanë propozuar formimin e komisionit ad hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social.

Përfaqësuesi i grupeve parlamentare ftohet që ta paraqesë dhe arsyetojë këtë propozim. Nëse e kërkon fjalën, Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Pra Qeveria e Republikës së Kosovës ka përgatitur një koncept-dokument, përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka përgatitur një koncept-dokument, i cili lidhet me çështjen e pensioneve dhe beneficioneve sociale. Siç e kemi thënë disa herë në këtë Kuvend, sistemi pensional dhe beneficionet sociale kanë nevojë për një kodifikim, një kod unik pensional, i cili i përmbledh dhe i rregullon çështjet e skemave pensionale dhe beneficioneve sociale dhe këtu i përmbledhon në një kod, në një reformë të madhe pensionale, e cila i bën sipas nesh disa gjëra.

E para, këtë farë si të them skemën e madhe, numrin e madh të skemave, numrin e madh të ligjeve e shndërron në një. E dyta, sigurohet që meritoret i marrin beneficionet edhe pensionale edhe sociale, dhe tre e ka një qasje të themi më barazitare për sa i përket shpërndarjes dhe mbledhjes së kontributeve në skemat pensionale, beneficionet sociale. Mendojmë se me komision të tillë, të gjitha subjektet në këtë Kuvend mund të punojnë së bashku që të sjellin një kod pensional i cili njëherë e përgjithmonë e zgjedh problemet e skemave të shumta pensionale dhe ligjeve të shumta që rregullojnë një temë e që mendojmë ne është tepër me rëndësi, le të themi i shëndetit buxhetor e qëndrueshmërinë financiare të skemave pensionale dhe beneficioneve sociale. Rrjedhimisht, do të isha shumë mirënjohës nëse Kuvendi i Republikës së Kosovës voton për formimin e këtij komisioni ad hoc për kodifikimin e sistemit pensional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë, kërkesa e propozuesve është që Komisioni ad hoc të formohet në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Është një sqarim procedural të cilin të gjithë e dini. Ju njoftoj se sipas marrëveshjes, të cilën e kemi arritur në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit me nënkryetarët e grupeve parlamentare më 5 dhjetor 2017, kryesimi i Komisionit ad hoc do të bëhet me radhë sipas formulës për ndarjen e komisioneve.

Për kryesimin e komisionit radhën e ka Partia Socialdemokrate, e cila e propozon kryetarin. AAK-ja e propozon zëvendëskryetarin e parë. Lista serbe e propozon zëvendëskryetarin e dytë.

Grupi Parlamentar i LDK-së, dy anëtarë. Grupi Parlamentar i PDK-së i propozon dy anëtarë. Lëvizja Vetëvendosja, dy anëtarë. Nisma një anëtar dhe 6+ një anëtar.

E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të PSD-së ta propozojë kryetarin e këtij komisioni. Zonja Shqipe Pantina, urdhëroni!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Siç duket kur e ke qëllimin e mirë edhe fati pastaj është në anën tënde, sepse besojmë se ne e kemi njeriun më të thirrur që e njeh mirë fushën e sistemit pensional. Prandaj, e propozojmë edhe të jetë kryesues i këtij komisioni, ai është Dardan Sejdiu, shefi ynë i grupit parlamentar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zëvendëskryetarin e parë, ju lutem!

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryetar!

Ne e propozojmë ekspertin Blerim Kuçi për nënkryetar.

KRYETARI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, dy ekspertë!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

E harruat nënkryetarin e dytë, partnerin tuaj të koalicionit Listën serbe, po faleminderit që e kalove radhën.

Kryetar i Kuvendit, unë besoj që ju e keni për detyrë edhe në interpretimin e Rregullores së punës, por edhe t'i ruani edhe praktikën e mira parlamentare, edhe funksionimin korrekt të komisioneve parlamentare sipas rregullores të cilat janë të votuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

E para, unë i kuptoj kolegët e mi nga PSD-ja, sepse janë për herë të parë në Kuvendin e Kosovës. Mund të kenë mungesë të përvojës, nuk po e them për qëllim të keq dhe mos ta marrin personale. Është e drejtë e tyre që të bëjnë politikë edhe të hapin tema të cilat edhe për mendimin tonë janë të rëndësishme siç është Kodi Pensional, sepse duhet vënë një rregull edhe pajtohemi plotësisht.

Por, ajo çka dëgjuam, anëtari i cili e paraqiti këtë propozim, na tregoi që ekziston një koncept-dokument i përgatitur nga ministria përkatëse, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

E dyta, mendoj që deputetët kanë të drejtë të marrin nisma legjislative, 6 deputetë e më shumë apo 1 i mbështetur nga 6, dhe kjo mundësi ekziston. Atëherë, autorizohet Qeveria që ta hartojë Kodin Pensional. Ta sjellë në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ekziston Komisioni

Funksional për Punë, Mirëqenie Sociale dhe Shëndetësi. Janë anëtarët nga të gjitha grupet politike dhe kontributi parlamentar do të jetë aty.

Tash, kështu qysh keni filluar ju me komisione ad hoc për çdo situatë dhe duke krijuar mekanizma shtesë, mendoj që nuk jeni duke u kontribuar praktikave të mira parlamentare. Andaj, LDK-ja rezervohet që sonte t'ju jep emra të caktuar, sepse nuk po e shohim serioze. Këtë më shumë po e shohim si njëloj propagande edhe partiake.

Këto pjesët tjera, shantazh, kështu nuk po dua që t'i përmend, pro mendoj që e kemi një ministri, e cila e ka për detyrë ta menaxhojë skemën pensionale në Republikën e Kosovës.

Tash, ky kompozim i ri, është përzierje e kompetencave të plota. Është edhe ministri i Financave këtu i pranishëm, kryeministri i Kosovës dhe mendoj që jeni duke krijuar trupa paralele, të cilët vetëm e devalvojnë punën parlamentare dhe të komisioneve parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Sa i përket asaj, që të jem korrekt dhe të jem i qartë, ne e përkrahim çdo iniciativë që vë rregull në sistemin pensional në Republikën e Kosovës, por jo në këtë formë duke tentuar që në emër të meritave të krijohet kaos apo të vazhdohet kaos sa u përket skemave pensionale.

**KRYETARI:** Kryetari i Grupit Parlamentar të Listës serbe, e ftoj që ta paraqesë zëvendëskryetarin e dytë. Po më duket që nuk është.

Atëherë, i nderuar kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Memli Krasniqi, dy anëtarë. Dy ekspertë!

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit, zoti kryetar!  
Edhe ne në këtë komision ad hoc i propozojmë deputetet Safete Hadërgjonaj dhe Flora Brovina.

**KRYETARI:** Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, dy anëtarë po ashtu.

**FATMIRE KOLLÇAKU:** Faleminderit!  
Siç e dini, Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka udhëhequr Lëvizja Vetëvendosje pas marrjes së mandatit.

Pikërisht unë kam qenë shumë e angazhuar që ta kemi ne këtë komision nën udhëheqje për shkak të dy sferave, besoj shumë të rëndësishme që i mbikëqyr ky komision, dy ministri siç është Ministria për Punë dhe Mirëqenie dhe ajo e Shëndetësisë.



Siç e dini, pjesa e atyre që e braktisën Lëvizjen, tani e udhëheqin këtë komision dhe më habit fakti sesi kërkojnë të formohet një komision ad hoc, duke e ditur që e kemi Komisionin Funkcional që e udhëheqin vetë për momentin.

Sigurisht se nuk do t'ju pengonte që ekspertët t'ju japin ndihmë për reformën të cilën ne jemi të informuar që aktualisht është duke e bërë Ministria për Punë dhe Mirëqenie, dhe na kanë paraqitur edhe në agjendën legislative, që aktualisht është duke u marrë grupi punues brenda Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie dhe Kuvendi e ka rolin e vet.

Nuk na pengon asgjë që të merremi edhe ne si Kuvend, pra me Komision Funkcional. Prandaj, ne duke e parë plotësisht të paarsyeshme këtë iniciativë, nuk do të marrim pjesë. Nuk e shohim të arsyeshme që të delegojmë anëtarë në një komision të panevojshëm duke e pasur Komisionin Funkcional.

**KRYETARI:** Faleminderit! Nisma Socialdemokrate e propozon një anëtar. Urdhëro, Bilall Sherifi!

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, kryetar!

Ju e dini të nderuar deputetë që Ministria e Punës dhe Mirëqenie Sociale ka punuar pothuajse një vit në një projekt së bashku me shumë organizata ndërkombëtare të cilat kanë ndihmuar që të përgatitet një planprogram i tillë.

Meqë deputeti Enver Hoti është anëtar i Këshillit Ekonomi Social dhe është shumë mirë i familjarizuar me temën, besoj që do të jetë një ndihmesë e madhe për këta të cilët i propozuan partitë politike. Do t'ju ndihmojë për t'ua sqaruar atë që deri më tani ka punuar Ministria e Punës edhe Mirëqenies Sociale.

Prandaj, e propozojmë deputetin Enver Hoti.

**KRYETARI:** Faleminderit! Grupi Parlamentar 6+, Albert Kinolli, 1 anëtar.

**ALBERT KINOLLI:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Duke e pasur parasysh se po nevojitet që në këtë komision ad hoc të jenë ekspertë të fushës, edhe ne propozojmë që si anëtar i këtij komisioni të jetë eksperti nga 6+, Fikrim Damka.

**KRYETARI:** Faleminderit! Ne i morëm emrat. Tash jemi në procedurë të votimit. Regjia dhe deputetët përgatiten për votim. Administrata, thirrini deputetët!

Deputetë të nderuar, përgatitemi për votim. Janë 88 deputetë, 89. Votojmë tash!

Kanë votuar 63 deputetë, 61 për, 2 abstenime.

Kuvendi e formoi Komisionin ad hoc për përpilimin e Kodit për rregullimin dhe menaxhimin e fushës së pensioneve dhe beneficioneve nga sigurimi social.

## **7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit mbi ndarjen buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019**

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

Ndërsa Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka konstatuar se projektligji nuk i cenon të drejtat dhe interesat e komuniteteve, por nuk e ka përkrahur amendamentin 100, propozimi a.

Zonja deputete Safete Hadërgjonaj, ju lutem paraqitni dhe arsyetoni raportet me rekomandime në emër të Komisionit të Buxhet dhe Financa.

**SAFETE HADËRGJONAJ:** Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka afruar raportin me amendamente për projektbuxhetin e vitit 2019.

Para se ta arsyetoj këtë raport me amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, unë dua fillimisht ta falënderoj ministrin e Financave, zotin Bedri Hamza, i cili bashkë me stafin e tij kanë marrë pjesë në të gjitha takimet e grupeve punuese, duke dhënë një kontribut të çmuar në plotësimin e bërë në draft-buxhetin sipas kërkesave, të cilat i janë drejtuar Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Dua të falënderoj dhe të gjithë deputetët e anëtarët e Komisionit për Buxhet dhe Financa si dhe stafin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për punën me profesionalizëm dhe me korrektësi që kanë bërë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa për të shqyrtuar Projektligjin numër 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, ka formuar dy grupe punuese, të cilat kanë mbajtur disa takime punuese, ku janë shqyrtuar të gjitha kërkesat buxhetore të organizatave buxhetore të nivelit qendror dhe lokal dhe si rezultat janë përkrahur kërkesat e

arsyeshme në funksion të rindarjeve buxhetore në fusha dhe sektorë ku përfitojnë drejtpërsëdrejti qytetarët e Republikës së Kosovës.

Në takimet e grupeve punuese dhe të komisionit kanë qenë prezentë ministri i Financave dhe zyrtarët e Departamentit për Buxhet të Ministrisë, të cilët kanë dhënë arsyetimet, sqarimet dhe kontributin shumë konstruktiv në të gjitha çështjet e trajtuara nga komisioni dhe, në veçanti në propozimin e shkurtimeve buxhetore për të mbuluar propozimet për rindarjet e reja buxhetore brenda buxhetit të vitit 2019 dhe parashikimeve për vitin 2020 dhe 2021.

Komisioni gjithashtu ka shqyrtuar të gjitha amendamentet e propozuara nga deputetët, komisionet dhe grupet parlamentare që i janë adresuar komisionit dhe të gjitha kërkesat që kanë qenë të arsyeshme për të gjitha projektet që janë në proces të realizimit komisioni i ka përkrahur dhe ka rekomanduar për ndarjen e buxhetit të nevojshëm për vitin 2019 dhe dy vjetët vijuese.

Pas përfundimit të punës komisioni ka propozuar 318 ndryshime në draftbuxhet. Ndryshimet e propozuara kanë të bëjnë me riorientimin e buxhetit në fushën e rregullimit dhe mbrojtjes së mjedisit, në përmirësimin e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit, në rregullimin e shtretërve të lumenjve dhe mbrojtjen e tyre nga vërshimet, në zhvillimet e kulturës dhe trashëgimisë kulturore të arsimit dhe të edukimit përmes financimit të ndërtimit të shkollave të reja, në përkrahjen e sportit përmes financimit të rregullimit të stadumeve, palestrave dhe sallave sportive, për mbështetjen e projekteve në shëndetësi dhe si rezultat janë ndarë mjete për blerjen e pajisjeve për onkologji dhe për blerjen e aparaturave në Institutin e Anatomisë Patologjike për të ofruar shërbime të diagnostikimit të sëmundjeve malinje.

Në kuadër të fushës së shëndetësisë, Fondi për Sigurime Shëndetësore është bërë organizatë e pavarur buxhetore që është në funksion të funksionalizimit të punës së tij.

Mjetet buxhetore janë ndarë edhe në përkrahjen e asistencës sociale, respektivisht janë ndarë mjete për shpenzimet bazike për strehimoret për gra dhe fëmijët nga dhuna në familje dhe viktimat e trafikimit.

Janë specifikuar projekte për komunitetet joshumicë, si dhe në përmirësimin e infrastrukturës dhe shpërndarjen e projekteve në komuna të ndryshme të Kosovës dhe aty ku është e nevojshme.

Komisioni ka rekomanduar që të ndahet numër i ri i punësuarve në disa komuna, veçanërisht në sektorin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, për shkak të rritjes së numrit të nxënësve, siç është rasti në komunën e Fushë-Kosovës, por edhe në sektorin e shëndetësisë.

Po ashtu janë përkrahur kërkesat e arsyeshme buxhetore të agjencive të pavarura, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe fuqizimit të tyre.

Me propozimin e Ministrisë së Financave projektet kapitale që financohen përmes klauzolës së investimeve janë transferuar nga ministritë në komunat përkatëse.

Më duhet të theksoj se me ndryshimet e propozuara është bërë e mundur shpërndarja e mjeteve buxhetore në financimin e projekteve kapitale, ku përfitojnë drejtpërdrejt qytetarët dhe në shtrirjen më gjithëpërfshirëse në nivel vendi.

Si rezultat i angazhimit dhe punës intensive, komisioni ka arritur ta shqyrtojë pjesën tekstuale dhe tabelat e projektbuxhetit dhe Kuvendit i ka propozuar raportin me amendamente për miratim.

Gjithsej raporti përmban 156 amendamente, prej të cilave 127 amendamente janë të komisionit, përfshirë këtu edhe amendamentet e deputetëve, të cilët e kanë marrë përkrahjen nga Komisioni për Buxhet, janë 13 amendamente me nga dy propozime, përfshirë këtu propozimet e komisionit dhe propozimet e deputetëve dhe komisioneve parlamentare. Ndërsa amendamentet nga 128 deri në 156 janë pa përkrahjen e komisionit.

Të nderuar deputetë,

Komisioni rekomandon që të përkrahen amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe amendamentet e tjera me përkrahje të komisionit. Ndërsa ato amendamente, të cilat nuk janë përkrahur nga komisioni, rekomandojmë të mos miratohen, pasi që nuk janë të mbuluara me ndarjet apo shkurtimet buxhetore. Nuk i përmbushin kushtet teknike dhe nuk ka mbulueshmërinë e buxhetit nga kursimet e brendshme.

Miratimi i ndonjë amendamenti të tillë nënkupton tejkalimin e ndarjeve të kufijve të buxhetit dhe pamundësinë e financimit të këtyre projekteve.

Të nderuar deputetë,

Meqenëse ka pasur një numër të madh të amendamenteve që është një rast specifik në këtë buxhet, me gjithë këto ndryshime të cilat janë bërë, janë lëshuar edhe disa gabime në katër amendamente.

Unë dua t'jua lexoj secilin një nga një, janë krejtësisht gabime teknike.

Tek amendamenti 16 është bërë një gabim të referenca e shumave në projektbuxhet. Ndryshimi që duhet të bëhet është “Shuma një milion e 805 167 euro” duhet të jetë 2 milionë e 599 mijë e 167 dhe shuma 2 milionë e 305 mijë e 167 euro, duhet të ndryshohet në 3 milionë e 999 mijë e 167 euro. Pra, vlera totale nuk ndryshon dhe mbetet siç është rekomanduar në komision, 500 mijë euro.

Amendamenti 18, pika 1.28, në projektin e ri të shtuar “ndërtimi i impianteve të mbeturinave ricikluese në Suharekë për vitin 2020 shtohet shuma 700 mijë euro”.

Tek amendamenti 106, pika 1.1, shuma e referuar në projektbuxhet është gabim, në vend të shumës “3 milionë e 73 mijë e 312 euro”, ndryshohet në “3 milionë e 75 mijë e 312 euro”. Pra, ndryshimi është se numri 3 duhet të bëhet 5.

Në amendamentin 113, në fund të tekstit të projektit “Shpronësime” shuma prej 650 mijë eurove ndryshon në shumën “580 mijë euro”.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj që t’i miratoni amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa, së bashku me këto plotësime teknike, të cilat i paraqita para jush. Ju falënderoj të gjithëve për punën dhe kontributin dhe uroj që buxheti të përkrahet dhe të miratohet, ato amendamente të cilat i ka përkrahur Komisioni për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 156 amendamente.

Unë kisha propozuar mocion procedural për votimin aty ku mundemi, ku janë amendamentet bashkë në përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, ato të cilat po ashtu janë nga deputetë të caktuar me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL t’i vëmë në pako, ato të cilat janë pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, shkojmë një për një.

A shkojmë mocion procedural, votojnë deputetët, i kisha lutur të kthehen në sallë, të votojnë, për arsye se tash është procedurë votimi.

Regjia, zilja, deputetët le të kthehen në sallë dhe shkojmë në proces të votimit. Në rend të parë e bëj në mënyrë elektronike mocionin procedural, pastaj shkojmë në votim në bazë të vendimmarrjes suaj.

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi në votimin e mocionit procedural, i cili i krijon mundësi seancës, përkatësisht juve, deputetë të nderuar, t’i votojmë në pako projektligjet. Janë duke ardhur deputetët.

E di se ka kaluar mesnata, po ligji ka të bëjë me interesat vitale të qytetarëve. Deputetë, kthehuni në sallë!

82 deputetë janë në sallë, a ka mundësi të kthehen edhe të tjerë, do të presim edhe pak, pastaj prapë i kemi te amendamentet, të mos na dështojë.

Po votojmë mocionin procedural, a të shkojmë në votim? 87 deputetë janë.

Përgatitemi për votim, mocionin procedural, votojmë tash! Kalon mocioni procedural.

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara në bazë të vendimmarrjes së seancës, mocion procedural.

Deputetët të kthehen në sallë, ju lutem, kryetarët e grupeve parlamentare, le t'i kthejnë deputetët në sallë, ata të cilët janë në ndërtesën e Kuvendit.

Amendamentet nga 1 deri 5, në pjesën tekstuale të projektligjit janë propozuar nga Komisioni FunkSIONAL, pastaj amendamenti nga 6 deri 56 dhe 106 deri 119 dhe amendamenti 127 në pjesën tabelore të projektligjit janë propozuar nga Komisioni FunkSIONAL.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim këto amendamente, të cilat i theksova më lart, i votojmë bashkërisht, votojmë tash!

72 deputetë kanë votuar, 72 janë për. Kalojnë këto amendamente.

Edhe në mënyrë publike thërras administratën të më përcjellë si udhëheqës i kësaj seance, në qoftë se bëj ndonjë lëshim në amendamentet e propozuara.

Do të mundohem t'i hedh në votim, në qoftë se pranojnë deputetët të gjitha amendamentet e deputetëve që janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Të mos i përmend një nga një. Do të thotë, të gjitha amendamentet me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Administrata, më përcjell, ju lutem, regjia.

Jemi tek amendamenti 58, se nuk i kam të ndara, të lutem, vetëm pak!

Amendamenti 58 deri në amendamentin 81, edhe një herë kërkoj nga administrata, a është në rregull, ta vë në pako votimin, 58 deri në amendamentin 81, përfshirë amendamentin 81, të keni parasysh. 58 - 81 përfshirë, votohen në pako, janë propozime të deputetëve, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!

68 deputetë kanë votuar, 67 për, një abstenim, kaluan të gjitha.

Amendamenti 86 po ashtu do ta vë në pako me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL 87, vëmendje 88, me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, 90, 91, 92, 93, 94, 96, vëmendje 101, 102, 103, 105, 120, 121, 122, 123, 125, 126, të gjitha këto shkojnë në pako, janë propozime të deputetëve, amendamente të deputetëve me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, i votojmë të gjitha bashkë, votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar, 65 për, të gjitha kalojnë.

Tani kisha dëshiruar, deputetë të nderuar, shkojmë një nga një, janë amendamente të propozuara pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Rastet kur janë dy propozime në bazë të rregullës e votojmë, cila fiton më shumë, Zafir, ai kalon, variacioni a ose b. Po, të lutem, zonja Safete Hadërgjonaj!

**SAFETE HADËRGJONAJ:** I nderuar kryetar!

Tek amendamentet, të cilat janë dy propozime: propozimi a dhe propozimi b, unë i kisha ftuar të gjithë deputetët ose komisionet që kanë bërë kërkesa të tilla ta tërheqin variantin e dytë, sepse amendamentet e tyre janë të përfshira në variantin e parë, mirëpo disa kanë ndryshime të vogla në shumë apo disa, meqenëse i kanë pasur të përcaktuara mjetet prej nga merren për t'u financuar projektet e caktuara, ka mbetur që ministri i Financave të gjejë burimin e financimit, çka do të thotë që ato janë të përkrahura nga komisioni, prandaj kisha ftuar ata deputetë apo komisionet që të tërhiqen në variantin e dytë e të shkojmë me variantin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

**KRYETARI:** Zonja zëvendëskryetare e komisionit, unë do t'u jap mundësinë në mënyrë vullnetare, a ka ndonjë nga deputetët, të cilët kanë paraqitur amendamentet e propozuara pa përkrahje të Komisionit FunkSIONAL që dëshirojnë t'i tërheqin, urdhëro, Bekim Haxhiu.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Duke e falënderuar Komisionin për Buxhet dhe Financa për punën që ka bërë, bashkë me ministrin Hamza dhe kolegët e tjerë, për shkak që Komisioni FunkSIONAL, ashtu siç e tha nënkryetarja Safetja, ka përfshirë amendamentin, i cili ka qenë për parkun e biznesit në Marinë, për ndërtimin e sallës së edukatës fizike të shkollës "Shaban Jashari" në Skenderaj, në "Fazli Grajçevci" në Shipol dhe "Azem Bejtës" në Prekaz të Epërm dhe "Anton Çetës" në Skenderaj, janë të përfshira, amendamenti 82 dhe 83 propozoj të votohen sipas Komisionit FunkSIONAL, sepse vetëm kanë ndryshuar formën e financimit për projektet e njëjta.

**KRYETARI:** Atëherë, të nderuar kolegë deputetë, kemi dy propozime: amendamentin 82 dhe 83, pas tërheqjes të deputetit Bekim Haxhiu janë vetëm me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, po i vendos në pako, më duket edhe Fikrim Damka e pati një propozim t'i vendos në pako. Urdhëro, zoti Damka! Po edhe Dardan Sejdiu.

**FIKRIM DAMKA:** Faleminderit, kryetar!

Edhe ne si Grupi Parlamentar 6+ te amendamenti 100 tërheqim variantin b, të mbetet varianti a, i cili është i Komisionit FunkSIONAL, i cili e ka formuluar.

**KRYETARI:** Zoti Damka, folëm për amendamentin 100, në rregull e kuptuam. U tërhoq propozimi i Grupit Parlamentar 6+, ka mbetur i Komisionit FunkSIONAL. Zoti Dardan Sejdiu, fjala për ju.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Pas konsultimeve që kanë ndodhur mes Ministrisë së Financave, përkatësisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Prishtinës unë e tërheq amendamentin 104, pra variantin b, amendament ky i cili ndërlidhet me Rrugën A. Kështu që, pasi që ka marrëveshje mes Komunës dhe ministrive përkatëse, atëherë jam dakord që të procedojmë vetëm me amendamentin sipas përkrahjes së komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: A ka tjetër reagim të deputetëve? E nderuara zonja Duda Balje, po shkojmë së pari me zonjat, pastaj Veton, menjëherë tek ju. Duda Balje urdhëroni!

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Moja malenkost i poslanik Bahrim Šabani imali smo zahtev u ovoj Funkcionalnoj komisiji za Duv u opštini Prizren za klisuru i tražili smo 1,5 milion, međutim komisija je odvojila 700 hiljada i mi povlačimo naš amandman, jer zadovoljni smo time.

KRYETARI: Cili numër është?

DUDA BALJE: Amandman 84.

KRYETARI: Zoti Veton Berisha, po ashtu, urdhëroni!

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Deputetë,

Po ashtu edhe unë e tërheq amendamentin 148, i cili po ashtu nuk e ka pasur përkrahjen e komisionit, për shkak se jemi dakorduar që ministrinë e linjës, çështjet që unë i kam shtruar do të ndërmarrin veprime dhe shumë çështje janë paraparë me amendamentin, i cili u përkrah. Ka pasur përkrahje, i cili është amendamenti 101, domethënë unë e tërheq 148, sepse disa prej çështjeve janë përfshirë në amendamentin 101. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka të tjerë deputetë vullnetarë? Enver Hoti, po ashtu.

ENVER HOTI: Faleminderit, kryetar! Në fakt, unë i kam dy çështje. Në fillim dua t' ju kërkoj falje deputetëve dhe kërkoj një mbështetje nga ministri i Financave. Amendamenti 121, i cili ka të bëjë me organizatën buxhetore Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, është një shumë e shtuar që është në vlerë 200 mijë euro, që ka kaluar me përkrahje të Komisionit për Buxhet dhe Financa, e cila është e dedikuar në promovimin e turizmit.



Në tabelat është vendosur në kategorinë e ‘mallrave dhe shërbimeve’, nëse kisha pasur mundësinë të mbështetem që ky destinim të kalojë në mbështetje të promovimit për turizëm, për çka edhe ka marrë mbështetjen në Komisionit për Buxhet. Por, unë mendoj që nëpërmes kësaj kategorie nuk mund të jetë në qëllimin e caktuar. Nëse ka mundësi që deputetët ta votojnë, duke e adresuar në investime kapitale brenda organizatës buxhetore, nuk ka asnjë ndryshim dhe nuk bën asnjë, ministër, nëse kishe pasur mundësi një sqarim të shkurtër ose le të mbetet në seancë.

KRYETARI: Zoti deputet, ne e kemi kaluar, ta kesh parasysh, ne e kaluam në votim 121-shin, ju e kaluat më herët. E rregullon ministri, por e kemi kaluar. A ka tjetër, po urdhëro, Enver!

ENVER HOTI: Sa i përket amendamentit tim 142, që është pa përkrahje të Komisionit për Buxhet dhe Financa, unë e tërheq, ashtu jemi pajtuar dhe e tërheq. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Faton Topalli, fjala për ju.

FATON TOPALLI: Faleminderit, kryetar!

Unë kam kërkuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që të rrisë numrin e inspektorëve të punës, meqë Komisioni Funkcional e ka plotësuar pjesërisht këtë kërkesë dhe duke pasur parasysh që propozimi im nuk mund të kalojë, unë e tërheq amendamentin 95b.

KRYETARI: Atëherë, 95b tërhiqet. A ka të tjerë vullnetarë? Nait Hasani, po e shoh reagimin, urdhëro zoti Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni Funkcional nuk e ka marrë komplet amendamentin që e kam bërë dhe e ka ndarë në vija buxhetore në shumën që nuk mund të realizohet, prandaj për vitin 2019 300 mijë euro, për vitin 2020 200 mijë, rruga që është prej 8km në Pashtrik prej Planejës deri te Likeni i Hasit e varrezat e rënies së dëshmorëve atje, Mujë Krasniqit, Kapuçit, është e pamundur të realizohet me këtë buxhet. Prandaj, amendamentin e kam bërë që shuma buxhetore për këtë rrugë është 700 mijë dhe ky është minimumi, por megjithatë duhet të shtohet edhe kjo, nëse duhen të bashkohen po, përndryshe unë kërkoj t'i shtohet ose të votohet amendamenti.

Nëse komisioni pranon ose ministria pranon që këto shtesa të plotësohen, jam në rregull, nëse jo, po kërkoj që të hyjë në votim amendamenti. Nuk e kam ndërmend të tërhiqem.

KRYETARI: Zoti Hasani, s'na tregove cili amendament, as cila kërkesë tamam. Specifiko amendamentin!

NAIT HASANI: Amendamenti 98. Janë dy propozime: Komisioni Funkcional që e ka marrë pjesërisht amendamentin tim dhe amendamenti im në b që shkruan në tabelën 3.2. në programin

205070 infrastruktura rrugore, 41-8000 rehabilitimi i rrugëve shtohet projekti i ri rehabilitimi dhe zgjerimi i rrugës Planejë - Mazrek - Likeni i Hasit - rënia e dëshmorëve në shumën 700 mijë euro.

KRYETARI: Nait, të jem më i qartë, ti nuk je duke dashur ta tërheqësh, kur vjen te amendamenti veç, pastaj ua qartëson deputetëve për të lobuar, ta lëmë kështu. Jemi duke folur veç kush do ta tërheqë një herë. A ka tjetër kush tërheqje propozimi? Urdhëroni, Sami Kurteshi dhe Blerim Kuçi, Rasim Selmani.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryetar!

Është fjala për amendamentin 57, këtu janë dy propozime: propozimi varianti b është një propozim që kemi bërë unë dhe deputetja Arbërie Nagavci. Ka të bëjë me një program për strehimorët, për mbrojtjen nga dhuna në familje, meqenëse po e shoh që për herë të parë Komisioni Funkcional e ka tejkaluar shumën që ne e kemi kërkuar për këto strehimore, me shumë kënaqësi ne e tërheqim amendamentin.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, jemi te amendamenti 57, mbetet vetëm i Komisionit Funkcional, do të thotë, largohet variacioni b. A shkojmë një herë t'i votojmë këto që administrata të më përcjellë.

Amendamentet 82, 83, 84, 100, 104, 95a dhe 57 janë të gjitha me përkrahje të Komisionit Funkcional, 142 dhe 148 largohet, s'ka nevojë të votohen. Largohen krejt, atëherë s'ka nevojë në votim.

Edhe një herë i përsëris: 57, 82, 83, 84, 95, 100, 104 kanë mbetur veç amendamentet me përkrahjen e Komisionit Funkcional, i votojmë tash, bashkë në pako.

65 deputetë. 65 për. Kalojnë të gjitha! Do të thotë, amendamentet 142 dhe 148 janë larguar nga vetë propozuesit.

Shkojmë tani 97, janë dy propozime: do të shkojmë në votim të dyfishtë. Propozimi i parë çdoherë votohet i Komisionit Funkcional.

Amendamenti 97 me përkrahjen e Komisionit Funkcional, votojmë tash!

65 deputetë, 65 deputetë kanë votuar për.

Jemi në amendamentin 97. Deputeti Hajdar Beqa, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, duhet të votojnë 61, përndryshe bllokohemi. Votojmë tash!

Ky është rezultati, do të thotë, kalon propozimi i Komisionit Funkcional, amendamenti 97.

Rikthehem tek amendamenti 85, pashë që janë dy propozime. Propozimi i Komisionit Funksional, votojmë tash!

Ky është rezultati: 64 deputetë. 64 për.

Varianti b është i deputetes Hykmete Bajrami, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Ky është rezultati. Kalon propozimi i Komisionit Funksional.

Jemi në amendamentin 89. Tani dy propozime, po ashtu, i Komisionit Funksional nën a, votojmë tash!

Ky është rezultati i votimit: 66 deputetë. 65 për. 1 kundër.

Jemi tani në variantin e propozuar nga zonja deputete Arbërie Nagavci, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

E shihni edhe vetë rezultatin, kalon amendamenti 89, varianti a, i Komisionit Funksional.

Jemi në amendamentin 98, po ashtu janë dy propozime: varianti a i Komisionit Funksional, votojmë tash!

65 deputetë kanë votuar. 62 për. 2 kundër. 1 abstenim.

Tani e kemi variantin b, të propozuar nga deputeti Nait Hasani, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Urdhëro, zoti Nait.

**NAIT HASANI:** Faleminderit, kryetar!

Po kërkoj që shuma që është këtu, që e kemi vendosur në amendament, është e realizueshme për projektin atje, ndërsa komisioni që ka bërë amendamentin, që i ka marrë elementet e amendamentit tim të rrugës nuk i plotëson këto kushte, prandaj kërkoj që amendamenti im të votohet dhe të plotësohet projekti. Përndryshe, një projekt do të mbetet në gjysmë. Prandaj, të mbetet një rrugë në gjysmë, për rrugën atje në Pashtrik, është e pamundshme të shkohet deri te varrezat e dëshmorëve, rënia e tyre atje. Për këtë po kërkoj që të votohet amendamenti, sepse do t'ua mundësojë të gjithë familjarëve dhe një histori të luftës sonë pikërisht atje, ku kanë rënë 41 dëshmorë. Po kërkoj që ta votoni amendamentin dhe të realizohet si projekt i mirëfilltë, edhe të kenë mundësi qytetarë dhe familjet ta vizitojnë atë vend.

KRYETARI: Faleminderit! Jemi në amendamentin 98, propozimi i Nait Hasanit, pa përkrahjen e Komisionit Funksional, votojmë tash!

Ky është rezultati. A ka mundësi veç pak, ministër, kalon amendamenti 98, propozim i Komisionit Funksional.

Amendamenti 99, janë dy propozime: i Komisioni Funksional dhe deputetët...

*(Ndërhyrje)*

Unë nuk mund ta ndërroj, Nait, për besë, precedent, regjia, në qoftë se ka mundësi të amendamenti 98, kam dëshirë që deputetit Nait Hasani t'ia dërgoni rezultatin e të dy votimeve. Në bazë të Rregullores së Kuvendit veprova, përndryshe vota ime ishte pro amendamentit tënd, por kaloi më shumë amendamenti i Komisionit Funksional, për qartësim.

Shkojmë te amendamenti 99. Regjia, ju lutem, ia sjell vendimin.

Amendamenti 99, janë dy propozime: një është i Komisionit Funksional, votojmë amendamentin me përkrahjen e Komisionit Funksional, votojmë tash!

64 deputetë kanë votuar, 63 për, 1 kundër.

Deputetët Arban Abrashi dhe Fidan Rekaliu kanë amendament B pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash! Ky është rezultati i votimit. Kalon amendamenti 99, propozim i Komisionit Funksional.

Tani jemi në amendamentin 104. E kemi kryer 104.

Amendamenti 124. Janë dy propozime, të Komisionit Funksional. Votojmë tash!

61 deputetë, 56 për, 5 kundër, s'ka abstenim.

Varianti i Komisionit për Legjislacion, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. Votojmë tash!

Kalon amendamenti 124, propozim i Komisionit Funksional.

Deputeti Ahmet Isufi, pa përkrahjen e Komisionit Funksional. A e dëshironi fjalën? Urdhëroni z. Isufi! Zoti Isufi, i ke dy amendamente. A dëshiron të dytë përnjëherë, apo ndaras?

AHMET ISUFI: Të dytë përnjëherë.

KRYETARI: Atëherë i arsyeton, atë 128 dhe 129.

AHMET ISUFI: Po, faleminderit!

Në amendamentin 128 është paraparë renovimi i Shtëpisë Muze “Nuhi Berisha” në Sfirçë, që është në pjesën kufitare, por që teknikisht nuk ka dalë emri i muzeut Nuhi Berisha, por vetëm Shtëpia Muze në Sfirçë. Prandaj, unë kërkoj që të ma përkrahni këtë amendament. Është i detajuar, është i deponuar në Ministrinë e Kulturës dhe po ashtu e ka vlerën prej 184 555 euro.

Ndërsa amendamenti 129 ka të bëjë me rrugët e Malësisë së Gollakut të Kamenicës, që ka të bëjë për vitet 2020 dhe 2021, prandaj që edhe ky amendament të përkrahet.

KRYETARI: Unë do t’ia jap fjalën ministrit të Financave, në qoftë se mund ta akomodojmë, veçanërisht te shtëpia e heroit të kombit, Nuhi Berisha. Urdhëro zoti ministër, për arsye se çdoherë duhet të dihet ku t’i marrim paratë, ku i largon që i merr. Ministër në qoftë se ka mundësi. Daut, a dëshiron fjalën? Daut, urdhëro fjalën, pastaj ministri e qartëson. Ministër rri aty, s’prish punë.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Vetëm për nenin 98, se ndoshta edhe nuk u shpjegua saktë më herët nga Naiti. D.m.th. nuk është dhënë shuma e kërkuar, jo që nuk është miratuar në parim. D.m.th. i është ndarë një shumë e caktuar dhe ministri lehtësisht mund ta japë një premtim se do ta rritë vlerën e caktuar për t’u realizuar ai projekt, për shkak se është e ndjeshme. Se po e shoh edhe ministri që po e miraton prej atje. Më fal që të ndërhyra. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti ministër, urdhëro!

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit zoti kryetar!

Siç e tha edhe kryetarja e Komisionit, edhe deputeti zoti Haradinaj, te amendamenti i zotit Hasani është kodi, është shuma, dhe ne japim garanci që në moment kur këto mjete të shpenzohen, ne e rritim deri në nivelin e shumës së kërkuar.

Ndërsa sa i përket amendamentit 128 të zotit Isufi, që ka të bëjë me kullën e Nuhi Berishës, mjetet merren nga Ministria e Financave, nënprogrami Kontigjenca në Ministrinë e Financave, kodi 28900, zvogëlohet kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

KRYETARI: Do të thotë, zoti Isufi vetëm amendamenti 128 është përkrahur, 129 jo. Veç ta kesh parasysh. Unë do t’i vë ndaras në votim, është çështje procedurale. A shkojmë në votim? Nait, urdhëro pasi të është përmendur emri.

NAIT HASANI: Faleminderit ministër që ma dhe mundësinë edhe një herë. Me garanci politike është vështirë, nëse e ke atë mundësi, vendose shumë dhe jemi në rregull. Prandaj, jo garanci politike. Deklaratat politike le të mbeten deklarata politike. Unë të falënderoj shumë për atë që e the, por vendose si shumë.

KRYETARI: Faleminderit! Ndërsa për hir të publikut, ministri e tha shumë mirë. Në momentin kur harxhohen ato të cilat janë dhënë, nuk është ai projekt pa mjete të ndara në amendamentin 98, do të plotësohet i tëri. Tash mund të dramatizohet, por kjo është situata.

Atëherë shkojmë te propozimi i Ahmet Isufit. Amendamenti 128, Shtëpia Muze e heroit të kombit, Nuhi Berisha. Ministri i Financave i arsyetoi prej nga jepen paratë. Do të thotë, e votojmë tash! Faleminderit!

71 deputetë, 70 për, 1 abstenim. Kalon ky amendament.

Amendamenti 129, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash! Vetëm se duhet të dini ku i merrni paratë. Nuk kalon me këtë gjendje.

62 deputetë, 29 për, 26 kundër, 7 abstenime. Nuk kalon amendamenti 129.

Amendamenti 130, deputeti Rasim Selmanaj, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, por me përkrahjen e Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim. Zoti Selmanaj, e dëshiron fjalën, apo shkojmë në votim?

RASIM SELMANAJ: Faleminderit, kryetar!

Unë i kam dy amendamente, 130 dhe 131. Amendamentin 131 e tërheq. Kërkoj nga deputetët që ta përkrahin amendamentin 130, bëhet fjalë për një shumë 50 mijë euro për një fushë sportive në fshatin Shaptej të komunës së Deçanit. Nuk i kalon kufijtë buxhetorë, edhe me ministrin Hamza bisedova, në qoftë se e merr përkrahjen e deputetëve të Parlamentit d.m.th. ka mundësi që këto mjete të gjenden dhe të përkrahjet ky projekt. Kështu që e kërkoj përkrahjen e deputetëve, që kjo shumë simbolike të votohet.

KRYETARI: Rasim Selmanaj ka biseduar edhe me ministrin, e ka edhe zotimin e ministrit të Financave që i gjen mjetet. Ka të bëjë me një projekt i cili është projekt publik për nxënës me aq sa po e marr vesh. Urdhëroni votoni, 131-shin e ka larguar. Urdhëro, z. Abdixhiku!

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

Për hir të korrektësisë dhe procedurave korrekte, ministri duhet të na tregojë tash ku i merr paratë, në qoftë se duam të kemi amendament siç duhet. Përndryshe, duhet të dalë siç është kështu në raport të komisionit.

KRYETARI: Megjithatë, ne deputetët nganjëherë vendosim edhe vetë, pastaj paratë i gjeni. Ministër, a votojmë ne?

Regjia, deputetët përgatiten për votim. Është një projekt i deputetit Rasim Selmanaj, fshati Shaptej, komuna e Deçanit, 50 mijë euro. Votojmë tash!

63 deputetë kanë votuar, 52 për, 3 kundër, 8 abstenime.

Urdhëroni ministër, prej nga i merr paratë, pasi kaloi? Urime zoti Selmanaj!

MINISTRI BEDRI HAMZA: E tha edhe kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, për të qenë amendamenti i plotë duhet të jetë edhe burimi i financimit. Sidoqoftë, për të mos e lënë të paimplementueshëm këtë amendament, pasi nuk është shumë e madhe, përndryshe nuk janë këto praktika që përdoren në seancë, se amendamenti pa burim të financimit ta prishë krejt strukturën, edhe mund ta kthejë buxhetin në lexim të tretë. Ministria e Financave, nënprogrami i Kontigjencave në Ministrinë e Financave, kodi 28900 zvogëlohet kategoria e mallrave dhe shërbimeve.

KRYETARI: Deputeti Etem Arifi i ka amendamentet 132, 133, 134, 135, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. I nderuar deputet, mund t'i radhitësh, mua më tregon si t'i vendosim në votim dhe t'i arsyetoni. Urdhëroni, fjala për ju!

ETEM ARIFI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar dhe respektuar deputetë,

Duke pasur parasysh që komunat nuk i kanë përfshirë në buxhetin e tyre, nuk e kanë paraparë rregullimin e infrastrukturës të komunitetit ashkali, po mendoj vendbanimet ku jetojnë ashkalinjtë, unë po kërkoj nga deputetët që të më mbështetin me këto amendamente. D.m.th. amendamentet 132 dhe 133 kanë të bëjë me rregullimin e infrastrukturës, amendamenti 132 ka të bëjë me rregullimin e asfaltimit dhe të rrugicave të vogla, disa rrugica në komunat Ferizaj, Lipjan, Gjakovë dhe Podujevë. Amendamenti 133 ka të bëjë me rregullimin e infrastrukturës në kanalizim, ujësjellës, ndriçim publik në të njëjtat vendbanime.

Kurse amendamenti 134 ka të bëjë me promovimin e identitetit, d.m.th. në organizatën buxhetore Ministria e Kulturës dhe Rinisë, për promovimin e kulturës, identitetin dhe përkrahjen e klubeve sportive të komunitetit ashkali. Amendamenti 135, në organizatën buxhetore Ministria për Bujqësi ka të bëjë me përkrahjen nëpërmjet granteve të vogla bujqësore për komunitetin ashkali. Duke pasur parasysh që në Ministrinë e Bujqësisë asnjëherë asnjë pjesëtar i komunitetit ashkali nuk ka përfituar projekte ose grante, sepse siç e kemi cekur edhe më herët nuk kanë mundur të

përfitojnë, sepse kanë pasur kritere jashtëzakonisht të rënda, të mëdha. Në këtë rast e kërkoj votën nga deputetët që t'i përkrahin këto amendamente. Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti ministër, fjala për ju. Amendamentet me aq sa e kuptova 132, 133, 134, 135 i arsyetoi deputeti.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kemi marrë në konsideratë me qëllim të përkrahjes së të gjitha komuniteteve dhe të gjitha grupeve politike amendamente dhe i kemi reflektuar. Asnjëherë në procedurat e buxhetit nuk ka pasur numër kaq të madh të amendamenteve me këtë shumë kaq të madhe. Prandaj, zoti deputet, i kemi marrë në konsideratë propozimet tuaja, ka fonde të veçanta që janë në përkrahje të komuniteteve dhe për këto nuk ka burim të financimit. Janë trajtuar në Komision për Buxhet dhe Financa dhe unë i lus deputetët e Kuvendit të Kosovës që për të gjitha amendamentet që janë në vijim pa përkrahjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa nuk ka mundësi të sigurohet shuma e financimit, pasi janë trajtuar në procedura të rregullta.

KRYETARI: Shkojmë në votim. 132, amendamente. Urdhëro z. deputet edhe njëherë.

ETEM ARIFI: Faleminderit, kryetar!

Zoti ministër, nëse ka mundësi që në ato kodet e veçanta së paku të përkrahën së paku këto dy amendamente, sepse rrugicat që janë të shtruara, që nuk janë të asfaltuara dhe nuk janë të shtruara, për ata fëmijë që e përshkojnë në shkollë po kanë telashe të mbërrijnë deri te shkolla, atëherë urdhëro zoti ministër ato kode që the që janë ato mjete përcaktoji për ato rrugica. Tregoji Palit ku t'i marrë, o ministër!

KRYETARI: Ok, është korrekte. Zoti Arifi, ju mendoni, në qoftë se të votohen dy amendamentet, që i përmendni, dy i tërhiqni. Kjo është korrekte. Ministri i Transportit dhe ministri i Financave, a ke kod ku i jep. Dil publikisht zotoi se po e shoh reagimin. Urdhëro!

MINISTRI PAL LEKAJ: I nderuar deputet!

Sa i përket kërkesës suaj, mendoj që për dy amendamente që i keni propozuar dhe keni kërkuar që ta rregulloni infrastrukturën lokale, ne e kemi një kod për bashkëpunim me komunat dhe të jeni të bindur që ne do ta aprovojmë. Faleminderit!

KRYETARI: A po del ministër specifikojë, se është mirë të specifikohet.

MINISTRI BEDRI HAMZA: A ok, në mirëbesim, në rregull jemi.



KRYETARI: Zoti Arifi, a ka mundësi, specifikoji dy amendamentet që i tërhoqe dhe dy që i lë, t'i vë në votim. Jo veç pak, se po dua prej fjalës së tij. Urdhëro!

ETEM ARIFI: Faleminderit edhe një herë kryetar!

Faleminderit ministër Lekaj,

D.m.th. mua po më mbetet, unë i tërheq në fakt amendamentet 134 dhe 135, kështu që për këto dy amendamente faleminderit ministër për përkrahjen tuaj!

KRYETARI: Jo, t'i votojnë deputetët tash, i vendosim 132, 133. Ministri i Transportit e ka treguar fondin nga e merr për t'i realizuar dy projektet. Votojmë tash deputetë të nderuar për 131 dhe 132. Jemi duke i votuar vetëm këto dy. Janë larguar 134 dhe 135. Të jemi korrektë.

Kaluan me 61 vota, 61 deputetë amendamentet 132 dhe 133.

Amendamentet 136, 137, 138, 139, 140, deputeti Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, urdhëroni zoti deputet! Vetëm pak! Ministër, urdhëro, po u desh edhe para votimit. Vetëm ta specifikosh për amendamentet 132 dhe 133.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Jo, jo! Me qëllim që amendamenti të jetë i plotë, pasi Kuvendi votoi dhe i përkrahu, duhet të specifikohet Ministria e Infrastrukturës, kodi që tash është kohë që duhet kërkuar për ta gjetur cili është ai kod, te bashkëfinancimi komunal, administrata bashkë me Ministrinë e Financave le ta gjejnë numrin e kodit, do të thotë financohen nga projektet te Ministria e Infrastrukturës, projektet e bashkëfinancimit komunal me kod kaq e kaq zvogëlohen këto mjete të cilat u aprovuan për amendamentet e deputetit.

KRYETARI: Për specifikim edhe më të qartë. Amendamenti 134 dhe 135 u tërhoqën nga vetë propozuesi. I kemi votuar vetëm 132, 133, me ndërhyrje, përkatësisht qartësimet e mënyrës së financimit nga ministri i Transportit dhe ministri i Financave.

Do të thotë, zoti deputet Haxhiu, tani është fjala për ju amendamentet nga 136, përfshirë edhe 140-shin, të gjithë me radhë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Fillimisht kërkoj që votimi të jetë për gjithsecilin amendament veç e veç pas arsytimit të cilin do ta bëj.

Amendamenti për të cilin po flasim, amendamenti 136 është ngritja e pllakave përkujtimore për të gjithë të rënë për liri dhe pavarësinë e Kosovës. Të fillojmë këtë vit me një shumë prej 200 mijë eurove. Tabelat buxhetore janë të planifikuara ku janë, ku merren për vitet e ardhshme.

Këtu kanë qenë të planifikuara 700 mijë euro te Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së në Kleçkë, Divjakë, në Male të Berishës, nuk mund të harxhohen 700 mijë euro me procedura sivjet.

Prandaj, kemi marrë 200 mijë euro këtu për të filluar me një projekt në bashkëpunim me Agjencinë për Memorialë të Dëshmorëve dhe mendoj që është koha e fundit që ne të vendosim pllaka përkujtimore në vendin e rënies të të gjithë dëshmorëve dhe martirëve në Republikën e Kosovës, sepse këtë vit po hyjmë në vit po hyjmë në vitin e 20-të të lirisë sonë dhe gjurmët e luftës e të të rënëve po humbin përditë.

Prandaj, do të ishte mirë që këto pllaka, ashtu siç është e përshkruar, në bashkëpunim me Agjencinë për Memorialë të Dëshmorëve të marrin mbështetjen e deputetëve dhe të votohen.

**KRYETARI:** Amendamenti 136, deputeti Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Ministër, meqë është çështje e financimit? E ka dhënë edhe propozimin që 200 mijë euro merren nga investimet, të cilat do të bëhen në Kompleksin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Nga shuma 700 mijë euro merren 200 mijë euro dhe barten për këtë projekt, të cilin po e propozon në amendamentin 136, deputeti Bekim Haxhiu.

Deputetë, votojmë tash! Nuk ka vendimmarrje me këtë mënyrë të votimit. I kisha lutur deputetët, votoni po, jo, ose abstenim. Prani ka, e votojmë edhe një herë këtë amendament 136. Votojmë tash!

Edhe një herë, duhet të votojmë 60 deputetë. Votoni në një formë, votojmë tash! Edhe një herë, votojmë tash!

Kjo është vendimmarrja: 63 deputetë, kanë votuar 21 për, 29 kundër, 13 abstenime. Nuk kalon amendamenti 136. Votojmë amendamentin 137 të Bekim Haxhiut, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Urdhëro, zoti deputet!

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Propozimi për këtë amendament është ngritja e shtatores dhe parkut “Fadil Vokrri” në Prishtinë, pranë stadiumit me emrin e tij.

Po flasim për një njeri i cili ka dhënë shumë për futbollin e Kosovës, një projekt i cili duhet ta ketë votën tuaj, sepse besoj që të gjithë ndihemi krenarë me punën dhe veprën e Fadil Vokrrit. E kërkoj votën tuaj.

**KRYETARI:** Vetëm mënyrën e financimit?

BEKIM HAXHIU: Dua ta sqaroj, te gjithsecili amendament, i nderuar kryetar, te cilin e kam propozuar, kam planifikuar ku merren mjetet dhe ku shtohen. Nuk ka asnjë implikim, as ndryshim të tabelave buxhetore, as nuk e rrezikon buxhetin.

Prandaj, kërkoj votën tuaj, sepse të gjithë...

KRYETARI: Sa është shuma, bëjua me dije deputetëve?

BEKIM HAXHIU: Në tërësi 200 mijë euro.

KRYETARI: 200 mijë euro. Atëherë, ministër, a ka ndonjë reagim, apo të shkojmë në votim. Shkoni drejt në votim, votojmë tash për "Fadil Vokrrin". Votoni ju lutem se... Edhe një herë duhet të votohet. Votoni, 61 deputetët duhet të votojnë për ta marrë validitetin e votës suaj.

Edhe një herë, ka të bëjë me parkun "Fadil Vokri", afër stadiumit "Fadil Vokri", në Prishtinë. E ka specifikuar, vendimmarrja është e juaja. Votojmë tash!

Urime! 65 deputetë, 47 për, 12 kundër, 6 abstenime. U përkrah ky amendament për "Fadil Vokrrin".

Deputeti Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, amendamenti 138. Urdhëroni, zoti Haxhiu! Po, mjaft amendamente të kaluan.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Nuk janë për mua, janë për qytetarët. Bëmë diçka për një njeri, i cili ka dhënë kaq shumë për futbollin.

Amendamenti 138 është te Ministria e Infrastrukturës, biseduam edhe ministrin Pal Lekaj, është i dakorduar, sepse po flasim për projektin e rrugës Pantinë - Frashër.

Zakonisht edhe komuna e Vushtrisë, edhe ajo e Mitrovicës e harrojnë, sepse po flasim për një rrugë që është në mes dy komunave, prandaj kërkoj mbështetjen tuaj. Planifikimet janë në detaje dhe nuk ka implikim të madh buxhetor. Po flasim për një rrugë në vlerë prej 100 mijë eurove.

KRYETARI: Ku merren paratë? Ta qartësojmë, ose duhet ta pyesim ministrin e Transportit se nga merren. Urdhëro, deputet!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

100 mijë euro merren te qarkorja e Malishevës dhe nuk bëhet ndonjë ndryshim i madh në buxhet, përveçse e bëjmë një qarkore mes Mitrovicës edhe Vushtrisë.

KRYETARI: Shkojmë me votimin e amendamentit të deputetit Bekim Haxhiu, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Amendamenti 138, votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 14 për, 34 kundër, 13 abstenime. Nuk kalon amendamenti i Bekim Haxhiut.

Amendamenti 139, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL... Urdhëroni, zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Amendamentet 139 dhe 140, po flasim për dy amendamente; pishina gjysmë-olimpike në Skenderaj, shuma 50 mijë euro, dhe po flasim për poligonin multifunkSIONAL, janë në dakordim të plotë me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe me kryetarin e Komunës, Bekim Jashari.

Planifikimet janë se ku merren mjetet dhe ku shtohen. Asnjë ndryshim nuk ka. Jam në bashkëpunim me kryetarin e Komunës dhe me ministrin.

KRYETARI: Atëherë, po e shoh se e kemi edhe një amendament 139, votojmë tash!

60 deputetë kanë votuar. Edhe një herë do të votojmë amendamentin 139, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 16 për, 35 kundër, 10 abstenime. Nuk kalon amendamenti 139.

Deputeti Bekim Haxhiu, amendamenti 140.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Është poligoni sportiv multifunkSIONAL. Është në dakordim të plotë, edhe një herë që t'i sqaroj të gjithë deputetët, me ministrin e Kulturës, Rinisë, Sportit. Mjetet merren nga qendra sportive në Firajë, për të cilën janë planifikuar 300 mijë euro. Atje mbeten 200 mijë, këtu bëhen 100 mijë. Ashtu-kështu janë të planifikuara dhe asnjëherë këto projekte asnjë prej ministrive nuk po arrin as t'i fillojë brenda vitit kur po ua ndajnë mjetet.

Nëse arrijnë t'i shpenzojnë 100 mijë euro sivjet sigurisht që është sukses, nëse e përfundojmë këtë projekt në vitin 2020. Prandaj, e kërkoj votën dhe mbështetjen tuaj të nderuar kolegë deputetë, dhe tuajën kryetar.

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Amendamenti 140, votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar, 12 për, 38 kundër, 12 abstenime. Nuk kalon amendamenti 140, për fat të keq.

Amendamenti 141, zoti Bekim Haxhiu, i fundit i juaji. Megjithëse ka kaluar shumë amendamente ky vetë.

**BEKIM HAXHIU:** Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kjo është paksa jashtë domenit të infrastrukturës edhe sportive, por është për instrumentet muzikore për ansamblet e Kosovës.

Shumat të cilat janë të planifikuara janë për instrumentet muzikore për ansamblet e Kosovës, të cilat asnjëherë nuk janë mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Artistët tanë performojnë nëpër këto ansamble me vegla të huazuara, nganjëherë të falura të dhuruara, por asnjëherë nuk janë ripërtërirë.

Prandaj, kërkoj një shumë simbolike që të fillohet të mbështeten këto ansamble. Faleminderit!

**KRYETARI:** Zoti Haxhiu, përcaktoje shumën, në mënyrë që ta dinë se nga e merr, sepse zakonisht po e kërkojnë.

**BEKIM HAXHIU:** Janë të planifikuara. Janë të përshkruara dhe çdonjëri deputet i ka përpara, prandaj le t'i votojnë.

**KRYETARI:** Faleminderit! Amendamenti 141, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, deputeti Bekim Haxhiu, votojmë tash!

63 deputetë kanë votuar, 11 për, 39 kundër, 13 abstenime. Nuk kalon as ky amendament, për fat të keq.

Jemi tek amendamenti 143, deputetja Hykmete Bajrami, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash! Po e shoh që nuk ka reagim, votojmë tash! A dëshiron... Më fal, veç pak... ! Ndaleni procesin e votimit. Zonja deputete, urdhëro, arsyetojeni!

**HYKMETE BAJRAMI:** Kryetar!

Unë i kam bërë amendamentet në Komisionin FunkSIONAL, tani edhe sikur të votohet amendamenti nuk ka buxhet, kështu që e tërheq amendamentin.

**KRYETARI:** Tërhiqet amendamenti 143. Deputetja Arbërie Nagavci, amendamenti 144.

**ARBËRIE NAGAVCI:** Faleminderit!

Amendamenti 144 ka të bëjë me një çështje që e kam ngrehur disa herë deri sot. Bëhet fjalë për pagesat e pagave të mësimdhënësve të pensionuar sipas kontratës kolektive. Pra, për pagën jubilarë dhe tri pagat përcjellëse.

Për informatën tuaj, të gjithë mësimdhënësit i realizojnë këto të drejta, por paguhen edhe shpenzimet e gjykatës dhe të përmbartuesve, që do të thotë se rëndohet buxheti për shkak se nuk planifikohen me kohë. Andaj, nëse konsideroni se duhet të kemi kujdes për buxhetin, por edhe respekt për mësimdhënësit, ju ftoj që ta votoni këtë amendament.

**KRYETARI:** Atëherë, a shkojmë në votim? Përgatituni për votim, deputetja Arbërie Nagavci, amendamenti 144, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, votojmë tash!

73 deputetë kanë votuar, 29 për, 39 kundër, 5 abstenime. Nuk kalon amendamenti 144.

Amendamentet 145, 146, 147, deputetja Mirjeta Kalludra, na trego mënyrën sesi të votohen dhe arsyetimi. Urdhëroni, zonja deputete!

**MIREJTA KALLUDRA:** Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Janë tri amendamente të cilat i kam propozuar në Komisionin për Buxhet dhe të cilat janë kërkesa të qytetarëve dhe janë shumë të rëndësishme për banorët e Komunës së Klinës.

Është projekti asfaltimi i rrugës Çupevë e Ulët - Çupevë e Lartë. Është kjo një rrugë për të cilën kam kërkuar buxhet shtesë në vlerë prej 200 mijë eurosh. Pra, këto dy fshatra të cilat lidhen me rrugën magjistrale Klinë - Gjakovë.

Kjo është një rrugë, e cila ndikon shumë në përmirësimin e jetës së nxënësve për ato fshatra, të cilët e përshkojnë këtë rrugë çdo ditë për vijim në shkollë.

Kurse amendamenti 146 është një projekt ndërtimi i aneksit të shkollës “Motrat Qiriazit” në Klinë. Ky projekt është planifikuar në kuadër të reformave të procesit arsimor për mësimin gjithëditor, si dhe për krijimin e hapësirave për trajnim të personelit arsimor në Komunën e Klinës.

Duke e pasur për bazë edhe numrin e nxënësve, pra rritjen e numrit të nxënësve në këtë shkollë, mendoj se është i rëndësishëm për Komunën e Klinës.

Një projekt tjetër të cilin e kam paraqitur si amendament është amendamenti 147 dhe kërkoj përkrahjen e deputetëve, nëse ka mundësi që të votohet. Është ndërtimi i fushave ndihmëse sportive, duke e pasur parasysh se është shumë i rëndësishëm për të rinjtë e kësaj komune.

Të gjitha burimet e financimit i kam paraqitur në amendament, prandaj kërkoj tani përkrahjen e të gjithë deputetëve. Besoj që do të votohen meqë janë shumë të rëndësishme për të gjithë qytetarët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zonja deputete, a dëshironi që të votohen një nga një dhe a ke ndonjë arsytim se nga të merren paratë, sepse ma kërkojnë deputetët?

MIRJETA KALLUDRA: Po, unë kërkoj që votohen një nga një, duke qenë se unë nuk e kam bërë një koalicion, ose sikur ndodhi me kushtet të cilat iu plotësuan deputetëve të PSD-së. Është rasti i pjesës të Kamenicës, ishin disa amendamente të cilat u votuan në vlera shumë të mëdha. Këto nuk janë amendamente të cilat i plotësojnë kërkesat e mia, por janë amendamente të cilat i plotësojnë kërkesat e qytetarëve të asaj pjese.

Nëse do të kishte pasur mundësi, edhe ministri i Financave ta gjejë burimin për mënyrën e financimit të këtyre projekteve.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,  
Zonja deputete Mirjeta Kalludra dëshiron t'i votojmë një nga një amendamentet. Unë do të shkoj në bazë të propozimit të saj.

Amendamenti 145, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!

66 deputetë kanë votuar, 27 për, 29 kundër, 10 abstenime. Nuk kalon.

Amendamenti 146, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!

67 deputetë kanë votuar, 27 për, 33 kundër, 7 abstenime. Nuk kalon.

Jemi te amendamenti 147, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash!

Të nderuar kolegë deputetë, 62 deputetë kanë votuar, 24 për, 29 kundër, 9 abstenime. Nuk kalon.

Amendamenti 149, deputeti Albert Kinolli, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, por me përkrahjen e Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Komuniteteve.

Zoti Kinolli, a dëshironi ta arsyetoni? Urdhëroni...!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Ka të bëjë me rregullimin e rrugës në lagjen “Jeta e Re” në Prizren, rrugë e cila kryesisht banohet nga pjesëtarët e komunitetit rom, ku në këtë lagje jetojnë mbi 150 pjesëtarë të komunitetit rom, e cila është në gjendje skajshmërisht të mjerueshme, sidomos kur ka reshje atmosferike dhe nëpër këtë rrugë kalojnë edhe nxënës të shkollës së mesme dhe filllore, edhe fatosat e vegjël, të cilët shkojnë në çerdhe, kështu që është një amendament i vetëm imi, i cili ka të bëjë një shumë prej 150 mijë eurosh. Mendoj se ky projekt vlen të përkrahet, meqenëse është projekt i vetëm të cilën

e kam për këtë vit në këtë buxhet, kështu që kërkoj përkrahjen e të gjithë kolegëve deputetë. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti deputet, tash për respekt në bazë të rregullës, kah t'i marrim paratë, apo luti kolegët, apo të na tregojnë ministrat, ta dimë nga t'i marrim.

ALBERT KINOLLI: I nderuar kryetar!

Kisha lutur ministrin e Infrastrukturës, zotin Pal Lekaj, nëse ka mundësi me bashkëfinancim përmes Komunës, do t'i isha mirënjohës. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri i Financave është duke marrë fjalën, pastaj edhe ministri i Transportit.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti kryetar!

Duke mirëkuptuar deputetin dhe rëndësinë e secilit projekt që u diskutua, po 100% jo më pak, 100% të asaj çka jemi dakorduar i kam reflektuar në buxhet, asnjë devijim prej marrëveshjes nuk e kam bërë. Prandaj, iu kisha lutur deputetëve që amendamentet pa përkrahje të Komisionit për Buxhet dhe Financa të mos përkrahen, për shkak se nuk ka mundësi të sigurohet burimi i financimit pa e dëmtuar ndonjë projekt tjetër.

KRYETARI: Ministri i Transportit nuk ka reagim, shkojmë në votim.

E votojmë amendamentin 149, deputeti Albert Kinolli, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional, votojmë tash!

65 deputetë, 41 për, 19 kundër dhe 5 abstenime.

Tani jemi në situatë të re, duhet të gjenden mjetet, ju e keni votuar, duhet të gjenden mjetet, gjeni diku! Për arsye se krejt buxheti bie në zero nga një situatë e tillë.

Ministri i Infrastrukturës dhe i Financave, a keni ndonjë zgjidhje? Sa ishin, Albert? Albert Kinolli, ta dimë shumë.

ALBERT KINOLLI: 150 mijë euro, kryetar, po viti është i gjatë, i ka 365 ditë, me vullnetin e ministrit të Financave dhe të ministrit të Infrastrukturës besoj që i gjejmë këto.

KRYETARI: Albert, ti je i fituari, tash le t'i gjejmë ministrat diku, ministër i Transportit, bëje ndonjë tërheqje diku, për faktin se deputetët e kanë votuar.



Ta keni parasysh se çdo votim krijon këtë vështirësi, për faktin se të arsyeshëm janë çdo amendament, por e zorshme është të gjendet mënyra e financimit. Me respektin e madh për secilin amendament dhe projekt, që është në shërbim të qytetarëve.

Po presim edhe pak, për faktin se çka do të vazhdojmë më tutje, kemi një vendimmarrje e cila duhet të arsyetohet diku.

**KRYETARI:** Ministri e ka fjalën, vëmendje, ju lutem!

**MINISTRI BEDRI HAMZA:** Deputetë të nderuar!

Po e them me përgjegjësi, disa që s'e kanë respektuar marrëveshjen, bashkë me komisionin, e falënderoj Komisionin për Buxhet dhe Financa, jemi dakorduar, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka përkrahur, Ministria e Financave ia ka përkrahur dhe janë reflektuar në buxhet, keni dalë mbi këtë dhe s'po i tërhiqni amendamentet.

Për sonte kam mundësi, ngase është një ligj ndër më të rëndësishmit, të mos shkohet tutje, jeni të lodhur dhe të bëj një zgjidhje të fundit, shumë të zorshme.

Prapë Ministria e Financave në programin 'Kontigjenca në Ministrinë e Financave', kodi 28900, zvogëlohet kategoria e 'Mallrave dhe shërbimeve'.

**KRYETARI:** Të nderuar kolegë deputetë,

Ju kisha lutur për vëmendje, për arsye se jemi duke shkuar në rrezikimin e tërësishëm të Projektligjit për buxhet.

Amendamenti 150.

Deputeti Danush Ademi, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, me përkrahjen e Komisionit për Komunitete. Urdhëro, zoti Danush!

**DANUSH ADEMI:** Faleminderit, i nderuar kryesues!

Projekti ka të bëjë, sepse 50 mijë euro vetëm janë ndarë dhe këtu është një gabim, jo terren sportiv, po salla sportive. 50 mijë euro janë ndarë nga Ministria e Kulturës dhe ne kemi kërkuar edhe 80 mijë euro të shtohen, sepse vlera e projektit është 130 mijë euro dhe unë nuk e shoh të arsyeshme projekti të jetë në gjysmë me 50 mijë euro dhe kërkojmë mbështetjen që projekti të kalojë me vlerë për 130 mijë eurosh, ajo është sallë sportive, jo terren sportiv.

Besoj qysh i kanë gjetur mjetet për shumë projekte më të mëdha, besoj që edhe këtu t'i gjeni me mirëkuptim, sepse ka të bëjë me disa aktivitete sportive dhe një sallë sportive. Kërkoj përkrahjen e të gjithë deputetëve.

KRYETARI: Faleminderit, deputet Danush Ademi!

Zoti ministër, 80 mijë euro.

Kur nuk ka mënyra të buxhetimit, unë vetëm mund ta vë në votim, por mënyrë buxhetimi nuk ka.

I nderuar kryetar, a ke ndonjë propozim për buxhetim. Urdhëro, zoti Memli Krasniqi, mos ka ndonjë propozim, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

MEMLI KRASNIQI: Zoti kryetar!

Kam biseduar me zotin Ademi, po edhe me ministrin e Kulturës, zotin Gashi, i cili nuk është këtu, kërkesa është shumë legjitime. Ky terren nuk mund të realizohet me këtë shumë, ka nevojë për më shumë, po ministri Gashi, po flas në emër tij, se jam konsultuar me të, është zotuar se kjo gjë mund të bëhet përmes ndarjeve buxhetore që mundet vetë ministria me Qeverinë t'i bëjë përmes rirregullimeve pas miratimit të buxhetit.

Propozimi im për ta mbështetur kërkesën e zotit Ademi është: të kalojë kështu si është, meqenëse s'ka burim të financimit ku të merren këto 80 mijë euro, po me zotimin po them të Qeverisë...

KRYETARI: A po flisni për Danush Ademin?

MEMLI KRASNIQI: Për Danush Ademinin po flas, me propozim të ministrit të Kulturës dhe me vendim të Qeverisë të bëhet rirregullimi dhe t'u shtohen mjetet, qoftë 50, qoftë deri 80 mijë euro përmes rirregullimit të investimit kapitalë të Ministrisë së Kulturës, por gjithsesi të miratohet në proces të Qeverisë, po jo me këtë amendament, meqenëse ministrat s'e dinë prej kah t'i marrin mjetet. Ky ishte propozimi im, sepse edhe më herët kemi biseduar.

Pra, i bie të mos votohet ky amendament, por të sigurohet zotin Danush Ademi që Qeveria do t'ia japë të njëjtën shumë të mjeteve, se ka të drejtë për rirregullimet e veta në kapitale të kulturës. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Danush Ademi, ka një propozim 'gjentëlmën' nga kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, në emër të ministrit të Kulturës. Urdhëro, fjala për ju.

DANUSH ADEMI: Unë e mirëkuptova shefin e Grupit Parlamentar, po kërkoj mbështetjen e deputetëve, ta votojmë, pastaj të gjenden mjetet financiare, meqenëse ka premtuar ministri.

KRYETARI: Danush, i jashtëzakonshëm je. Unë po e vë në votim. Urdhëro, Lumir Abdixhiku, nga Komisioni për Buxhet, fjala për ju.

LUMIR ABDIXHIKU: Faleminderit, kryetar!

A mund të bëjmë një praktikë, meqenëse po na del prej kontrollit. Që secili amendament të ketë edhe burimin e financimit, përndryshe nuk është i plotë si amendament dhe s'mund të shtrohet si i tillë.

Pra, çdo deputet që e propozon amendamentin, të tregojë nga i merr ato para, përndryshe nuk ka kuptim si amendament. Faleminderit!

KRYETARI: Është legjitime çka po kërkon, po në momentin kur deputeti nuk tërhiqet, deputetët duhet ta kenë parasysh se nuk dihen kah merren ato para, kjo është një situatë reale që, në fakt, është inekzistente kërkesa, por në aspektin formal-juridik unë jam i detyruar ta vë në votim. Me rregulloren e re, kjo është një situatë e re, e cila me rregulloren e re duhet të mos vijë fare amendamente të tilla, kur nuk e kanë bazën financiare. Në këtë formë ne kemi shumë amendamente, po nuk kemi buxhet.

Danush, a nuk po i beson ministrit! Urdhëro, Danush Ademi! Nuk ka arsyeshmëri financiare.

DANUSH ADEMI: Kryetar, nuk është puna që nuk po i besoj, po s'e kam princip të dorëzohem asnjëherë.

KRYETARI: Urdhëro, nënkryetar! Më thoshte sekretari, Kujtim Shala, mendoja nuk është ministri tash, gjithë më ngatërrohet. Urdhëro, nënkryetar!

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Zoti kryetar, Lumiri ka të drejtë, unë po e them edhe pak më ndryshe, pak më thjeshtë. Amendamentet, të cilat s'e kanë, s'e tregojnë burimin e financimit, nuk janë të ligjshme dhe s'duhet të procedohen fare.

KRYETARI: Kjo do të ishte e mirë, në fakt, të ishte një rregull dhe i kisha lutur grupet parlamentare në rregulloren e re kjo të përcaktohet qartë, përndryshe deputetët vullnetin e kanë, po mundësitë buxhetore janë pothuajse të perealizueshme.

Danush, a ka mundësi që ta marrësh një përgjegjësi me ministrin e Kulturës, ku i bashkëngjitëm edhe unë një garancie. Janë 70 mijë euro, me aq sa po e shoh, apo 50 mijë, ju kërkon edhe 80 mijë. Pastaj ministri i Kulturës publikisht po ju premton, në bazë të asaj çka ka thënë shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së, edhe unë ju premtoj se do të qëndrojmë mbrapa atij qëndrimi që do t'i gjejmë, ta tërhiqni amendamentin.

DANUSH ADEMI: Kryetar!

Unë e thashë edhe pak më herët, meqenëse është këtu kryeministri dhe ju merrni përgjegjësi, patjetër këtu s' domethënë që të jetë e shënuar, po është interesant të kryhet.

KRYETARI: Atëherë, ju e tërhiqni amendamentin, po marr zotim edhe unë. Kjo është. E tërheq deputeti Danush Ademi. Faleminderit!

Amendamentet 151, 152, deputeti Adem Hoxha, urdhëro, zoti deputet, për arsyeshmërinë financiare. Zonja Duda Balje për çka, ku ka mbetur tash?

DUDA BALJE: Po, kryetar, Adem Hoxha s' është këtu, unë do të marr fjalën për amendamentin 151, domethënë do të tërhiqet, ndërsa amendamentin 152 është amendament në emër të komuniteteve në Kosovë, edhe ne kemi kërkuar ta mbështesë Zyra për komunitete të Kryeministria.

Ne kemi biseduar edhe me ministrin, ministër nëse mundeni, ne kemi kërkuar një shumë sa është ministria në mundësi, është për neve.

KRYETARI: Ministri i Financave e ka fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetar!  
Faleminderit, deputete!

KRYETARI: Ministër, po flasim vetëm për amendamentin 152, 151 është tërhequr.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Sa u përket amendamenteve që u propozuan ka mundësi të rregullohet përmes rregullimeve të brendshme, brenda për brenda të Qeverisë. Ka mjete edhe te Zyra për komunitete, ka mjete edhe prej rezervës së Qeverisë dhe ka mundësi kjo çështje të adresohet, pa pasur nevojë që të votohen amendamentet dhe unë e lus që të njëjta të tërhiqet, jo para rishikimit.

KRYETARI: Zonja Duda Balje, propozimi është që të tërhiqet, se këta do ta rregullojnë brenda, përndryshe Danush Ademit 80 mijë euro s' mundem t'ia kryejmë. Urdhëro!

DUDA BALJE: Domethënë, ministër, ne do ta tërheqim, nëse ju mund të na përkrahni financiarisht, domethënë. Ok, në rregull. Faleminderit!

KRYETARI: Tërhiqet amendamenti 151 dhe 152. Faleminderit!

Amendamentet 153, 154, 155, Komisioni për Legjislacion, pa përkrahjen e Komisionit Funkcional. Urdhëroni, zonja kryetare! Kush është? Hajdar Beqa, në emër të komisionit.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Legjislacion i ka dëgjuar organizatat, të cilat hyjnë në fushëveprimtarinë e Komisionit për Legjislacion. Ne kemi bërë, i kemi bërë si komision gjithsej 4 amendamente, një amendament është përkrahur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa, falënderojmë komisionin. Kurse, për amendamentet e tjera sot kemi biseduar edhe me ministrin e Financave, është zotuar që në momentin kur ka mjete, do të thotë kur kanë nevojë për mjete, ne do t'i përkrahim. Unë kam obligim në emër të komisionit të lexoj: amendamenti 1 janë ndarë mjete shtesë për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, në kodin organizativ 241 dhe me kodin të programit e 32 mijë e 600, në shumë totale prej 60 mijë e 984 mijë euro, në kuadër të kategorisë ekonomike “Paga dhe mëditje”.

Për 10 zyrtarët e agjencisë dhe 9 mijë e 888 euro e 56 centë në kuadër të kategorisë ekonomike “Mallra dhe shërbime”. Arsyetimi është i nevojshëm të përkrahët kërkesa buxhetore për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, në shumën totale prej 60 mijë e 984 euro, në kuadër të kategorisë ekonomike “Paga dhe mëditje” dhe 9 mijë e 88 euro në kuadër të kategorisë ekonomike “Mallra dhe shërbime”. Nga këto mjete 9 mijë e 698 euro janë ndarë për aktivizimin e Klinikës mobile, ku do të ofrohet ndihmë juridike falas për komunitat e Kosovës, ku nuk ka zyre për ndihmë juridike falas dhe gjeografikisht janë larg. Amendamenti 2 është përkrahur nga komisioni, ku janë ndarë mjete shtesë për Agjencinë Kundër Korrupsionit, në kodin organizativ, realisht nuk po e lexoj se është kryer.

Amendamenti 3 është të ndahen mjete shtesë për zbatimin e ligjit për gjykata për vitin 2019, në total prej 1 milion e 70 mijë e 524 eurosh. Numri i punëtorëve është 35 në kuadër të kategorisë “Paga dhe mëditje” 876 mijë e 524 euro, në kuadër të kategorisë “Mallra dhe shërbime” 147 mijë e 400 euro, shpenzime komunale 27 mijë euro dhe në kuadër të kategorisë “Shpenzime kapitale” 20 mijë euro. Arsyetimi është i nevojshëm të ketë përkrahje me mjete shtesë për zbatimin e ligjit për gjykata, për vetë faktin se në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në organizimin e brendshëm të saj do të themelohet departamenti special për lëndët e kompetencës të prokurorit special të Republikës së Kosovës dhe themelimi i degës në Han të Elezit, në Komunën e Hanit të Elezit, kostoja buxhetore shtesë e vlerës është 3 milionë e 184 mijë e 742 euro dhe numri shtesë i punëtorëve është 35 pozita. Këto mjete buxhetore dhe pozita shtesë nuk janë pjesë e buxhetit të Republikës së Kosovës të planifikuar për vitin 2019-2021. Realisht, këto edhe kur janë paraparë, janë paraparë për tre vjet, do të thotë nga vitit 2019-2021.

Amendamenti 4, të ndahen mjete shtesë për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Do të thotë, unë që të mos ju ngarkoj, se jemi edhe vonë, realisht ju e keni amendamentin, ne e kemi pasur vullnetin në komision t'i përkrahim, duke pasur parasysht edhe arsyetimet që i kanë ...

KRYETARI: O, Hajdar, a ka mundësi të na drejtosh diku, se...

HAJDAR BEQA: Ne si komision, kryetar, si Komision për Legjislacion i përkrahim këto amendamente dhe kërkojmë prej deputetëve t'i përkrahin, po ne e dimë që është pak e vështirë të barten në buxhetin e Republikës së Kosovës. Andaj, kisha kërkuar prej ministrit të Financave një sqarim, sepse kemi biseduar edhe më herët dhe ka garantuar që në moment kur të kërkohej mjete të domosdoshme, ne do t'i gjejmë mjetet, kështu kanë pasur një dakordancë me ministrin e Financave dhe kjo ishte arsyeja pse nuk kemi të drejtë ta tërheqim, sepse janë në emër të komisionit, jo në emër timin. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Hajdar! Mbase të kanë marrë vesh këta. Ministri i Financave do të duhej të ketë marrë vesh.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, kryetar!

Amendamentet e propozuara s'janë të plota, se i kanë veç kërkesat, pa burim të financimit. E dyta, kanë pozita të paplotësuara dhe kërkojnë pozita shtesë! Le t'i plotësojnë pozitat që i kanë, kur t'i plotësojnë këto pozita që i kanë, atëherë flasim për pozita të reja.

Sa u përket mallrave dhe shërbimeve, jo që kanë pak, po kanë tepicë dhe është diçka interesant, me dy organizata buxhetore, po e them. Këshillit Prokurorial edhe Këshillit Gjyqësor në Ministrinë e Financave çdoherë u plotësohen kërkesat, dalin me kërkesa të plotësuara, vijnë me kërkesa në Komision për Legjislacion dhe me kërkesa në Komision për Buxhet dhe Financa. Prandaj, kur t'i plotësojnë pozitat e paplotësuara, kur t'i shpenzojnë mjetet, të cilat i kanë në dispozicion për shpenzim, ne i garantojmë që ata do të kenë fonde të mjaftueshme t'i kryejnë punët e tyre pa asnjë pengesë.

KRYETARI: Zoti Beqa, a ka mundësi të tërhiqen?

HAJDAR BEQA: Kryetar!

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit ka qenë shumë i qartë, të gjithë deputetët i kanë amendamentet me shkrim. Unë e dëgjova çka tha ministri, unë nuk kam mandat nga komisioni t'i tërheqim, prapë po e them që në emër të komisionit i mbështesim këto amendamente. Faleminderit!

KRYETARI: Si dëshiron, a ka mundësi t'i hedhim të tria në votim përnjëherë, të katërtat? 153, 154, 155, tri, a ka mundësi t'i vëmë përnjëherë në votim, apo ndaras?

HAJDAR BEQA: Do të thotë tri amendamente, se një ka marrë mbështetje, janë tri amendamente gjithsej. Kurse, amendamenti që realisht që këtu te ne ka qenë amendamenti 2 për Agjencinë Kundër Korrupsion e ka marrë përkrahjen e komisionit, ne pranojmë të shkojnë në pako votim. Faleminderit!

KRYETARI: Amendamentet 153, 154 dhe 155, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash, në pako, të tria!

Rezultati i votimit: 70 deputetë kanë votuar, 24 për, 41 kundër, 5 abstenime.  
Nuk kalojnë amendamentet 153, 154 dhe 155.

Amendamenti 156, deputetja Albulena Balaj Halimaj, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Urdhëroni, zonja deputete!

ALBULENA BALAJ HALIMAJ: Faleminderit, kryetar!

Meqë amendamenti im është i fundit, po besoj që deputetët do të tregohen zemërgjerë dhe ta votojnë, nuk i vë faj Komisionit për Buxhet që nuk e ka votuar, për shkak se nuk ka qenë me detaje të plota dhe i specifikuar mirë, për shkak se administrata e ka dërguar ashtu siç e ka dërguar në komision.

Është fjala për Komunën e Prizrenit, kërkohen 20 norma shtesë në arsim, në sistemin arsimor. Nga 2 mijë e 268 vende që janë, për 2 mijë e 288 vende Drejtoria e Arsimit në Prizren ka bërë kërkesë në Ministri të Arsimit, në Ministri të Financave, në Ministri të Administratës Publike, madje na kanë njoftuar edhe neve në komision, por që këto ministri nuk janë përgjigjur, prandaj ne e kemi parë të nevojshme ta bëjmë në formë amendamenti dhe pres përkrahje. Pra, nuk po kërkojmë miliona, as miliarda, po i kërkojmë 20 vende, duke ditur se në Prizren mësimi zhvillohet në tri gjuhë, ne e kemi të pamundur t'u plotësojmë kërkesat edhe minoriteteve, nuk kemi shërbim as pedagogjik, as psikologjik nëpër shkolla, na mungojnë edukatorë, na mungojnë profesorë të gjuhës gjermane. Prandaj, kjo do ta mundësonte një zhvillim në arsim në komunën e Prizrenit pak më të mirë se sa që është tani. Kërkoj mbështetjen dhe votën tuaj. Faleminderit!

KRYETARI: Është amendamenti 156, deputetja Albulena Balaj Halimaj, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

73 deputetë kanë votuar, 33 për, 34 kundër, 6 abstenime.  
Nuk kalon amendamenti 156.

Në të njëjtën kohë, derisa ne kemi votuar, kam kërkuar interpretimin e amendamentiit 98, kanë qenë dy propozime: i Komisionit FunkSIONAL ka marrë 63 vota. 60 për. 2 mundet abstenim ose kundër, 1 abstenim ose kundër, po ta kemi parasysh. Edhe deputeti Nait Hasani, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL, 30, 28, 6. Do të thotë, ka kaluar amendamenti 98, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Kjo është përfundimtare.

Kemi përfunduar amendamentet me rezultatin të cilin e kemi.  
Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi në orën një çerek pa dy, pas mesnatës, jemi duke votuar tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Të thirren deputetët në sallë, jemi duke e votuar buxhetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Unë do të pres derisa të krijohen kushtet, deputetët të kthehen në sallë për ta hedhur në votim një projektligj të rëndësishëm, sot i kemi pasur të gjitha projektligjet me rëndësi.

Pas kësaj e kemi Trepçën, statutin e Trepçës, po ashtu shumë me rëndësi.

Aktualisht janë 89 deputetë në sallë. Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara, votojmë tash!

Ky është rezultati, vetë salla e tregoi:  
65 deputetë kanë votuar, të gjithë për.

Urime qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06/L-133 mbi ndarjen buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019.

## **8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuar me Ligjin nr. 06/L-20 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018**

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuar me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. Në qoftë se s'ka dikush të flasë, shkojmë në votim drejt. Po e shoh që askush s'është lajmëruar, a shkojmë në votim drejt?

Të nderuar deputetë, procedojmë me votimin e Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

61 deputetë kanë votuar, 60 për, 1 abstenim.

Kuvendi e miratoi Vendimin për zgjatjen e ndarave buxhetore për muajin shkurt të vitit 2019, të përcaktuar me Ligjin nr. 06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, në pajtim me nenin 24.1, pika B dhe 24.2, të Ligjit 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë e ndryshuara dhe plotësuara me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Jemi në pikën ndër më të rëndësishmet.



## 9. Shqyrtimi i Propozim-Statutit të shoqërisë aksionare Trepça sh. a.

Edhe këtë propozim-statut e ka shqyrtuar Komisioni FunkSIONAL dhe ia ka rekomanduar Kuvendit miratimin e tij. Në qoftë se nuk e do kush fjalën, a shkojmë në votim drejtpërdrejt? Jemi në votim të këtij propozim-statuti. Një sqarim procedural: Sipas nenit 6, paragrafi 2 të Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën, Statuti i Trepçës shoqëri aksionare propozohet nga Bordi Mbikëqyrës, miratohet nga aksionarët, pas aprovimit të Kuvendit të Kosovës.

Në vazhdim, të nderuar deputetë, kërkohet deklarimi me votim për aprovimin e Propozim-Statutit të shoqërisë aksionare Trepça sh. a. Urdhëro, nënkryetar! A e dëshironi fjalën? Urdhëro, zonja Hykmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar.

Atëherë më fal, nga Komisioni, zonja Sala Berisha-Shala. Edhe unë ju pyeta, asnjë s'm'u lajmëruat në fillim. Zonja Sala Berisha-Shala, fjala është për ju!

**SALA BERISHA-SHALA:** Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Kabinet qeveritar,

Kryeministër,

Media dhe të gjithë ju të pranishëm,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit dhe në pajtim me nenin 6, paragrafi 2 i Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën, në mbledhjen e mbajtur më 25 janar 2019, e shqyrtoi Projekt-Statutin e Trepçës shoqëri aksionare, dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

### R e k o m a n d i m

Të miratohet Projekt-Statuti i Trepçës shoqëri aksionare.

Komisioni, pas shqyrtimit të Projekt-Statutit Trepça sh.a. vlerësoi se projekt-statuti i plotëson kushtet e parapara me nenin 6, paragrafi 2 të Ligjit për Trepçën dhe i rekomandon Kuvendit për miratim. Është i bashkëngjitur Projekt-Statuti. Vlen të përmendet se Komisioni unanimisht e ka miratuar Projekt-Statutin në mbledhjen e mbajtur të Komisionit FunkSIONAL. Uroj që këtë status të mos e përcjellë fati i Ligjit të Trepçës, që është miratuar para tre vjetësh po kështu në orët e vona të mesnatës dhe uroj që deputetët t'ia japin pëlqimin miratimit të statutit dhe të funksionalizohet sa më parë Trepça si një gjigant për zhvillimin ekonomik të vendit. Ju ftoj për miratim. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Atëherë tani jemi në radhën e grupeve parlamentare. Ministër më fal, a e dëshiron fjalën? Atëherë, zonja Hykmete Bajrami.

**HYKMETE BAJRAMI:** Faleminderit, kryetar!

Shumë shkurt, për të mos i mbajtur kolegët dhe veten më gjatë, por dua të theksoj që në Komisionin Funkcional si përfaqësuese e GP të Lidhjes Demokratike të Kosovës i kemi pasur vërejtjet tona. Draft-statuti që e kemi për votim sot para nesh mund të them që nuk i plotëson kushtet për mirëfunktionim të ndërmarrjes Trepça si shoqëri aksionare. Deputetët e opozitës e kanë pasur kusht që Qeveria ta sjellë një draft-statut, ku pajtohen sindikata me përfaqësuesit e Bordit, do të thotë me përfaqësuesit e Qeverisë. Ka ardhur një draft ku të dyja palët pajtohen, mirëpo ne i kemi vërejtjet tona.

Drafti që e kemi përpara është draft në të cilin nuk kanë ndërhyrë deputetët e Komisionit për shkak se është hera e parë që në Parlamentin e Kosovës aprovohet një statut i tillë i një shoqërie aksionare dhe kalon me një lexim, bile çka është anormale është që ky statut pasi të votohet sot në Parlament do të aprovohet në Qeveri, që i bie që Qeveria të jetë instanca e fundit, e jo Parlamenti.

Gjithashtu vërejtje kemi pasur se këtu përpos gabimeve esenciale, ka edhe vërejtje të tjera, siç janë p.sh. emrat dhe mbiemrat e anëtarëve të Bordit që nuk ishte dashur të jetë, sepse ata mund të ndërrohen dhe duhet të jenë funksionet, e jo emrat dhe mbiemrat. Ne si GP i LDK-së do ta japim votën pro draftit të statutit, të cilin e kemi para nesh, për shkak të rëndësisë që ka kompleksi Trepça për zhvillimin e Kosovës. Përndryshe, vërejtjet tona i kemi aty dhe për shkak se kemi vërejtje, ne mendojmë që Qeveria shumë shpejt do ta sjellë edhe Ligjin për ta përmirësuar, po gjithashtu edhe këtë statut do ta bëjë më të mirë. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit! Në emër të GP të Partisë Demokratike të Kosovës, znj. Sala Berisha-Shala.

**SALA BERISHA-SHALA:** Faleminderit, kryetar!

Kam folur në emër të Komisionit, tash në emër të grupit.

Partia Demokratike e Kosovës i jep mbështetje të fuqishme Statutit të Trepçës dhe kjo shkon konform angazhimeve të saj vazhdimisht në vitet e mëparshme e deri më tani. Urojmë që për Statutin e Trepçës të mos dalë ndonjë grup parlamentar që do ta stopojë në rrugë e tutje. Më vjen mirë që edhe kolegja ime në emër të grupit parlamentar të saj e paraqiti mbështetjen e saj.

Ju ftoj ta votoni dhe ta përfundojmë këtë seancë maratonike me një votim shumë të rëndësishëm që lidhet me zhvillimin ekonomik të Kosovës, e që është funksionalizimi i gjigantit industrial Trepça. Faleminderit!

**KRYETARI:** Faleminderit shumë! Albin Kurti, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,  
Qytetarë të Republikës,  
Kabineti i Qeverisë,

Është shumë mirë që Trepça do të bëhet me statut. Është shumë e rëndësishme për Trepçën, për ekonominë, për shtetin, mirëpo duhet ta themi që ky dokument është i shkruar dobët dhe në mënyrë joprofesionale. Statuti ka mangësi në secilin aspekt, duke filluar nga vetë radhitja e neneve, apo përbërja e tyre. Ka raste kur nene që do të duhej të ishin pjesë e ndonjë neni tjetër, janë ndarë si nene të veçanta, por edhe raste të kundërta, kur brenda nenit ka paragrafë që do të duhej të trajtoheshin në veçanti në një nen tjetër.

Përshtypja që del pas analizimit të këtij draft-statuti është që në të kanë punuar disa persona paralelisht, por jo bashkërisht, të gjithë jokompetentë në fushën e hartimit të dokumenteve të tilla dhe që pastaj konsolidimi i punës së secilit është bërë në shpejtësi, pa e shikuar radhitjen dhe pa e kontrolluar mundësinë e përsëritjes së gjërave në nene të ndryshme.

Statuti nuk i liston të gjitha asetet e Trepçës, sidomos i injoron komplet asetet e kompanisë paraprake jashtë territorit të Kosovës. Ne e dimë që edhe nëpër republikat e ndryshme të ish-Jugosllavisë, Trepça i ka pasur asetet e veta, të cilat kësisoj ngelin jashtë.

Statuti përcakton elementët bazë të funksionimit të shoqërisë dhe nuk përbën listë kërkesash për agjenci, kompani, apo institucione të tjera. Brenda këtij statuti, në nenin 6, paragrafët 7,8 dhe 9, në fakt përbëjnë listë kërkesash për AKP-në, KPMN-në, apo edhe për Qeverinë e Kosovës.

Neni 7 është konfuz, meqë në mënyrë implicite nënkupton që Kuvendi nuk është organi më i lartë vendimmarrës në vend. Sipas këtij neni, statuti, edhe pas kalimit në Kuvend, e ka edhe një pengesë tjetër, që është miratimi nga aksionarët. Kjo është e palogjikshme.

Më tutje, neni 10 është kontradiktor, meqë në paragrafin 2 lejon mundësinë e emetimit të aksioneve nga më të ndryshmet, dhe menjëherë në paragrafin 3 e cakton vlerën e aksionit, që do të duhej të ishte 1 euro. Së pari nuk ka mundësi që aksionet e llojeve të ndryshme ta kenë të njëjtin çmim. Fundja, kjo është edhe njëra prej arsyeve pse emetohen aksione të ndryshme dhe meqë emetohen në momente të ndryshme kohore. Dhe, së dyti ne e dimë që çmimet e aksioneve i përcakton tregu. Nëse, siç parashihet në nenet e mëvonshme, shoqëria nëpërmjet Bordit Mbikëqyrës dhe Këshillit të Aksionarëve ka të drejtë të vendosë për emetimin e aksioneve shtesë, atëherë çmimi i tyre varet nga situata aktuale në treg, e jo nga një paragraf i nenit të statutit.

Neni 10 është i palogjikshëm, meqë harron që punëtorët individualisht janë aksionarë, e jo si grupacion. Rrjedhimisht, kur një individ vendos t'i shesë aksionet e tij, ai nuk do të duhej që patjetër këtë ta bëjë te Qeveria si aksionar i 80-përqindëshit, por mund t'ia shesë aksionet edhe

punëtorëve të tjerë, që janë pjesë e 20-përqindëshit të aksioneve. Për më tepër, në momentin që lejohet shitblerja e aksioneve, pa pasur treg të aksioneve në Kosovë, ideja e ndarjes së aksioneve ndërmjet shtetit dhe punëtorëve humb. Teorikisht shumë lehtë një biznesmen mund t'i grumbullojë të gjitha aksionet në duart e punëtorëve. Sidomos e palogjikshme është ideja që theksohet në pikën 7 të këtij neni, ku thuhet që vlera e shitjes nuk mund ta kalojë vlerën e tregut. Kjo është ndërhyrje e drejtpërdrejtë në lirinë e vendimmarrjes së agjentëve ekonomikë. Nëse një agjent ekonomik ka gatishmëri ta paguajë dyfishin e vlerës së tregut, p.sh. pse një aksionar s' do të duhej të përfitonte nga rasti dhe ta rriste pasurinë e tij. Themelimi i shoqërisë aksionare në një mënyrë është konfirmim i synimit për të operuar brenda kornizës së ekonomisë së tregut.

Neni 12 është shumë joprofesional dhe krejt i panevojshëm. Ja një shembull: Pika 2 e këtij neni, vetëm dëgjojeni me vëmendje se çfarë thotë: Mënyra e funksionimit të njësive biznese bëhet duke menaxhuar aktivitetet e veta. Ose neni 14 sërish tregon mosnjohjen e principeve bazë të funksionimit të ekonomisë së tregut. Dividendi nuk përcaktohet në bazë të Ligjit për Trepçën, por në bazë të vendimit të Bordit Mbikëqyrës rreth shumës së fitimit që do të mbahet për riinvestim dhe për përmbushjen e obligimeve rreth rezervave të obligueshme, duke shpërndarë pjesën tjetër si dividendë më pastaj.

Neni 16 është përplot formulime konfuze dhe të palogjikshme. Kjo vlen sidomos për paragrafin 3 dhe 4. Ja një shembull nga paragrafi 4: Sipas rregullave të përcaktuara, çështjet shtesë mund të përfshihen në agjendën e mbledhjes së përgjithshme vjetore, një kërkesë e tillë mund të mos përfilllet në rast se dorëzohet jo më vonë se 100 ditë pas mbylljes së vitit financiar të shoqërisë. Përpos mungesës së logjikës, kjo fjali e krijon përshtypjen që është përkthyer me Google Translate.

Në këtë kontekst, edhe më keq qëndron neni 17, ku mes tjerash thuhet: Në njoftimin për mbajtjen e mbledhjes së përgjithshme se duhet të njoftohet nëse dikush nga aksionarët nuk do të jetë i pranishëm në këtë mbledhje. Kjo nënkupton që kur një aksionari i dërgohet ftesa për mbledhje, në rregull, 30 ditë para afatit të mbledhjes, atij duhet t'i thuhet që pas 30 ditësh një aksionar tjetër nuk do të jetë në mbledhje. Absurde! Ndërsa paragrafi 3 i këtij neni është kurioz edhe për nga kreativiteti i krijimit të një fjalie pa asnjë kuptim, ose edhe një fjali në paragrafin 8: Kuorumi duhet të jetë i pranishëm nëse aksionarët duhet përfaqësuar së paku, dhe vazhdon më tej. I palogjikshëm komplet është edhe paragrafi 10 në këtë nen, brenda të cilit edhe tregohet se sa vota kanë anëtarët dhe thuhet se duhet të njoftohen 30 ditë para mbajtjes së mbledhjes së përgjithshme. Për çka të njoftohen? Lexojeni me vëmendje paragrafin 10.2 për ta parë nivelin e profesionalizmit që është shumë dobët edhe për Google Translation. Vota e dhënë nga i autorizuari duhet të jetë e vlefshme, pa marrë parasysh shkarkimin e mëhershëm të autoritetit të personit votues.

Paragrafi 11 është problem, meqë një statuti i cili aprovohet në Kuvendin e Kosovës i lihet hapësirë të ndryshohet nga mbledhja e aksionarëve. Shumë problematik është edhe paragrafi 11.1.2, që parasheh të drejtën e mbledhjes së aksionarëve që të vendosë për uljen apo ngritjen e vlerës së aksioneve të shoqërisë. Kjo tregon që përpiluesi s'e ka idenë e operimit të një shoqërie aksionare.

Çka nëse mbledhja e aksionarëve e vendos një vlerë të aksioneve që nuk korrespondon aspak me vlerën e tregut? Neni 19 i ka dy probleme. Fillimisht duke gëzuar 80% të aksioneve, Qeveria ka veto në emërimin e Bordit Mbikëqyrës dhe së dyti, si ka logjikë që në një statut të organizatës të futen edhe emra të përveçëm si anëtarë të bordit?

Çka nëse aksionari e vendos një emër tjetër? Të ndërrohet statuti? Me statut duhet të definohet numri i anëtarëve të bordit, por jo të përcaktohet se kush do të jetë brenda me emër të posaçëm.

Neni 26 flet për rezervat obligative, edhe ky është i palogjikshëm, përderisa thuhet në një nen tjetër që kapitali themeltar është vetëm 10 mijë euro. Sipas këtij neni, në momentin që rezerva obligative mbërrin në nivelin e 10%-shit të kapitalit themeltar, e që i bie në total vetëm 1 000 euro, ato mbeten në atë nivel.

Kjo edhe njëherë dokumenton që individë të ndryshëm kanë punuar në këtë dokument, por pa u harmonizuar fare. Edhe një fillorist do ta shihte si të palogjikshme që Trepça duhet t'i mbajë rezervat e obligueshme në nivelin e 1 000 eurove dhe atë ta mbërrijë gradualisht në këtë nivel.

Neni 31 është përsëritje e çështjeve të cekura disa herë në fillim të statutit dhe rrjedhimisht i panevojshëm në tërësi.

Për fund, asetet e Trepçës në nenin 7.2 thuhet që asetet e shoqërisë janë asete të njëjta sipas nenit 6 të këtij statuti dhe nenit 2 të Ligjit për Trepçën. Problemi është se neni 6 i statutit nuk është i njëjtë me nenin 2 të Ligjit për Trepçën sh.a.

Duhet precizuar se asetet e Trepçës sh.a. janë asete të përfshira në nenin 6 të statutit Trepça sh.a., pa iu referuar nenit 2 të Ligjit për Trepçën.

Problemi kryesor i këtij statuti për bindjen time është se të gjitha ndërrimet në transformimin e Trepçës po bëhen pa pjesëmarrjen e pjesës veriore. Nga aprovimi i Ligjit për Trepçën te bordi që është zgjedhur vetëm me shqiptarë, sepse serbët nuk i kanë propozuar kandidatët për tri vende në bord.

Statuti i Trepçës po përgatitet kështu edhe një herë, bordi mban mbledhje, ia propozon statutin Qeverisë sikur të ishte çdo gjë normale dhe në njëfarë mënyre vazhdimisht konfirmohet kjo ndarja veri - jug.

Statuti ka shumë probleme dhe e mira e vetme, por shumë e madhe e këtij statuti është që ekziston, pra që Trepça do të ketë statut. Faleminderit!

**KRYETARI:** Kemi të bëjmë me Trepçën, ky është vendim shumë i rëndësishëm. Urdhëroni, tani në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate, Dardan Sejdiu.

**DARDAN SEJDIU:** I nderuar kryetar,  
Të nderuar deputetë,  
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Qasja në ligjin i cili është votuar dy vjet më parë ka sjellë probleme dhe paqartësi, meqë Ligji për Trepçën nuk e definon këtë as si ndërmarrje publike, apo nuk definohet si ndërmarrje publike dhe, rrjedhimisht, kemi pikëpyetje të mëdha rreth organizimit të Trepçës.

Në fakt, problemi fillestar dhe esencial është ky, që nuk emërtohet si ndërmarrje publike. Problemi rreth mënyrës sesi është e regjistruar nuk ekziston për mua. Pra, të gjitha ndërmarrjet publike për mua duhet të jenë shoqëri aksionare dhe shteti është aksionar në ndërmarrjet publike. Normalisht që nuk do ta regjistrojmë si biznes individual.

Ndërkohë, mendoj që me statut kemi bërë një lëvizje në qartësimin e pozicioneve. Ka hapësirë dhe domosdoshmëri që të amendamentohet Ligji për Trepçën. Ka mundësi dhe hapësirë që njësitet biznesore, ashtu siç janë të paraqitura në Ligjin për Trepçën, me një amendamentim të Ligjit për Trepçën ta kthejmë në situatë në të cilën këtë e shndërrojmë në ndërmarrje publike. Por, që duhet të jetë shoqëri aksionare duhet të jetë, meqë shteti duhet të jetë aksionar qind për qind, në këtë rast qytetarët e kësaj republike.

Rrjedhimisht, Partia Socialdemokrate e përkrah statutin dhe ka qenë edhe si pjesë e komisionit, e ka parë që edhe sindikatat i kanë pasur vërejtjet e tyre, të cilat janë adresuar. Pra, në këtë drejtim ne e përkrahim statutin dhe besojmë që hapi tjetër duhet të jetë rishikimi i ligjit.

**KRYETARI:** Faleminderit! Daut Haradinaj, në emër të AAK-së.

**DAUT HARADINAJ:** Faleminderit, kryetar!  
Aleanca është për.

**KRYETARI:** Faleminderit! Nisma dhe 6+? E mbështetin. Islam Pacolli, pa grup.

ISLAM PACOLLI: Kryetar, faleminderit!  
I përgëzoj të gjithë dhe AKR-ja e përkrah fuqishëm.

KRYETARI: Dukagjin Gorani nga PSD-ja e ka fjalën si deputet edhe bëhet gati Milaim Zeka. Atëherë Milaim Zeka i fundit qenka dhe përfundon.

MILAIM ZEKA: Jo, kryetar, shumë shkurt. Kurrkush sot nuk foli për çerdhe edhe aq shumë lodhur veç nuk doja që thosha futma kokën në ujë se shumë jam lodhur.

KRYETARI: Faleminderit! Më nuk ka deputetë. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën. Jemi në votim. Regjia dhe deputetët përgatiten për votim për aprovimin e Propozim-Statutit të shoqërisë aksionare Trepça sh.a. A janë të gjithë deputetët? Votojmë tash!

85 deputetë kanë votuar, 80 për, 2 kundër, 3 abstenime.

Kuvendi e miratoi statutin e shoqërisë aksionare Trepça.

Të nderuar deputetë,  
Qytetarë të Republikës së Kosovës,  
Urime për të gjitha këto vendime të cilat i ka marrë Kuvendi i Republikës së Kosovës! Me fat!  
Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance plenare.

Mirupafshim në seancat plenare të radhës!

*E përgatiti:  
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*